Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
*Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave*

WITH FUNDING FROM
AUSTRIAN DEVELOPMENT COOPERATION

# Mjaft më me arsyetime

## Analizë e qëndrimeve, incidencës dhe reagimeve institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë

Domosdo dhuna ndodh kur dikush pi alkool ose përdor drogë.

Nuk ka arsyetim për dhunën

Ne ishim duke ndërhyrë, por kam dëgjuar se gruaja e tradhtonte burrin e saj [Zyrtari policor]

Nuk ka arsyetim për mos-hetime

Disa gra meritojnë të rrahen.

Nuk ka arsyetim për dhunën, asnjëherë.

# Mjaft më me arsyetime

**Analizë e qëndrimeve, incidencës dhe reagimeve institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë**

Nga Nicole Farnsworth, Ariana Qosaj-Mustafa, Iliriana Banjska, Adelina Berisha, dhe Donjeta Morina

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
Prishtinë, Kosovë
2015

© Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, 2015

Autorët: Nicole Farnsworth, Ariana Qosaj-Mustafa, Iliriana Banjska, Adelina Berisha, dhe Donjeta Morina

ISBN 978-9951-8848-9-1

Printuar nga Night Design në Prishtinë, Kosovë

Përkthyer nga: Mars A

Ky hulumtim është financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim. Pikëpamjet e paraqitura nuk korrespondojnë domosdoshmërisht me pikëpamjet e Agjencisë Austriake për Zhvillim.

www.womensnetwork.org

# Përmbajtja

Përmbajtja ..... v

Akronimet ..... 1

Mirënjohje ..... 3

Parathënie ..... 4

Përmbledhje ekzekutive ..... 5

Hyrje ..... 7
- Metodat e hulumtimit ..... 7
- Lidhur me këtë raport ..... 8
- Shënim për terminologji ..... 8

KORNIZA LIGJORE ..... 9

Dhuna në familje dhe ligji i aplikueshëm në Kosovë ..... 9
- Dispozitat civile lidhur me aktet e dhunës në familje ..... 9
- Procedurat civile në lidhje me mbrojtjen kundër akteve të dhunës në familje ..... 10
- Aktet nën-ligjore dhe politikat për mbrojtje nga dhuna në familje ..... 12
- Dispozitat penale në lidhje me dhunën në familje ..... 17

PERCEPTIMET ..... 19

Vetëdijesimi dhe qëndrimet ndaj dhunës në familje ..... 19
- Çka mendojnë njerëzit se përbën dhunën në familje? ..... 20
- Shkaqet e perceptuara të dhunës në familje ..... 25

RRËNJOSJA ..... 31

Shkalla e dhunës në familje ..... 31
- "Një numër i errët": incidenca e dhunës në familje ..... 36
- Kryesit e dhunës në familje ..... 45
- Grupet në rrezik ..... 46
- Pasojat e dhunës në familje ..... 54

PARANDALIMI, MBROJTJA, NDJEKJA, REHABILITIMI: Reagimi institucional ..... 60
- Koordinatori Nacional kundër Dhunës në Familje ..... 62
- Policia ..... 63
- Prokuroria ..... 66
- Mbrojtësit e viktimave ..... 67
- Zyrat për Ndihmë Juridike ..... 68
- Institucioni i Avokatit të Popullit ..... 69
- Mbrojtja e dëshmitarëve ..... 69
- Procedurat civile përpara gjykatave themelore ..... 70
- Procedurat penale përpara gjykatave ..... 73
- Shërbimi Korrektues i Kosovës ..... 74
- Shërbimi sprovues ..... 74
- Qendrat për Punë Sociale ..... 75
- Strehimoret dhe OJQ-të ..... 77
- Institucionet arsimore ..... 79
- Institucionet shëndetësore ..... 80
- Qendrat e Aftësimit Profesional dhe Zyrat e Punësimit ..... 82
- Institucionet komunale ..... 83
- Koordinimi ndër-institucional: "Nëse nuk e raportoj rastin, zinxhiri shkëputet" ..... 83

Rekomandime ..... 85

Shtojca 1. Metodologjia e hulumtimit ..... 90

Shtojca 2. Monitorimi i Zbatimit të Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje 2011-2014 Korniza Logjike ..... 94

Shtojca 3. Pyetësori ..... 102
Shtojca 4. Lista e të intervistuarve ..... 116
Shtojca 5. Tregime personale të rasteve të dhunës në familje ..... 121
Shtojca 6. Gjetjet e tjera të anketimit ..... 125
Shtojca 7. Statistikat nga policia ..... 126
Bibliografia ..... 130
Shënime ..... 133

# Akronimet

| | |
|---|---|
| ABGJ | Agjencia për Barazi Gjinore |
| UA | Udhëzim Administrativ |
| ASK | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| KPK | Kodi Penal i Kosovës |
| KEDKG | Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave |
| OSHC | Organizatat e Shoqërisë Civile |
| QPS | Qendra për Punë Sociale |
| DPP | Departamenti i Punës dhe Punësimit |
| NJHDHF | Njësia e Hetimit e Dhunës në Familje |
| KEDNJ | Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut |
| EULEX | Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë |
| ZBGJ | Zyrtari për Barazi Gjinore |
| HIV | Virus i Mungesës së Imunitetit Njerëzor |
| ICITAP | Programi Ndërkombëtar i Ndihmës së Trajnimit të Hetimit Kriminal |
| IOM | Organizata Ndërkombëtare për Migracion |
| AKSP | Akademia e Kosovës për Siguri Publike |
| SHKK | Shërbimi Korrektues i Kosovës |
| IKAP | Instituti i Kosovës për Administratë Publike |
| IGJK | Instituti Gjyqësor i Kosovës |
| PK | Policia e Kosovës |
| RrGGK | Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës |
| LGBT | Lesbike Gei Biseksualë Transgjinorë |
| MKRS | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit |
| DKA | Drejtoria Komunale e Arsimit |
| MZHE | Ministria e Zhvillimit Ekonomik |
| MEF | Ministria e Ekonomisë dhe Financave (tani Ministria e Financave) |
| MASHT | Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë |
| MF/MeF | Ministria e Financave |
| MD/MeD | Ministria e Drejtësisë |
| MPMS | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale |
| MeSH | Ministria e Shëndetësisë |
| MiM | Memorandumi i Mirëkuptimit |
| MAP | Ministria e Administratës Publike |
| PNV | Plani Nacional i Veprimit |
| OJQ | Organizatë Jo-Qeveritare |
| OSBE | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë |
| PEN | Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë |
| QESH | Qendra për Emancipim Shoqëror |
| QRP | Qendra Rajonale e Punësimit |
| RTK | Radio Televizioni i Kosovës |
| SMIA | Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim |
| PSV | Procedurat Standarde të Veprimit |
| SST | Sëmundjet Seksualisht të Transmetueshme |
| UMPE | Urdhri për Mbrojtje të Përkohshme Emergjente |
| KB | Kombet e Bashkuara |
| UNDP | Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara |
| UNFPA | Fondi për Popullsi i Kombeve të Bashkuara |
| UNICEF | Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë |
| UNIFEM | Fondi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara për Gratë |
| UNKT | Ekipi i Kosovës i Kombeve të Bashkuara |

| | |
|---|---|
| UNMIK | Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë |
| USAID | Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar |
| MV | Mbrojtësi i Viktimave |
| DMNV | Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave |
| ZMNV | Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave |
| QAP | Qendra e Aftësimit Profesional |
| OBSH | Organizata Botërore e Shëndetësisë |
| WSSI | Iniciativa për Sigurinë e Grave |

# Mirënjohje

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës falënderon të gjithë ata që janë përfshirë në këtë hulumtim, si hulumtuesit ashtu edhe institucionet, të cilët nuk kursyen kohën as mendimet e tyre për këtë proces. Ky hulumtim ishte rezultat i përpjekjeve të mëdha të një ekipi hulumtues të palodhur dhe të përkushtuar: Nicole Farnsworth (hulumtuese kryesore, MSc), Ariana Qosaj-Mustafa (eksperte ligjore), dhe ndihmës-hulumtueset: Adelina Berisha, Nertila Qarri-Gërguri, Iliriana Banjska, Antonia Hoidal, dhe Donjeta Morina. Erëblina Elezaj ofroi përvojën e saj të çmuar dhe ekspertizë falas, duke ndihmuar me analiza statistikore. Kaltrina Kelmendi (Asistente, Departamenti i Psikologjisë, Universiteti i Prishtinës) me mirësi ofroi mbështetje dhe mbikëqyrje psikologjike për ekipin hulumtues dhe për respondentët e anketuar, sipas nevojës. Falënderojmë praktikantët e mëposhtëm që kanë dhuruar disa ditë apo muaj të kohës së tyre për këtë hulumtim të rëndësishëm, duke i transkriptuar të gjitha intervistat e realizuara me institucione: Alma Ademi, Dije Rizvanolli, Erleta Morina, Renea Hasani, Hana Rizvanolli, Lejla Cana, Nita Bislimi, Marigonë Vrajolli, dhe Miranda Muharremi.

Grupi Këshillëdhënës i themeluar për këtë hulumtim dhe rishikuesit bashkëmoshatarë kanë mbështetur procesin dhe kanë ofruar të dhëna të dobishme për projekt-raportin: Natasha Banfield (studente e LLM, Universiteti Ulster dhe Pika e Mëparshme e Kontaktit për Gjini, UNMIK), Këshilltarët për çështje gjinore të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), Lepa Mladjenoviç, Driton Zeqiri (sociolog), Valentina Bejtullahu-Turjaka (Zyrtare e Programit Kombëtar, Misioni i OSBE-së në Kosovë), dhe UN Women. Dëshirojmë të falënderojmë në veçanti Agjencinë për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Programin Universitar për Studime Gjinore dhe Kërkime në Universitetin e Prishtinës, Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), dhe Ekipin e Kosovës të Kombeve të Bashkuara (UNKT) Programi mbi dhunën në bazë gjinore që kanë dhënë mbështetjen e tyre gjatë tërë procesit. E falënderojmë në mënyrë të veçantë Iris Duri, në UNDP për këshillat e saj dhe mbështetjen teknike.

Shfaqim shumë mirënjohje për 46 anketuesit të cilët kanë punuar pa pushim për të përfunduar procesin e anketimit me kohë (sipas renditjes alfabetike): Adni Kukesi, Agnesa Haxhiu, Aida Gashi, Arbnora Kolgjeraj, Ardian Batusha, Bardha Çelaj, Beshir Seferi, Dafina Halili, Dardan Ahmeti, Diana Shaka, Driton Gusia, Dua Dauti Kadriu, Edon Gërbani, Egzona Azemi, Erisa Xhemajli, Fanol Ahmetaj, Fjolla Vukshinaj, Flamur Kadriu, Florent Thaci, Gyltene Osmani, Ilir Miftari, Iliriana Banjska, Jetbardha Selmani, Jeton Dukagjini, Jeton Jashari, Jovan Rikallo, Katarina Besova, Leutrim Shahini, Leyza Mripa, Luan Bajraj, Lulzim Hasari, Marina Milosevic, Mergim Gerbeshi, Mrika Rizvanolli, Nevenka Rikallo, Ramadan Sokoli, Roland Sylejmani, Shenoll Rexhepi, Srdjan Milosevic, Suzana Emini, Uran Haxhiu, Valdrin Misini, Venera Cocaj, Vesna Stajic, Vilsona Blakaj, and Yllza Xheladini. Futja e të dhënave është bërë nga Abetare Qarri, Adelina Berisha, Din Terpuni, Edona Vatoci, Elona Osmani, dhe Gentiana Halimi.

# Parathënie

Ky raport ishte gati për t'u shtypur kur mësuam për një tragjedi të re: vrasjen e Zejnepe Bytyçit-Berishës, që dyshohet të jetë therur për vdekje nga burri i saj. Familja dhe miqtë e saj, aktivistet për të drejta të grave, mediet dhe të gjithë qytetarët u përpoqën të zbulojnë arsyetimin për ushtrimin e një dhune të tillë të pakuptimtë. Ne u tronditëm edhe më shumë kur mësuam se ajo kishte kërkuar ndihmë disa herë në polici, porse kërkesat e saj kishin mbetur pa përgjigje. Progresi që ne menduam se kishim vërejtur me shkrimin e këtij raporti duket të zbehej me çdo fakt të ri që u ndriçua. Ishim të zemëruar thellë me thashethemet që dëgjuam nga përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, duke pëshpëritur prapa dyerve të mbyllura: "ndoshta ajo kishte folur me një burrë në telefon, gjë që e kishte zemëruar burrin e saj", ose "ndoshta ajo ishte e pamoralshme". Ishim të tronditur dhe të pikëlluar nga institucionet dhe shoqëria që vazhdonte ta fajësonte viktimën e një krimi. Në ASNJË rast, qoftë nga papunësia, alkooli, droga, apo tradhtia, dhuna KURRË nuk është e pranueshme. NUK KA ARSYETIM për dhunën.

Prandaj, ne kemi vendosur ta ndryshojmë titullin e raportit tonë. Duam të theksojmë se nuk ka asnjë arsyetim për dhunën në familje. Titulli flet edhe për institucionet e Kosovës: nuk ka arsyetim për mosveprim institucional ose për vonesë. Ky raport paraqet një thirrje të re për veprim për të gjitha institucionet, që t'i përmbushin përgjegjësitë e tyre për mbrojtjen e personave, të cilët kanë përjetuar dhunë në familje, veçanërisht për mbrojtjen e grave. Institucionet nuk duhet kurrë, në asnjë situatë, të tolerojnë dhunën! Siç u tha nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Ban Ki-moon "Ekziston një e vërtetë universale, e zbatueshme për të gjitha vendet, kulturat dhe komunitetet: dhuna ndaj grave nuk është asnjëherë e pranueshme, asnjëherë e falshme, asnjëherë e tolerueshme".

Ne ua kemi dedikuar këtë raport grave që kanë humbur jetën si pasojë e dhunës në familje: ndër të tjera Zejnepe Bytyçit-Berishës dhe Diana Kastratit. Ne zotohemi para familjeve të tyre se do të bëjmë gjithçka që është në fuqinë tonë për të kërkuar drejtësi, për të kërkuar ndryshime shoqërore dhe institucionale, në mënyrë që një dhunë e tillë e pakuptimtë të mos marrë jetë të tjera në të ardhmen.

# Përmbledhje ekzekutive

Dhuna në familje mbetet një ndër format më të përhapura të dhunës të ushtruar në mbarë botën. Ky raport tregon se situata në Kosovë nuk ndryshon. Ai pason hulumtimin me titull *Siguria fillon në shtëpi* të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) 2008, i cili shqyrtoi kornizën ligjore, nivelin e vetëdijesimit në lidhje me dhunën në familje, format e dhunës në familje, si dhe institucionet që ofrojnë ndihmë. Ky raport vlerëson ndryshimet në: vetëdijesimin e qytetarëve për dhunën në familje, incidencën, dhe reagimin institucional që nga viti 2008. Raporti synon të ofrojë informata për procesin e hartimit të Programit dhe Planit të ri të Veprimit kundër Dhunës në Familje të Kosovës, që do të fillojë në vitin 2016, si dhe t'u ofrojë institucioneve përkatëse rekomandime konkrete për përmirësimin e qasjes së tyre në adresimin e dhunës në familje. Ai gjithashtu shqyrton shkallën në të cilën vetëdija, qëndrimet, dhe incidenca e dhunës në familje kanë ndryshuar që nga viti 2008.

Korniza ligjore në lidhje me dhunën në familje është përmirësuar në mënyrë thelbësore që nga viti 2008. Aplikohen konventa të ndryshme ndërkombëtare dhe ligje kombëtare. Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2008) ka zënë vendin e Rregullores së Misionit të mëparshëm të Kombeve të Bashkuara të Administratës së Përkohshme në Kosovë (UNMIK). Programi i Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014, caktoi veprime për institucionet që të adresojnë dhunën në familje. Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) përcaktojnë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të veçanta, si dhe hapat për përmirësimin e koordinimit ndërmjet institucioneve kryesore që merren me dhunën në familje. Përkundër këtyre përmirësimeve, janë të nevojshme rishikime të mëtejshme të kornizës ligjore, siç jepen hollësisht në këtë raport.

Sipas monitorimit të RrGGK-së është konstatuar se është përmirësuar zbatimi i kornizës së aplikueshme ligjore përkitazi me adresimin e dhunës në familje. Megjithatë, sfidat mbeten, duke përfshirë: mosraportimin e mjaftueshëm të dhunës nga ana e qytetarëve; shërbimet joadekuate në dispozicion për personat që kanë pësuar dhunë dhe autorët e dhunës, duke përfshirë programe rehabilitimi dhe riintegrimi; qëndrueshmërinë e pamjaftueshme të strehimoreve; zbatimin e dobët të masave përmbarimore, siç janë alimentacioni i fëmijëve; disa persona të trajnuar në mënyrë joadekuate apo të dobët brenda institucioneve; burimet e pamjaftueshme njerëzore dhe financiare në disa institucione, veçanërisht në QPS; mungesën e psikologëve profesionalë; koordinimin e pamjaftueshëm mes institucioneve në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje; dhe normat gjinore tradicionale që kontribuojnë në "fajësimin e viktimës" dhe të cilat ofrojnë një mjedis të përshtatshëm për vazhdim të dhunës.

| Gjetjet kryesore | Gra | Burra | Të gjithë |
|---|---|---|---|
| Përqindja e kosovarëve që kanë përjetuar dhunë në familje në jetën e tyre | 68% | 56% | 62% |
| Përqindja e kosovarëve që kanë përjetuar një formë të dhunës në familje në vitin 2014 | 41% | 20% | 31% |
| Përqindja e atyre që kanë përjetuar dhunë fizike në vitin 2014 | 12% | 14% | 12% |
| Përqindja e kosovarëve që pajtohen se "ndonjëherë është në rregull që një burrë ta godasë gruan e tij" | 21% | 22% | 21% |
| Përqindja e atyre që pajtohen se "një Ligj kundër Dhunës në Familje ekziston në Kosovë" | 73% | 78% | 75% |
| Përqindja e atyre që mendojnë "Nëse burri është i papunë, dhuna detyrimisht do të ndodhë ndonjëherë" | 58% | 47% | 53% |

Në shqyrtimin e vetëdijes dhe qëndrimeve ndaj dhunës në familje, RrGGK-ja ka gjetur se qytetarët janë pak më të vetëdijshëm sesa ishin në vitin 2008. Për shembull, në vitin 2008, 55.7% e kosovarëve (61.8% e burrave dhe 49.7% e grave) e dinin se ekzistonte rregullorja për mbrojtje kundër dhunës në familje, ndërsa 75.3% e kosovarëve (77.6% e burrave dhe 73.1% e grave) e dinë se sot ekziston Ligji. Më shumë njerëz e konsiderojnë dhunë fizike një formë të dhunës në familje, sesa më parë në disa masa, duke përfshirë ndëshkimin e fëmijës, duke e goditur me shuplakë (81.1% e shohin si dhunë); partneri që e detyron partnerin e tij ose të saj që të bëjë akte seksuale, që ai ose ajo nuk dëshiron t'i bëjë (91%); dhe një i rritur e godet me shuplakë, grusht, apo, me shkelm një anëtar të familjes gjatë një grindjeje

(93.3%). Përqindja e kosovarëve që besojnë se "marrëdhënia seksuale kurrë nuk mund të jetë dhunë, nëse ajo ndodh midis dy të rriturve, të cilët janë të martuar", ka rënë ndjeshëm, nga 67.1% në 2008, në 24.6% në vitin 2015. Përkundër këtyre përmirësimeve në vetëdijesim, mbetet e pranishme ideja (29.9%) se "dhuna në familje është pjesë normale e çdo marrëdhënieje, dhe shoqëria në përgjithësi pranon se dhuna ndodh nganjëherë". Më tej, 31.3% e kosovarëve ende besojnë se dhuna në familje është "një çështje familjare, kështu që fqinjët nuk duhet ta raportojnë atë në polici". Në disa aspekte, njerëzit duket se janë bërë pak më konservativë. Për shembull, 21.1% e kosovarëve ende besojnë se "nganjëherë është në rregull që një burrë ta godasë gruan e tij", në krahasim me 18.7% në vitin 2008.

Shkalla e saktë e dhunës në familje në një shoqëri nuk mund të vlerësohet kurrë për shkak të raportimeve të pakta. Kështu, në lidhje me shkallën e *vlerësuar* të dhunës në familje në Kosovë, 31% e kosovarëve (41% e grave dhe 20% e burrave) thanë se ata kanë përjetuar një formë të dhunës në familje në vitin 2014, duke përfshirë atë fizike, psikologjike, ose dhunën ekonomike. Më tej, 62% e kosovarëve (68% e grave dhe 56% e burrave), thanë se kishin përjetuar ndonjë formë të dhunës në familje në jetën e tyre (e rritur nga 43% në vitin 2008). Kjo rritje nuk do të thotë domosdo se më shumë njerëz kanë përjetuar dhunë; kjo thjesht mund të jetë se njerëzit janë më të vetëdijshëm dhe të gatshëm që të flasin për dhunë, sesa në vitin 2008, pasi që këtë e sugjerojnë përgjigjet e tyre në pyetjet e tjera.

Sipas statistikave, ka gjasa që gratë të përjetojnë dhunë në familje më shumë se sa burrat. Ndërsa kosovarët kanë qenë të prirë të besojnë se dhuna ndodh më shumë në familjet e varfra, rurale ose të paarsimuara, dëshmitë e kundërshtojnë këtë. Nuk ka ndonjë marrëdhënie statistikore të rëndësishme në mes përjetimit të dhunës në vitin 2014 dhe vendndodhjes gjeografike (rurale/urbane ose rajonale), nivelit arsimor, marrjes së ndihmës sociale, të ardhurat e familjes, respektivisht të ardhurat individuale të anketuarve. Është interesante se të anketuarit, partnerët e të cilëve ishin të punësuar me paga, në të vërtetë kishin më shumë *gjasa* të përjetojnë dhunë në familje në mënyrë të konsiderueshme në vitin 2014. Ndërsa autorët e dhunës në familje ishin të ndryshëm, nënat, baballarët, dhe partnerët ishin ndër kryesit më shpesh të përmendur nga personat që kishin përjetuar dhunë. Burrat ishin të prirë që të raportojnë përjetimin e dhunës nga prindërit e tyre, ndërsa gratë pësuan dhunë edhe nga prindërit edhe nga partnerët. Ky hulumtim vërteton se dhuna në familje mund të ketë pasoja të ndryshme për shëndet, familje dhe shoqëri.

Kur u pyetën se si ata do ta trajtonin dhunën në familje, nëse do ta kishin përjetuar atë, 73.6% e të gjithë të anketuarve thanë se ata do ta kontaktonin policinë. Pak prej tyre dinin për akterët e tjerë që ofrojnë shërbime, siç janë Mbrojtësit e Viktimës (MV) ose Qendrat për Punë Sociale (QPS).

Përkundër disa përmirësimeve, të dhënat kualitative sugjerojnë një tendencë të mbetur në mesin e disa përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme për "ta fajësuar viktimën" për krimet e kryera kundër tyre ose për t'i "pajtuar" familjet. Pajtimi i familjeve nuk është pjesë e roleve dhe e përgjegjësive të shumicës së institucioneve dhe mund të minojë përgjegjësinë e tyre për të siguruar mbrojtjen apo drejtësinë. Disa përfaqësues të institucioneve ende nuk kanë njohuri në lidhje me rolet dhe përgjegjësitë e tyre sipas PSV-ve.

Institucionet që punojnë drejtpërdrejt në ndihmën e personave që kanë përjetuar dhunë në familje, siç janë policia, gjykatat, MV-të, QPS-të dhe strehimoret, duket se kanë përmirësuar reagimin e tyre. Policia është më mirë e trajnuar dhe ka tendencë të dijë detyrat e saj. Fakti se disa gjykata themelore tani kanë gjyqtarët e gjykatave civile të specializuar për rastet e dhunës në familje, është një përmirësim i rëndësishëm. Perceptimet në lidhje me performancën e MV-ve dhe QPS-ve dhe qasjen e tyre ndaj njerëzve që kanë përjetuar dhunë, ishin të përziera. Strehimoret ofrojnë disa shërbime rehabilituese, por financimi i tyre i qëndrueshëm nuk është zgjidhur ende. Institucionet e tjera, siç janë institucionet arsimore, komunat, Qendrat për Aftësim Profesional (QAP), zyrat e punësimit, institucionet shëndetësore dhe organizatat joqeveritare (OJQ) janë më pak të informuara në lidhje me dhunën në familje dhe për mënyrën sesi të trajtohen rastet e tilla.

Rekomandimet për ndryshimin e kornizës ligjore, për Planin e ri të Veprimit, dhe për çdo institucion janë të detajuara në pjesën e fundit të këtij raporti.

# Hyrje

Në vitin 2008, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) ka bërë studimin e parë për tërë Kosovën për incidencën e dhunës në familje, në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës (ABGJ), Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), dhe Iniciativën për Sigurinë e Grave (WSSI). I titulluar *Siguria Fillon në Shtëpi*, publikimi shqyrtoi nivelet e vetëdijesimit në lidhje me dhunën në familje, shtrirjen e saj dhe punën e institucioneve për të ndihmuar personat që kishin përjetuar dhunë në familje[1]. Hulumtimi gjithashtu përfshiu intervista me zyrtarët në institucionet përgjegjëse për zbatimin e kornizës ligjore që ka të bëjë me dhunën në familje. Ky studim i rëndësishëm i ofroi të dhëna Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje; Programit të Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Planit Nacional të Veprimit kundër Dhunës në Familje (PNV); dhe Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) në Kosovë për personat që kanë përjetuar dhunë në familje, të përdorur nga të gjitha institucionet.

Pasi ka kaluar shumë kohë që nga studimi bazë, dhe në kontekstin e hartimit të një dokumenti të ri të PNV-së, RrGGK pa se kishte ardhur koha për të kryer një studim pasues për të matur se sa kanë ndryshuar qëndrimet me kalimin e kohës, si dhe për të identifikuar boshllëqet e mbetura në kornizën ligjore dhe në zbatimin e saj. Më konkretisht, ky hulumtim synon: 1) të masë (ndryshimet në) qëndrime, vetëdijesim, përkatësisht incidencën e dhunës në familje në Kosovë; dhe 2) të monitorojë zbatimin e kornizës ligjore nga ana e institucioneve publike përkatëse. Çështjet kyçe që nxisin hulumtimin përfshijnë:

1. Si kanë ndryshuar qëndrimet dhe niveli i vetëdijesimit në lidhje me dhunën në familje që nga viti 2008, në qoftë se ka ndryshuar?
2. Si ka ndryshuar incidenca e formave të ndryshme të dhunës në familje që nga viti 2008, nëse ka ndryshuar?
3. Deri në çfarë mase po zbatohet korniza ligjore lidhur me dhunën në familje, dhe sa është përmirësuar kjo që nga viti 2008?
4. Cili është reagimi institucional ndaj dhunës në familje?

Nga shkurti deri në tetor 2015, RrGGK ka kryer një hulumtim që përshkohet në këtë raport, në bashkëpunim me ABGJ, Koordinatorin Kombëtar për Dhunën në Familje, UNKT, Nën-grupin punues për dhunën e bazuar në gjini të Grupit për Siguri dhe Gjini, si dhe një rrjeti të gjerë të akterëve të tjerë kyçë nga institucionet publike, akademike, dhe shoqërisë civile. Hulumtimi është financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim me vet-kontributet e rëndësishme nga disa individë të përkushtuar. [2]

## Metodat e hulumtimit

Hulumtimi përfshin metoda të përziera, në të cilat bën pjesë rishikimi i kornizës ligjore për të identifikuar boshllëqet e mbetura në të dhe zbatimin e saj; përmbledhja e të dhënave të mbledhura nga institucionet përkatëse; një studim prej 1,315 kosovarëve (51.6% gra dhe 48,4% burra) për të matur vetëdijesimin, qëndrimet, dhe rastet e dhunës në familje; dhe intervistat me përfaqësues të institucioneve publike dhe shoqërisë civile. Studimi është bërë në tërë Kosovën, duke mbuluar si zonat urbane (40.8%), ashtu edhe ato rurale (59.2%). Mostra është përfaqësuese e të gjitha grupeve etnike në Kosovë pasi që përzgjedhja është bërë duke përdorur metodën shumëshkallëshe me përzgjedhje rastësore të mostrave. Më pas, kërkuesit kanë realizuar intervista me rreth 200 përfaqësues të institucioneve dhe akterëve të tjerë përgjegjës për zbatimin e kornizës ligjore, duke përfshirë: policinë; Mbrojtësit e Viktimave (MV-të); Qendrat për Punë Sociale (QPS-të); gjyqtarët; prokurorët; përfaqësuesit e strehimoreve për viktimat e dhunës në familje; zyrtarët e ndihmës juridike; Qendrat e Aftësimit Profesional (QAP-të); Zyrat e Punësimit; Drejtoritë e arsimit në komuna; mësuesit; punonjësit e kujdesit shëndetësor; psikologët; psikiatrit; Institucioni i Avokatit të Popullit; viktimat e dhunës në familje; disa organizata të shoqërisë civile (OShC); dhe akterë të tjerë të interesuar dhe të përfshirë. Për informata të mëtejshme, luteni të shikoni shtojcën: I. Metodologjia e hulumtimit.

## Lidhur me këtë raport

Ky raport së pari shqyrton ligjin e aplikueshëm dhe kornizën e politikave në lidhje me dhunën në familje, duke përfshirë dispozitat penale dhe civile, duke identifikuar mangësitë dhe duke paraqitur rekomandime për adresimin e tyre. Pjesa e dytë shqyrton perceptimet e kosovarëve rreth dhunës në familje dhe rreth shkaqeve të saj, të cilat janë nxjerrë kryesisht nga të dhënat e studimit. Krahasimet janë bërë, aty ku kërkohet, me studimin e vitit 2008, duke identifikuar ndryshimet. Pjesa e tretë merret me përhapjen e parashikuar të dhunës në familje, duke u mbështetur kryesisht në të dhënat e studimit. Këtu përfshihet identifikimi i grupeve, që duken se janë më të rrezikuara të përjetojnë dhunë në familje. Më pas, diskutohen pasojat e mundshme të dhunës dhe reagimet e qytetarëve ndaj dhunës. Pjesa e katërt mbështetet në intervistat me institucionet dhe të dhënat e anketës, duke shqyrtuar punën e institucioneve përgjegjëse të Kosovës lidhur me parandalimin e dhunës në familje, mbrojtjen e viktimave të dhunës, sigurimin e drejtësisë për krimet e kryera, dhe ofrimin e shërbimeve për rehabilitim dhe riintegrim. Kjo pjesë identifikon përmirësimet dhe mangësitë e mbetura në reagimin institucional ndaj dhunës në familje. Në fund janë nxjerrë rekomandimet për kornizën ligjore dhe institucione të caktuara. Shtojcat përfshijnë një përshkrim më të detajuar të metodologjisë së hulumtimit (Shtojca 1); një përmbledhje e vlerësimit të RrGGK-së për zbatimin e PNV-së për 2011-2014 (Shtojca 2); instrumenti i studimit (Shtojca 3); një listë e të anketuarve për intervista (Shtojca 4); histori personale nga të anketuarit e studimit (Shtojca 5); dhe gjetje të tjera të studimit që nuk lidhen drejtpërdrejt me këtë raport, por që janë me interes (Shtojca 6).

## Shënim për terminologji

Personat që kanë pësuar dhunë në familje, sulm seksual dhe ngacmim seksual, shpesh referohen ose si “viktima” ose si “të mbijetuar”. Opinionet lidhur me terminologjinë e duhur ndryshojnë. Në disa qarqe njerëzit besojnë se, duke iu referuar personave që kanë pësuar dhunë në familje si “viktima” do të përmirësohet reagimi institucional. Të tjerë besojnë se kjo mund të shfuqizojë personat që kanë përjetuar dhunë, duke ua shuar aftësinë vepruese, dhe duke hedhur një dritë pasive mbi personat të cilët kanë përjetuar dhunë. Jo të gjithë personat që kanë përjetuar dhunë janë “të mbijetuar”, pasi që dhuna në familje mund të sjellë vdekje, si dhe trauma permanente që ndikojnë në mirëqenie. RrGGK-ja ka zgjedhur që ta shmangë termin “viktimë” përveç nëse citohet nga dokumentet ligjore, duke vendosur në vend të kësaj “personat të cilët kanë përjetuar dhunë”. Ku është relevante, përdoret fjala “e mbijetuar”, drejt njohjes së aftësisë vepruese të grave.

# KORNIZA LIGJORE
# Dhuna në familje dhe ligji i aplikueshëm në Kosovë

Pasi që dhuna mund të ndodhë në forma të ndryshme, e drejta ndërkombëtare për të drejta të njeriut parasheh se çdo shtet duhet të zhvillojë mekanizma efektivë juridikë dhe institucionalë për të reaguar ndaj akteve të dhunës në familje. Shteti është përgjegjës për veprimet e përfaqësuesve dhe të qytetarëve të tij, duke përfshirë aktet e dhunës në familje. Se si duhet t'i përgjigjen shtetet dhunës në familje, është përcaktuar në parimet e përgjithshme të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEDKG). Në Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 19 mbi dhunën ndaj grave, Komiteti KEDKG kërkon që shtetet duhet "të ndjekin me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe pa vonesa, një politikë të eliminimit të diskriminimit kundrejt grave" dhe gjithashtu "të kenë kujdes për të parandaluar, për të hetuar dhe në pajtim me ligjin nacional, të dënojnë aktet e dhunës kundër grave, pa marrë parasysh se a janë kryer këto vepra nga shteti a personat privatë" (neni 9). Komiteti i KEDKG në interpretimin e konventës, ka thënë se "shtetet mund të jenë përgjegjëse për veprimet private, nëse ato kanë dështuar së vepruari me kujdes për të parandaluar shkeljen e të drejtave ose për të hetuar dhe për të dënuar aktet e dhunës, dhe të ofrojnë kompensim". [3]

Kur shpalli pavarësinë e saj si shtet sovran, Kosova miratoi disa detyrime ndërkombëtare duke inkorporuar standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si pjesë e së drejtës së saj të aplikueshme. Kosova emëroi në mënyrë specifike konventat ndërkombëtare si KEDKG, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), si dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe protokollet e saj të zbatueshme drejtpërdrejt në ligjin e Kosovës. Kosova hoqi dorë nga zbatueshmëria e ligjeve të saj dhe aktet e tjera të institucioneve publike të saj në rastet kur ato bien ndesh me dispozitat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Kosova kështu i konsideron këto dispozita ndërkombëtare që të kenë prioritet mbi ligjet e Kosovës.[4] Më tej, Kushtetuta thekson se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore "interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".[5] Kjo gjykatë ka nxjerrë disa vendime për rastet e dhunës në familje që mund të përdoren për përmirësimin e zbatimit të dispozitave ligjore në Kosovë.

Megjithatë, zbatimi praktik i këtyre klauzolave kushtetuese rrallë është përdorur në gjykatat e Kosovës. Vetëm kohët e fundit, Gjykata Kushtetuese e Kosovës iu referua KEDKG-së në vendimin e saj të paprecedent në rastin e Diana Kastratit, duke deklaruar se vonesa për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes nga Gjykata Komunale në Prishtinë, e paraparë me Ligjin e Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, përbën shkelje të të drejtave të njeriut. Kjo shkelje ka ndikuar në mbrojtjen e të drejtës së personit për jetën dhe të drejtën për mjete efektive të garantuar me konventat ndërkombëtare dhe Kushtetutën.[6] Në instanca të tjera, në kuadër të gjykatave të ligjit, dispozita kushtetuese për zbatueshmërisë e drejtpërdrejtë të dispozitave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nuk është dokumentuar sa duhet në Kosovë.

## Dispozitat civile lidhur me aktet e dhunës në familje

E ndodhur në mjegullën e zbatueshmërisë së dispozitave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Kosova miratoi një numër të ligjeve dhe politikave për të reaguar ndaj akteve të dhunës në familje. Legjislacioni i Kosovës e përkufizon dhunën në familje në bazë të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, të miratuar në korrik të vitit 2010.[7] Ky ishte ligji i parë për dhunën në familje i miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Ligji ishte nxjerrë thelbësisht nga dispozitat në Rregulloren e mëparshme të UNMIK-ut 2003/12 mbi Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje.[8] Në mesin e ndryshimeve nga Rregullorja e UNMIK-ut, kishte një qasje të re për trajtimin e sjelljeve të dhunshme të kryesve. Ligji i vitit 2010 parasheh masën e trajtimit psiko-social dhe kërkon që Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të bashkëpunojnë për nxjerrjen e akteve nënligjore për mënyrën e zbatimit të këtyre masave. [9] Ajo

përcakton qartë rolet e ministrive përkatëse dhe përcakton infrastrukturën e duhur për të mbështetur dhe për të përmbushur nevojat e personave që kanë përjetuar dhunë në familje, duke përfshirë edhe shërbimet mjekësore dhe obligimet e ndihmës sociale.[10]

Sipas Ligjit të Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, aktet e dhunës në familje janë të definuara si akte të qëllimshme ose si mosveprime kur kryhen nga një person kundër personit tjetër me të cilin personi është në marrëdhënie familjare. Këto akte, pa u kufizuar, përfshijnë, a) përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik; b) që shkaktojnë ose kërcënojnë t'i shkaktojnë dhembje fizike dhe vuajtje psikike një tjetri anëtar të familjes; c) që shkaktojnë ndjenjën e frikës apo cenimin e dinjitetit; d) sulmin fizik; e) ofendimin, sharjen, thirrjen me emra ofendues, si dhe forma të tjera të shqetësimit të vrazhdë; f) sjelljet e përsëritura me qëllim që të përulin personin; g) aktet jokonsensuale seksuale; h) kufizimin e kundërligjshëm të lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër; i) dëmtimin e pronës apo kanosjen për ta dëmtuar pronën e një anëtari tjetër të familjes; j) vënien e personit tjetër në pozitën qe ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike; k) hyrjen apo largimin me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesën e personit tjetër; dhe l) rrëmbimin.[11]

Ligji gjithashtu ofron një përkufizim të veçantë të një "marrëdhënieje familjare" bazuar në format brenda-familjare të banimit në Kosovë. Ai thotë se marrëdhëniet e tilla që ndodhin ndërmjet personave në qoftë se ata janë "të fejuar" apo "kanë qenë" të fejuar; janë të martuar apo "kanë qenë" të martuar; janë në bashkësi jashtëmartesore apo "kanë qenë" në bashkësi jashtëmartesore; bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët ose "kanë bashkëjetuar" në një ekonomi të tillë; përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martese, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat, vëllezërit dhe motrat, hallat e tezet, xhaxhallarët e dajallarët ose kushërinjtë; janë prindër të një fëmije të përbashkët; dhe janë palë procedurale në një kontest nga marrëdhëniet familjare".[12] "Këto marrëdhënie ndërmjet personave përdoren si bazë për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes. Urdhrat e mbrojtjes ofrohen për të mbrojtur personat, të cilët kanë përjetuar dhunë në familje, të definuar si "palë e mbrojtur" ose si "viktimë" kundër akteve të dhunës në familje nga ana e kryesit.[13]

## Procedurat civile në lidhje me mbrojtjen kundër akteve të dhunës në familje

Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, në thelb, e përkufizon dhunën në familje brenda një marrëdhënie familjare me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes së viktimave nga shfaqja ose rishfaqja e akteve të dhunës në familje me lëshimin e urdhrave të mbrojtjes. Tri llojet e urdhrave të mbrojtjes përcaktohen në përputhje me autoritetin e organit që e lëshon urdhrin për mbrojtje, përmbajtjen dhe procedurat që duhet të ndiqen. Kjo përfshin llojet e masave që mund të lëshohen me urdhrat e mbrojtjes. Ligji përcakton Urdhrin për Mbrojtje, Urdhrin për Mbrojtjen Emergjente, dhe Urdhrin e Mbrojtjes së Përkohshme Emergjente.[14]

**Urdhri për Mbrojtje** mund të lëshohet vetëm nga gjykata themelore[15] ku banon viktima e dhunës në familje apo pala e mbrojtur, ose në gjykatën, e cila është duke vendosur mbi kontestet familjare siç janë rastet e shkurorëzimit ose rastet e kujdestarisë për fëmijën.[16] Urdhri për mbrojtje duhet të lëshohet brenda tetë ditësh, nëse urdhri për mbrojtje emergjente është nxjerrë, ose brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga dita në të cilën gjykata e ka marrë kërkesën për lëshimin e urdhrit për mbrojtje.[17] Ky është një urdhër afatgjatë, i cili lëshohet për një periudhë deri në dymbëdhjetë muaj me një mundësi të vazhdimit. Ai mund të përtërihet vetëm nëse ekzistojnë rrethana për lëshimin e tij pas përfundimit të afatit të vendosur.

Përkundër kësaj, ish-Rregullorja e UNMIK-ut për Mbrojtje nga Dhuna në Familje nuk e kufizonte mundësinë e vazhdimit të urdhrit të mbrojtjes, për sa kohë që rrethanat për lëshimin e tij kanë vazhduar të ekzistojnë. Rregullorja vetëm kërkonte që të mbrohej siguria, shëndeti, dhe mirëqenia e viktimës dhe për këtë arsye nëse kryerësi do të vazhdonte për ta vënë personin në rrezik, mund të lëshohej një urdhër i ri i mbrojtjes.[18] Ligji i Kosovës njeh kushtet e nevojshme për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes. Megjithatë, duke kufizuar vazhdimin e urdhrit për mbrojtje për jo me shumë se njëzet e katër (24) muaj, Ligji nuk ofron mjet efektiv juridik në rastet kur kushtet për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes ende ekzistojnë. Për shembull, nëse viktima ose pala e mbrojtur mbetet e kërcënuar

vazhdimisht nga kryerësi ose nëse siguria dhe shëndeti i tyre është ende në rrezik pas 24 muajve, ata nuk do të kenë mbrojtje. Kufizimet e tanishme të Ligjit për vazhdimin e urdhrave të mbrojtjes, pa ofruar masa alternative kur kushtet vazhdojnë, është shkelje e të drejtave të viktimave të dhunës në familje në mjet efektiv dhe mbrojtje nga ana e shtetit nga aktet e dhunës në familje. Prandaj, institucionet e Kosovës duhet të marrin parasysh urgjentisht korrigjimin e kësaj shkeljeje, të krijuar me Ligjin e ri për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

**Urdhrat për Mbrojtje Emergjente** gjithashtu lëshohen nga gjykatat themelore. Ata skadojnë në fund të seancës dëgjimore për vërtetimin e urdhrit të rregullt të mbrojtjes. Kjo periudhë nuk duhet të jetë më e gjatë se tetë ditë, të cilat caktohen me afatin e fundit për konfirmimin e urdhrit për mbrojtje.[19] Përveç kësaj, Ligji parasheh që urdhri për mbrojtje emergjente mund të vazhdohet kur brenda dy ditëve pala e mbrojtur ose përfaqësuesi ligjor kërkon vazhdimin e tij. Kohëzgjatja e urdhrit të vazhduar të mbrojtjes nuk është specifikuar në kuadër të ligjit.[20]

**Urdhri i Mbrojtjes së Përkohshme Emergjente** (UMPE) lëshohet jashtë orarit të rregullt të punës së gjykatave. [21] Organi i autorizuar për lëshimin e urdhrit për Mbrojtje të Përkohshme Emergjente është Shefi i Njësisë së Policisë Rajonale të Kosovës kundër Dhunës në Familje. UMPE-ja duhet menjëherë t'i dorëzohet kryesit të akteve të dhunës në familje.[22] UMPE skadon në fillim të ditës së ardhshme kur gjykata rifillon orarin e rregullt të punës.[23]

Ligji i Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje parasheh që masat që mund të lëshohen nga gjykatat për Urdhrin e Mbrojtjes dhe Urdhrin për Mbrojtje Emergjente, janë të pakufizuara; kërkuesit mund të kërkojnë që të vendosen të gjitha masat. Masat që mund të vendosen janë: masa mbrojtëse për trajtimin psiko-social; masa për të ndaluar kryerësin që t'i afrohet viktimës në një distancë të caktuar; ndalimin e ngacmimit të viktimës nga ana e kryesit; masa për të kërkuar largimin e kryesit nga vendi i banimit me viktimën; urdhërimi i një polici që ta shoqërojë viktimën gjatë mbledhjes së sendeve personale nga familja; urdhërimi i kryesit që t'i nënshtrohet trajtimit mjekësor për varësi nga droga dhe alkooli; ose urdhërimi i konfiskimit të armës ose sendit të përdorur në kryerjen e veprës së dhunës në familje ose sendin e përdorur për të kërcënuar për të kryer aktin.[24] Ligji më tej parasheh edhe një sërë masash mbrojtëse në lidhje me pronën, siç është urdhërimi i kryesit që të paguajë qiranë apo alimentacionin për fëmijët, në rastet kur rrezikohet siguria e fëmijëve, fëmijët duhet të mbesin me viktimën, dhe/ose viktima ka nevojë për një zgjidhje afatgjatë pas strehimit për shkak të rreziqeve shëndetësore të shkaktuara nga kryesi pasi ajo nuk mund të kthehet në familjen e përbashkët; urdhërimi i kryesit që të lejojë kthimin e viktimës në familje të përbashkët, por vetëm në rastet kur nuk rrezikohet shëndeti dhe siguria e viktimës dhe t'i ofrojë mundësinë viktimës që të përdorë mjetet dhe sendet personale; dhe ndalimi i kryesit ose palës së mbrojtur të shesë ose të asgjësojë mjetet brenda një periudhe të caktuar kohore.[25]

Ligji kufizon masat që mund të vendosen nga Policia e Kosovës përmes një UMPE për katër llojet e mëposhtme të masave: ndalimin e kryesit që t'i afrohet viktimës, ndalimin e ngacmimit të viktimës, largimin e kryesit nga banesa e përbashkët e kryesit , dhe konfiskimin e sendeve me të cilat dhuna është kryer ose është kërcënuar të kryhet.[26] Masat e parapara me këtë urdhër për mbrojtje të lëshuar nga policia janë të kufizuara për të garantuar një proces të drejtë dhe të duhur në një gjykatë të ligjit, pas skadimit të UMPE-së.

> **"Nuk më pëlqen sesi ne e heqim viktimën nga shtëpia dhe kryesi mbetet në liri, jashtë burgut. [...] Më shumë kushton financimi i strehimoreve për viktimat, sesa për të futur në burgje kryesit, të cilët tashmë janë atje."**
> 
> \- Zyrtari

Të anketuarit e intervistuar nga institucionet përmendën problemet që ata kishin me ligjin ekzistues, duke përfshirë: mungesën e zgjidhjeve afatgjata ose masave; integrimin e pamjaftueshëm të Ligjit për Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje në Kodin Penal; dhe përkthimi i dobët i ligjit në gjuhën serbe. Një çështje tjetër me Ligjin e ri, të cilën e vuri në dukje gjyqtari, është se gjuha e merr përsipër fajin e kryesve para gjykimit; kjo mund të adresohet në qoftë se ligji kishte ruajtur të njëjtën gjuhë si të Rregullores paraprake, duke iu referuar "autorëve të dyshuar".

Pas intervistave, RrGGK-ja pa se disa institucione të rëndësishme ende nuk kanë njohuri rreth Ligjit, veçanërisht në lidhje me atë se kush mund të kërkojë urdhra të mbrojtjes. Perspektivat e të

anketuarve të intervistuar ndryshonin në lidhje me zbatimin e Ligjit, ndërsa disa deklaruan se ai kishte qenë plotësisht i zbatuar, të tjerët thanë se ai ishte zbatuar pjesërisht, dhe disa të tjerë mendonin se nuk ishte zbatuar fare. Edhe kështu, tema e përsëritur, edhe pse jo unanime, ishte se zbatimi i ligjit ishte përmirësuar. Të anketuarit theksuan, për shembull, se gjykatat caktuan rastet me prioritet dhe i trajtuan ato më shpejt se në vitet e mëparshme.

**"Problemi nuk është Ligji; problem janë traditat tona dhe fakti që jetojmë në familje të mëdha e të zgjeruara. [...] Kur një grua e raporton burrin e saj, ajo vazhdon të jetojë me familjen e tij, gjë që do ta bëjë atë të përballet me më shumë dhunë sepse ata do ta akuzojnë atë [gruan] për largimin e djalit të tyre dhe ndaljen e të ardhurave [...] Ligji mund të zbatohet kur ne të fillojmë të punojmë për trajtimin e kryesve të veprave."**

- Zyrtar/e për Barazi Gjinore

Sfidat e cituara në mënyrë të përsëritur për zbatim përfshinin: vonesa në hartimin e legjislacionit dytësor; qytetarët nuk e raportojnë dhunën; hapësira të pamjaftueshme strehimi; stafi i pamjaftueshëm në institucione të veçanta; buxhet i pamjaftueshëm për zbatim;[27] mungesa e njohurive në mesin e disa zyrtarëve; zbatim i dobët i masave, siç janë alimentacioni i fëmijëve; dhe, lidhur me këtë, mungesa e kushteve në Kosovë për zbatimin e tij (p.sh., vështirësitë në ndarjen e pronës dhe familjet me shumë kurora, mungesa e shërbimeve në dispozicion për trajtimin psiko-social të kryesve të dhunës, etj).

Disa të anketuar vunë në dukje çështjet e zbatimit të masave në urdhrat e mbrojtjes, duke përfshirë identifikimin e pronës që i takonte viktimës në mënyrë që ajo të mund të kërkohet; dhe distanca që një kryes mund t'i afrohet një viktime. "Ju nuk mund të nxirrni dhjetë anëtarë të familjes jashtë shtëpisë në mënyrë që ta vendosni viktimën atje; dhe nëse viktima kthehet në familjen e burrit të saj, mundësitë janë që ajo do të përballet me dhunë në familje edhe prej tyre", komentoi një përfaqësues i një strehimoreje.[28]

## Aktet nën-ligjore dhe politikat për mbrojtje nga dhuna në familje

Ligji i Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje parasheh hartimin dhe miratimin e dy akteve nënligjore, me qëllim të adresimit të nevojave të kryesve të veprave të dhunës në familje.[29] Ministria e Shëndetësisë dhe MPMS ishin paraparë si ministri kryesore përgjegjëse për hartimin e procedurave dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme për ofrimin e trajtimit psiko-social të kryesve. Ato gjithashtu duhet të ofrojnë shërbime, kur gjykatat shqiptojnë trajtim të detyrueshëm për varësi nga alkooli dhe droga. Prandaj, janë hartuar dhe miratuar dy nënakte ligjore: Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2012 për përcaktimin e vendit dhe mënyrat e trajtimit psiko-social për kryesit e dhunës në familje dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2013 mbi metodat e trajtimit për kryesit e dhunës në familje të vendosur me masën e trajtimit të detyrueshëm nga alkoolizmi dhe varësia ndaj substancave psikotropike. Udhëzimi i parë u miratua nga Kryeministri i Republikës së Kosovës në vitin 2012 dhe ky i fundit nga Ministria e Shëndetësisë në vitin 2013.[30]

Këto akte nënligjore përqendrohen vetëm në nevojën për kryesit e varur nga alkooli dhe droga që të trajtohen nga shteti, duke identifikuar alkoolin dhe drogën si shkaqe të mundshme të akteve të dhunës në familje. Ligji thekson se nevoja për këshillim të urdhëruar nga gjykata dhe trajtimi i kryesve i ka rrënjët edhe në sjelljen psiko-sociale të kryesve të dhunës në familje. Me këtë njohje, Ligji sugjeron se sjellja e keqe psiko-sociale është shkak i dhunës në familje. Më tej, Udhëzimi Administrativ (UA) thekson se me anë të trajtimit të detyrueshëm të urdhëruar nga gjykata, do të parandalojë dukuritë e mëtejshme të dhunës në familje, të rrisë vetë-kontrollin e kryesve duke ofruar këshillim, të identifikojë origjinën e sjelljeve të dhunshme, të ngritë nivelin e përgjegjësisë së kryesve në pranimin e akteve të dhunshme.[31] Aktet nënligjore lejojnë krijimin dhe licencimin e OJQ-ve dhe agjencive qeveritare përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale për të ofruar trajtime të detyrueshme të urdhëruara nga gjykatat. Kjo përfshin ndihmën e ofruar në nivel komunal. UA gjithashtu përshkruan afatet kohore të detajuara, procedurat dhe shërbimet që ofrohen nga institucionet. Trajtimi psiko-social i kryesve mund të bëhet në bashkëpunim me viktimat në qoftë se ato pajtohen me masën e propozuar të mbrojtjes.[32] Përveç kësaj, plani i trajtimit i zhvilluar nga autoriteti shëndetësor përkatës mund të ndahet me viktimën.[33]

Ligji nuk specifikon cili autoritet shëndetësor në mënyrë eksplicite është përgjegjës. Më tej, këto masa mund të kundërshtojnë qëllimin për të mbrojtur viktimat e dhunës në familje, siç reflektohet në qëllimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.[34] Ligji kryesisht adreson nevojën për të lëshuar masa ligjore për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. UA i ri shkon përtej qëllimit të këtij Ligji, duke propozuar pajtimin midis kryesit dhe viktimës. UA nuk i kushton vëmendje të mjaftueshme mbrojtjes së personave të cilët kanë përjetuar dhunë në familje nga kryesit me probleme të shëndetit mendor apo me varësi nga droga dhe alkooli, të cilët mund të rrezikojnë shëndetin dhe sigurinë e viktimës. Në këto dhe raste të tjera, pajtimi mund të vendosë viktimën në rrezik, në kundërshtim me qëllimin e ligjit.[35] Përveç kësaj, vlerësimi i planeve të trajtimit për kryesit nga personeli adekuat mjekësor është shpjeguar në mënyrë të pamjaftueshme.

Siç japin hollësi kapitujt më vonë, pajtimi mbetet problem në Kosovë. Edhe pse Kosova nuk është e obliguar me Konventën e fundit të Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, në vijim do të jetë në përputhje me praktikat më të mira evropiane. Kjo Konventë ndalon proceset e detyrueshme alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe të dënimit.[36] Në Kosovë, dispozitat e Kodit Penal që kanë të bëjnë me dhunën në familje, Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, dhe Ligji i ri për Familje duhet të shprehin qartë se parimet e pajtimit nuk aplikohen në rastet e dhunës në familje, duke përfshirë rastet e së drejtës familjare. Më tej, vendimi për politikat duhet të deklarojë se pajtimi mund të mos përdoret si reagim ligjor ndaj dhunës në familje, por vetëm si reagim psiko-social kur ofrohet nga ekspertë profesionalë, të kualifikuar, dhe të licencuar. Avokatët, policia, prokurorët dhe gjyqtarët nuk duhet të angazhohen në përpjekjet e pajtimit.

### Programi i Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit

Në lidhje me procedurat e mbrojtjes dhe masat rehabilituese për personat që kanë vuajtur nga dhuna në familje, pak masa janë përfshirë në Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Ky ligj vetëm kërkon që qeveria të hartojë dhe të miratojë Programin e Kosovës kundër Dhunës në Familje. Programi duhet të përcaktojë "infrastrukturën e nevojshme dhe strukturat ndihmëse [...] mbështetjen dhe plotësimin e nevojave të personave ndaj të cilëve është ushtruar dhuna në familje, përfshirë këtu asistencën sociale dhe shërbimet mjekësore".

> **"Korniza ligjore duhet të rishikohet në mënyrë që viktimat e dhunës në familje të kenë një zgjidhje të përhershme, jo afat-shkurtër siç është tani."**
> - Gjyqtar i Gjykatës Komunale

Në përputhje me këtë, Qeveria përmes ABGJ-së ka hartuar dhe miratuar Programin e Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Planin e Veprimit në vitin 2011. Programi përfundoi në vitin 2014.[37] Prandaj, viktimat nuk kanë bazë të mjaftueshme nënligjore për rehabilitim dhe asistencë sociale derisa të hartohet dhe të miratohet programi tjetër. Ligji dhe dy aktet e tij nënligjore lejojnë mbështetjen e detyrueshme psiko-sociale që do të ofrohet vetëm për kryesit.[38] Të drejtat e viktimave për asistencë psiko-sociale dhe rehabilitim nuk janë të mandatuara me ligj në mënyrë të qartë. Përkufizimi dhe ndarja e trajtimeve mjekësore përkatëse, mbështetja psiko-sociale, strehimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i viktimave nuk pasqyrohen në synimin dhe qëllimin e ligjit, duke përfshirë një përshkrim të qartë të përgjegjësive për secilin institucion. Pak komuna si Gjakova, Dragashi, Prizreni dhe Gjilani, kanë miratuar planet komunale të veprimit në drejtim të zbatimit të Ligjit në nivel komunal.

Programi i skaduar i Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit ka tre objektiva strategjikë: 1) parandalimin dhe përfshirjen në mënyrë që të krijojë mekanizma efikas për parandalimin e dhunës në familje; 2) mbrojtjen, me qëllim që të krijojë mekanizma efikas për mbrojtje; dhe 3) shërbimet, me qëllim që të krijojë shërbime efikase për rehabilitimin dhe integrimin e viktimave të dhunës në familje, për të përmirësuar qasjen e tyre në shërbime, si dhe për të ngritur shërbime për kryesit në tërë Kosovën.[39] Më konkretisht, në bazë të objektivit strategjik 1, rastet e raportimit të dhunës në familje duhet të rriten; dhe politikat në nivel qendror dhe lokal në ofrimin e shërbimeve për viktimat dhe kryesit duhet të hartohen. Nën objektivin strategjik 2, duhet të ofrohet ndihmë juridike falas për viktimat dhe të ndërtohen kapacitetet e palëve të interesuara për t'u marrë me rastet e dhunës në familje për të siguruar kështu ofrimin e shërbimeve efikase për viktimat në mënyrë që të mbrohen ato mirë fizikisht. Nën objektivin strategjik 3, kapacitetet e punonjësve të shëndetësisë,

shërbimeve sociale, si dhe të personelit arsimor duhet të rriten në mënyrë që të ofrojnë shërbime efikase për viktimat; përmirësimin e mundësive ekonomike për viktimat e dhunës në familje dhe për kryesit; dhe forcimin e shërbimeve sociale për viktimat dhe kryesit e dhunës në familje. Çuditërisht, shumica e veprimeve barazojnë pozitën e personave që kanë pësuar dhunë në familje me atë të kryesve të krimit. Plani merr parasysh jo vetëm 'abuzimin me drogë apo varësinë ndaj alkoolit të kryesve si shkaqe rrënjësore të dhunës në familje, por edhe mundësitë ekonomike dhe ofrimin e shërbimeve sociale për kryesit. Mbetet të vlerësohet se si ka ndikuar barazimi i nevojave të personave, që kanë përjetuar dhunë, me ato të kryesve praktikisht në ndarjen e institucioneve 'të punës dhe vëmendja e kushtuar personave që në të vërtetë kanë përjetuar dhunë.

Probleme të tjera kanë ekzistuar me PNV-në e skaduar, lidhur me detyrimet që PNV-ja u vë institucioneve të caktuara. "Kolona Institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse" numëron disa institucione që janë përgjegjëse për zbatimin e çdo aktiviteti. Megjithatë, institucionet nuk janë gjithmonë të emëruara në mënyrë të qartë; disa janë referuar gjerësisht, siç janë "institucionet lokale dhe qendrore" ose "akterët privatë". Kjo është problematike për shkak se përgjegjësia për ta zbatuar një veprim të caktuar nuk i është caktuar një akteri apo institucioni konkret. Kjo ka krijuar një ambient në të cilin disa institucione u kanë ikur përgjegjësive, duke deklaruar se kjo nuk është në kompetencën e tyre. Lidhur me këtë, PNV-ja u jep përgjegjësi ligjore "akterëve privatë", "donatorëve", "medieve" dhe "shoqërisë civile". Kjo është problematike për shkak se këta akterë jo-shtetërorë nuk mund të jenë ligjërisht përgjegjës nga qeveria për zbatimin e PNV-së. Përderisa këta akterë nuk duhet të jenë përgjegjës të vetëm për veprimet që duhet të plotësohen nga shteti, ata ende mund të përfshihen në PNV-në e re si akterë të rëndësishëm mbështetës që ndihmojnë qeverinë. Për shembull, PNV-ja e re mund të specifikojë mekanizmat përmes të cilëve qeveria mund t'i përfshijë ata.

Një problem tjetër i rëndësishëm ka të bëjë me buxhetin e pamjaftueshëm të caktuar për zbatimin e PNV-së nga ana e institucioneve përkatëse. Për disa masa të planifikuara, kjo kontribuoi në faktin se ato nuk janë zbatuar plotësisht. Një PNV e miratuar nga qeveria nuk duhet të varet nga mbështetja e pasigurtë e donatorëve dhe OJQ-ve, por duhet të jetë në pronësinë e qeverisë, e cila duhet të vendosë mënjanë burime adekuate për zbatimin e saj. Veçanërisht, nuk ka gjasa që të gjitha aktivitetet nuk do të kenë "asnjë shpenzim", siç thuhet në PNV, dhe duhet të bëhen vlerësime më të sakta të shpenzimeve.[40]

Në fund, në PNV-në e skaduar, ekzistojnë treguesit vetëm në nivel të aktivitetit, por jo në nivelin e objektivit strategjik ose në nivelin specifik objektiv. Kjo lejon vetëm matjen e rezultateve (ndryshimeve të vogla, afat-shkurtra), ndërsa ndikimi i përgjithshëm (ndryshimeve e gjera, afat-gjata) mbeten të pamatura. Lidhur me këtë, PNV-ja nuk ka vënë baza të qarta dhe as objektiva të qartë, duke i bërë ndryshimet dhe arritjet e objektivave të vështira për t'u matur. Afatet kohore për zbatimin e objektivave të caktuara nuk janë përcaktuar, duke e bërë të vështirë për të ndjekur ndryshimet. Kështu, disa mësime mund të nxirren nga PNV-ja paraprake, në të cilat mund të bazohet procesi i hartimit të një të riu.

Rishikimi zyrtar i zbatimit të PNV-së paraprake nga ana e Koordinatorit Kombëtar nxjerr disa përfundime të ngjashme për të mbuluar PNV-në e ardhshme.[41] Rishikimi rekomandon që aktivitetet e mëtejshme duhet të realizohen për të rritur vetëdijen e strukturave gjyqësore për standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe përdorimin e praktikës gjyqësore që rrjedhë nga konventat ndërkombëtare. Gjithashtu, zbatimi i këtyre dy akteve nënligjore, të miratuara për të adresuar nevojat e kryesve të dhunës në familje, nuk ka gjetur zbatim për shkak të mungesës së plotë të infrastrukturës për të zbatuar këto akte të veçanta. Në veçanti, institucionet duhet të kërkojnë të rrisin përgjegjshmërinë e zyrtarëve profesionalë, siç janë policia, prokurorët dhe gjyqtarët për të rritur efektivitetin e tyre duke sanksionuar mungesën e tyre të përgjegjësisë, kur dështojnë në trajtimin e menjëhershëm të rasteve të dhunës në familje. Për shembull, këto krime duhet të raportohen menjëherë dhe çdo dështim për ta bërë këtë duhet të konsiderohet vepër penale në qoftë se nuk raportohet. Raporti gjithashtu gjeti se në disa raste treguesit ishin shumë të përgjithshëm dhe vështirë për t'u matur. Këto duhet të monitorohen rregullisht nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar dhe Sekretariati. Mungesa e pronësisë dhe e qëndrueshmërisë së Sekretariatit/Zyrës së Logjistikës në varësi vetëm nga donatorët duhet të jetë një nga mësimet e nxjerra nga PNV-ja. PNV-ja e ardhme nuk

duhet të varet nga mbështetja e donatorëve dhe e OJQ-ve, por qeveria duhet të ndajë mjete adekuate për zbatimin e saj.

**"Nëse më pyesni mua është zbatuar vetëm 5%. Ne nuk kemi nevojë për strategjinë e shkruar mirë. Ne kemi nevojë për strategjitë që mund të zbatohen. Strategjia është e shkruar mirë, por shteti duhet ta zbatojë atë. Ata duhet të ndajnë buxhet për implementimin e saj."**

\- Përfaqësuesi i OJQ-së

Ndërkohë, RrGGK-ja ka kryer një shqyrtim të pavarur të zbatimit të PNV-së. Përderisa disa institucione besonin se ajo ishte zbatuar, të tjerat kishin përshtypjen se është zbatuar vetëm pjesërisht ose nuk është zbatuar fare. RrGGK-ja gjeti një mungesë të përgjithshme të njohurive në mesin e shumicës së institucioneve në lidhje me Programin dhe PNV-në dhe përgjegjësitë e tyre në bazë të saj. Kjo ka të ngjarë të ketë penguar zbatimin e tij.[42] Derisa kapitujt e mëvonshëm diskutojnë zbatimin e PNV-së nga institucionet individuale dhe gjetjet e përgjithshme janë përmbledhur në Shtojcën 2, nën-seksionet e mëposhtme përmbledhin shkurtimisht gjetjet e RrGGK-së.

### *Parandalimi*

Objektivi Strategjik 1 duket se ka qenë i mirë-financuar si nga Kosova, ashtu dhe nga institucionet ndërkombëtare. Shumë fushata mediale, të edukimit dhe vetëdijesimit, duke përfshirë edhe tryeza të rrumbullakëta janë mbajtur mbi temën e dhunës në familje dhe mbi atë se si ta raportojnë atë.[43] Të anketuarit për intervista nga institucionet theksuan rolin që kanë luajtur mediat dhe OJQ-të e udhëhequra nga gratë, veçanërisht strehimoret, në rritjen e vetëdijesimit të publikut në lidhje me dhunën në familje.[44] Për shembull, MV theksoi se numri i thirrjeve në linjën e tyre ndihmëse gjithmonë ishte rritur ndjeshëm menjëherë pas fushatave të vetëdijesimit. Megjithatë, nuk dihet për asnjë analizë ndikimi për të vlerësuar shkallën në të cilën fushatat kishin rritur vetëdijen në afat të gjatë (vetëm në nivel të menjëhershëm të rezultatit). Ndoshta matja më e mirë e kësaj është ky raport, i cili sugjeron se sensibilizimi është rritur dukshëm. Për hartimin e programeve për fëmijë lidhur me dhunën në familje ka pasur më pak dëshmi. Edhe pse janë vënë në skenë disa pjesë teatrale lidhur me këtë temë, ato jo gjithmonë e kishin synim zbatimin e PNV-së. Veprimi i planifikuar për të përditësuar "bazën e të dhënave aktuale, duke përfshirë kontributin nga ana e institucioneve të tjera" nuk ka përfunduar, dhe secili institucion vazhdon të përdorë sistemin e vet.[45] Më tej, disa zyrtarë nuk i dinin përgjegjësitë e tyre në mënyrë të qartë për të mbledhur të dhënat e zbërthyera gjinore.[46]

### *Mbrojtja*

Në lidhje me objektivin e dytë, nuk ishte siguruar financimi për të kryer "studimin mbi hartën e mbulimit të shërbimeve për viktimat".[47] As komunat nuk kanë realizuar planin për të zhvilluar banimin social për strehimin dhe mbrojtjen e personave që kanë përjetuar dhunën në familje, me përjashtim të Gjakovës.[48] Ndërsa mekanizmat koordinues janë ngritur në disa komuna, mekanizmat formalë nuk ekzistojnë në të gjitha komunat me përjashtim të Koalicionit të Strehimoreve që i referohet personave të cilët vuajnë dhunën në mesin e strehimoreve. Një grup i ndryshëm i trajnimeve u organizuan për disa institucione, siç parashihet me PNV-në.

Ndërsa disa stacione policore kanë pranuar pajisje, siç ishte paraparë, të tjerët thanë se ende nuk kishin pajisje të mjaftueshme për të kryer detyrat e tyre. Të anketuarit dhanë informata të përziera në lidhje me "Sigurimin e hapësirës së mjaftueshme për palët e interesuara për të trajtuar rastet e dhunës në familje, që nga raportimi deri në gjykim". Mbështetja ndërkombëtare mundësoi krijimin e dhomave miqësore të intervistimit të fëmijëve në të paktën tetë QPS dhe shtatë stacione policore. Komunat mbështetën disa dhoma të tjera. Megjithatë, të anketuarit nga QPS-të, strehimoret, prokuroria, dhe qendrat shëndetësore folën për hapësirë të pamjaftueshme. Zyrat e ndihmës juridike përgatitën dhe shpërndanë broshura për të informuar njerëzit për të drejtat e tyre, siç ishte planifikuar.[49] Disa institucione të përfshira në trajtimin e rasteve të dhunës në familje nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi, dhe PSV-të themeluan një mekanizëm më formal për bashkëpunim midis institucioneve.[50]

*Shërbimet: "Rehabilitimi = 0"?*[51]

Një temë e përsëritur në mesin e të anketuarve ishte se mungonte veçanërisht zbatimi i objektivit të tretë, lidhur me rehabilitimin dhe riintegrimin. Sfidat kryesore përfshinin mungesën e opsioneve pas strehimores, mundësitë ekonomike të pamjaftueshme për gratë, financim të pamjaftueshëm komunal për banim social, dhe mospasje të trajtimit psiko-social për kryesit. Shumica e këtyre çështjeve lidhej me mungesën e financimit të institucionalizuar përmes linjave të përhershme buxhetore. Siç ishte theksuar në hulumtimin paraprak të RrGGK-së *Me çfarë çmimi?*, përderisa parandalimi dhe prokuroria janë financuar mjaft mirë për shkak se ata mbështeten përmes buxheteve të institucioneve ekzistuese, shërbimet nën rehabilitim, riintegrim, dhe në një farë mase mbrojtja, janë në mungesë të madhe të fondeve.[52] Pa shërbime të duhura rehabilituese dhe riintegruese, personat që kanë përjetuar dhunë janë në rrezik të dhunës recidiviste. Një përfaqësues i strehimores komentoi: "Gratë që nuk kanë punë dhe nuk kanë vend ku të shkojnë, kthehen në rrethin e dhunës së kryesit [burrit]. Ato ri-viktimizohen".

Një vështrim nga afër i veprimeve individuale të parashikuara në PNV sugjeron se disa janë zbatuar. Ministria e Shëndetësisë ka bashkëpunuar me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për të zhvilluar një protokoll mjekësor për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, që zbatohet që nga viti 2012.[53] Disa punëtorë shëndetësorë janë trajnuar.[54] Disa përfaqësues të strehimoreve, edhe pse jo të gjithë, janë trajnuar për raste klinike, Virusin e Mungesës së Imunitetit Njerëzor (HIV), dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme (SST).[55] Të paktën një trajnim është organizuar për gazetarë për raportimin e dhunës në familje, [56] edhe pse ekziston shqetësimi që mediet ende nuk raportojnë mirë për raste të tilla.[57] Trajnimi gjithashtu u mbajt për punëtorët social në QPS-të për çështjet që lidhen me dhunën në familje, shëndetësi, dhe shërbime sociale për personat me nevoja të veçanta dhe viktimat.[58] Megjithatë, si duket nuk është zhvilluar asnjë program ekonomik afatgjatë.[59] Personat që kanë përjetuar dhunë dhe që janë të strehuar në strehimore kanë qasje në ekzaminime mjekësore falas.[60] Trajnimi profesional dhe ndërmjetësimi në sigurimin e vendeve të punës gjithashtu ishte vënë në dispozicion për personat që kanë përjetuar dhunë. [61] Përderisa disa projekte të financuara nga donatorët krijuan disa të ardhura për gratë, pasi projektet u përfunduan, pak dëshmi ekzistuan për qëndrueshmëri dhe ndikim afatgjatë. Të anketuarit ishin të prirë të pajtohen se shërbimet sociale për personat që kishin përjetuar dhunë në familje nuk ishin mjaftueshëm "të ndërlidhura me programet për fuqizimin e familjes", megjithëse me disa përjashtime në disa komuna.[62] Strehimoret kishin mbështetje minimale nga MPMS-së dhe donatorët për "ofrimin e shërbimeve të rehabilitimit dhe atyre psiko-sociale,"[63] por të anketuarit ishin të prirë të mos e konsiderojnë atë të mjaftueshme për të siguruar të gjithë mbështetjen e nevojshme psikologjike për personat të cilët kanë pësuar dhunë në familje.[64]

Në pajtim me kornizën ligjore, shërbimet falas, këshillimi ligjor, dhe mbrojtja ligjore duhet të vihen në dispozicion të personave që kanë përjetuar dhunën në familje.[65] Të anketuarit kanë qenë të prirë të pajtohen se kjo ishte duke u zbatuar në bashkëpunim me MV-të dhe OJQ-të që ofrojnë ndihmë juridike falas. Megjithatë, fakti që disa nga Zyrat për Ndihmë Juridike janë mbyllur për shkak të financimit të pamjaftueshëm të qeverisë dhe OJQ-të kishin marrë raporte për persona që nuk kishin mundur të kishin qasje në ndihmë juridike falas, sugjeron se ndihma juridike nuk është në mënyrë universale në dispozicion. Zyrat e punësimit, QAP, OJQ-të, dhe programet e financuara nga donatorët, kanë kërkuar për të ofruar shërbime dhe kualifikime profesionale për personat që kanë përjetuar dhunë në familje, megjithëse shkalla në të cilën këto kualifikime korrespondonin me kërkesat e tregut të punës dhe që i çonte të mbijetuarit në sigurimin e vendeve të punës, është e paqartë. [66] Si përmbledhje, ndërsa zbatimi mund të mos jetë "0" siç është sugjeruar, ndoshta është "0.5", meqenëse është zbatuar pjesërisht.

Në përgjithësi, vlerësimi i RrGGK-së për zbatimin e PNV-së sugjeron se 70.6% është zbatuar.[67] Mësimet e nxjerra nga kjo përvojë duhet të ofrojnë të dhëna për PNV-në e re.

## Procedurat Standarde të Veprimit

Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) u miratuan nga Koordinatori Kombëtar i Kosovës kundër Dhunës në Familje në vitin 2013.[68] Ky dokument i rëndësishëm ofron hollësi për rolet ligjore dhe institucionale dhe përgjegjësitë e institucioneve të pavarura, gjykatave dhe prokurorisë.[69] Këshilli

Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, si institucione të pavarura, nuk i kanë nënshkruar PSV-të. Kjo mund të nënkuptojë se PSV-të teknikisht ndërhyjnë në pavarësinë e këtyre institucioneve.

Ndër të anketuarit e ndryshëm me të cilët RrGGK-ja ka bërë intervista, policinë, MV-të, dhe strehimoret duket të jenë më së shumti të informuar për PSV-të. Oficerët e policisë, veçanërisht ata që punojnë në Njësitë për Hetimin e Dhunës në Familje (NJHDHF), janë të trajnuar mirë në kuadër të institucionit të tyre dhe kështu ata kanë njohuri. MV-të dhe strehimoret punojnë intensivisht me rastet e dhunës në familje dhe duhet t'i njohin PSV-të mirë në mënyrë që ata të kryejnë detyrat e tyre. Ata gjithashtu ndjekin procedurat që nga fillimi në fund, sipas masës në të cilën PSV-të janë ekzekutuar në praktikë. Prokurorët, gjykatat, institucionet arsimore, QPS-të, Zyrat e Punësimit, QAP-ve, institucionet komunale, OJQ-të dhe institucionet shëndetësore nuk janë të informuar mirë në lidhje me PSV-të.[70]

Përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme duket se i konsiderojnë PSV-të të dobishme. Koordinimi me PSV-të duket se është përmirësuar, veçanërisht në komunat ku janë themeluar mekanizmat koordinues komunalë apo rajonalë. Me pak përjashtime, të anketuarit ishin të prirë të pajtohen se PSV-të janë zbatuar, edhe pse vetëm pak e dinë se çfarë janë PSV-të dhe rolet e përgjegjësitë e tyre, sipas tyre. Sfidat përfshijnë hapësirën e kufizuar në institucione për të ofruar shërbime cilësore dhe burime të kufizuara. Një oficer i policisë tha gjithashtu se formularët e paraparë që do të përdoren nga PSV-të ishin shpërndarë në të gjitha institucionet, përveç policisë. "Këto janë shumë të dobishme, sepse të ndihmojnë të mbash mend se çfarë t'i kërkosh dhe t'i thuash viktimës. [N]donjëherë për shkak të stresit mund të harrosh ndonjë gjë."[71]

## Dispozitat penale në lidhje me dhunën në familje

Kodi Penal i Kosovës (KPK) nuk ofron një përkufizim të dhunës në familje *per se* (*në vetvete)*, edhe pse një numër i veprave penale të kryera brenda një marrëdhënie familjare mund të konsiderohen për prokurori akte të dhunës në familje. Sidoqoftë, KPK për herë të parë përmend dhunën në familje në dispozitat penale të Kosovës si një përjashtim. Dy nene theksojnë "Me përjashtim të veprave penale që përfshijnë abuzimin e fëmijëve dhe dhunën në familje, personi nuk është penalisht përgjegjës .." . [72] Me fjalë të tjera, dështimi për të raportuar abuzimin e fëmijëve ose të dhunës në familje është vepër penale dhe kushdo që nuk i raporton veprat penale që ndodhin brenda një marrëdhënieje në familje mund të ndiqet penalisht.

KPK-ja parasheh ndjekje *ex-officio* (sipas detyrës zyrtare) të krimeve të lëndimeve të lehta trupore, lëndim i rëndë trupor, kushte të ngjashme me skllavërinë, puna e detyruar, përdhunimi dhe sulmi seksual, kur kryhet në marrëdhënie familjare.[73] Shkelja e urdhrave të mbrojtjes gjithashtu konsiderohet bazë për ndjekje penale sipas detyrës zyrtare, të mbuluara me Ligjin e Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.[74]

Risia e KPK-së së re, të miratuar në vitin 2012, janë përkufizimet e ofruara në përcaktimin e viktimës së ndjeshme dhe të Fondit për Kompensimin e Viktimës. "Viktimë e ndjeshme" konsiderohet një fëmijë, një person me aftësi të kufizuara fizike ose mendore, një person që vuan nga aftësia e zvogëluar, një grua shtatzënë, dhe një partner familjar.[75] Një partner familjar është nxjerrë nga përkufizimi i marrëdhënies familjare të përcaktuar si një:

> marrëdhënie ndërmjet dy (2) personave: që janë të fejuar apo të martuar apo janë në bashkësi jashtëmartesore; bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martese, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat, vëllezërit dhe motrat, hallat e tezet, xhaxhallarët e dajallarët ose kushërinjtë; ose janë prindër të një fëmije të përbashkët.[76]

Më tej, Fondi për Kompensimin e Viktimës është një fond që duhet të përdoret për të kompensuar viktimat e krimit në mënyrë financiare dhe duhet të ngrihet nga dorëzanitë e humbura dhe pasuritë e tjera të autorizuara të depozituara sipas Ligjit. Megjithatë, në praktikë nuk funksionon ky Fond i Kompensimit. Qeveria hartoi një Ligj për Kompensimin e Viktimave të Krimit të miratuar së fundmi nga Kuvendi i Kosovës.[77] Ligji për Kompensim të Viktimave të Krimit numëron të drejtën e

kompensimit për të gjitha viktimat e krimeve të dhunshme të qëllimshme dhe vartësit e tyre, procedurën e pretenduar, dhe autoritetet vendimmarrëse.[78] Sipas këtij ligji, një "viktimë e krimit" është personi të drejtat personale apo të pronësisë të të cilit janë shkelur nga një vepër penale të përcaktuar me Kodin e Procedurës Penale.[79] Ligji gjithashtu parasheh kushtet formale dhe materiale për të drejtën për kompensim, të cilat duhet të plotësohen në mënyrë të rregullt nga parashtruesi i kërkesës.[80] Megjithatë, ai trajton të gjitha viktimat e krimit pa ofruar në mënyrë specifike ndonjë trajtim të veçantë për personat që kanë vuajtur dhunën e bazuar në gjini ose dhunën në familje në veçanti. Programi për Kompensimin e Viktimave të Krimit duhet të financohet nga Ministria e Drejtësisë dhe alokimin e saj vjetor të buxhetit. Gjyqtarët duhet të parashtrojnë kompensim për viktimat. RrGGK-ja nuk ka gjetur asnjë dëshmi të kompensimit të dhënë.[81] Institucionet e Kosovës mund t'iu kenë mohuar personave që kanë përjetuar dhunë në baza gjinore realizimin e të drejtës së tyre për kompensim në praktikë, edhe pse kjo e drejtë ishte përmendur në Kodin Penal dhe Kodin Civil në të kaluarën.

Kodi Penal përcakton një numër të veprave të tjera penale të kryera në marrëdhënie familjare që mund të konsiderohet si një bazë për ndjekje penale. Megjithatë, në Kodin Penal nuk përfshihen të gjitha aktet e dhunës në familje të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Veprat penale të kryera në kuadër të marrëdhënieve familjare, të cilat janë paraparë për ndjekje në qoftë se janë kryer në marrëdhënie familjare, përfshijnë: lëndime të lehta trupore; lëndim të rëndë trupor; ngacmim; sulm; rrëmbim; shtrëngim; privim të kundërligjshëm nga liria; dhunim, duke përfshirë dhunimin martesor dhe sulmet seksuale; degradim të integritetit seksual; abuzim seksual me persona me çrregullime mendore ose emocionale ose aftësi të kufizuara në lidhje familjare; keqtrajtim apo braktisje të fëmijës; dhe akte të shkeljes së detyrimeve familjare, duke përfshirë edhe shmangien nga mbështetja e fëmijës.[82] Në lidhje me një marrëdhënie familjare, dispozitat penale gjithashtu ndalojnë mbajtjen e një personi në skllavëri, në kushte të ngjashme me skllavërinë, dhe punë të detyruar.[83]

Ndërsa të anketuarit e intervistuar ishin të prirë për të deklaruar se dispozitat e Kodit Penal që kanë të bëjnë me dhunën në familje janë duke u zbatuar, disa mendonin se ato ishin zbatuar vetëm pjesërisht, duke përmendur si probleme trajtimin e ngadalshëm të rasteve, ekzekutimin e dobët të dënimeve, nepotizmit, dhe dënimit të ulët. Disa të anketuar mendonin se ajo nuk është zbatuar fare, veçanërisht dënimet për format e ndryshme të dhunës psikologjike dhe seksuale në marrëdhëniet e brendshme, përfshirë atë ndaj fëmijëve.

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës detyron subjektet publike të raportojnë krimet që duhet të ndiqen sipas detyrës zyrtare. Kur punonjësit socialë, punonjës të kujdesit shëndetësor, ose mësues ndeshen me një rast në të cilin ata dyshojnë se ka ndodhur abuzim i fëmijëve apo dhunë në familje, veçanërisht veprat penale kundër integritetit seksual, ata duhet të raportojnë rastet menjëherë. Moslajmërimi i veprave penale gjithashtu përbën një vepër penale.[84]

Përveç kësaj, Kodi i ri i Procedurës Penale të Kosovës ka pësuar ndryshime substanciale në lidhje me të drejtat e viktimave duke rritur rolin e MV-ve për të përfaqësuar të gjitha viktimat e krimit. [85] Pasi që Kodi i ri i ka hequr të drejtën e viktimës për akuzë private, kjo masë është parë si një masë balancuese. [86] E drejta për akuzë private nga ana e viktimës është hequr nga Kodi i ri në mënyrë që të përputhet me detyrimin e shtetit që të ndjekë penalisht krimet dhe që të mbrojë qytetarët e saj. [87] Kodi i ri autorizon MV-të të përfaqësojnë të gjitha viktimat e krimit në procedurat gjyqësore. Nëse një viktimë nuk ka avokatin e tij/saj, interesat e viktimës mund të përfaqësohen nga MV-të.[88] Që nga viti 2003, MV-të kanë përfaqësuar viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje në gjykatore. Megjithatë, me Kodin e ri, pala e dëmtuar ose viktima konsiderohen të njëjtë, të përkufizuar si "personi të drejtat personale apo të pronësisë të të cilit janë shkelur apo rrezikuar nga një vepër penale". Rritja e rolit të MV-ve gjithashtu parasheh të drejtën e kërkimit në emër të viktimës të sqarimeve për dëmet dhe shumën e kompensimit të kërkuar, me anë të parashtrimit të një deklarate të thjeshtë mbi dëmet.[89] Dëmet e pretenduara mund të jenë fizike, financiare, emocionale, dhe mund të përmendin ndonjë rrethanë të ndryshuar të jetës.[90] Padia duhet të parashtrohet gjatë fazës hetimore, ose brenda 60 ditësh nga paraqitja e aktakuzës nga prokurori. Në faqen zyrtare të internetit të prokurorit të shtetit, në dispozicion është edhe një formular për kërkesat për dëmshpërblim. Ky formular jep hollësi për procedurat për deklarimin e dëmeve. Kërkime të mëtejshme janë të nevojshme se si këto ndryshime kanë ndikuar në praktikë në lidhje me rolin e zgjeruar të MV-së, duke përfshirë mbrojtjen e personave të cilët kanë përjetuar dhunë në familje.

# PERCEPTIMET
# Vetëdijesimi dhe qëndrimet ndaj dhunës në familje

Të anketuarit nga institucionet e ndryshme të intervistuara ishin të prirë të pajtohen se që nga viti 2008, në mesin e qytetarëve dhe institucioneve, është përmirësuar vetëdijesimi në lidhje me dhunën në familje, të paktën pjesërisht. Të tjerët nuk pajtoheshin, duke menduar se njerëzit akoma nuk e kuptojnë dhunën në familje dhe format e saj të ndryshme. Disa të intervistuar shprehën shqetësimin se grupeve të caktuara demografike, siç janë gratë dhe personat me aftësi të kufizuara, u mungon vetëdija dhe njohuritë në lidhje me dhunën në familje. Përderisa këto gjetje janë të bazuara në përshtypje të institucioneve, kjo pjesë shqyrton rezultatet aktuale të studimit në mbarë Kosovën, duke siguruar informata më të sakta në lidhje me vetëdijesimin e qytetarëve dhe qëndrimet ndaj dhunës në familje.

Të dhënat e studimit tregojnë se situata është përkeqësuar në atë se 21.1% e kosovarëve besojnë se "nganjëherë është në rregull që një burrë ta godasë gruan e tij", në krahasim me 18.7% në vitin 2008. [91] Siç ilustron Grafiku 1, në mesin e personave të gjinive të ndryshme kanë ndodhur ndryshime të vogla. Në vitin 2015, një përqindje pak më e lartë e burrave pajtohen apo deri diku pajtohen (20,1%), se është në rregull që një burrë ta godasë gruan e tij, në krahasim me vitin 2008 (16.9%).[92] Në të njëjtën kohë, përqindja e njerëzve që nuk pajtohen apo deri diku nuk pajtohen me këtë deklaratë ka rënë nga 83.3% në 2008 në 77.6% në vitin 2015. Për më tepër, 22% e grave pajtohen apo deri diku pajtohen se është në rregull që një burrë ta godasë ndonjëherë gruan e tij. Ndryshe nga burrat, perceptimet e grave kanë mbetur mjaft të qëndrueshme me kalimin e kohës. [93] Kjo gjetje në fjalë sugjeron një potencial në rritje për dhunë në mesin e burrave.

Grafiku 1. Ndonjëherë është OK që burri ta godas gruan e tij




Siç u përmend, që nga studimi i vitit 2008, është miratuar Ligji i ri për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, duke i zënë vendin Rregullores së mëparshme të UNMIK-ut për Mbrojtjen Kundër Dhunës në Familje. Në vitin 2008, 55.7% e kosovarëve (61.8% e burrave dhe 49.7% e grave) u pajtuan apo disi u pajtuan se një rregullore e tillë ekzistonte, ndërsa 9.7% nuk besonte se ajo ekzistonte dhe 34.4% nuk e dinin (shih Grafikun 2). Në vitin 2015, njohuria duket se është përmirësuar; 75.3% e kosovarëve (77.6% e burrave dhe 73.1% e grave) pajtohen se ekziston një Ligj për Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje.

Megjithatë, 9.2% e kosovarëve nuk mendojnë se një ligj i tillë ekziston dhe 14.4% nuk janë të sigurt. Kjo sugjeron se është e nevojshme ngritja e mëtejshme e vetëdijes.




## Çka mendojnë njerëzit se përbën dhunën në familje?

Grafiku 3 tregon disa lloje të dhunës që mund të ndodhin brenda marrëdhënies familjare. Kontrollimi se ku një anëtar i familjes mundet ose nuk mundet të shkojë është një formë e dhunës psikologjike që mund të përfshijë dhunën fizike ose edhe dhunën ekonomike. Megjithatë, vetëm 44.7% e kosovarëve e konsiderojnë kontrollin e lëvizjes së një personi një formë të dhunës. Më shumë burra (46%) dhe të anketuar rural (47%) sesa gra (44%) dhe të anketuar urban (42%) pajtohen se kjo është një formë e dhunës në familje.[94]

Në lidhje me format e tjera të dhunës psikologjike, 72.7% e kosovarëve e konsiderojnë dhunë thirrjen me emra fyes të një anëtari të familjes apo sharjet e një anëtari të familjes. Të anketuarit shqiptarë kanë më shumë gjasa sesa të anketuarit serbë apo pakicat e tjera etnike të besojnë se duke e thirrur me emër fyes një anëtar të familjes apo duke sharë një anëtar të familjes është një formë e dhunës në familje.[95] Moslejimi i një tjetër anëtari të familjes që të punojë jashtë shtëpisë është dhunë për 74.3% e të anketuarve. Ka më shumë gjasa që shqiptarët ta konsiderojnë këtë dhunë sesa serbët ose anëtarët e grupeve të tjera etnike që jetojnë në Kosovë. Të anketuarit me nivel më të lartë të të ardhurave kanë një probabilitet më të lartë që ta konsiderojnë dhunë në familje "moslejimin e një anëtari të familjes që të punojë jashtë shtëpisë".[96] Kërcënimi për të lënduar një tjetër anëtar të familjes konsiderohet një formë e dhunës nga 86.6% e kosovarëve. Gratë kanë më shumë gjasa sesa burrat ta konsiderojnë këtë dhunë në familje, ashtu si të anketuarit me nivel më të lartë të të ardhurave. Shqiptarët e konsiderojnë këtë dhunë në familje, ndërsa pjesëtarët e grupeve të tjera etnike jo.[97]



Grafiku 3. Përceptimi për atë se cilat ndërveprime paraqesin dhunë në familje
Nuk e di
Jo, kjo nuk është dhunë
Po, kjo është dhunë
0%
10%
20%
30%
40%
50%
60%
70%
80%
90%
100%
Ngacmimi/prekj a e një anëtari të familjes në mënyrë seksuale pa pëlqimin e atij personi
Të gjithë 2.3% 3.3% 93.0%
Burra 3.0% 4.3% 90.8%
Gra 1.7% 2.3% 95.2%
Një person i rritur që i bie me shuplakë, e godet apo e shkelmon një anëtar të familjes kur debatojnë
Të gjithë 1.5% 4.3% 93.3%
Burra 1.9% 4.2% 92.4%
Gra 1.2% 4.4% 94.1%
Një partner i cili e detyron partneren e tij/saj të bëjë veprime seksuale të cilat ai/ajo nuk i dëshiron
Të gjithë 4.0% 3.6% 91.0%
Burra 5.0% 3.4% 89.8%
Gra 3.2% 3.8% 92.2%
Ndëshkimi i fëmijës duke i rënë me rrip apo me shkop
Të gjithë 2.1% 7.4% 89.7%
Burra 2.6% 7.5% 88.5%
Gra 1.5% 7.4% 90.8%
Kërcënimi i një anëtari të familjes me lëndim
Të gjithë 3.4% 8.8% 86.6%
Burra 3.7% 10.2% 84.2%
Gra 3.2% 7.4% 89.0%
Ndëshkimi i fëmijës duke i rënë me shuplakë
Të gjithë 2.6% 15.5% 81.1%
Burra 2.9% 12.4% 83.3%
Gra 2.3% 18.5% 78.9%
Ndikimi mbi një person me aftësi të kufizuara se me kë të martohet
Të gjithë 7.0% 15.6% 76.5%
Burra 6.8% 16.8% 75.2%
Gra 7.2% 14.4% 77.8%
Mos lejimi i një anëtari të familjes që të punojë jashtë shtëpisë
Të gjithë 5.2% 19.5% 74.3%
Burra 6.8% 18.8% 72.7%
Gra 3.6% 20.2% 75.9%
Sharja e anëtarëve të familjes
Të gjithë 4.6% 21.9% 72.7%
Burra 6.2% 19.3% 73.3%
Gra 3.0% 24.5% 72.2%
Kontrolli se ku mund të shkojë një anëtar i familjes/e ku jo
Të gjithë 8.6% 45.8% 44.7%
Burra 10.6% 42.4% 45.5%
Gra 6.6% 49.0% 43.9%

Dhuna fizike ka tendencë të konsiderohet më shpesh një formë e dhunës në familje, duke përfshirë edhe ndëshkimin e një fëmije duke e goditur atë (81.1%); ndëshkimin e një fëmije duke e goditur atë me rrip ose shkop (89.7%); duke e detyruar partnerin të bëjë akte seksuale që ai ose ajo nuk dëshiron të bëjë (91%); duke e ngacmuar ose prekur një anëtar të familjes në mënyrë seksuale pa pëlqimin e atij personi (93%); dhe duke e goditur me shuplakë, me grusht, apo shkelm një anëtar të familjes, gjatë një grindjeje (93.3%). Të anketuarit shqiptarë e konsiderojnë këtë të fundit një akt të dhunës në familje, ndërsa serbët dhe pjesëtarët e pakicave të tjera etnike nuk janë të prirë ta konsiderojnë atë dhunë.[98] Në lidhje me abuzimin fizik të fëmijëve, të anketuarit më të rinj dhe të anketuarit shqiptarë kishin më shumë gjasa të pajtohen që ndëshkimi i një fëmije me të goditur është dhunë në familje.[99]

Ka qenë një marrëdhënie statistikore e rëndësishme në mes të gjinisë dhe nëse të anketuarit e konsiderojnë si formë të dhunës në familje ngacmimin ose prekjen e një anëtari të familjes në mënyrë seksuale pa pëlqimin e atij personi. Gratë (96%) kishin më shumë gjasa sesa burrat (92%) ta konsiderojnë këtë një formë të dhunës në familje. Më tej, të rinjtë, shqiptarët, dhe të anketuarit me nivel më të lartë të të ardhurave ishin më të prirë ta konsiderojnë këtë dhunë në familje.[100] Edhe pse pjesa më e madhe e të anketuarve konsiderojnë se kur një partner e detyron partnerin e tij/saj të bëjë akte seksuale që ai/ajo nuk dëshiron t'i bëjë, është një formë e dhunës në familje, nuk kishte marrëdhënie statistikore të rëndësishme në mes gjinisë dhe nëse i padituri kishte mbajtur këtë besim. Shqiptarët (në krahasim me pjesëtarët e bashkësive etnike jo-serbe) dhe të anketuarit me nivel më të lartë të të ardhurave kishin më shumë gjasa që ta konsiderojnë këtë dhunë në familje.[101]

Siç ilustrohet në Grafikun 4, disa perceptime në lidhje me çfarë përbën dhunë në familje nuk kanë ndryshuar në thelb që nga viti 2008, siç janë ngacmimi ose prekja e një anëtari të familjes në një mënyrë seksuale pa pëlqimin e atij personi; goditja me shuplakë, grusht, apo shkelm e një anëtari të familjes nga një i rritur gjatë një zënke; ose, ndëshkimi i fëmijës me goditje me rrip ose shkop. Shumica dërmuese e kosovarëve vazhdojnë t'i identifikojnë këto si forma të dhunës. Në thelb, më shumë njerëz tani e konsiderojnë dhunë në familje ndëshkimin e një fëmije me goditje me shuplakë (nga 61.3% në 81.1%) ose ndikimin në një person me aftësi të kufizuara me kë të martohet (nga 35.9% në 76.5%). Më tej, duket se ka pasur një rritje të lehtë në përqindjen e popullsisë që e konsiderojnë si dhunë kërcënimin me lëndim të një anëtari tjetër të familjes (nga 86.6% në 91.6%); dhe një partner që detyron partnerin e tij ose të saj të bëjë akte seksuale që ai ose ajo nuk dëshiron t'i bëjë (nga 87% në 2008 në 91% në vitin 2015).

## Grafiku 4. Krahasimi i perceptimeve mes viteve 2008 dhe 2015 mbi atë se cilat ndërveprime respondentët mendojnë se paraqesin dhunë në familje



Disa pikëpamje lidhur me dhunën seksuale duket se kanë ndryshuar ndjeshëm në vitet e fundit. Në vitin 2008, 67.1% e kosovarëve janë pajtuar se "marrëdhënia seksuale kurrë nuk mund të jetë dhunë nëse ajo ndodh midis dy të rriturve të cilët janë të martuar", ndërsa 24.6% pajtohen me këtë deklaratë në vitin 2015 (shih Grafikun 5). Një përqindje pak më e lartë e burrave nuk pajtoheshin me këtë deklaratë (63.7%) sesa gratë (56.4%), edhe pse marrëdhënia statistikore është e parëndësishme.

**Grafiku 5. Marrëdhënia seksuale asnjëherë nuk mund të konsiderohet si dhunë nëse ndodhë midis dy personave të moshës madhore të cilët janë të martuar**




Në anën tjetër, siç ilustrohet në Grafikun 4 më lart, njerëzit duket se janë bërë më konservatorë në lidhje me të kuptuarit e tyre të shumicës së formave të dhunës ekonomike dhe psikologjike. Derisa 78.7% e të anketuarve konsideronte një formë të dhunës moslejimin e një tjetri anëtar të familjes të punojë jashtë shtëpisë në vitin 2008, tani 74.3% e konsiderojnë këtë një formë të dhunës. Përqindja e njerëzve që e konsiderojnë të drejtuarit në mënyrë fyese anëtarëve të familjes apo sharja e ndonjë anëtari të familjes si një formë të dhunës ka rënë nga 77.9% në 2008 në 72.7% në vitin 2015, ashtu si përqindja e njerëzve që besojnë se kontrolli ku një anëtar i familjes mund ose nuk mund të shkojë është dhunë (nga 46.4% në 44.7%).[102]

## A konsiderohet ende çështje e turpshme, personale?

Shumica e kosovarëve besojnë se dhuna në familje është një sjellje e turpshme; 88.3% pajtohen se "çdo burrë që godet gruan e tij duhet t'i vijë turp për veten e tij". Megjithatë, një përqindje e vogël e popullatës (8.2%) vazhdon të besojë goditja e gruas është në rregull. Në vitin 2008, 82.1% e të anketuarve u pajtuan se "nëse fqinjët dinin se në një familje ka dhunë brenda, ata do ta konsideronin këtë të turpshme". Kjo tregon kufizimet shoqërore që pengojnë raportimin e dhunës në familje, pasi që njerëzit nuk donin të ndihen të turpëruar në shoqëri të fqinjëve të tyre. Ky besim duket se ka ndryshuar në një masë, pasi që më pak kosovarë (67.1%) pajtohen me këtë deklaratë në vitin 2015. Kjo tregon se më pak njerëz e konsiderojnë dhunën në familje "të turpshme" që të dëgjohet ose të flitet për të, krahasuar me vitin 2008. Burrat ende duket të kenë më shumë të ngjarë se gratë që ta konsiderojnë dhunën në familje të turpshme, edhe pse shumë burra i kanë ndryshuar mendimet e tyre që nga viti 2008 (shih Grafikun 6).[103]

**"Njerëzit flasin më hapur për dhunën në familje. Nuk është më fshehtësi familjare."**
- Zyrtar për Barazi Gjinore




> **"Nëse dëgjoni zhurmë të madhe te fqinjët, ju mund ta thirrni policinë, por është më mirë që t'i leni ta zgjidhin ata vetë."**
> - Një grua e moshës 43 vjeçare, Malishevë

Ideja se "dhuna në familje është një pjesë normale e çdo marrëdhënieje, dhe shoqëria në përgjithësi pranon se dhuna ndodh ndonjëherë" mbetet e pranishme (29.9%). Më tej, 31.3% e kosovarëve ende besojnë se dhuna në familje është "një çështje familjare, kështu që fqinjët nuk duhet ta raportojnë atë në polici". Kjo mund të jetë ndër faktorët që kontribuojnë në mos-raportim. Në të vërtetë, presioni i familjes për të mbajtur çështjet "brenda familjes" bëri që disa gra të durojnë dhunën.[104] Siç kujtoi një i anketuar: "Një grua raportoi një rast të përdhunimit martesor. Ne e inkurajuam atë për ta ndjekur çështjen në institucionet përkatëse, por ajo nuk pranoi ta bëjë këtë për shkak të presionit nga familja e saj."[105]

Shumica e kosovarëve (88.9%) pajtohen se "kryesit e dhunës në familje janë fajtorë dhe duhet të dënohen me ligj", ndonëse 7.2% nuk pajtohen. Megjithatë, 61.7% e kosovarëve besojnë se "nëse ka dhunë në familje, gruaja duhet të shkojë në strehimore apo te familja e saj, ndërsa burri duhet të qëndrojë në shtëpi, derisa çështja të zgjidhet".

## Shkaqet e perceptuara të dhunës në familje

> **ÇFARË E SHKAKTON DHUNËN NË FAMILJE**
>
> **"Morali: Është vështirë të mbahet nga gratë, prandaj ato krijojnë probleme".** – Një grua, 39 vjeçare, Prizren
>
> **"Kur personi më i vjetër në familje [burri] nuk vendos rregulla/urdhra".** - Një grua, 42 vjeçare, Prizren
>
> **"Burrat shkojnë me gra tjera, i shpenzojnë të hollat, nuk kujdesen për fëmijët, etj.".**
> – Një burrë, 64 vjeçar, Kamenicë
>
> **"Sepse gruaja nuk mund ta mbushë kupën dhe mos të pajtohet me burrin e saj".** - Një grua, 52 vjeçare
>
> **"Varet nga tradita ku është zhvilluar familja".**
> - Një grua, 43 vjeçare, Ferizaj

Perceptimet e njerëzve se pse dhuna në familje ndodh mund të mos jenë shkaqe të sakta apo reale. Ashtu siç sugjeron titulli i këtij raporti, asnjëherë nuk ka ndonjë arsyetim për dhunën në familje. Edhe kështu, është e rëndësishme për të kuptuar besime të përbashkëta në mënyrë që ato të mund të adresohen përmes përpjekjeve për rritjen e vetëdijesimit. Siç ilustron Grafiku 7, shkaqet më shpesh të cituara të dhunës në familje janë papunësia (identifikuar nga 67.2% e të anketuarve) dhe lidhur me këtë, gjendja e keqe ekonomike brenda një familjeje (63.4%). Për 52.3% të burrave (vetëm 27.8% e grave), alkooli është shkaktari kryesor i dhunës në familje. Burrat (36.5%) gjithashtu konsiderojnë mungesën e arsimimit, martesën kundër vullnetit

(34.3%), dhe traumat nga lufta në Kosovë (33.7%) si shkaqet kryesore të dhunës. Një përqindje e lartë e grave konsiderojnë se grindjet apo mosmarrëveshjet që bëhen shumë intenzive (33.8%), janë arsye kryesore për dhunën në familje. Megjithatë, një pyetje e veçantë në studim sugjeron se më pak kosovarë besojnë se "është e natyrshme që dhuna fizike ndodh ndonjëherë kur një çift fjaloset" se sa në vitet e mëparshme; 31.8% e të anketuarve pajtohen me këtë deklaratë në vitin 2015, në krahasim me 35.2% në vitin 2008. Si duket nuk ekziston dallim i madh midis grave dhe burrave.[106]




Pak njerëz e konsiderojnë martesën e hershme (13.6%), kulturën apo traditën (12.2%), familjet e mëdha që jetojnë së bashku në hapësirë të pamjaftueshme (11.9%), ose nevojën për të disiplinuar anëtarët e familjes (7.3%) si shkaqe të dhunës në familje. Përveç këtyre opsioneve të ofruara në studim, të anketuarit shtuan xhelozinë nga partnerët, tradhtinë bashkëshortore, sëmundjet mendore, drogën dhe bixhozin si shkaqe të tjera të mundshme të dhunës në familje. Shkaqe të tjera më pak të përmendura të perceptuara përfshijnë: modën (p.sh., minifunde), mungesën e moralit, mungesën e informatave të grave në lidhje me të drejtat e tyre, kompleksin e inferioritetit, emancipimin e pamjaftueshëm të grave (dhe e kundërta, emancipimi i grave), teknologjinë (p.sh., dhuna në televizion, duke përfshirë edhe telenovelat), mungesën e dashurisë mes çifteve, pozitën e pafavorshme të grave në shoqëri, pasurinë e tepruar, naivitetin, dhe mungesën e fëmijëve. Perceptimet në lidhje me shkaqet

kryesore të dhunës në familje nuk kanë ndryshuar shumë që nga viti 2008, edhe pse në vitin 2015 një përqindje e lartë e të anketuarve kishin prirje të pajtoheshin me çdo arsye të mundshme.

### Situata ekonomike dhe papunësia

Kur përfaqësuesit e intervistuar të institucioneve reflektuan mbi shkaqet e besuara të dhunës në familje, temat e përsëritura ishin: "shkaqet ekonomike", papunësia, dhe kushtet e vështira sociale. Më tej, më shumë se gjysma e popullsisë (52.6%) duket se beson se "në qoftë se një burrë është i papunë, dhuna është e destinuar të ndodhë ndonjëherë". Më shumë gra pajtohen me këtë deklaratë (58%) sesa burra (47%).[107] Në përgjithësi, përqindja e popullsisë që u pajtua me këtë deklaratë, ka rënë pak që nga viti 2008, kur u pajtuan 62.4% e të anketuarve.

Grafiku 8. Nëse një burrë është i papunë, dhuna është e pashmangshme ndonjëherë




Megjithatë, dëshmitë tregojnë të kundërtën e këtyre perceptimeve. Siç komentoi një i anketuar: "Njerëzit mendojnë se dhuna në familje ndodh vetëm në zonat rurale dhe në familjet e varfra, por kjo nuk është e vërtetë. Kjo ndodh edhe në mesin e intelektualëve me pozita të larta".[108] "Të dhënat e anketës vërtet kundërshtojnë besimin e rëndomtë se papunësia çon në dhunë. Në veçanti, të anketuarit partnerët e të cilëve ishin të punësuar me paga kishin në të vërtetë më shumë gjasa të përjetojnë dhunë në familje në vitin 2014. [109] Ky raport tregon se kur partneri është i punësuar, dhuna prapë se prapë do të ushtrohet. Duhet të theksohet se kur kufizohet mostra vetëm me gra, raporti në mes të përjetimit të dhunës dhe statusit të punësimit të partnerit bëhet statistikisht i parëndësishëm.

Përderisa papunësia apo një situatë e vështirë ekonomike mund të mos e shkaktojë dhunën në familje, varësia financiare e grave ndaj burrave mund ta bëjë të vështirë për ta lënë një situatë të dhunshme në shtëpi dhe e vendos gruan para rrezikut të dhunës së vazhdueshme në familje.[110] Në Kosovë, vetëm 21.1% e grave marrin pjesë në tregun e punës në krahasim me 61.8% të burrave.[111] Asnjë vend tjetër në Evropë nuk ka kaq pak gra që marrin pjesë në tregun e punës, si në Kosovë.[112] Më pak se 10% e bizneseve janë të udhëhequra nga gratë dhe vetëm 3% e kredive shkojnë për gratë meqenëse ato kanë tendenca të posedojnë më pak kolateral se burrat, duke zotëruar diku rreth 8-10% të të gjithë pasurisë.[113] Drejtori i Drejtorisë për Mirëqenie Sociale shpjegon:

> Unë besoj se gratë janë të varura nga burrat dhe për aq kohë sa ato janë të varura, ato as nuk guxojnë t'i raportojnë rastet. Ka edhe raste kur ato nuk dinë se ku të raportojnë, por kryesisht nuk guxojnë të raportojnë një rast për shkak se babai i familjes u thotë atyre: "Ju jeni të

martuara. Ne nuk kemi mjete për të ju mbështetur. Tani ju keni edhe fëmijë. Ju keni jetën tuaj. Ju duhet t'i nënshtroheni burrit tuaj vetëm për të pasur bukën e gojës".[114]

Disa të anketuar për intervista vunë në dukje mungesën e zgjidhjeve afatgjata, duke përfshirë strehimin dhe mirëqenien ekonomike, si arsye kryesore pse gratë nuk raportojnë dhunën. Të tjerët theksuan se sigurimi i pavarësisë ekonomike të grave mund tu mundësojë atyre që të largohen nga situatat e dhunshme në shtëpi: "Ne kemi nevojë për më shumë qendra ditore të kujdesit afër vendeve të punës për gratë që të jenë në gjendje të gjejnë punë dhe të jenë ekonomikisht të pavarura nga burrat".[115] Prandaj, përderisa çështjet ekonomike nuk *shkaktojnë* dhunë në familje, ato mund të kontribuojnë në pamundësinë e grave që ta raportojnë dhunën ose të largohen nga situata të dhunshme në shtëpi.

## Alkooli dhe droga

Mundësia që alkooli dhe droga të shkaktojnë dhunën në familje është parparë në kuadër të kornizës ekzistuese ligjore dhe është bazë për disponueshmërinë e masave në kuadër të urdhrave të mbrojtjes për trajtimin e kryesve për alkoolizëm dhe abuzimin e substancave psikotrope. Më pak kosovarë besojnë se "është e natyrshme që dhuna familjare ndodh pasi dikush pi alkool" në vitin 2015 (33,9%) sesa në vitin 2008 (43%). Pak më shumë gra (37.1% e grave) sesa burra (30.5%) u pajtuan se alkooli shkakton dhunën në familje.[116]




## "Gratë e kërkojnë vetë": Norma sociale dhe kulturore, duke përfshirë edhe patriarkatin

Ishte një besim në mesin e pak të anketuarve se gratë duhet të respektojnë burrat e tyre. Dështimi i tyre për ta bërë këtë do të kontribuonte në dhunën në familje. Siç tha një i anketuar:

**"Gratë duhet të jenë më të kujdesshme, sepse nuk është e njëjta gjë: të jesh në shtëpinë e burrit apo në shtëpinë e babës. Nëse punon burri dhe mban familjen, gruaja duhet ta dëgjojë atë".**
- Grua, mosha 44, Obiliq

Gruaja duhet të jetë e bindur. Ajo duhet të kujdeset për bashkëshortin dhe fëmijët e saj. Ajo nuk duhet të krijojë situata që burri të ngrit dorë kundër saj. Ajo nuk është në shtëpinë e saj. Ajo është në shtëpinë e burrit. Kjo është arsyeja pse ajo duhet të mbajë kokën e saj ulur. "Më parë, burri im më rrihte kur jam fjalosur me të apo me nënën e tij, kur dreka nuk ishte gati, apo kur fëmijët bënin probleme. Kur ishim më të moshuar nuk ka pasur dhunë, por ka pasur fyerje. Burri im ka vuajtur nga diabeti, kështu që unë është dashur ta mbaja të disponuar. Kur ai ishte i shqetësuar, unë largohesha nga shtëpia derisa ai qetësohej. Një grua duhet të dijë vendin e saj.

Ajo duhet të dëgjojë fjalën e burrit të saj. Nuk ka nevojë për shtëpitë e grave. Gratë duhet të heshtin".[117]

Një i anketuar tjetër ka komentuar se "60-70% e grave meritojnë të rrihen".[118] Përderisa, besimet e tilla duket të mos jenë të përhapura në Kosovë, komentet e lartpërmendura tregojnë se ende ekzistojnë pikëpamje të tilla.

Sipas traditës shqiptare, nuset e reja brenda familjes duhet të kryejnë pjesën më madhe të gatimit, pastrimit dhe përkujdesjes brenda familjes (shih Grafikun 10). Në vitin 2008, 62.4% e të anketuarve (64.3% e burrave dhe 70.4% e grave), besonin se "nuset e reja do të duhej të kishin më shumë përgjegjësi për pastrim dhe gatim se sa anëtarët e tjerë të familjes". Në vitin 2015, 43.4% e të anketuarve (42.3% e grave dhe 44.6% e burrave) u pajtuan me këtë deklaratë, duke sugjeruar një rënie të mbizotërimit të kësaj tradite. Edhe pse kështu, marrëdhëniet e pushtetit brenda familjes, ku gratë e reja kanë më pak rol në vendimmarrje mbesin të përhapura. Të anketuarit e studimit gjithashtu vunë në dukje se dhuna në familje mund të rezultojë nga ajo që "vjehrrat nuk kanë marrëdhënie të mira me nuset e tyre".

Grafiku 10. Nga nuset e reja pritet që të kenë më shumë përgjegjësi për pastrim dhe gatim sesa nga anëtarët tjerë të familjes




Shumë shoqëri imponojnë role të veçanta gjinore për gratë dhe burrat në lidhje me mënyrën se si ata duhet të "sillen". Stereotipet gjinore shpesh kontribuojnë në zgjedhje dhe mundësi të kufizuara në jetë për gratë në lidhje me arsimimin, punësimin, dhe shëndetin. Diskriminimi në baza gjinore ndikon në atë se si gratë janë të pozicionuara brenda shoqërisë, duke ndikuar në përfshirjen e tyre sociale, politike, dhe ekonomike. Patriarkati i referohet sistemit social të një shoqërie (e përhapur në Kosovë dhe në shumicën e shoqërive në botë), në të cilën burrat kanë tendencë të fitojnë më shumë pushtet se sa gratë. Jo vetëm burrat përforcojnë një sistem patriarkal; siç ilustrojnë citatet e lartpërmendura, gratë shpesh promovojnë normat tradicionale të shoqërive patriarkale. Pa trajtuar patriarkatin, pabarazitë gjinore në shoqëri, dhe pushtetin mashkullor si shkaqe thelbësore, është vështirë të adresohet dhuna në familje. Në të vërtetë, disa të anketuar të intervistës konsideruan kulturën, mentalitetin, dhe/ose familjet patriarkale si shkaqe të dhunës në familje.

### Kush i merr vendimet brenda familjes?

Varësisht se kush merr vendime brenda një familje mund të tregojë marrëdhëniet e pushtetit që ekzistojnë brenda familjes dhe cilët anëtarë të familjes mund të jenë më të rrezikuar nga dhuna si rezultat i këtyre marrëdhënieve të pushtetit. Se kush merr vendime mbi çështjet financiare brenda një familje, mund të sinjalizojë shkallën në të cilën anëtarët e tjerë të familjes kanë fuqi vendimmarrëse. Kjo mund të tregojë për një potencial për dhunë ekonomike ose psikologjike. Hulumtimi i RrGGK-së i vitit

2008 tregoi se gratë nuk marrin pjesë në vendimmarrje në familje në të njëjtën masë si burrat, dhe njësitë familjare kosovare ende janë kryesisht të udhëhequra nga burrat.[119] Në vitin 2015, burrat mbetën vendimmarrësit primar në përafërsisht një të tretën e familjeve të Kosovës.[120]

Më tej, mënyra si familjet trajtojnë konfliktet brenda saj mund të shërbejë si një tregues nëse familja mund të jetë e prirë për të zgjidhur mosmarrëveshjet duke përdorur dhunën. Siç ilustron Grafiku 11, në qoftë se dikush tjetër në familje nuk pajtohet me "vendim-marrësin", afërsisht gjysma e familjeve kosovare bëjnë një diskutim dhe pastaj marrin një vendim së bashku. Përafërsisht 32% e familjeve (35% e burrave të anketuar dhe 28% e grave të anketuara), kanë thënë se "asgjë" nuk ndodh nëse dikush nuk pajtohet me "vendim-marrësin". Kjo sugjeron se mospajtimi me vendim-marrësin nuk ka asnjë ndikim çfarëdo qoftë në vendimin që është marrë përfundimisht. Me fjalë të tjera, anëtarët e familjes mund të kenë pak ndikim në vendimet e marra.

Dhjetë për qind e kosovarëve (14% e grave dhe 6% e burrave) kanë thënë se vendim-marrësi zemërohet në qoftë se dikush nuk pajtohet; pesë për qind (8% e grave dhe 2% e burrave) kanë thënë se vendim-marrësi u bërtet personave të cilët kundërshtojnë; dhe një për qind (kryesisht gra) kanë thënë se vendim-marrësi mund të lëndojë fizikisht personin i cili kundërshton. Dy për qind e grave kanë deklaruar në mënyrë eksplicite se "nuk mund të kundërshtojnë" lidhur me atë se çfarë vendim-marrësi vendos.

**"Askush nuk mund të thotë asnjë fjalë".**
– Burrë, mosha 29, Zveçan

**"Unë duhet të bindem. Çfarëdo që thotë ai bëhet".**
– Grua, mosha 53, Skenderaj

**"Unë çdoherë pajtohem me bashkëshortin tim. Nuk dua të shkaktoj probleme".**
– Grua, mosha 58, Dragash

**Grafiku 11. Çka ndodhë nëse dikush nuk pajtohet ose debaton me vendimmarrësin(it)**




Në përfundim, për disa çështje të tilla si dhuna ndaj fëmijëve, dhuna fizike dhe dhuna seksuale, vetëdijesimi publik duket se është përmirësuar që nga viti 2008. Në fusha të tjera që kanë të bëjnë me dhunën ekonomike dhe psikologjike, kosovarët duket se janë bërë pak më konservatorë. Perceptimet se papunësia, gjendja e rëndë ekonomike, alkooli, arsimi i pamjaftueshëm, mospajtimet dhe kultura që kontribuojnë në dhunën në familje, mbesin mjaft të përhapura. Mesazhe më të qarta duhet të jepen mbi atë se asnjëherë nuk ka asnjë justifikim për dhunën në familje. Një vetëdijesim me shënjestër në rritje të vetëdijesimit nevojitet për të edukuar më tej qytetarët rreth të drejtave të tyre dhe format e mbrojtjes në dispozicion.

# RRËNJOSJA
# Shkalla e dhunës në familje

Përfaqësuesit e institucioneve ishin të prirë të pajtohen se dhuna në familje mbetet e përhapur në Kosovë. Në vitet 2008 dhe 2015, të anketuarve të hulumtimit iu kërkua të vlerësonin përhapjen e dhunës në familje në qytezën apo qytetin e tyre. Përderisa perceptimet e shkallës së dhunës në familje nuk reflektojnë domosdoshmërisht përhapjen *reale* në një vend të caktuar, ato mund të jenë të dobishme për të kuptuar shkallën në të cilën njerëzit mendojnë se dhuna në familje është problem në komunitetin e tyre. Ato gjithashtu mund të shërbejnë si një matës për dhunën që ndodh rreth të anketuarve. Më tej, nëse të anketuarit besojnë se dhuna në familje ndodh në të gjitha familjet, ajo sinjalizon se dhuna ka shumë të ngjarë që po ndodh në familjen e tyre, edhe pse ata nuk është e thënë t'ua thonë këtë intervistuesve.

Në Grafikun 12, shiritat me pika tregojnë shtrirjen e dhunës në familje që të anketuarit besojnë se ekziston në komunitetet e tyre. Më shumë pika brenda shiritit tregojnë besimin se më shumë raste të dhunës ekzistojnë brenda komuniteteve të tyre. Kështu shiriti më i errët me pika tregon përqindjen e njerëzve që besonin se dhuna në familje ndodh në çdo familje në qytezën apo qytetin e tyre, ndërsa shiriti bosh tregon përqindjen e njerëzve që mendonin se nuk ka dhunë. Përqindja e mbetur e mostrës jo e përfaqësuar në mënyrë vizuale thanë se nuk e dinin.

**Grafiku 12. Përceptimet lidhur me prevalencën e dhunës në familje në qytezën apo qytetin e respondentëve**




Duke mbledhur përqindjet brenda shiritave individualë deri në shiritin më të errët, mund të vërehet se 49.1% e kosovarëve në vitin 2015, në krahasim me 52.3% në vitin 2008, besojnë se dhuna

po ndodh në një ose më shumë familje brenda qytezës ose qytetit të tyre. Edhe në vitin 2008 edhe në 2015, një përqindje më e lartë e grave duket se besojnë se dhuna po ndodh në më shumë familje se sa burrat.[121] Në vitin 2015, një përqindje më e lartë e burrave (36.5%), tha se dhuna në familje nuk ka ndodhur fare në qytezën apo qytetin e tyre, në krahasim me përqindjen e grave që besonin në mënyrë të ngjashme (23.8%).

Grafiku 13 ilustron përqindjen e të anketuarve, gra dhe burra, të cilët kanë dëgjuar njerëzit në të njëjtën familje duke i bërtitur njëri-tjetrit në vitin 2014, përkatësisht në vitin 2008. Gjetjet janë paraqitur në një mënyrë të ngjashme me grafikun paraprak me më shumë pika që tregojnë dhunën shtesë në familje të dëgjuar që po ndodh. Këtu pikat i referohen shpeshtisë me të cilën të anketuarit i kanë dëgjuar njerëzit në të njëjtën familje t'i bërtasin njëri-tjetrit, ku kategoritë fillojnë nga një deri në katër herë në vit për çdo ditë. Pjesa e fundit e shiritit përsëri i referohet përqindjes së njerëzve të cilët kurrë nuk dëgjuar njerëz në të njëjtën familje të çirren në njëri-tjetrin në vitin e kaluar. Të anketuarit mund t'i jenë referuar çjerrjes brenda familjes së tyre ose në një familje tjetër.

**Grafiku 13. Në vitin 2014, sa shpesh ju personalisht keni parë ose dëgjuar persona nga e njëjta familje duke i bërtitur njëri tjetrit?**




**"Pothuajse çdo javë unë dëgjoj zhurma të forta nga banesa në katin e poshtëm si njerëz që përplasen në mobile ose enët duke u hedhur. Zakonisht kjo është e shoqëruar nga shumë ulërima dhe britma, dhe pastaj, më vonë, me rënkime ose të qara."**

Gjithsej, 37.4% e kosovarëve (45.4% e grave dhe 29.2% e burrave), kishin dëgjuar njerëzit në të njëjtën familje duke i bërtitur njëri-tjetrit të paktën një herë në vitin 2014. Kjo paraqet një rënie në krahasim me vitin 2008, kur 52.1% e kosovarëve raportuan se kishin dëgjuar njerëzit duke i bërtitur njëri-tjetrit të paktën një herë në vit përpara.[122] Një përqindje më e lartë e grave (64.1%) në krahasim me burrat (61.1%) raportojnë se kanë dëgjuar anëtarët e familjes duke i bërtitur njëri-tjetrin në vitin 2014, si dhe se ato kanë dëgjuar më shpesh se burrat. [123] Kjo mund të jetë pjesërisht kështu për shkak të faktit se gratë

priren të kalojnë më shumë kohë në shtëpi, ku ato mund të kenë më shumë gjasa që të dëgjojnë fqinjët apo anëtarët tjerë të familjes duke bërtitur, ndërsa burrat ka më shumë gjasa të jenë në punë gjatë ditës.[124]

Më pak të anketuar raportuan se kanë dëgjuar ose potencialisht kanë qenë dëshmitarë të dhunës fizike, dhe përqindja e njerëzve të cilët besonin se ata dëgjuan apo panë dhunë potenciale gjithashtu ka rënë pak që nga viti 2008. Siç tregon Grafiku 14, gjithsej 22.6% e kosovarëve (25.9% e grave dhe 19.2% e burrave), thanë se kishin parë ose dëgjuar zhurmë të madhe në vitin 2014, sikurse dy anëtarë të familjes të ishin duke e goditur apo shtyrë njëri-tjetrin. Në vitin 2008, 31.1% e të anketuarve kishin dëgjuar zhurma të tilla gjatë vitit paraprak. Në vitin 2015, një përqindje më e madhe e grave sesa e burrave kishte raportuar se kishin dëgjuar zënka të tilla.[125] Një përqindje edhe më e vogël e të anketuarve (10.7%, duke përfshirë 7.9% të burrave dhe 13.4% të grave) thanë se personalisht kishte parë një grua që kishte mavijosje, sikur dikush ta kishte goditur atë në vitin 2014. Edhe kjo ka rënë në krahasim me 13.1% të të anketuarve që kishin parë ndonjëherë një grua me mavijosje në vitin 2008 (10.1% e burrave dhe 16% e grave).

Grafiku 14. Në vitin 2014, sa shpesh ju personalisht keni parë ose dëgjuar zhurma të mëdha, të tilla si kur dy anëtarë të familjes po rriheshin me njëri-tjetrin




Tridhjetë e dy për qind (39.2% e grave dhe 24.6% e burrave) kanë thënë se e njihnin të paktën një familje në të cilën dhuna ushtrohej në vitin 2014. Kjo ishte një rritje e lehtë në krahasim me vitin 2008, kur 30% e grave dhe burrave të intervistuar raportuan se dinin për familje ku dhuna në familje kishte ndodhur vitin e mëparshëm.

Grafiku 15. Përqindja e respondentëve të cilët njihnin familje ku ka pasur dhunë në familje në vitin e fundit, sipas numrit të familjeve të cilat ata i njohin dhe gjinisë së respondentit




Më konkretisht, 384 të anketuar në vitin 2015 (29.2%) kanë dhënë informacion demografik në lidhje me njerëzit që ata i njihnin personalisht të cilët përjetonin dhunë në familje. Gati dy herë më shumë gra (255), sesa burra (129) të anketuar, përmendën raste të dhunës në familje. Kjo mund të dëshmojë se ka gjasa se gratë mund të jenë pika e parë e kontaktit për personat që vuajnë nga dhuna. Rritja nga 2008 edhe mund të sugjerojë se rritja e vetëdijesimit ka rezultuar në më shumë persona të cilët kanë përjetuar dhunë të kenë folur për të me miqtë e tyre të ngushtë, veçanërisht gratë.

Në mesin e personave për të cilët të anketuarit e dinin se janë duke vuajtur nga dhuna, 40 (10.4%) ishin burra, 321 ishin gra (83.6%), dhe 23 të anketuar përmendën edhe burrat edhe gratë. Personat për të cilët anketuarit e dinin që po përjetonin dhunë në familje ishin kryesisht të rritur (74%). Dymbëdhjetë për qind ishin të moshës 51 e sipër, 9% adoleshentë, dhe 5% fëmijë. Personat që përjetonin dhunë kishin nivele të ndryshme të shkollimit: nga asnjë vit shkollë (47 persona) me shkollë fillore (120), me shkollë të mesme (74), dhe universitet (25). Tetëdhjetë për qind ishin të papunë (veçanërisht gratë), 18% ishin të punësuar, dhe 2% punonin si bujq, por nuk merrnin asnjë të ardhur (shiko Grafikun 16).

Grafiku 16. Statusi i punësimit të personave për të cilët dihet se vuajnë nga dhuna




Grafiku 17 ilustron llojet e dhunës së përjetuar nga personat të njohur nga të anketuarit, të ndarë sipas gjinisë së personit që vuante nga dhuna. Bazuar në njohuritë e të anketuarve, shumica e njerëzve që ata i njihnin duket se vuanin nga dhuna fizike (312 persona) dhe dhuna psikologjike (260).

Grafiku 17. Llojet e dhunë në familje të cilat i kanë përjetuar personat të cilët njihen nga respondentët



Megjithatë, ata gjithashtu përmendën raste të personave që përjetonin dhunë ekonomike (80) dhe dhunë seksuale (33). Njerëzit mund të vuajnë nga më shumë se një formë e dhunës.

Kryesit e dhunës, siç raportohet nga të anketuarit, kryesisht kanë qenë partner i personit që ata e njihnin (296 të anketuar). Kryerësi i dytë më i shpeshtë ishte babai i personit të cilin të anketuarit e njihnin (78). Kryesit e tjerë të dhunës përfshinin të bijtë (24), vjehrrat (17), vjehrrit (17), vëllezërit (16), nënat (15), kunetërit (14), kunatat (8), nipat (4), nuset (4), dhe vajzat (3).

**Grafiku 18. Personat të cilët kanë ushtruar dhunë ndaj personit të njohur**




Si rezultat i dhunës së pësuar, të anketuarit thanë se personat që ata i njihnin ishin ballafaquar me disa probleme, duke përfshirë: probleme psikologjike (228 njerëz të njohur nga të anketuarit), lëndime trupore (214), një paaftësi për t'u kujdesur për fëmijët e tyre (41), mendimet e vetëvrasjes (34), dhe një paaftësi për t'u kujdesur për veten e tyre (32) (shih Grafikun 19). Njerëzit që vuajnë nga dhuna kishin ndërprerë edhe shkollimin e tyre (12) dhe nuk ishin në gjendje të punonin (8), çka potencialisht ka ndikuar në situatën e tyre ekonomike. Katër të anketuar njihnin njerëz që ishin vrarë dhe kishin vdekur si pasojë e dhunës në familje.

**Grafiku 19. Cilat kanë qenë rezultatet negative të dhunës mbi personin e njohur?**




Mekanizmat që kanë përdorur personat që kanë pësuar dhunë për t'u marrë me këtë dhunë, bazuar në përgjigjet e të anketuarve, janë përmbledhur në Grafikun 20. Shumica e të anketuarve thanë se personat që vuajnë dhunë e kanë përballuar atë duke biseduar me anëtarët e familjes (117), duke u

tërhequr në vetvete dhe duke mos folur me të tjerët (94), duke informuar policinë (80), duke folur me miqtë (71), duke shkuar te mjeku (46), dhe/ose duke e lënë shtëpinë për një kohë për të jetuar diku tjetër (42). Disa të anketuar thanë se personi që ata e njihnin ishte i ndarë ose i shkurorëzuar nga kryerësi (35). Disa të tjerë gjithashtu kishin folur me këshilltarët (31) dhe/ose kishin shkuar në strehimore (16).

**Grafiku 20. Si e përballon ai person dhunën ose si e zvogëlon dhimbjen që i shkaktohet?**




Megjithëse këto informata demografike dhe të tjera në lidhje me personat që vuajnë nga dhuna nuk janë domosdoshmërisht përfaqësuese të popullsisë së njerëzve që vuajnë dhunën në familje, kjo jep informata të rëndësishme në lidhje me rastet aktuale në Kosovë sot që mund të mos jenë raportuar tek autoritetet.

## "Një numër i errët": incidenca e dhunës në familje

Raportimi i dhunës në familje ka tendencë të jetë i ulët kudo në botë.[126] Siç komentoi një i anketuar: "Ka një 'numër të errët' të rasteve të dhunës në familje që kurrë nuk raportohen".[127] Rastet e qarta të raportuara në institucione nuk janë përfaqësuese të shtrirjes së dhunës në familje, sepse jo të gjitha rastet raportohen. Edhe pse shkalla në të cilën rastet raportohen nuk paraqet një pasqyrë të saktë, është interesante që të monitorohet deri në çfarë mase rastet raportohen në institucione. Kur krahasohen me incidencën e vlerësuar aktuale (të paraqitur më poshtë), kjo mund të hedhë pak dritë mbi shkallën në të cilën dhuna në familje raportohet në institucione. Kjo është interesante si një shenjë e shkallës në të cilën qytetarët u besojnë institucioneve ose ndjehen rehatshëm duke raportuar dhunën.

**"Në përgjithësi, unë besoj se qytetarët janë më të vetëdijshëm për të raportuar dhunën, por edhe ka një rritje të konsiderueshme në besimin ndaj policisë".**
- Zyrtari policor, NJHDHF

**"Gratë në ditët e sotme janë më të vetëdijshme për të drejtat e tyre. Ato raportojnë më shumë. Nuk është si ka qenë dikur kur gratë kishin frikë madje të flasin edhe me prindërit e tyre".**
– Infermiere

Një koment i përsëritur i bërë nga të anketuarit e intervistuar ishte se raportimi ishte rritur në Kosovë. "Dhuna në familje është një nga aktet më të rënda në Kosovë në këtë moment," tha një MV. "Si ta them këtë? Ajo është si kanceri për shoqërinë". Të anketuarit ia atribuuan raportimin e rritur përmirësimit të vetëdijesimit rreth të drejtave dhe si të raportohet, veçanërisht në mesin e grave, përmirësimit të besimit në institucione, në veçanti në polici; dhe përmirësimit në masat mbrojtëse në dispozicion për personat që kishin përjetuar dhunë. Pavarësisht disa përmirësimeve, disa ende mendonin se "ende ekziston mentaliteti tradicional se çka ndodh në familje duhet të mbahet brenda familjes", siç u evidentua më tej nga gjetjet e studimit të lartpërmendur të RrGGK.[128] Në vijim, ndërsa

raportimi në polici duket të ketë pasur një rritje të lehtë në mes të vitit 2011 dhe 2014, raportimi nga vitet e mëparshme (p.sh., 2002-2006) ka rënë. Tabela 1 ilustron numrin e rasteve të dhunës në familje të trajtuara nga institucione të ndryshme.[129]

**Tabela 1. Numri i rasteve të raportuara të dhunës në familje në institucione të ndryshme**

| Viti | Policia | Prokuroria | KGJK Procedura e krimeve | DMNV/ ZMNV | MPMS (strehimi) | Zyrat e Ndihmës Juridike[130] | QPS |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2001 | N/A | | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A |
| 2002 | 1273 | | N/A | N/A | N/A | N/A | N/A |
| 2003 | 1251 | | N/A | 314 | N/A | N/A | N/A |
| 2004 | 1318 | | N/A | 414 | N/A | N/A | 223 |
| 2005 | 1370 | | 72 | 592 | N/A | N/A | 380 |
| 2006 | 1371 | | 73 | 703 | N/A | N/A | 438 |
| 2007 | 1077 | | 74 | 645 | N/A | N/A | 170 |
| 2008 | 1034 | | 2795 | 610 | 290 | 36 | 247 |
| 2009 | 1080 | | N/A | 654 | 225 | 20 | 92 |
| 2010 | 944 | | N/A | 627 | 229 | 76.5 | 229 |
| 2011 | 1046 | 524 | N/A | 739 | 267 | 76.5 | 226 |
| 2012 | 1026 | 736 | 596 | 868 | 241 | 60 | |
| 2013 | 1087 | 4290 | 330 | 892 | 268 | 17 | |
| 2014 | 1179 | 6036 | 196 | 391 | 281 | 23 | |
| 2015 | 460 (qershor) | | 159 | | | 5 | |

**"Dhuna në familje ka ndodhur edhe para luftës, dhe ajo ende po ndodh edhe tash. Tani ne dëgjojmë më shumë për të, por kjo është për shkak se ne kemi më shumë qasje në informata dhe jemi më të vetëdijshëm për këtë".**
- Punëtor social

Hulumtimi i RrGGK-së i vitit 2008 me 1,256 gra dhe burra tregoi se 43% e kosovarëve (46% e grave dhe 39.6% e burrave), kishin përjetuar ndonjë formë të dhunës në familje në jetën e tyre. Në vitin 2015, studimi i dytë zbuloi se 62% e kosovarëve (68% e grave dhe 56% e burrave) kanë vuajtur nga dhuna në familje në jetën e tyre. Çfarë ka ndryshuar? RrGGK-ja ia atribuon këtë ndryshim përmirësimit të njohurive në mesin e të anketuarve në lidhje me atë çfarë përbën dhunë në familje; më shumë hapje brenda shoqërisë në diskutimin e dhunës në familje; dhe një metodë e përmirësuar e hulumtimit, e cila në vitin 2015 përfshiu një pyetësor krejtësisht anonim që shoqërohej me pyetje ballë për ballë. Ky i fundit u ka mundësuar të anketuarve të deklarojnë në mënyrë anonime se çfarë forma të dhunës ata kishin vuajtur. Prandaj, RrGGK-ja beson se shkalla e dhunës nuk është rritur aq ndjeshëm sa duket, por më tepër të anketuarit ishin më të rehatshëm në deklarimin se a kishte ndodhur.

Një faktor tjetër për t'u marrë parasysh është përkufizimi i dhunës në familje. Se si përkufizohet dhuna në familje bën një ndryshim në mënyrën se si është matur përhapja e saj. Çdo matje e një forme të dhunës në familje në Grafikun 21 kombinon disa tregues të ndryshëm të dhunës në familje, të diskutuara në pjesët në vijim.

**Grafiku 21. Përqindja e kosovarëve që kanë përjetuar dhunë në familje gjatë jetës së tyre**




Ndërsa grafiku paraprak shqyrtoi dhunën në familje që ka ndodhur gjatë periudhës së jetës, një matje më e mirë afatshkurtër e ndryshimeve në incidencë me kalimin e kohës është përqindja e popullsisë që ka përjetuar dhunë në familje në vitin e kaluar. Përderisa, për fat të keq RrGGK-ja e neglizhoi përfshirjen e kësaj mase në hulumtimin e vitit 2008, kjo mbikëqyrje është adresuar në hulumtimin e vitit 2015. Grafiku 22 tregon se në vitin 2014, 31% e kosovarëve (41% e grave dhe 20% e burrave), pësoi një formë të dhunës në familje. Dhuna psikologjike ishte forma më e përhapur me 30% të popullsisë që e ka përjetuar atë, edhe pse më shumë gra (41%) sesa burra (20%). Dymbëdhjetë për qind e popullsisë ka pësuar dhunë fizike, duke përfshirë 14% të grave dhe 12% të burrave. Tetë për qind përjetuan dhunë ekonomike (11% e grave dhe 5% e burrave). Dhuna seksuale, e cila gjithashtu ka tendencë të jetë ndër format më pak të raportuara të dhunës, preku 7% të popullsisë dhe vetëm pak më shumë gra se burra.




Pjesët në vijim hyjnë më në detaje në format e ndryshme të dhunës në familje.

## Dhuna Psikologjike

**"Kur flasin për dhunën, njerëzit ende mendojnë vetëm për dhunë fizike. Por askush nuk flet për dhunën psikologjike, e cila ndodh gjatë gjithë kohës."**
- Zyrtar për Barazi Gjinore

Sipas Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, dhuna psikologjike mund të përfshijë, por nuk kufizohet në, presion psikologjik, kërcënim të shkaktojë vuajtje psikologjike, sjellje që përulin personin tjetër, duke shkaktuar ndjenja të frikës apo cenimin e dinjitetit, kërcënim për dëmtimin e pronës së viktimës, dhe forma të tjera të pasigurive të shkaktuara nga kryesit.[131] Dhuna psikologjike tradicionalisht është konsideruar më e parëndësishme ose më pak serioze, sidomos kur krahasohet me dhunën fizike.[132] Mes viteve 2000 dhe fundit të qershorit 2015 në polici u raportuan 80 raste të "shkaktimit të ndjenjës së frikës, rrezikut personal dhe kërcënimit të dinjitetit". Për më tepër, 51 raste të dëmtimit të pronës apo kërcënimit me dëmtim të pronës; dhe 28 raste të një anëtari të familjes që kërcënon të shkaktojë dhembje fizike dhe vuajtje psikike janë raportuar në polici. [133] Sigurisht që nuk është raportuar e gjithë dhuna dhe kjo pjesë përdor të dhënat e hulumtimit për të vlerësuar shkallën e dhunës psikologjike në Kosovë.




Një formë e dhunës psikologjike që thuhet se ekziston tradicionalisht në Kosovë është kur anëtarët e familjes bëjnë presion në çifte që të kenë më shumë fëmijë. Megjithatë, përhapja e kësaj mund të jetë në rënie. Në vitin 2008, 8.7% e të anketuarve (11.5% e grave dhe 5.7% e burrave), thanë se ata kishin qenë nën presion që të kenë më shumë fëmijë se sa ata dëshironin. Në vitin 2015, kjo ra në 4.9%. Tre herë më shumë gra kanë thënë se ato ishin nën presion në krahasim me burrat (7.4% e grave

dhe 2.3% e burrave). Interesante, kur u pyetën se kush u bëri presion atyre, shumica e të anketuarve thanë se ato i bënin presion vetes (64). Kjo mund të rezultojë nga procesi më i gjerë i shoqërizimit, presioni shoqëror, dhe/ose obligimet që ato i mendojnë, madje edhe pa vetëdije. Të anketuarit e tjerë thanë se partnerët e tyre (44), prindërit (19), vjehrrit (13), dhe anëtarët e tjerë të familjes (6) kishin bërë presion te ata.

RrGGK-ja përdori tri pyetje të ndryshme për të vlerësuar nëse të anketuarit kishin pësuar dhunë psikologjike në jetën e tyre dhe/ose në vitin e fundit (2014). Këto përgjigje janë dhënë në mënyrë anonime. Grafiku 24 tregon përqindjen e grave dhe burrave që kanë përjetuar dhunë psikologjike.

Afër 20% e të anketuarve thanë se anëtarët e familjes i kishin sharë ata në fëmijërinë e tyre, vetëm gjashtë për qind thanë se dikush i kishte sharë ata në vitin e kaluar. Ndërsa 9.2% e të anketuarve raportuan se kanë anëtarë të familjes që i kontrollon ata se ku mund ose ku nuk mund të shkojnë në vitin 2014, një përqindje thelbësisht më e lartë e grave (12.9%) thanë se lëvizja e tyre ishte kontrolluar në krahasim me burrat (5.3%).

Pak të anketuar thanë se një anëtar i familjes i kishte kërcënuar se do t'i lëndojë ata apo një të afërm të tyre në vitin e fundit (3%). Disa gra gjithashtu raportuan se anëtarët e familjes i kishin sharë ato (23), duke kontrolluar lëvizjet e tyre (29), dhe duke i kërcënuar kur ato ishin shtatzënë (7).

Grafiku 24. Përqindja e grave dhe burrave që kanë përjetuar dhunë psikologjike në jetën e tyre




Gjithsej, 17.7% e kosovarëve treguan se ata kishin vuajtur ndonjë formë të dhunës psikologjike nga anëtarët e familjes në vitin 2014. Një përqindje ndjeshëm më e lartë e grave (26.6%) sesa e burrave (8.4%) thanë se kishin përjetuar dhunë psikologjike. Grafiku 25 tregon se sa shpesh ata raportuan që kishin përjetuar dhunë.

Grafiku 25. Në vitin 2014, anëtarët e familjeve të respondentëve sa shpeshë kanë bërtitur, sharë apo i kanë bërë respondentët që të ndihen shumë keq



## Dhuna ekonomike

Përqindja e personave të cilët raportuan se kanë përjetuar forma të ndryshme të dhunës ekonomike në jetën e tyre ose në vitin 2014 është e vogël:[134] 3.7% thanë se familja e tyre nuk do t'i lejonte që ata të punojnë për para jashtë shtëpisë në vitin 2014 (4.5% e grave dhe 2.8% e burrave); 3.2% thanë se një anëtar i familjes ka refuzuar t'u japë atyre para, kur ata me të vërtetë kishin nevojë për të mbijetuar (4.5% e grave dhe 1.9% e burrave); dhe 3.4% thanë anëtarët e familjes i detyruan ata që ta dorëzojnë pagën e tyre, ose ndihmën sociale (4.7% e grave dhe 2.2% e burrave). Grafiku 26 ilustron numrin e grave dhe burrave që raportuan se vuanin forma të ndryshme të dhunës ekonomike gjatë periudhave të ndryshme të jetës së tyre, duke përfshirë edhe vitin 2014.

Grafiku 26. Numri i grave dhe burrave që kanë vuajtur nga dhuna ekonomike në jetën e tyre




Asnjë hulumtim në Kosovë nuk ka shqyrtuar shpenzimet nga afër brenda familjes. Hulumtimi i tillë është i nevojshëm për të kuptuar më mirë se si familjet ndajnë mjetet dhe për të identifikuar se ku mund të ndodhë diskriminimi gjinor. Kjo është veçanërisht e rëndësishme, për shembull, në lidhje me ndarjen e ndihmës sociale të shtetit brenda familjes.[135] Disa të anketuar treguan se gratë mund të mos kenë njohuri për të ardhurat familjare apo kompetencën mbi shpenzimet brenda familjes. Për shembull, kur u pyet në lidhje me shpenzimet shtëpiake, një i anketuar ka thënë: "Gratë zakonisht nuk e dinë se sa para janë sjellë në shtëpi". [136] Kjo mund të kufizojë shkallën në të cilën gratë kanë kontroll apo një rol mbi shpenzimet brenda familjes.

RrGGK-ja shqyrtoi vetëm disa dimensione të vendimmarrjes brenda familjes. Siç ilustron Grafiku 27, afërsisht gjysma e kosovarëve (53%), thanë se edhe gratë edhe burrat brenda familjes vendosin së bashku kur bëhet një blerje e madhe siç është një veturë e re ose mobile; 35% thanë se burrat në familje marrin vendimin (p.sh., vetë i anketuari, bashkëshorti, baba, gjyshi, vëllai, etj); dhe 10% thanë se vendosin gratë (p.sh., vetë e anketuara, nëna, gjyshja, motra). Për sa i përket edukimit të fëmijëve (dhe shpenzimet në lidhje me këtë), 64% thanë se vendimi merret së bashku; 22% se burrat marrin vendimin; dhe 11% se gratë vendosin.




## Dhuna fizike: "Kjo është Kosovë; natyrisht që burrat i rrahin gratë e tyre"

Siç përshkruhet në pjesën mbi kornizën ligjore, dhuna fizike mund të përfshijë: përdorimin e forcës fizike; shkaktimin e dhimbjes fizike; dhe sulmin fizik. Shumica e formave të dhunës seksuale përbëjnë edhe dhunë fizike.

Disa të anketuar treguan përjetime të detajuara të dhunës fizike që ata ose njerëzit që i njihnin, kishin vuajtur. Përderisa këto nuk janë statistikisht përfaqësuese të popullsisë, ato janë thënë në kuptimin e dhunës në familje që ndodhë dhe ka ndodhur në Kosovë. Përderisa disa tregime janë shtjelluar në Shtojcën 5, disa nga përvojat më shqetësuese janë paraqitur këtu:

> "Unë do të doja të rrëfej historinë time që ka ndodhur katër vjet më parë. Unë u martova kur isha 16 vjeçe me një djalë që kam takuar në shkollë. Rashë në dashuri me këtë djalë. Mendova se ai ishte i vërteti. Pasi u martuam, ai filloi të më rrahë. Pastaj kam mbetur shtatzënë, edhe pse unë nuk desha, por nuk dita se si ta parandalojë një shtatzëni të padëshiruar. Ai më rrihte edhe gjatë shtatzanisë, vetëm sepse kam mbetur shtatzënë. Ai më torturonte. Më godiste me grusht. Më kërcënonte me armë dhe thika. Edhe vjehrra ime më rrihte. Ata më mbyllën në bodrum dhe as nuk më dhanë për të ngrënë. Ata më bën trupin plagë, ma djegën gjithë trupin me cigare. Por kam qëndruar dhe kam toleruar këtë për shkak të vajzës sime. Megjithatë, pas raportimit në polici prindërit e mi më bindën që të shkurorëzohesha, dhe unë u shkurorëzova". - Gruaja, 23 vjeçare, Gjakovë.

> "[Unë e di një] burrë i cili mori gruan e dytë dhe donte të jetonte me të dy [gratë], por gruaja e parë nuk donte. Ai e rrahu atë dhe pastaj u largua nga shtëpia". - Grua, mosha 52, Gllogoc.

> "[Unë e di] një grua 20-vjeçare që përjetonte dhunë nga burri i saj. Ajo u akuzua nga vjehrra e saj për vjedhje të parave. Ajo detyrohej t'i bëjë punët e shtëpisë, edhe pse ajo ishte në gjendje të keqe. Ajo është shtatzënë, e shkurorëzuar, dhe jeton me prindërit e saj". - Grua, 20 vjeçare, Malishevë.

> "Unë do të tregoj rastin e motrës sime, e cila vdiq për shkak të dhunës nga ana e bashkëshortit të saj. Ai jetonte jashtë vendit dhe e rrihte sa herë që vinte për ta vizituar. Njëherë, djali i motrës sime ra në një minë, dhe motra ime e dërgoi atë nëpër spitale të ndryshme, pasi burri i saj ishte jashtë vendit. Kur erdhi burri i saj, e rrahu atë për ditë, duke thënë se ajo nuk ka është kujdesur mirë për djalin e tyre, dhe pse ajo kishte shkuar vetëm në spital? Ai e rrahu atë për ditë, dhe ajo vdiq. Ajo kurrë nuk na ka treguar për dhunën që ajo pësoi. Policia mori burrin e saj dhe e mbajti në burg për disa muaj, por jo më shumë. Disa muaj më vonë, ai bëri vetëvrasje, por dhimbja për motrën time kurrë nuk është larguar". - Grua, 67 vjeçare, Podujevë.

Të anketuarit nga institucione publike gjithashtu përmendën edhe raste të grave të vrara si pasojë e dhunës në familje. Ndërmjet viteve 2005 dhe 2015, 22 raste të personave që u vranë brenda lidhjeve familjare u raportuan në polici. Më tej, ishin shtatë raste të vrasjes së rëndë, 24 raste të tentim vrasjes, 33 raste të nxitjes së vetëvrasjes ose ndihmës në vetëvrasje, 4,340 raste të lëndimeve të lehta trupore, dhe 1,162 raste të kërcënimeve brenda marrëdhënieve familjare.[137]

Vetëm 1.6% e të anketuarve (2.6% e grave dhe 0.6% e burrave), thanë se kishin përjetuar dhunë fizike nga anëtarët e familjes në vitin 2014. Duke pasur parasysh se të anketuarit mund të hezitojnë t'u tregojnë intervistuesve rreth dhunës fizike në shtëpi, studimi përbëhej nga një pyetësor anonim të plotësuar nga të intervistuarit dhe të mbyllur menjëherë. Forma e dhunës fizike që ishte raportuar më së shumti ishte goditja, të cilën e përjetuan 5.7% e kosovarëve në vitin 2014, duke përfshirë 8% të grave dhe 3.4% të burrave. Vetëm një pjesë e vogël e popullsisë thanë se ata kishin pësuar forma të tjera të dhunës fizike. Prandaj, kjo informatë është paraqitur në Grafikun 28 në numra realë. Njëqind të anketuar raportuan se janë goditur me shuplakë në vitin 2014; 95 thanë se një anëtar i familjes i kishte kërcënuar se do të përdorë armë kundër tyre; 51 thanë se një anëtar i familjes i kishte goditur, grushtuar, ose shqelmuar ata; dhe 27 nuk janë lejuar të shkojnë te mjeku për trajtim kur ishin të sëmurë.

Grafiku 28. Numri i grave dhe burrave që kanë përjetuar dhunë fizike në jetën e tyre




Gjithsej, 6.1% e kosovarëve kanë qenë ndonjëherë të goditur me një objekt si shkop, rrip, apo thikë në jetën e tyre (87 të anketuar, duke përfshirë 64 gra dhe 23 burra). Shumica (53) ishin goditur me shkop. Njëzet e tre të anketuar përjetuan dhunë të ushtruar me rrip, dy me thikë, një me shishe, dhe shtatë me lloje të tjera të objekteve. Të anketuarit treguan gjithashtu për rastet e personave që ata e dinin se kishin vuajtur dhunë të ushtruar me qëllim. Për shembull, një i anketuar tha: "Burri [në një familje që unë njoh], i cili ka probleme psikologjike, ka rrahur gruan e tij dhe e ka therur me thikë. Policia erdhi dhe e dërgoi burrin në spital. Tani burri është kthyer në shtëpi me gruan dhe fëmijët e tij."[138]

Shumica e të anketuarve të cilët ishin goditur me ndonjë objekt thanë se nëna dhe/ose babai i tyre kishin ushtruar dhunë. Të tjerët përmendën partnerin e tyre, axhën, gjyshin, kunatin, vjehrrën, dhe vëllanë.

## Dhuna seksuale

Një formë e dhunës fizike, dhuna seksuale mund të përfshijë detyrimin e dikujt për të kryer akte seksuale kundër vullnetit të tyre; prekjen e dikujt në mënyrë seksuale kundër vullnetit të tij/saj; ngacmimin seksual; dhe dhunimin. Ekzistojnë disa vështirësi në identifikimin e shkallës së dhunës seksuale në Kosovë (dhe gjetiu), duke përfshirë mungesën e lartpërmendur ende të pranishme të njohurive në mesin e disave sipas të cilëve dhuna seksuale mund të ndodhë brenda një martese; dhe për shkak vetëm të ndjeshmërisë për të folur me të tjerët rreth dhunës seksuale. Ndërmjet vitit 2000 dhe fundit të qershorit të vitit 2015, policia ka marrë raporte për nëntë raste të sulmit seksual brenda një marrëdhënieje në familje, 11 raste të dhunimit, dy raste të tentim dhunimit, dy raste të degradimit të integritetit seksual, si dhe një rast të akteve jo-konsensuale dhe keqtrajtimit seksual.[139]

**Grafiku 29. Numri i grave dhe burrave që kanë përjetuar dhunë seksuale në jetën e tyre**




Duke pasur parasysh ndjeshmërinë e çështjeve që lidhen me dhunën seksuale, gjatë anketës kombëtare RrGGK-ja ka bërë këto pyetje duke përdorur një pyetësor anonim.

Të anketuarit raportuan përjetimin e dhunës seksuale në fëmijërinë e tyre, adoleshencën, moshën e rritur dhe gjatë shtatzanisë (shih Grafikun 29). Shtatë për qind e grave dhe burrave kanë thënë se partneri i tyre i detyronte të kenë marrëdhënie seksuale kur ata nuk donin. Tre për qind e grave dhe burrave, thanë se një anëtar i familjes i detyroi ata të bëjnë veprime seksuale të cilat ata nuk donin t'i bëjnë. Gati tre për qind e kosovarëve raportuan dhunë seksuale të përjetuar në vitin 2014, duke përfshirë tre për qind të grave dhe 2.2% të burrave. [140] Të anketuarit përshkruan disa përvoja shqetësuese të dhunës seksuale të vuajtur vetë ose nga personat që i njihnin:

> "Gruaja ishte dhunuar nga bashkëshorti i saj, vjehrri dhe kunati. Ajo ishte në gjendje të tmerrshme. Ata e lidhën atë në shtratin e saj dhe e dhunuan, dhe nuk i dhanë asgjë për të ngrënë disa ditë. Ajo u përpoq të bëjë vetëvrasje duke u hedhur nga dritarja në lumë, por nuk pati sukses. Gjendja e saj u përkeqësua, derisa një ditë ata e vranë atë." - Grua, 46 vjeçare, Prizren.

> "Burri i saj ishte i dehur dhe ushtronte [...] dhunë seksuale para fëmijëve." - Grua, 36 vjeçare, Istog

> "[Unë e di një rast që përfshin një] përfaqësues fshati në Podujevë. Viktima është duke u dhunuar dhe keqtrajtuar vazhdimisht", - Burrë, 22 vjeçar, Podujevë

“Një person që unë e njoh pëson dhunë seksuale nga vëllai i saj. Ajo ishte shumë e re kur kjo ka ndodhur për herë të parë, në moshën 15 vjeçare. Dhe tani kjo vazhdon të ndodhë edhe pse ajo është 18 vjeçare. Ajo nuk guxon t’u tregojë prindërve të tyre për shkak se vëllai i saj e ka kërcënuar se do ta vrasë. Përpara familjes së saj të gjithë ata flasin normalisht, sikur të mos jetë duke ndodhur asgjë, sepse ajo nuk ka përkrahje. Dhe në qoftë se ajo i tregon familjes, ata do ta përkrahin vetëm vëllanë. Dhuna ndodh në shtëpi; ajo kthehet çdo fundjavë, sepse studion në një qytet tjetër. Ajo përjeton dhunë të rëndë fiziologjike. [...] Për shkak të dhunës që përjeton nga të gjithë, ajo mendon se nuk është vajza e tyre, se nuk kanë afërsi gjaku, dhe dëshiron të bëjë një test të ADN-së. Ajo është e tmerruar”, - Grua, 19 vjeçare, Prizren

“Ajo sinqerisht tha se ishte dhunuar, duke e treguar emrin e kryesit. Ajo tha se ajo përjetonte dhunë nga burri i saj dhe nëna, dhe nëna e saj gjithashtu e kishte kërcënuar me thikë”. - Shënimet kërkimore nga anketimi i një gruaje, 40 vjeçare, Podujevë

“Ishte ky rasti kur gruaja vdiq dhe e la burrin dhe vajzën e saj. Burri seksualisht e dhunonte vajzën për tre vjet, por pasi vajza ishte nëntë vjeçare ajo nuk e dinte se çfarë po ndodhte. Pastaj, kur ajo u bë 16 vjeç, ajo njoftoi policinë dhe ai është dënuar”. - Grua, 46 vjeçare, Prizren

“Është një rast kur një grua raportoi burrin e saj për abuzim seksual [dhunim]. Burri u arrestua për disa orë, por në fund ai u lirua. Më pas, sipas thashethemeve, ai ka thënë në polici: “Ajo është gruaja ime, dhe unë nuk mund të burgosem për dhunim”. - Grua, 43 vjeçare, Istog

Këto tregime sigurojnë prova të shumta jo vetëm se dhuna seksuale ekziston në Kosovë, por se ajo ka prekur dhe vazhdon të prekë një numër të grave. Historitë gjithashtu tregojnë për vështirësitë që personat të cilët kanë pësuar dhunë seksuale përballen me dhunë nga familjet e tyre dhe në raportimin e dhunës së tillë në institucione.

**Grafiku 30. Kush e ka kryer dhunën ndaj të anketuarve?**




## Kryesit e dhunës në familje

Ndër të anketuarit që kishin përjetuar dhunë në familje në jetën e tyre, shumica duket se kanë pësuar dhunë kryesisht nga nënat dhe etërit (shiko Grafikun 30) e tyre. Për gratë, kryesit më të shpeshtë të dhunës ishin partnerët e tyre, përkatësisht burrat. Vetëm tre burra thanë se ata kanë përjetuar dhunë nga gratë e tyre. Vëllezërit, vjehrrit dhe vjehrrat ishin kryesit tjerë të dhunës të përmendur më së shpeshti. Disa të anketuar gjithashtu përmendën kunetërit e tyre, xhaxhallarët, motrat, bijtë, gjyshet, nuset, kunatat, kushërinjtë, gjyshin, dhe vajzën.

## Grupet në rrezik

### Dhuna ndaj grave

Në Kosovë, gratë statistikisht kanë më shumë gjasa sesa burrat që të vuajnë të gjitha format e dhunës në familje, duke përfshirë edhe dhunën psikologjike, ekonomike dhe fizike. Gjithsej, 40.9% e të gjitha grave të anketuara thanë se kanë vuajtur nga dhuna në familje në vitin 2014, krahasuar me vetëm 9.7% të burrave të anketuar. Në mënyrë të qartë, gratë janë më shumë të rrezikuara nga dhuna në familje sesa burrat.

Dhuna ndaj grave është identifikuar ndërkombëtarisht si një nga format më të përhapura të dhunës. Statistikat globale të mbledhura nga organizata të ndryshme ndërkombëtare tregojnë se dhuna në familje është e përhapur në mbarë botën. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), vlerësoi në vitin 2014 se 35% e grave në mbarë botën kanë përjetuar dhunë seksuale apo dhunë në familje në jetën e tyre.[141] Mandej, statistikat tregojnë se në nivel global, deri në 38% të vrasjeve të grave janë kryer nga partnerët intimë apo familjarë.[142] Këto statistika shqetësuese në mesin e arsyeve për hartimin e KEDKG (1979), një traktat ndërkombëtar, i inkorporuar në Kushtetutën e Kosovës, i cili synon t'i japë fund të gjitha formave të dhunës dhe diskriminimit ndaj grave.[143] KEDKG fokusohet veçanërisht në gratë për shkak të statistikave globale që tregojnë se gratë janë në mënyrë disproporcionale viktima të dhunës familjare dhe seksuale. Sipas KEDKG, dhuna ndaj grave ndodh për shkak të sistemit patriarkal në të cilën jetojmë. Siç thekson Deklarata për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave e KB:

> Dhuna ndaj grave është një manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave, të cilat kanë çuar në dominim dhe diskriminim të grave nga burrat dhe në parandalimin e përparimit të plotë të grave, dhe se dhuna ndaj grave është një nga mekanizmat më të rëndësishëm social me të cilat gratë janë të vendosura në një pozitë vartëse krahasuar me burrat.

Patriarkati ka të bëjë me burra që kanë më shumë pushtet se sa gratë në pothuajse të gjitha sferat, dhe duke përdorur pushtetin e tyre mbi gratë.

Adresimi i marrëdhënieve të pushtetit shoqëror, të cilat krijojnë një mjedis të përshtatshëm për dhunë të ushtruar ndaj grave, është i nevojshëm në mënyrë që të ulet dhuna në familje. Me fjalë të tjera, me qëllim të adresimit të dhunës në familje, normat shoqërore në lidhje me rolet gjinore dhe marrëdhënie duhet të transformohen, duke u siguruar grave dhe burrave kompetenca të përbashkëta në aspekte të ndryshme të jetës së tyre.

### Dhuna kundër burrave

Ndërsa dhuna ndaj grave deri tani është më e përhapur, ekziston edhe dhuna ndaj burrave. Brenda një kulture patriarkale, burrat gjithashtu janë të socializuar të veprojnë në mënyra të veçanta. Ata mësohen të jenë të vështirë dhe të fortë, që të mos tregojnë dobësi. Këto norma shoqërore mund të jetë veçanërisht problematike për burrat që vuajnë dhunën në familje, nga të cilët shoqëria pret që ta përballojnë dhunën. Siç komentoi një i anketuar:

> Raportet tregojnë se edhe burrat përballen me dhunën në familje. [A]ta mbajnë një front të burrërisë, dhe në momentin që ata shkojnë në polici apo raportojnë rastin, ata [institucioni] i poshtëron shumë. [A]ta [policia] do t'u thoshte atyre: "Edhe ne do të rrahim, në qoftë se ti ke lejuar që gruaja jote të rrahë ose të të godasë me shuplakë".[144]

Dhuna ndaj burrave ende diskutohet pak publikisht në Kosovë. Perceptimet shoqërore në lidhje me burrëri i kanë kontribuar ideve që ose burrat nuk përballen me dhunë fare ose ata duhet të përballen me dhunë, sepse kjo do t'i bëjë ata më të fortë.[145] Prandaj, burrat që "ankohen", për vuajtje të dhunës priren të jenë të tallur nga shoqëria. Presioni

> **"Burrat nuk i përkrahin burrat sepse në të vërtetë në shumicën e rasteve burrat janë më pak të përgjegjshëm se gratë dhe meritojnë të rrihen më shumë se gratë."**
> - Përfaqësues i QAP

shoqëror kundër burrave që të "jenë të fortë" mund të parandalojë burrat nga raportimi i dhunës, edhe nëse ajo ndodh. Më tej, praktikisht nuk ekzistojnë shërbime për të mbështetur burrat që kanë pësuar dhunë. Për shembull, nuk ekzistojnë shtëpi të sigurta apo strehimore për burrat.

### Vendndodhja nuk ka rëndësi

Ndërsa hulumtimi i RrGGK-së i vitit 2008, gjeti se njerëzit në zonat rurale kishin më shumë gjasa që të kenë pësuar dhunë në familje në jetën e tyre,[146] ky studim 2015 sugjeron se nuk ka marrëdhënie të rëndësishme midis të jetuarit në një zonë urbane apo rurale dhe vuajtjes së dhunës në familje, qoftë gjatë jetës së tyre, ose vetëm në vitin 2014.[147] As nuk ekziston një marrëdhënie e rëndësishme e qartë statistikisht në mes të rajoneve të ndryshme dhe dhunës në familje që ndodhë.[148] Duke pasur këtë parasysh, Grafiku 31 ilustron përqindjen e popullsisë në çdo rajon që ka raportuar përjetimin e dhunës në familje në vitin 2014.

Grafiku 31. Përqindja e popullsisë në çdo rajon që raportuan vuajtje nga dhuna në familje në vitin 2014




Në përfundim, vendndodhja nuk ka fare rëndësi. Njerëzit që jetojnë kahdo e kudo janë në rrezik të dhunës në familje.

### Përkatësia etnike

Në mesin e të anketuarve, 61.2% e shqiptarëve, 71.2% e serbëve, dhe 72.7% e grupeve të tjera etnike raportuan vuajtjen nga dhuna në familje në jetën e tyre. Brenda vitit të kaluar, 29.8% e shqiptarëve, 39.6% e serbëve, dhe 36.4% e grupeve të tjera etnike kanë vuajtur nga dhuna në familje. Të anketuarit serbë janë më të prirë të raportojnë lloje të ndryshme të dhunës në jetën e tyre se sa persona të përkatësive të tjera.[149] Ekziston edhe një marrëdhënie e rëndësishme statistikore në mes të dhunës në familje në vitin 2014 dhe përkatësisë etnike. Personat e përkatësisë serbe dhe të etnive tjera janë të prirë të raportojnë se kanë përjetuar dhunë, ndërsa shqiptarët nuk kanë qenë të prirë të raportojnë se kanë përjetuar dhunë. Personat e përkatësisë serbe dhe të përkatësive të tjera etnike gjithashtu kishin pak më shumë gjasa të raportojnë përjetimin e dhunës psikologjike dhe fizike në vitin 2014.[150] Megjithatë, këto gjetje nuk sugjerojnë domosdoshmërisht që personat e një etnie të caktuar kanë vuajtur dhunën në familje pak a shumë; kjo thjesht do të thotë se shqiptarët janë në mëdyshje për ta raportuar atë apo se serbët dhe personat e etnive të tjera janë më të prirë për ta bërë këtë.

### Niveli i arsimimit

Një temë e përsëritur në intervistat me institucione ishte se dhuna në familje mund të rezultojë edhe nga mungesa e arsimimit. Megjithatë, në kundërshtim me këtë besim, të dhënat e anketës nuk tregojnë ndonjë marrëdhënie të rëndësishme në mes të dhunës në familje dhe viteve të shkollimit të

kryer. Dhuna në familje ndodh në të dy llojet e familjeve, si në ato të arsimuara ashtu edhe në ato të paarsimuara.[151]

## Statusi socio-ekonomik

Nuk ka ndonjë korrelacion të rëndësishëm statistikor në mes të përjetimit të dhunës në familje në vitin 2014 dhe të ardhurave familjare, të ardhurave individuale të anketuarve, ose marrjes së ndihmës sociale nga shteti. Kur testohet lidhja në mes të dhunës në familje në vitin 2014 dhe statusit të punësimit të të intervistuarve, të dhënat e anketës tregojnë që të anketuarit të cilët bëjnë punë të papaguar në shtëpi (kujdesit për fëmijë, kopshtarisë, mirëmbajtjes së shtëpisë, etj) dhe ata të cilët janë nxënës, kanë më shumë gjasa të përjetojnë dhunë në familje. Ata që bëjnë punë të papaguar jashtë shtëpisë dhe pensionistët (korrelacion i dobët) kanë më pak gjasa të përjetojnë dhunë në familje. Këto rezultate, megjithatë, duhet të trajtohen me kujdes sepse ato mund të lidhen me nivelin e vetëdijesimit të të anketuarve mbi dhunën në familje dhe prirjes për ta raportuar atë. Për shembull, nxënësit mund të jenë më të vetëdijshëm për llojet e ndryshme të dhunës në familje dhe më të prirë për ta raportuar atë në krahasim me të anketuarit e moshuar (të cilët mund ta kalojnë shumicën e kohës së tyre në shtëpi).[152]

## Mosha

Të dhënat e studimit tregojnë se të rinjtë (të moshës 18-25 vjeçare) kanë më shumë gjasa të kenë përjetuar dhunë në familje në vitin 2014 në krahasim me të gjitha grupmoshat e tjera. Në kundërshtim me këtë, ata të moshës 46-55 kanë më pak gjasa se grupmoshat e tjera të kenë përjetuar dhunë në familje.

**Grafiku 32. Personat që kanë përjetuar dhunë në familje ndonjëherë dhe në vitin 2014 sipas grupmoshës**




Të anketuarit e rinj (18-25 vjeçarë) gjithashtu kanë më shumë gjasa të kenë përjetuar dhunë fizike, psikologjike, dhe ekonomike në jetën e tyre, në krahasim me të tjerët.[153] Kjo mund të sugjerojë se dhuna në familje është rritur, ose mund të nënkuptojë se të rinjtë e kujtojnë dhunën që u ka ndodhur në fëmijërinë e tyre më lehtë, ndërsa të anketuarit më të vjetër mund të kenë probleme me kujtesë. Kjo gjithashtu mund të thotë se të rinjtë janë më të vetëdijshëm dhe i marrin aktet e veçanta të dhunës më seriozisht se të moshuarit. Për shembull, siç u përmend, të rinjtë janë më të prirë të pajtohen që ndëshkimi i një fëmije me goditje me shuplakë është dhunë në familje. Kjo mund të thotë se ata kanë

më shumë gjasa të raportojnë dhunën e tillë që i prek ata sesa personat e moshuar. Ekziston mundësia gjithashtu që të moshuarit ende hezitojnë të flasin për dhunë pasi ajo mbetet një temë tabu për ta.

### Dhuna ndaj fëmijëve

Ndërsa për arsye etike, RRGGK-ja nuk ka anketuar apo intervistuar fëmijë, studimi u përpoq që të marrë informata në lidhje me dhunën kundër fëmijëve duke bërë pyetje në lidhje me dhunën e përjetuar nga të anketuarit kur ata ishin fëmijë dhe në lidhje me dhunën që ata mund të kryejnë ndaj fëmijëve të tyre. Studimi shqyrtoi gjithashtu qëndrimet lidhur me disiplinimin e fëmijëve për të matur nëse mund të jetë e mundshme që njerëzit i konsiderojnë disa forma të dhunës ndaj fëmijëve të pranueshme.

Rreth 32.6% e kosovarëve pajtohen se "nganjëherë fëmija duhet të dënohet me shuplakë", që sugjeron se goditja fizike me shuplaka ndoshta ende ekziston në një të tretën e familjeve si një formë e disiplinës (shih Grafikun 33). Megjithatë, ky besim duket se ka ndryshuar ndjeshëm gjatë viteve të fundit; në vitin 2008, 45.6% e të anketuarve besojnë se fëmijët duhet të goditen me shuplakë.[154] Perspektivat e grave dhe burrave kanë prirje të ndryshojnë. Në vitin 2015, gati dy herë më shumë gra (41.7%), sesa burra (23.2%) pajtohen se fëmijët duhet të goditen me shuplakë. Përndryshe, 81.1% e konsiderojnë goditjen e fëmijëve me shuplakë një formë të dhunës në familje, dhe 89.6% besojnë se goditja e një fëmije me rrip ose shkop është një formë e dhunës.

Grafiku 33. Fëmija ka nevojë të goditet ndonjëherë




Përkitazi me metodat e ndryshme të disiplinimit të fëmijëve në bazë të gjinisë së fëmijës, 36.7% e kosovarëve (37.5% e grave dhe 35.9% e burrave) pajtohen se "djemtë duhet të ketë disiplinë më të rreptë sesa vajzat, sepse kjo i bën ata të fortë". Ky besim ka ndryshuar vetëm pak që nga viti 2008 kur 40.6% e kosovarëve pajtohen me këtë. Nuk ka dallime të mëdha në opinionin midis grave dhe burrave. Megjithatë, personat nga etnitë e tjera (jo-shqiptare dhe jo-serbe), janë më të prirë të besojnë se djemtë duhet të ketë disiplinë më të rreptë sesa vajzat, ndërsa personat me të ardhura më të larta kanë më pak të ngjarë të pajtohen këtë mendim.[155]

Ndërkaq, 54.7% e kosovarëve besojnë se "vajzat kanë nevojë për më shumë disiplinë sesa djemtë në mënyrë që ato të kenë moral të fortë". Interesante, kosovarët duket se janë bërë më konservatorë në këtë aspekt që nga viti 2008, kur 47% e të anketuarve u pajtuan me këtë deklaratë[156]. Në ditët e sotme, gratë kanë më shumë të ngjarë që të besojnë se vajzat kanë nevojë për më shumë disiplinë; 60.6% e grave pajtohen me këtë deklaratë në krahasim me 48.7% të burrave (shih Grafikun 34). Të anketuarit që jetojnë në zona rurale dhe në ato të etnive të tjera janë më të prirë të besojnë se vajzat kanë nevojë për disiplinë më të rreptë. Personat me nivele më të larta të të ardhurave kanë më pak gjasa ta ndajnë këtë besim.[157]

**Grafiku 34. Vajzat kanë nevojë për më shumë disiplinë se djemtë në mënyrë që ato të jenë moralisht korrekte**




RrGGK-ja pastaj pyeti të anketuarit se si mund ti disiplinojnë fëmijët e tyre në realitet, ose, për ata që ende nuk kanë fëmijë, si ata do t'i disiplinonin fëmijët e tyre. Shumica (67.4%) thanë se ata flisnin, këshilloheshin, apo bisedonin me fëmijët e tyre, duke i edukuar që të sillen më mirë në të ardhmen. Format tjera më të shpeshta të disiplinimit ishin t'u bërtasin atyre (18.3%), ose t'i godisnin me shuplakë (17.3%). Një përqindje më e lartë e grave sesa e burrave deklaruan se ata përdorin këto forma të disiplinimit. Një përqindje shumë e vogël e kosovarëve duket se përdorin qasje më fizike në disiplinimin e fëmijëve: 1.4% godasin fëmijën e tyre me rrip ose shkop; dhe 1.4% ua tërheqin veshin apo flokët fëmijëve. Nga personat të cilët kanë fëmijë, 7.2% përdorin rrip ose shkop për të ndëshkuar fëmijët e tyre.

**Grafiku 35. Si disiplinohen fëmijët?**



Në praktikë, 19.8% e të anketuarve (25.3% e grave dhe 14.1% e burrave), thanë se disiplinojnë vajzat dhe djemtë në mënyra të ndryshme. Në mesin e të anketuarve që thanë se vajzat disiplinohen në mënyra të ndryshme, shumica thanë se vajzat këshillohen apo edukohen më shumë se djemtë (43), dhe 42 thanë se vajzat kanë disiplinë më rigoroze. Përgjatë linjave të njëjta, 18 të anketuar thanë vajzat kanë më pak të drejta se djemtë; dhe 13 thanë se ato duhet të jenë më të përulura, të bindura, dhe të moralshme. "Disiplina duhet të jetë ndryshe për djem dhe ndryshe për vajza", tha një i anketuar. "Disa gjëra janë të lejuara për djemtë, por jo për vajzat". Në kundërshtim me këtë, 21 të anketuar thanë se vajzat kanë dënime më pak të ashpra se sa djemtë, apo nuk dënohen fare (2).

**"Vajzat duhet të jenë më të edukuara në sjellje, pasi që ajo një ditë do të shkojë në familje të huaj [familja e burrit të saj]."**
- Grua, 30 vjeçare, Skenderaj

Graph 36. Si disiplinohen vajzat?




Sa i përket djemve, shumica (64 të anketuar) kanë thënë se ata kanë prioritet, u janë dhënë më shumë të drejta, dhe/ose trajtohen në mënyrë më të favorshme sesa vajzat. Për shembull, një i anketuar tha: "Ata kanë më shumë liri; ata nuk i bëjnë punët e shtëpisë".[158] Në mënyrë të ngjashme, 24 thanë se ata janë këshilluar, dhe 14 thanë se ata janë udhëheqësit apo "bosët" e ardhshëm që duhen respektuar, të mësohen "të dominojnë në familje", dhe "të jenë burra me autoritet".[159] "Ata duhet të mësohen të jenë të guximshëm, më të fortë, dhe atyre nuk u lejohet të qajnë", tha një tjetër i anketuar.[160] Njëzet e pesë, thanë se djemtë disiplinohen më ashpër dhe/ose kanë më shumë rregulla se vajzat; dhe tre thanë se dhunë më e ashpër përdoret për të disiplinuar djemtë.

**"Djemtë duhet të trajtohen më ashpër pasi që ata do të bëhen 'burra'".**
- Gruaja, 30 vjeçare, Gllogovc

Grafiku 37. Si disiplinohen djemtë?




Besimet e lartpërmendura dhe praktikat lidhur me mënyrat në të cilat vajzat dhe djemtë "duhet të" disiplinohen ilustrojnë supozimet e vazhdueshme që lidhen me rolet specifike të gjinisë që burrat dhe gratë duhet të kenë në një shoqëri. Përtej ndikimit të menjëhershëm që ka disiplinimi i vajzave dhe djemve në mënyra të ndryshme lidhur me dhunën në familje ndaj fëmijëve, këto supozime kontribuojnë në forcimin e roleve gjinore në shoqëri. Kjo përforcon marrëdhëniet ekzistuese të pushtetit që mund të ofrojnë një mjedis të përshtatshëm për dhunën në familje, në mesin e formave të tjera përkitazi me pushtetin të formave të dhunës me bazë gjinore, që ndodhin më vonë në jetë. Siç u përmend, adresimi i këtyre marrëdhënieve të pushtetit, adresimi i patriarkatit, dhe mënyrat në të cilat vajzat dhe djemtë socializohen janë të rëndësishme për parandalimin e dhunës në të ardhmen në familje.

Kur kanë qenë fëmijë, shumica e kosovarëve duket se janë ndëshkuar me anë të britmës (49.1%). Disa (38.3%) janë goditur me dorë, dhe 11.4% me rrip ose shkop (shih Grafikun 38).

Grafiku 38. Si janë ndëshkuar respondentët kur kanë qenë fëmijë, nëse kanë bërë probleme?



Mësuesit, punonjësit socialë, strehimoret, si dhe përfaqësues të institucioneve të kujdesit shëndetësor dhanë hollësira për takimet e tyre lidhur me dhunën në familje ndaj fëmijëve. "Kam pasur disa raste të prindërve që abuzonin me fëmijët," tha një punëtor shëndetësor. "ka qenë një rast i një djali që është përpjekur të ikë nga babai i tij i cili donte ta godiste atë me rrip. Në vrapim e sipër, ra nga ballkoni".[161]

**"Prindërit kanë ardhur tek unë, duke më thënë se unë duhet ta rrah fëmijën e tyre nëse ai nuk sillet mirë, sepse ata nuk kuptojnë ndryshe".**
**-** Edukator

Një temë e përsëritur në mesin e të anketuarve ishte që personat që kanë pësuar dhunë në fëmijërinë e tyre do të kenë më shumë gjasa që të kryejnë dhunë, kur ata janë më të vjetër. "Viktimat e dhunës mund të kopjojnë sjelljet e dhunshme të kryesit dhe t'i përsëritin ato te fëmijët e tyre", komentoi një psikolog. Në të vërtetë, të dhënat e studimit tregojnë një korrelacion pozitiv dhe statistikisht të rëndësishëm në mes të përjetimit të ndonjë lloj dhune gjatë fëmijërisë ose adoleshencës dhe ndëshkimit aktual të fëmijëve duke i goditur ata me dorë, rrip, ose shkop.[162] Megjithatë, siç deklarojnë kritikët e teorisë së "ciklit të dhunës", vetëm sepse dikush ka përjetuar dhunë si fëmijë, nuk do të thotë se është e pranueshme që ata ta ushtrojnë atë më vonë në jetë. Gjithashtu nuk do të thotë se të gjithë personat që kryejnë veprime të dhunshme kanë përjetuar domosdoshmërish dhunë si fëmijë.[163]

### Martesat e hershme

Në mesin e të anketuarve, mesatarisht, gratë kanë tendencë të martohen për herë të parë në moshën 21 vjeçare, ndërsa burrat mesatarisht 25 vjeç. Në përgjithësi, 6.5% e të anketuarve (86) kanë thënë se ata janë martuar për herë të parë para moshës 18 vjeçare. Nuk ekziston një marrëdhënie e rëndësishme statistikore në mes të moshës kur i anketuari është martuar dhe ka përjetuar dhunë në familje në vitin 2014.[164] Pavarësisht kësaj, përderisa mund të mos ketë qenë raportuar si e tillë, RrGGK-ja e konsideron të rëndësishme të përmendë se martesa e hershme në vetvete është një formë e dhunës në familje; ajo përfshin dhunën seksuale ndaj një të miture, dhunë e cila automatikisht sjellë dhunë fizike, si edhe sipas të gjitha gjasave edhe dhunë psikologjike dhe ekonomike.

### Dhuna ndaj personave me aftësi të kufizuara

Qëndrimet në lidhje me kontrollimin e lëvizjeve të personave me aftësi të kufizuara duket se kanë ndryshuar për të mirë në vitet e fundit. Në vitin 2015, rreth 6.3% e kosovarëve pajtohen se "personat me aftësi të kufizuara duhet të qëndrojnë brenda shtëpisë së tyre, sepse ata janë turp i familjes", në krahasim me 8.7% të të anketuarve në vitin 2008. Nuk duket se ekziston dallim i madh në mesin e pikëpamjeve të grave dhe e burrave në këtë aspekt. Në ditët e sotme, shumica e njerëzve (76.5%) e konsiderojnë "ndikimin te një person me aftësi të kufizuara se me kë martohet "një formë të dhunës në familje, edhe pse 15.6% nuk pajtohen, dhe 7% nuk janë të sigurt.

Ndërsa qëndrimet mund të ndryshojnë, njerëzit me aftësi të kufizuara ende mund të jenë në rrezik të dhunës në familje për shkak të pozitës së tyre shpesh më të cenueshme brenda familjes së tyre dhe shoqërisë. Disa të anketuar theksuan se dhuna në familje ka pasur ndikim edhe në gratë edhe në burrat me aftësi të kufizuara. Një organizatë që punon me personat me aftësi të kufizuara ka raportuar se vetëm në vitin 2014 kishin ndihmuar 22 gra dhe vajza me aftësi të kufizuara që kishin përjetuar dhunë në familje. Personat me aftësi të kufizuara mund të përballen me forma të dhunës në familje që nuk përjetohen nga të tjerët:

> Për personat me aftësi të kufizuara, dhunë është kur anëtarët e familjes nuk mendojnë për lëvizshmërinë tonë, se si do të lëvizim ne rreth shtëpisë, apo si ngjitemi në katin e dytë. Prindërit, kur ndërtojnë shtëpitë nuk marrin parasysh kushtet e personave me aftësi të kufizuara. [Dhuna është gjithashtu] kur neve nuk na mundësohet ta vazhdojnë shkollimin, për shkak të pengesave financiare apo fizike[165]

### Dhuna ndaj personave LGBT

Përfaqësuesit e organizatave që punojnë me persona lesbikë, homoseksualë, biseksualë dhe transgjinorë (LGBT), thanë se ekziston dhuna në familje, e kryer nga partnerët, prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes. Fakti që disa persona LGBT nuk ndihen rehat kur diskutojnë seksualitetin e tyre me anëtarët e ngushtë të familjes është një formë e dhunës psikologjike në vetvete. Për shkak të frikës së refuzimit, personat LGBT nuk priren të informojnë anëtarët e familjes për seksualitetin e tyre. Përfaqësuesit e organizatave LGBT shprehën shqetësimin se, nëse personat LGBT do të flisnin më lirshëm për orientimin e tyre seksual me anëtarët e familjes, do të rriteshin rastet e dhunës në familje.

Ndërsa informatat lidhur me dhunën në familje ndaj personave LGBT janë të kufizuara, të dhënat fillestare kualitative sugjerojnë se ajo ndodh. Në hulumtimet në dispozicion, personat LGBT u pyetën: "Cili është vendi më i rrezikshëm për juve?" Më shumë se 70% janë përgjigjur "shtëpia".[166] OJQ QESH ka identifikuar më shumë se 20 raste të dhunës në familje në hulumtimin e kohëve të fundit. Përveç kësaj, ka pasur dy raste të vrasjes, një rast që përfshin një anëtar të familjes së gjerë. Një tjetër organizatë që punon më shumë me burrat GBT ka deklaruar se në vitin 2014 ka pasur 13 raste të raportuara në organizatën e tyre. Ata vërejtën se dhuna fizike është më e shprehur në mesin e burrave, ndërkohë që dhuna psikologjike ishte më e shpeshtë në mesin e grave.

Përfaqësuesit e organizatave LGBT u pajtuan se sfida e tyre kryesore është që të inkurajojnë personat LGBT që të raportojnë dhunën në familje në mënyrë që ata të mund të marrin mbështetje. Megjithatë, ata thanë se vetëdijesimi është rritur në mesin e personave LGBT lidhur me të drejtat e tyre ligjore. "Ndryshimi nuk ka të bëjë asgjë me ligjin," tha një i anketuar. "Komuniteti LGBT vetëm u bë më i vetëdijshëm për të drejtat e tyre".[167]

Sa i përket reagimit institucional, përfaqësuesit e organizatave LGBT thanë se policia i kryejnë detyrat e tyre më së miri në aspektin e mbrojtjes së personave LGBT. Ata shohin më shumë pengesa në lidhje me procesin gjyqësor, ku rastet zgjaten nga prokurorët apo gjyqtarët. Mungesa e komunikimit ndërmjet institucioneve relevante gjithashtu është identifikuar si një problem.

## Pasojat e dhunës në familje

Dhuna në familje mund të ketë disa pasoja negative për individë, familje, dëshmitarë, komunitete dhe shoqëri në kuptim më të gjerë. Përderisa nevojiten kërkime të mëtejshme për pasojat e sakta të dhunës në Kosovë, kjo pjesë shqyrton disa pasoja të identifikuara përmes këtij hulumtimi.

### Pasojat në shëndet

**"Meqë punoj në spital kam parë shumë gra që vijnë me mavijosje".**
- Grua, 53 vjeçare, Gjilan

Hulumtimet sugjerojnë se pasojat në shëndetin fizik mund të përfshijnë lëndime trupore, paaftësi të përhershme, dhimbje koke migrenë, dhe madje edhe vdekje.[168] Pasojat në shëndetin mendor mund të përfshijnë ankth, depresion, frikë, sindromën e stresit post-traumatik, dhe madje edhe vetëvrasje. Hulumtimi i RrGGK-së i vitit 2008 gjeti se nga të gjitha gratë që kanë përjetuar dhunë në familje, 80% raportuan probleme shëndetësore që rezultojnë drejtpërdrejt nga dhuna.[169] Këto përfshijnë:

> mavijosje; dhimbje koke/migrenë; hipertension (tensioni i lartë i gjakut); nervozizëm; frikë; lëndime trupore; fytyrë dhe sy të mavijosur/lënduar; depresion; pavetëdije (ku një e anketuar kishte mbetur e pavetëdijshme për tri ditë); krahë të thyer; lëndime të dorës; probleme me veshka; gjakderdhje të vazhdueshme; lëndime në kokë; paaftësi për t'u përqendruar në punë; pagjumësi; vetë-vlerësim të ulët; dhimbje të trupit dhe gjirit; mungesë të imunitetit ndaj sëmundjeve; anemi, tentim vetëvrasjeje; dhimbje të shpinës; probleme të frymëmarrjes; unazë të thyer; dhimbje gjoksi; lemzë kronike; shurdhim që rezulton nga një dëmtim i veshit; diabet; një cikël të parregullt menstrual; marramendje; gastrit; urrejtje; probleme të zemrës; lëndime të ekstremiteteve; plagë me thikë; humbje e dëshirës për të jetuar; presion gjaku i ulët; aborte spontane; sulme paniku; plagë; djersitje; sëmundje të gjëndrës tiroide; lodhje; dhe traumë[170]

Në vitin 2015, përfaqësues të institucioneve shëndetësore thanë se kanë hasur në persona në dhomat e emergjencës të cilët kishin pësuar lëndime në fytyrë, kishin përjetuar shkulje të flokëve, dhe dëmtime të tjera ekstreme të shkaktuara nga rrahjet apo shkelmimet.[171] Ndër të anketuarit që kishin vuajtur dhunën në familje, 23 gra dhe dy burra thanë se ata kishin probleme shëndetësore që rezultuan nga dhuna. Problemet e shëndetit fizik përfshinin dhimbje koke, tension të lartë të gjakut, mavijosje, gjymtyrë të thyera, hundë të thyer, shtatzëni të padëshiruar, dhe abort. Më tej, edhe pse jo të gjithë duket se i kanë konsideruar problemet psikologjike si shqetësim shëndetësor, 46 gra dhe 10 burra përmendën problemet psikologjike si rezultat të dhunës. Këto përfshinin depresionin, nervozizmin, frikën e vazhdueshme, trishtimin, sindromën e stresit post-traumatik, stresin, shqyrtimin e vetëvrasjes, dhe përpjekjen e vetëvrasjes. Tragjikisht, edhe pse nuk ka mundur të përmendet nga të anketuarit drejtpërdrejt, disa raste të dhunës në familje kanë përfunduar me vdekje, ose nëpërmjet vetëvrasjes ose vrasjes.

**"Ekzistojnë tri gra jetët e të cilave janë në rrezik nga dhuna në familje. Nëse dhuna u ndodh atyre edhe një herë ne jemi të frikësuar se ato mund të vriten".**
– Përfaqësues i OJQ-së

## Pasojat për Veten dhe Familjen

Rezultatet e tjera negative të dhunës në familje të përmendura nga të anketuarit që vuajnë nga dhuna përfshijnë paaftësinë për t'u kujdesur për fëmijët e tyre dhe vështirësitë të kujdesen për veten e tyre.[172] Ndër të anketuarit që kishin përjetuar dhunë, 143 (85 gra dhe 58 burra) kanë thënë se fëmijët kishin qenë dëshmitarë të dhunës së ushtruar ndaj tyre. Kjo mund të ketë pasur një ndikim negativ në mirëqenien e fëmijëve.[173] Siç komentoi një psikolog:

> Dhuna është një gjë negative që shkakton probleme jo vetëm për shoqërinë si tërësi, por edhe për të ardhmen e fëmijëve që vijnë nga familje të dhunshme, sepse ata janë ata që vuajnë, madje në mënyrë të tërthortë. Edhe në qoftë se ata vetë nuk kanë përjetuar dhunë, vetë shikimi i prindërve të tyre duke vepruar kështu përbën dhunë. Ne punojmë me këta fëmijë, por ende nuk mund t'i trajtojmë ata ashtu siç duhet të trajtohen.[174]

Një mësues u pajtua: "Ju i dalloni nxënësit që përjetojnë dhunë në familje. Ata janë ose më të mbyllur në vetvete ose tepër agresivë "Hulumtimi i RrGGK-së i vitit 2008 ka gjetur se të anketuarit që kishin vuajtur nga dhuna si fëmijë, kishin më pak të ngjarë të kenë diploma universitare në krahasim me ata që nuk kanë vuajtur nga dhuna; kishin më shumë gjasa të jenë të papunë; dhe kishin të ardhura të përgjithshme familjare më të ulëta. Më tej, të anketuarit të cilët kishin vuajtur nga dhuna në fëmijërinë e hershme ishin më të prirë të vuajnë nga dhuna më vonë në jetë.[175]

## Pasojat për shoqëri dhe në buxhetin e shtetit

Dhuna në familje shkakton shpenzime të konsiderueshme për buxhetin e Republikës së Kosovës, shfrytëzimin e fondeve që mund të ndahen për qëllime të tjera. Paratë e taksapaguesve shkojnë për zbatimin e kornizës ligjore, duke përfshirë zbatimin e PNV-së. Kjo përfshin aktivitetet parandaluese të financuara nga qeveria, shpenzimet procedurale siç janë ato të policisë, përfaqësimit të autorizuar, ndihmës juridike, shpenzimet gjyqësore, dhe shumë më tepër. Hulumtimi i RrGGK-së i vitit 2011 gjeti se qeveria dhe donatorët kishin ndarë 2.088.581 € në vit për mbrojtje, 526,264 € për parandalim, dhe 399,585 € për rehabilitimin dhe riintegrimin lidhur me PNV-në.[176] Dhuna në familje në këtë mënyrë i kushton shtetit dhe donatorëve (duke përfshirë taksapaguesit vendas dhe të huaj), më shumë se 3.014.430 € në vit. Gjithashtu shpenzohet financimi shtesë nga buxhetet e institucioneve, por nuk mund të llogaritet. Një sasi e konsiderueshme e buxhetit nacional, si dhe fondet nga donatorët ndërkombëtarë, janë të ndara për ta adresuar dhunën në familje. Në këtë mënyrë zvogëlimi i dhunës në familje mund të ulë nevojën për këto shpenzime.

## Reagimet e qytetarëve ndaj dhunës

### Njohuritë dhe përdorimi i ligjeve dhe institucioneve

Përqindja e popullsisë që është e vetëdijshme se ekziston një Ligj për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë është rritur ndjeshëm nga 54.1% në 2008,[177] në 75.3% në vitin 2015. Megjithatë, 9.2% e popullsisë nuk beson se ekziston një ligj i tillë dhe 14.4% nuk e dinë. Gratë priren të kenë më pak njohuri se sa burrat me 11% të grave që deklarojnë se ligji nuk ekziston (në krahasim me 7.5% të burrave) dhe 15.5% e grave nuk dinë nëse ekziston ligji (në krahasim me 13.4% të burrave).

**"Unë jam ligj në shtëpinë time".**

Në rast të ushtrimit të dhunës, 75.9% e kosovarëve thanë se do të përdornin ligjin për të ndihmuar gjendjen e tyre.[178] Në vitin 2008, më shumë kosovarë duket se kanë qenë të gatshëm të përdorin ligjin (80.4%). Për ata që nuk do të përdornin ndonjë ligj, kur u pyetën pse jo, shumica thanë se preferonin të zgjidhnin situatën në mënyrë të pavarur (74 të anketuar). Sikurse një burrë që tha: "Unë jam ligj në shtëpinë time."[179] Disa të anketuar gjithashtu thanë se në disa raste ka mjaft arsye për dhunë, dhe prandaj ajo duhet të zgjidhet brenda familjes. "Askush nuk e rreh tjetrin pa arsye", ka thënë një i anketuar.[180] "Unë do ta pranoja dhunën në qoftë se ajo do të ishte nga prindërit e mi", një tjetër u pajtua.[181]

**"Unë do të kisha frikë nga burri im. Policia nuk do ta mbante atë atje për gjithë jetën, dhe kur ai të lirohej, do të më rrihte përsëri".**
**-** Grua, 32 vjeç, Lipjan

Katërmbëdhjetë të anketuar thanë se nuk u besojnë institucioneve të Kosovës, trembëdhjetë mendonin se ishte një çështje private për të mos u ndarë me tjerë; tetë thanë se nuk ishte "punë e madhe"; shtatë thanë se ata nuk do ta raportonin dhunën për shkak të turpit apo sikletit; gjashtë kishin frikë;[182] pesë thanë se kjo nuk do të ndihmonte të përdornin ligjin; dhe një grua tha se ajo do të shqetësohej në lidhje me mirëqenien e fëmijëve të saj nëse ajo do ta kishte raportuar dhunën. Një e anketuar tjetër për intervista, burri i së cilës ushtronte dhunë ndaj saj tha se ajo nuk donte ta raportonte dhunën vetëm për faktin se ajo nuk dëshironte shkurorëzim.[183] Një tjetër tha se ajo nuk donte ta poshtëronte ose turpëronte burrin e saj duke raportuar dhunën. Arsyet pse disa të anketuar nuk do ta raportonin dhunën në familje nuk ka ndryshuar shumë prej arsyeve të dhëna në vitin 2008.

Të anketuarit gjithashtu janë pyetur nëse ata e dinin se ku një person mund të merrte ndihmë në qoftë se ai/ajo përjeton dhunë në familje, në mënyrë që të testohen njohuritë e njerëzve në lidhje me institucionet në Kosovë që mund të ofrojnë përkrahje (shih Grafikun 39). Shumica e njerëzve (73.6%) identifikojnë policinë si institucion ku personi që përjeton dhunë mund të marrë ndihmë, edhe pse një përqindje më e lartë e burrave (80%) përmendën policinë më shumë sesa gratë (67.4%). Së dyti, 18.7% e njerëzve thanë se dikush mund të kërkojë ndihmë nga një anëtar tjetër i familjes dhe 4.4% përmendi ndonjë mik.

Grafiku 39. Ku mundet të shkojë një person që të kërkojë ndihmë nëse i ndodhë dhuna?




Pak ka ndryshuar që nga viti 2008, kur dy të tretat e të anketuarve gjithashtu identifikuan policinë si institucion të aftë për të trajtuar rastet e dhunës në familje. Policia është pika e parë e kontaktit për personat që vuajnë nga dhuna. Përveç policisë, pak njerëz identifikuan institucionet ose organizatat tjera si vende për ofrimin e ndihmës. Përqindja e të anketuarve të cilët do të kontaktonin MV-të është rritur pak nga 4% në vitin 2008 në 13.4% në vitin 2015, dhe përqindja e atyre që do të kontaktonin OJQ-të është rritur nga 7.4% në 10.2%.[184] Përqindja e njerëzve që do të kontaktonin Qendrat për Punë Sociale ka mbetur e ngjashme (13.2% në vitin 2008 dhe 13.9% në vitin 2015). Vetëm 6.9% përmendën avokatët, 2.5% psikologët, 1.9% strehimoret, dhe 0.6% mjekët.

Këto të dhëna sugjerojnë se pavarësisht numrit të madh të fushatave të vetëdijesimit të organizuara nga institucionet dhe OJQ-të, institucionet e Kosovës dukshëm ende nuk kanë bërë sa duhet ose nuk kanë pasur një mënyrë mjaft të përshtatshme për të informuar qytetarët ku ata mund të marrin mbështetje institucionale në rastet e dhunës në familje. Hapat e mëtejshëm mund të merren nga institucionet për të informuar popullatën lidhur me llojet e asistencës që ato ofrojnë.

Në përgjithësi, 14.1% e të anketuarve njohin një person i cili realisht ka raportuar një rast të dhunës në familje tek institucionet. Prej 184 rasteve të raportuara, policia erdhi në 92.8% të rasteve (167). Në rreth gjysmën e këtyre rasteve (91), personi i cili ka përjetuar dhunë është larguar nga shtëpia për të qëndruar diku tjetër. Në 80 raste (44.4%) të të anketuarve thanë se autori i krimit është arrestuar nga policia, dhe në 58 raste (32.2%) të anketuarve ishin në dijeni se çështja kishte shkuar në gjykatë. Në 36.7% të rasteve ata thanë se nuk ka shkuar në gjykatë, ndërsa në 28.9% të rasteve i anketuari nuk kishte informacion. Në 37 raste (20.6%) e të anketuarve thanë se autori i dhunës ishte dënuar, ndërsa në 88 raste (48.9%) kryerësi nuk është dënuar.

Ndërsa ishte e vështirë për të gjithë të anketuarit që të kishin informacion të plotë nëse personi që ata e njihnin kishte marrë apo jo ndihmë nga institucionet, 34 të anketuar thanë se personi ka marrë ndihmë nga një QPS, 22 nga një strehimore apo organizatë e grave, 24 nga një MV, dhe 32 ndonjë formë tjetër të ndihmës juridike.

Ndër të anketuarit që në fakt kishin përjetuar dhunë, shumë pak iu afruan apo kishin marrë ndihmë nga institucionet, duke e bërë të vështirë vlerësimin e reagimit institucional në sy të personave

të cilët kanë përjetuar dhunë. Vetëm 12 iu afruan policisë, katër strehimoreve, dy OJQ-ve, dy punëtorëve social, dy mbrojtësve të viktimave, gjashtë psikologëve, dhe tre gjyqtarëve.[185] Nga 25 persona të anketuar të cilët kishin probleme shëndetësore që kanë rezultuar nga dhuna në familje, vetëm 12 kanë vizituar një mjek. Kur u pyetën se pse ata nuk shkojnë te mjeku, të intervistuarit thanë se preferonin të vetë-mjekohen ose trajtojnë veten; ata nuk dëshironin; familja e tyre nuk do të lejojë që ata të shkojnë; frika; apo dëmtimet nuk ishin "edhe aq keq".

**Përballja me dhunën dhe adresimi i saj**

Ndër të anketuarit që kishin përjetuar dhunë, shumica (35) ka thënë se duke folur me miqtë dhe anëtarët e familjes (30) i bëri ata të ndjehen më mirë. Nga 23 e të anketuarve të cilët iu treguan shokëve në lidhje me dhunën që ata kishin vuajtur, të gjithë, përveç dy prej tyre thanë se ishin trajtuar mirë ose shumë mirë nga miqtë e tyre. Për ata që ju treguan anëtarëve të tjerë të familjes në lidhje me dhunën, më së shumti në mënyrë të ngjashme mendonin se anëtarët e familjes i trajtuan ata shumë mirë apo mirë. Pak prej tyre mendonin se ata ishin trajtuar keq ose shumë keq. Të tjerët thanë se ata ishin përballuar me dhunë, duke jetuar diku tjetër për një kohë; duke bërë diçka me duart e tyre (p.sh., qepje ose duke prerë dru); duke fjetur; apo duke mos folur.

RrGGK gjithashtu i pyeti të gjithë të anketuarit në përgjithësi se si ata mendonin që shoqëria dhe qeveria mund të ndalonte dhunën ose ta pakësojë dëmin e saj. Shumica e njerëzve mendojnë se personat që i nënshtrohen dhunës mund të merrnin mbështetje nga një psikolog, psikiatër, ose këshilltar (shih Grafikun 40). Përgjigjet tjera më të shpeshta kanë qenë që personat që i nënshtrohen dhunës mund të përdornin si ndihmë punësimin, këshillimin familjar, akomodimin e sigurt, apo strehimin. Të anketuarit gjithashtu përmendën qasjen në arsim, qasjen në kujdesin shëndetësor pa pagesë, ndihmën ligjore pa pagesë, ndihmën e sigurimit të një shtëpie, asistencës për sigurimin e tokës, dhe ndihmën me fillimin e një biznesi.

**Grafiiku 40. Opinionet e qytetarëve se si shoqëria dhe qeveria do të mund ta ndalonin dhunën ose t'i zvogëlonin dëmet**




Në lidhje me qasjen e qeverisë ndaj dhunës në familje, shumica e të anketuarve thanë se krijimi i më shumë vendeve të punës do të ishte ndër mënyrat më të mira për parandalimin e dhunës në familje (shih Grafikun 41). Përgjigja e dytë më e zakonshme ishte nevoja që qeveria të zbatojë dhe/ose fusë në zbatim kornizën ligjore ekzistuese lidhur me dhunën në familje. Të tjerë sugjeruan arsim më të mirë dhe rritjen e vetëdijesimit për qytetarët; duke i bërë dënimet për kryesit më të rënda; vendosjen mënjanë të më shumë resurseve për personat të cilët i janë nënshtruar dhunës (p.sh., strehimoret, etj); zhvillim ekonomik; dhe për të fuqizuar, edukuar dhe punësuar gra. Një numër më i vogël i të anketuarve

sugjeroi rritjen e ndihmës sociale, duke ofruar këshillim familjar, duke vizituar familjet që kanë përjetuar dhunë, dhe duke mbështetur OJQ-të që punojnë në këtë fushë.

Disa të anketuar thanë se qeveria është e padobishme apo që nuk punon; ata nuk besonin se qeveria do të veprojë mbi ndonjë nga rekomandimet e dhëna. Të tjerë thanë se dhuna në familje është një çështje e brendshme që duhet të trajtohet nga vetë familjet, dhe qeveria nuk duhet të ndërhyjë.

**Grafiku 41. Çfarë mund të bëjë qeveria për ta trajtuar më mirë dhunën në familje?**



# PARANDALIMI, MBROJTJA, NDJEKJA, REHABILITIMI: Reagimi institucional

Kjo pjesë analizon performancën e secilit institucion përgjegjës për sigurimin e parandalimit, mbrojtjes, ndjekjes, rehabilitimit dhe shërbimeve të riintegrimit,. Në të gjithashtu shqyrtohet se në çfarë mase këto institucione kanë një përgjigje të bashkërenduar. Gjetjet nxirren kryesisht nga intervistat me institucionet e ndryshme.

Një konsensus i përgjithshëm ekzistoi në mesin e të anketuarve të intervistuar se qëndrimet e përgjithshme dhe reagimet institucionale ndaj dhunës në familje janë përmirësuar që nga hulumtimi i RrGGK-së së vitit 2008, si dhe përmirësime vijuese në kornizën ligjore të vitit 2011. Pavarësisht progresit, një temë e përsëritur në mesin e të anketuarve ishte se ende "shteti nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme për gratë që raportojnë dhunë". Siç tha një punëtor social:

**"Ajo që kemi vënë re është se për njerëzit që vizitojnë [OJQ-në tonë] për të kërkuar ndihmë, ajo zakonisht është thirrja e fundit, pasi ta kenë raportuar atë në polici dhe shkuar në gjyq. Është thirrja e fundit për ndihmë, pasi nuk janë përkrahur nga askush".**
**-** Përfaqësues i OJQ-ve

> Ka disa hapa që mungojnë në procesin e ofrimit të shërbimeve nga ana e institucioneve. Prandaj, ju nuk mund t'i thoni lirshëm dikujt: "Vazhdo, raportoje rastin," sepse ju nuk mund t'i premtoni atij personi se institucionet do ta mbështesin atë deri në fund të procesit dhe se procesi nuk do të ngecë diku.[186]

Disa të anketuar të intervistuar gjithashtu vunë në dukje dallimet në njohuri dhe qasje në mesin e kolegëve, veçanërisht të gjeneratave të ndryshme, edhe pse ata kishin ndjekur trajnime të ngjashme dhe kishin të njëjtat role dhe përgjegjësi ligjore.

RrGGK kishte vërejtur përparim në njohuri institucionale dhe qasje në krahasim me intervistat e zhvilluara me zyrtarë në vitet e mëparshme. Megjithatë, ka pasur disa zyrtarë (një MV dhe një polic NJHDHF në veçanti) që mbetën të njëjtë si në vitin 2008. Për shembull, ata ende besonin se ishte e pranueshme që një burrë ta rrihte gruan e tij kur ajo nuk e kishte përgatitur drekën ose kur ajo shikon shumë telenovela. Deklarata të tilla tregojnë për besimet në mes disa përfaqësuesve të institucioneve që mund të minojnë aftësinë e tyre për të përmbushur përgjegjësitë e tyre ligjore për të mbrojtur personat të cilët kanë pësuar dhunë në familje.

### Fajësimi i viktimës

Termi "fajësimi i viktimës" i referohet tendencës për të konsideruar viktimën pjesërisht ose plotësisht përgjegjëse për krimin apo veprimin e gabuar të kryer ndaj tyre. Në Kosovë, fajësojnë gratë për dhunën që ato e vuajnë. Të anketuarit e institucioneve gjithashtu vënë barrën e adresimit të dhunës në familje vetëm mbi gratë . Deklaratat e mëposhtme thonë:

> "Ligji nuk funksionon. Zakonisht policia thonë: "Ky ishte faji juaj. Ndoshta keni bërë diçka të gabuar. Burri juaj ju rrah, sepse ju keni bërë diçka". - Përfaqësues i OJQ-së

> "Secili percepton gjërat në mënyra të ndryshme. Nganjëherë ata thonë se ky është faji i gruas sepse ajo bëri diçka apo nuk e respektoi atë, dhe ajo shkoi deri në pikën që ai nuk kishte zgjidhje, prandaj duhej përdorur dhuna". - Mësues

> "Burrat nuk do të falen për dhunën, por gratë duhet të dinë detyrat e tyre në familje". - Zyrtar i Policisë

> "Nëse një grua përballet me dhunën në familje, gjëja më e mirë është që ajo të qëndrojë në dhomën që e kemi këtu derisa burrat, partnerët e gruas shqiptare, të jenë më të vetëdijesuar lidhur me dhunën në familje". - Zyrtar i Policisë

> "Gjëja më e mirë që një grua që përballet me dhunën në familje mund të bëj është që së pari të përpiqet që të gjej një gjuhë të përbashkët me burrin e saj. Nëse kjo nuk funksionon, të përpiqet të gjej ndihmë nga rrethi (familja, miqtë)". - Zyrtar i Policisë

> "Një grua që përballet me dhunë në familje duhet ta raportojë atë në polici dhe në një OJQ, të heq veten nga situata të dhunshme, të arsimohet në qoftë se ajo nuk është, dhe të sigurohet që nëse ajo ka fëmijë ata të mos viktimizohen". - Psikolog shkolle

Veçanërisht i gjithë fokusi i këtyre deklaratave bazohet në atë që gratë duhet *të bëjnë*. Supozimi themelor është se nëse gratë janë komunikuesit më të mirë apo kryejnë më mirë 'detyrat' e caktuara shoqërore në familje apo e kontrollojnë më mirë veten e tyre, atëherë dhuna nuk do të ndodhë. Duke "fajësuar viktimën" këta përfaqësues të institucioneve nuk përfillin krejtësisht fuqinë që burrat kanë mbi gratë dhe nevojën për ndryshimin e sjelljes së burrave. Ekziston një vëmendje e pamjaftueshme për përgjegjësitë e personave që kanë kryer dhunën dhe se si ata duhet të marrin përgjegjësinë për ndryshimin e sjelljes së tyre, si dhe kompensimin e viktimës për dëmet, aty kur është e zbatueshme. Dështimi për të adresuar sjelljen e burrave thjesht përforcon rolet gjinore që krijojnë një mjedis të përshtatshëm për të ndodhur dhuna, duke e vendosur gruan para rrezikut të dhunës së vazhdueshme. Kjo ka gjasë që të përforcohet nga dështimi i shtetit për të ofruar programe rehabilituese adekuate, duke përfshirë këshillimin psikologjik, për kryesit.

Në të njëjtën kohë, ka rezistencë në mesin e disave, megjithëse jo te të gjithë, burra dhe gra brenda institucioneve, për trajtimin e këtyre, roleve tradicionale, gjinore patriarkale. Bazuar në deklaratat e bëra gjatë intervistave, disa burra prokurorë, gjyqtarë, dhe policë ende mendojnë se burrat duhet të kenë fjalën e fundit dhe që pushteti i tyre nuk duhet të minohet.[187] Një punëtor social komentoi: "Ka mendime në mesin e burrave se gratë janë duke kërkuar shumë të drejta. Është e vështirë për ata [burra]; që gratë të kenë më shumë të drejta në ditët e sotme, pasi ata [burrat] janë mësuar të dominojnë".[188] Në mënyrë që të kryejnë detyrat e tyre për parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e personave të cilët kanë përjetuar dhunë, është thelbësore që të gjithë përfaqësuesit e institucioneve të kuptojnë shkaqet rrënjësore të dhunës, domethënë pushtetin dhe kontrollin, dhe përcaktimin për t'i adresuar këto në mënyrë aktive.

### Pajtimi

Supozimet e ndërlidhura ngushtë, ato tradicionale dhe ato të ndikuara në mënyrë shoqërore në lidhje me rëndësinë e familjes dhe se si gratë do të jenë "më së miri" mund të parandalojë zyrtarët nga zbatimi i detyrave të tyre për të mbrojtur të drejtat e grave. "Në qoftë se ajo ka fëmijë, gjëja më e mirë për të bërë është që të përpiqen për t'i bërë ata [gruan dhe burrin] së bashku, nëse dhuna nuk është e shkallzuar, në mënyrë që fëmijët të mos rriten në rrugë ose me nënën e tyre e cila nuk ka të ardhura," tha një zyrtar i policisë. Nevoja që një çift të "përpiqet të arrijë mirëkuptim", ishte një temë që rishfaqej në mesin e përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme.[189] Ata thanë se u përpoqën të "pajtojnë" familje nëpërmjet "këshillimit". Arsyet e dhëna për këtë qasje përfshinë mirëqenien e fëmijëve, paaftësinë e grave për të mbijetuar në mënyrë të pavarur për shkak të mjeteve të pamjaftueshme ekonomike, dhe mungesën e përkrahjes institucionale në dispozicion për gratë që kanë përjetuar dhunë. Veçanërisht, këto arsye të gjitha bien përsëri mbi supet e vetë institucioneve dhe dështimin e institucioneve për të siguruar mbështetjen e duhur për gratë ashtu siç është paraparë me kornizën ligjore. Më tutje, për shumicën e institucioneve këshillimi apo një rol i pajtimit nuk është paraparë në kuadër të kompetencave apo përgjegjësive të tyre. Një qasje e tillë mohon të drejtat e personave që kanë përjetuar dhunë (zakonisht gratë), mund të dështojë për të mbrojtur personat nga vuajtjet e dhunës në të ardhmen, dhe shkel përgjegjësitë ligjore të institucioneve për të adresuar krimet e kryera.

### Kuptimi i traumës dhe qasja

Kuptimi dhe komunikimi me personat të cilët i janë nënshtruar dhunës kërkon që traumat, si dhe presionet sociale, siç është përshkruar më parë, të kuptohen. Jo të gjithë përfaqësuesit e institucioneve kishin qasje të duhur në punën me personat që kishin përjetuar dhunë dhe të cilët kishin të ngjarë të kishin përjetuar traumë. Për shembull, një zyrtar i policisë komentoi:

> Shpesh nuk është e qartë se i kujt ishte faji. Ju duhet të dëgjoni të dyja palët dhe pastaj të vendosni. Shpesh viktimat për shkak të presionit na thonë diçka të ndryshme nga ajo që ata i thonë gjykatës. Për shembull, ato deklarojnë se është kërcënuese për jetën e tyre për të jetuar me kryesit dhe pastaj në gjykatë ato ndryshojnë tregimet e tyre.

Një tjetër zyrtar tha: "70% e grave gënjejnë". Një grua që ka vuajtur nga dhuna mund të ndryshojë tregimin e saj ose mendjen e saj për shkak të traumave që ajo vuan ose për shkak të presionit shoqëror, veçanërisht nga anëtarët e familjes. Në raste të tilla, është e rëndësishme që institucionet të kuptojnë personin që ka pësuar dhunë dhe arsyen se pse ato mund t'i ndryshojnë deklaratat e tyre (p.sh., për shkak të presionit social). Të gjitha institucionet dhe policia në veçanti kanë nevojë për trajnim të mëtejmë në mënyrë specifike për traumën dhe se si të flasin me gratë që kanë pësuar trauma.

### Konfidencialiteti

**"Është e vështirë në Kosovë, sepse ne jemi njerëz që i duam thashethemet."**
– Mbrojtës i Viktimave

Konfidencialiteti gjithashtu mbetet një sfidë për gjitha institucionet. "Është problem, sepse ne jemi një vend i vogël dhe njerëzit flasin", tha një zyrtar i policisë. "Në vende të vogla është vështirë që të mbahen rastet konfidenciale, sepse të gjithë e njohin njëri-tjetrin," u pajtua një tjetër i anketuar. "Ne patëm një rast në Dragash, ku një grua tha: "Si mund të shkoj në polici kur polici është xhaxhai i burrit tim?" Një tjetër shqetësim ishte se meqenëse institucione të ndryshme janë të përfshira në rastet e dhunës në familje, duket se nga dikush rrjedh informacioni, dhe pastaj ishte e vështirë të kuptohet se kush ishte përgjegjës. Një zyrtar i policisë tha se strehimoret kanë zbuluar vendndodhjen dhe mediet kanë bërë publike emrat e personave që vuajnë nga dhuna, duke i vënë ata në rrezik të mëtejshëm. "Unë do të doja të mbyllë institucionet", tha një zyrtar i policisë. "Kështu që ata të mbajnë gjërat konfidenciale, dhe në këtë mënyrë ata nuk do të ecin përreth duke thënë: "Unë e bëra këtë gjë. Kam takuar këtë person". Në të vërtetë kjo është vendimtare për mirëqenien dhe mbrojtjen e personave që vuajnë nga dhuna.

Përderisa në këtë pjesë janë shikuar prirjet dhe çështjet e përsëritura në të gjitha institucionet përgjegjëse për adresimin e dhunës në familje, pjesët që pasojnë shqyrtojnë institucionet individuale dhe shkallën në të cilën ato kanë përmbushur rolet dhe përgjegjësitë e tyre në përputhje me kornizën e aplikueshme ligjore.

## Koordinatori Nacional kundër Dhunës në Familje

Koordinatori Nacional kundër Dhunës në Familje është përzgjedhur automatikisht si personi që shërben si Zëvendës Ministër i Drejtësisë dhe ka mandatin që, mes përgjegjësve të tjera, të mbikëqyrë zbatimin e Programit të Kosovës kundër Dhunës në Familje, të koordinojë punën e Grupit Koordinues Ndërministror Kundër Dhunës në Familje dhe të monitorojë zbatimin e aktiviteteve që lidhen me implementimin e PNV-së.[190] Caktimi i Koordinatorit Nacional ka synuar të përsërisë shembullin pozitiv të Koordinatorit Nacional kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, me zyrë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Në fillim ka pasur debate lidhur me atë se ku do të duhej të vendosej zyra e Koordinatorit Nacional kundër Dhunës në Familje: në ABGj, Ministri të Drejtësisë, apo MPMS. Në veçanti disa akterë ndërkombëtarë, kanë qenë të mendimit që MPMS-ja është e mbingarkuar tashmë me përgjegjësi të tjera. Për këtë arsye, u inkurajua vendosja e Koordinatorit në Ministrinë e Drejtësisë.[191] Ideja e pasjes së një koordinatori nacional të emëruar politikisht ka qenë që të sigurohet një përmirësim i vullnetit politik.[192] RrGGK-ja në atë kohë, pati shprehur shqetësim se kjo do ta vinte drejtësinë lidhur me

dhunën në familje në një fokus shumë të ngushtë dhe egocentric. Kjo do të mund të nënkuptonte se nuk do të kishte vëmendje të mjaftueshme për qasjen holistike që duhet për të adresuar rehabilitimin dhe, po ashtu, ri-integrimin.

Pas krijimit të pozitës së koordinatorit nacional, Kosova kaloi një proces të stërgjatur të zgjedhjeve parlamentare, gjë e cila për disa muaj e la Kosovën pa koordinator nacional të emëruar, duke shkaktuar kështu zvarritje në koordinimin dhe hartimin e një Programi të ri dhe një PNV-je. Për këtë shkak, do të ishte e këshillueshme që të krijohej një sekretariat i përhershëm që udhëhiqet nga nëpunës civilë. Me një buxhet të mjaftueshëm qeveritar dhe me përgjegjësi të qarta, Sekretariati do të mund të zhvillonte ekspertizë në këtë fushë, e cila do të vazhdonte të vepronte pavarësisht ndryshimeve gjatë kohës në lidershipin politik. Veç kësaj, do të mund të krijohej një grup punues ndërministror kundër dhunës në familje. Kjo do ta përmirësonte koordinimin midis institucioneve kyçe dhe palëve të tjera të interesuara në nivel qendror, në drejtim të një adresimi më të mirë të dhunës në familje në Kosovë, duke përmirësuar shërbimet që u ofrohen personave që kanë vuajtur dhunë në familje dhe kryesve të veprave penale, duke parandaluar kështu recidivizmin. Me anë të përfshirjes së shërbyesve civilë, shoqërisë civile, dhe palëve të tjera kyçe të interesuara, grupi do të mund t'i bënte ballë ndryshimeve në qeveri, duke ruajtur kështu ofrimin e qëndrueshëm të shërbimeve në drejtim të adresimit të dhunës në familje.[193] Koordinatori Nacional, në bashkëpunim të ngushtë me këtë grup, duhet të krijojë edhe një zgjedhje të qëndrueshme qeveritare për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të Ligjit, Programit të ri, dhe PNV-së së re, gjë e cila deri më sot nuk ka ekzistuar.

## Policia

Policia e Kosovës heton krime që lidhen me dhunën në familje dhe i referon viktimat e dhunës tek shërbime të tjera. Policia mbështet ndjekjen penale për krimet që kryhen brenda familjes, në pajtim me Kodin Penal të Kosovës (KPK). Siç u theksua, KPK-ja parashikon ndjekje penale *ex officio* (sipas detyrës zyrtare) për rastet e krimeve të lëndimeve të lehta trupore, ato të lëndimeve të rënda trupore, kushteve skllavërore, punës së detyruar, përdhunimit, dhe ngacmimit seksual, kur këto ndodhin brenda familjes.[194] Shkelja e urdhrave për mbrojtje konsiderohet si bazë për hetime dhe ndjekje penale *ex officio*, edhe sipas Ligjit të Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.[195] Edhe policia mund ta zbatojë këtë ligj duke lëshuar urdhra për mbrojtje të përkohshme emergjente jashtë orarit të punës së gjykatave.[196] Policia duhet ta shoqërojë viktimën me qëllim që ai/ajo të marrë sendet personale, t'i përgjigjet çfarëdolloj njoftimi për kërcënime apo akte të dhunës në familje ose, në rastet kur ekzistojnë dyshime se kanë ndodhur akte të dhunës në familje, t'i arrestojë menjëherë kryesit që dyshohen se kanë kryer vepra penale.[197] Krahas një linje të rregullt telefonike për të kontakt me policinë, është krijuar edhe një numër publik falas për thirrjet që kanë të bëjnë me dhunën në familje, e cila është e hapur nga ora 8:00 deri në orën 22:00: 0800 11 112. Megjithatë, numri i kufizuar i orëve të operimit nuk është në harmoni me mbështetjen e vazhdueshme që parashikohet në Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje që të ofrohet nga ana e policisë.[198] Me qëllim që ta kryejë në mënyrë efikase mandatin e saj, policia ka themeluar Njësitë e Hetimeve për Dhunë në Familje (NjHDhF), të cilat ndodhen në çdo komunë dhe përbëhen nga një grua dhe një burrë.

Rritja e qartësisë së procedurave raportohet se e ka lehtësuar punën e zyrtarëve të policisë gjatë viteve të fundit.[199] Krahasuar me akterët e tjerë, policia ka demonstruar se ka njohuri më të mëdha për përgjegjësitë dhe detyrat e saj, në pajtim me PSV-të. Një vlerë e shtuar për policinë ka qenë ajo se PSV-të janë shumë të ngjashme me procedurat e përgjithshme operuese të policisë. Megjithëse pjesa më e madhe e oficerëve të intervistuar dukej se kishin njohuri për PSV-të, disa nuk kishin. Pjesa më e madhe e oficerëve të policisë, në mos të gjithë, e njihnin politikën e policisë për konfidencialitetin, në mënyrë të veçantë lidhur me identitetin e viktimave dhe të të dyshuarve. Disa respondentë, gjatë intervistave, vunë në dukje ekzistimin e mungesës së njohurive në disa prej lokacioneve lidhur me lëshimin e urdhrave të përkohshëm për mbrojtje emergjente nga ana e policisë, ndërsa në disa raste respondentë të tjerë u shprehën se policia nuk e kryente mirë këtë detyrë.[200] Në të njëjtën kohë, raportohet se informatat lidhur me shkeljet e urdhrave për mbrojtje nuk i janë vënë në dispozicion policisë, edhe pse policët janë të parët që mbërrijnë në skenat e dhunës në familje dhe duhet të përcaktojnë nëse është shkelur urdhri i mbrojtjes.[201]

Të gjithë policët kanë ndjekur në Shkollën e Policisë së Kosovës trajnime të detyrueshme, themelore, në kohëzgjatje një javore, lidhur me dhunën në familje, ndërkohë që zyrtarët e NjHDhF-ve ndjekin trajnime shtesë për PSV-të, si dhe për kornizën më të gjerë ligjore, e cila lidhet në mënyrë specifike me dhunën në familje. Krahas trajnimit të institucionalizuar të deritanishëm, një prej qëllimeve të PNV-së ka qenë "ta zhvillojë më tutje kapacitetin e PK-së me qëllim të ndryshimit të qasjes ndaj dhunës, viktimave dhe keqbërësve".[202] Lidhur me këtë, janë organizuar disa trajnime për policinë, duke përfshirë organizatat ndërkombëtare. Trajnimet kanë pasur të bëjnë me temat ku bëjnë pjesë ri-integrimi i viktimave dhe fëmijëve viktima, kanë thënë zyrtarët. Në këtë mënyrë, respondentët kanë prirje të bien dakord që ky qëllim i PNV-së është arritur, së paku në mënyrë të pjesshme. Megjithatë, disa oficerë të policisë kanë shprehur shqetësimin se "në trajnime shkojnë vetëm njerëzit që kanë të njohur", në veçanti në vizitat studimore jashtë vendit, edhe pse këta zyrtarë mund të mos merren në mënyrë të drejtpërdrejtë me trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Më tej, lidhur me këtë, disa policë thanë se nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim për dhunën në familje. Pavarësisht përmirësimeve, ende ekziston nevoja për trajnime shtesë, thanë respondentët, me qëllim që të sigurohet që zyrtarët e policisë të marrin trajnimin bazë të mjaftueshëm. "Ndonjëherë ndodh që ndonjë oficer i patrullimit të shkojë e të trajtojë ndonjë rast dhe s'di se çfarë të bëjë," tha një zyrtar i NjHDhF-së. Mungesa e stafit në stacionet e policisë mund të lërë të nënkuptohet se oficerët patrullues duhet medoemos të dinë se si të merren me raste të tilla në situata emergjence.

Sikurse është paraparë në pikën 2.2.2 të PNV-së, disa stacioneve të policisë u janë vënë në dispozicion pajiset e duhura, kryesisht nga ana e akterëve ndërkombëtarë. Këto pajisje kanë qenë kompjutera, printera, kamera, telefona mobilë, lodra për fëmijë, kolltukë, si dhe meremetimi i së paku shtatë sallave të hetimit të dhunës në familje, të përshtatura për pritjen e fëmijëve, në stacionet e policisë. Ndërkohë që disa stacione të policisë përkrahen me fonde për krijimin e sallave miqësore ndaj fëmijëve për intervistimin e tyre, të tjerat ende kanë mungesa në hapësirë dhe materiale për fëmijët. Një oficer u shpreh:

> Është shumë problematike kur fëmijët vijnë në stacionin e policisë. Ne nuk kemi fonde për t'u blerë ushqime, në rast se janë të uritur, apo ndonjë vend ku mund t'i dërgojmë ndërkohë që i marrim në pyetje prindërit e tyre. Procedurat në stacionin policor mund të zgjasin nga një deri në gjashtë orë, ndërsa prindërve u duhet të qëndrojnë aty për nevojat tona. [...] Ku mund t'i dërgojmë fëmijët për t'u relaksuar, ose si t'ia bëjmë që të mos e kuptojnë këtë situatë të vështirë?[203]

Shumë prej oficerëve të policisë thanë se ende nuk i kanë hapësirat dhe pajisjet e mjaftueshme, duke përfshirë automjetet, kamerat dhe impulset telefonike.

Gjithashtu, duke u mbështetur në PNV, policia duhet ta vënë popullsinë në dijeni për institucionet ku munden të raportojnë rastet e dhunës në familje. Përmes policimit në komunitet dhe takimeve të tjera me qytetarët, policia mbetet njëra prej pak institucioneve që është në kontakt në mënyrë proaktive me qytetarët, duke i informuar ata lidhur me institucionet që ofrojnë mbrojtje kundër dhunës në familje. Megjithatë, komentet që kanë bërë disa zyrtarë të NjHDhF-së lënë të kuptohet se ata mund të mos ofrojnë të gjitha informatat më të sakta (shihni më poshtë).

Respondentët, gjatë intervistave, në përgjithësi kanë komentuar se policia është efikase dhe serioze në punën e saj, duke vënë në dukje edhe përmirësimet që janë bërë me kalimin e kohës. "Ekziston sensibilizimi lidhur me dhunën në familje në nivel institucional. Neve na është dashur të punojmë dhe ta reformojmë policinë, me qëllim që ata të kuptojnë se rastet e dhunës në familje duhet të menaxhohen në rrugë institucionale."[204] Një respondent tjetër është shprehur se ka rritje të sensibilizimit në radhët e policëve lidhur me mënyrën e shmangies së ri-viktimizimit të personave të cilët raportojnë raste të dhunës në familje. [205] Në pjesën më të madhe, intervistat me policinë lënë të kuptohet se perceptimi dhe qasja e tyre në dhënien e ndihmës për personat që kanë vuajtur nga dhuna në familje ka pasur prirje të përmirësohet. Megjithatë, disa komente të bëra nga zyrtarë të policisë, lënë të kuptohet se kultura dhe fajësimi i viktimës mund të ndërhyjë në aftësinë e tyre për t'i zbatuar me

efektivitet detyrat që ata kanë."[206] "Ti ke akoma policë që mendojnë që ajo [dhuna në familje] s'është problem në disa raste", [207] tha një respondent. Për shembull, një zyrtar i NjHDhF-së tha:

> Zakonisht pas këtyre fushatave ka një rritje të raportimeve. Ndonjëherë është gjë e mirë t'i informosh, ndonjëherë jo. E kam fjalën që kjo gjë e mirë është, por mirë është edhe që t'i informosh për marrëdhëniet dhe përgjegjësitë brenda familjes, dhe jo vetëm për ligjin. Pas punës, shkojmë në shtëpi dhe merremi me punët e shtëpisë. Njëlloj si në institucione, edhe në familje secili ka përgjegjësitë e veta. Tani, nëse gruaja ulet dhe sheh televizor kur burri vjen dhe ushqim nuk ka, është normale që do të krijohen tensione dhe ndonjëherë do të ushtrohet edhe dhunë.[208]

Komentet që kanë bërë disa oficerë të policisë lënë të kuptohet se jo të gjithë zyrtarët mendojnë se dhuna në familje është diçka që ia vlen të raportohet apo se ndaj saj duhet të ndërmerren veprime:

> Nuk po them që nuk duhet kërkuar ndihmë kur ndonjë grua është viktimë e dhunës së përsëritur në familje, sepse është e vështirë ta rehabilitosh [personin që ka pësuar] dhunën në familje. Por, as nuk po them që duhet shkuar menjëherë te policia dhe t'i kërkosh ndihmë, ose te zyra e mbrojtësit të viktimave. Natyrisht që dyert do të jenë gjithmonë të hapura, mirëpo ne jemi SHQIPTARË. Edhe ligji na e lejon që t'i rregullojmë vetë disa gjëra të vogla, që të mundohemi dhe të gjejmë zgjidhje.[209]

Është shqetësues fakti se disa zyrtarë të NjHDhF-së e konsiderojnë dhunën në familje si diçka normale në situata të caktuara. Komentet e tyre lënë të kuptohet se zyrtarët mund të jenë duke përforcuar rolet tradicionale gjinore, të cilat krijojnë një mjedis që e mundëson dhunën, sikurse edhe është diskutuar më sipër. Nuk arsyetohet mos-reagimi i zyrtarëve ndaj çfarëdolloj njoftimi për dhunë në familje, qoftë raporti i parë, qoftë raporti i njëqindtë; qoftë njoftim për dhunë fizike, qoftë për dhunë psikologjike; pavarësisht nëse zyrtarët besojnë në mendimin e tyre personal lidhur me atë nëse gruaja i ka kryer përgjegjësitë e saj në shtëpi apo jo.

Te disa prej oficerëve të policisë mbizotëron edhe ideja se dhuna duhet të jetë serioze dhe intensive për t'iu raportuar policisë. "Unë akoma besoj se gratë duhet të raportojnë vetëm nëse ka dhunë *të vërtetë* në familje", është shprehur një oficer. "Ne kemi një mendësi të përbashkët që është e papranueshme që gruaja të raportojë për dhunë thjesht për një shuplakë, edhe pse unë vetë jam feminist." Edhe ky pohim sugjeron se ka mungesë të njohurive dhe të të kuptuarit lidhur me atë se çka është dhuna në familje, në pajtim me ligjin e Kosovës, dhe për ndikimet negative që mund të kenë format e dhunës psikologjike dhe jo-fizike.

Edhe pse 73.6% e kosovarëve e identifikojnë policinë si vendi ku merret ndihma (meqë pak persona dinë për institucionet e tjera që ofrojnë ndihmë), 24.9% vazhdojnë të mendojnë se "nuk ka kuptim t'i telefonosh policisë kur ka raste dhune sepse policia nuk bën asgjë." Në të vërtetë, respondentët, gjatë intervistave, kanë dhënë hollësi lidhur me disa raste nga përvoja personale të disa njerëzve që ata i njohin, ku "policia erdhi, por nuk u bë gjë".[210] Më tej, një përfaqësues i një organizate që ndihmon personat me aftësi të kufizuara u shpreh se kur njerëzit me aftësi të kufizuara marrin zemër të raptojnë dhunën, policia i "ofendon" ata.[211] Me disa policë duhet bërë punë shtesë, për t'ua theksuar më tej të drejtat e personave që kërkojnë ndihmë.

Mes respondentëve, viktima të dhunës, vetëm 12 prej tyre i kanë telefonuar policisë. Nga këta, tetë thanë se "janë trajtuar mirë" dhe njëri tha se ishte trajtuar "mirë", ndërsa dy gra thanë se ishin trajtuar "keq", ndërsa një burrë tha se ishte trajtuar "shumë keq". Respondentët, gjatë intervistës, kanë përmendur raste ku policia ka ardhur në vendngjarje dhe nuk e ka arrestuar keqbërësin.[212] Në një rast, "burri i gruas që dhunohej ishte polic. Prandaj ai nuk ishte arrestuar apo dënuar. Policia nuk bëri asgjë, pasi bashkëshortja e kallëzoi në polici".[213]

Disa respondentë kanë raportuar se në familjet që ata njihnin kishte dhunë recidiviste, por thanë se policia "kishte ardhur vetëm sa për ta qetësuar gjendjen". Në disa raste, kryesit mesa duket kishin njerëz të njohur në radhët e policisë, të cilët i kishin liruar ata. Disa respondentë kanë raportuar edhe raste ku policia thjesht e ka arrestuar keqbërësin, por e kanë liruar atë pas një kohe të shkurtër.

"Viktima e ka kallëzuar bashkëshortin e saj disa herë në polici," tha një grua nga Peja. "Burrin ia arrestuan, por e mbajtën në burg për disa orë dhe e liruan menjëherë. Në fund, viktima u divorcua nga bashkëshorti i saj." Ky rast dhe raste të tjera specifike që janë përmendur nga respondentët gjatë anketës lënë të kuptohet se mund të vazhdojnë të ketë raste ku policia e konsideron arrestimin afatshkurtër si dënim të mjaftueshëm, edhe pse ata nuk janë të autorizuar të marrin vendime të tilla. [214]

Në raste të tjera, "pajtimi" midis anëtarëve të familjes bëri që policia t'i hidhte poshtë akuzat e ngritura kundër kryesve. Ja shembulli i tregimit të një respondenti: "Ndodhi në mbrëmje. E morën në telefon policinë, e cila erdhi, e mori keqbërësin, dhe e mbajti një natë në stacionin e policisë. Pas kësaj, ia morën në telefon të shoqen që ajo të jepte një deklaratë dhe ajo e fali atë, kështu që e liruan."[215] Megjithatë, policia nuk ka autoritet që të lirojë kryesit e dyshuar nga akuzat penale, pas mbajtjes afatshkurtër, apo të hedhë poshtë akuzat penale për shkak të "pajtimit" në familje. Sikurse thamë edhe më lartë, në pajtim me Kodin Penal, policia duhet të sigurojë që të gjitha krimet që kryhen brenda familjes duhet të hetohen *ex officio*.

Me pak fjalë, mes çështjeve që janë ende të pranishme brenda forcave të policisë, respondentët kanë përmendur mos-trajtimin me seriozitet të rasteve të kallëzuara nga gratë, dështimin në hetimin e të gjitha kallëzimeve penale për dhunë në familje, qasjen e dobët në komunikimin me personat që kanë pësuar dhunë në familje, si dhe korrupsionin.

**"Ne kishim një rast kur një viktimë nuk mund ta gjente raportin e saj në polici. Kryesi i veprës e kishte korruptuar një polic, prandaj dokumentat e saj u zhdukën. Ne nuk mundëm të mbledhim prova të mjaftueshme për të vërtetuar që ajo ka qenë viktimë e dhunës në familje."**

– Zyrtar për Ndihmë Ligjore

### Akademia e Kosovës për Siguri Publike

Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) organizon trajnimin dhe arsimimin e lartë për personat që kanë detyrimin të zbatojnë ligjet e Kosovës, duke përfshirë Policinë e Kosovës, Inspektoratin Policor, Shërbimin Sprovues të Kosovës, Shërbimin Korrektues të Kosovës, dhe Doganat. Krahas kurseve themelore të detyrueshme për këta zyrtarë, Sektori i Trajnimeve të Avancuara dhe të Specializuara në AKSP organizon trajnime për NjHDhF-të lidhur me "Hetimin e Dhunës në Familje".[216] Departamenti i Trajnimeve i përzgjedh të gjithë pjesëmarrësit. Trajnimet janë të detyrueshme për personat e përzgjedhur. Që prej vitit 2010, Akademia ka organizuar 20 trajnime të tilla. Secili sesion zgjatë pesë ditë intensive (35 orë). Gjithsej, janë trajnuar 281 zyrtarë (67 gra dhe 264 burra). Numri i ulët i pjesëmarrëseve mund të ndikojë në performancën e Policisë së Kosovës në ofrimin e shërbimeve të përshtatshme për personat që janë dhunuar në familje. AKSP-ja përballet edhe me pengesa të vazhdueshme që vijnë nga financimi i pamjaftueshëm në buxhetin e saj për mbulimin e kostove të trajnimit.

## Prokuroria

"Prokurori i shtetit ka detyrimin për të shqyrtuar provat e një incidenti të dhunës në familje për të përcaktuar nëse ekzistojnë prova të mjaftueshme për të justifikuar dhe mbështetur ndjekjen penale të rastit, kjo përfshin edhe çdo shkelje të urdhrave të mbrojtjes.[217] Pra, bashkëpunimi midis prokurorëve dhe policisë është vendimtar në rastet e dhunës në familje. Kur vihen në dijeni për një rast, prokurorët janë të detyruar të marrin veprime të menjëhershme lidhur me të dhe t'i japin përparësi, duke marrë parasysh specifikat e rastit. Prokurorët janë të detyruar edhe që të sigurojnë që gjatë intervistave me personat që kanë përjetuar dhunë, të jenë të pranishëm të gjithë personat që me ligj parashikohen të jenë të pranishëm, duke përfshirë personin që ka pësuar dhunën, MV-në, punonjësin social, prokurorin, dhe mjekët. Në detyrat e tjera të prokurorëve bën pjesë mbikëqyrja e punës së policisë, kryesisht e NjHDhF-ve, për të siguruar që ndërmerren të gjitha hapat për mbledhjen e provave. Pasi përfundojnë hetimet dhe kur provat janë të mjaftueshme, prokuroria, pa vonesë, duhet të ngrejë padi ose t'i hedhë poshtë akuzat. Të gjitha informatat që lidhen me rastin duhet të mbahen konfidenciale deri në momentin e ngritjes së akuzave, moment ky në të cilin informatat bëhen publike. I dyshuari mund të arrestohet dhe t'i shqiptohet masa e paraburgimit. Masat e paraburgimit mund të shqiptohen nga një gjyqtar i procedurës paraprake pas propozimit me shkrim të prokurorisë, pas

plotësimit të kushteve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. Në rastin e fëmijëve viktima, prokurori ka për detyrë të zhvillojë ndjekjen penale në mënyrën që i shërben interesave më të mira të fëmijës.[218]

Prokurorët janë shprehur se janë të vetëdijshëm për detyrat e tyre që parashikohen në PSV, por atyre u duhet infrastrukturë e përshtatshme me qëllim që t'i kryejnë detyrat që kanë. Prokurorët priren të thonë se qëndrimet dhe qasja e tyre ka mbetur e njëjtë me kalimin e kohës, meqenëse detyrat e tyre nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim thelbësor. Respondentë të tjerë kanë vënë në dukje sfida, siç është procedimi i ngadaltë i rasteve. "Rastet zakonisht mbeten në zyrën e prokurorit," tha një përfaqësues i një organizate që ndihmon personat që kanë përjetuar dhunë në familje. "Ata kanë thënë se policia nuk i ka sjellë asnjëherë para tyre rastet e raportuara, ndërsa policia thotë se rastet janë parashtruar në prokurori. Mes institucioneve ka komunikim të pamjaftueshëm. Ndonjëherë nuk ka prova të mjaftueshme." Në këtë mënyrë, ndërkohë që PNV-ja parashikon veprimet që duhet të ndërmerren nga prokuroria me qëllim të përmirësimit të performancës së tyre, duket se jo të gjithë prokurorët themelorë kanë vepruar kështu.

Prokuroria është në procesin e përditësimit të bazës së saj të të dhënave. Në këtë bazë të të dhënave do të përfshihen vetëm rastet e ndjekjes penale, pa informata të tjera nga institucione relevante, sikurse parashikohet nga PNV-ja.[219] PNV-ja ka parashikuar edhe hapësira shtesë për zyrat e prokurorëve. Prokuroria themelore në Komunën e Prizrenit është shprehur se ka hapësirë të mjaftueshme për të kryer detyrat e veta. Megjithatë, gjendja mbetet shumë e keqe në zyrat e prokurorive të tjera, duke përfshirë atë të Gjakovës dhe Mitrovicës. Një prokuror bëri këtë koment:

> Nuk kemi hapësira për marrjen në pyetje dhe tani për tani kjo përbën prioritet. Kur kemi ndonjë rast të ndonjë personi të traumatizuar ose raste kur përfshihen edhe fëmijët, e kemi shumë të vështirë t'i trajtojmë, meqenëse nuk mund të vazhdojmë me marrjen në pyetje ndërkohë që fëmijët janë të pranishëm. Nuk kemi ndonjë vend tjetër ku mund t'i dërgojmë këta fëmijë. Nuk mund t'i lëmë në koridor apo në të njëjtën sallë me viktimën.[220]

Prokuroria ka prokurorë të dedikuar, të cilët punojnë vetëm me rastet e dhunës në familje, dhe një gjë e tillë është parë si një hap pozitiv në drejtim të adresimit të këtyre rasteve. Prokurorët e intervistuar nga RrGGK-ja duket se janë të vetëdijesuar për detyrat dhe detyrimet që kanë, në pajtim me PSV-të, si dhe përgjegjësitë e tyre ligjore.[221] Megjithatë, intervistat me prokurorët rajonalë themelorë lënë të kuptohet se në rastet kur përfshihen fëmijë, prokurorët kanë prirjen të bëjnë lëshime kur shohin se personi që është përfshirë në dhunën në familje "shfaq keqardhje" për atë që ka bërë: "Ne i trajtojmë me më shumë përparësi rastet e dhunës në familje ku përfshihen fëmijët. Shpeshherë i "zbusim" rastet e dhunës në familje duke mos dhënë dënime, për shkak se bashkëshorti dhe bashkëshortja janë pajtuar, kështu që heqim dorë nga ajo çështje për të mos e përkeqësuar gjendjen."[222] Sikurse është diskutuar më sipër në lidhje me "pajtimin" në rastet e dhunës në familje, kjo qasje mund t'i kontribuojë recidivizmit. Respondentët kanë raportuar edhe raste të prokurorëve që e konsiderojnë dhunën në familje si çështje private dhe "familjare".

## Mbrojtësit e viktimave

Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV) gjendet në Zyrën e Prokurorit të Shtetit të Kosovës. Sipas PSV-ve, "Mbrojtësit e viktimave zakonisht takohen me viktimat menjëherë pas reagimit të policisë ndaj një rasti të lajmëruar të dhunës në familje. Përgjegjësia e Mbrojtësit të Viktimave është që të sigurojë se viktima kupton shërbimet që mund t'i ofrohen nga Shteti dhe si mund t'i pranojë ato."[223] Me mandatin e ri, sipas Kodit Penal të vitit 2013 dhe Kodit të Procedurës Penale, MV-të kanë një rol të përmirësuar në përfaqësimin e interesave të viktimave duke kërkuar në emër të tyre mbrojtje të të drejtave.[224] Deri më sot, MV-të kanë ndihmuar 2,920 raste të dhunës në familje.

ZMNV-ja ka një numër telefonik falas për personat që raportojnë dhe/ose marrin ndihmë lidhur me dhunën në familje: 0800 11 112. Operatori telefonik është i disponueshëm 24 orë në ditë, çdo ditë jave. I hapur në vitin 2005, ky numër ka qenë funksional që prej vitit 2011.[225] Sipas ZMNV-së, numri falas është një "mekanizëm konfidencial për raportimin e veprave të ndryshme penale të abuzimit, për

informimin e viktimave dhe personave të tjerë lidhur me të drejtat e tyre,sigurimin e informatave të nevojshme për shërbimet ekzistuese."[226] Që prej tetorit të vitit 2011 deri në qershor të vitit 2014, drejt numrit të linjës ndihmëse janë bërë më shumë sesa 1,105 thirrje lidhur me dhunën në familje, me një mesatare vjetore prej 335.[227] Edhe pse numri publik mbulon pjesën dërmuese të territorit të Kosovës, pjesa veriore e vendit mbetet e pambuluar. Kjo gjë ua bën të vështirë qytetarëve që jetojnë në veri që të kërkojnë ndihmë nga MV-të në raste të dhunës në familje.

ZMNV-ja ka prezantuar në vitin 2013 edhe një formular kërkese për nxjerrjen e urdhrave të mbrojtjes, i cili jep me hollësi kërkuesit, masat që mund të kërkohen, si dhe rrethanat e përshtatshme për kërkimin e urdhrave.[228] Më parë, kërkesa për urdhër për mbrojtje nuk përfshinte masat që parashihen për lëshimin e tij sipas ligjit. Formulari i ri i kërkesës ofron informata lidhur me masat e disponueshme që janë parashikuar nga ligji.

Në të kaluarën, RrGGK-ja i ka kritikuar autoritetet ku paraqiten ankesat, për kufizimin e përdorimit të masave që parashikohen nga Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. [229] Personat të cilët kanë pësuar dhunë në familje shpeshherë, pas muajve që kanë kaluar në strehimore, kanë nevojë për akomodim të përkohshëm, pagesë të qirasë dhe/ose pagesë të alimentacionit për fëmijët e tyre, si masa potenciale të parashikuara me ligj. RrGGK-ja ka vënë re se këto masa do të ndikonin në pavarësinë ekonomike të grave nga anëtarët burra të familjes, si dhe në rritjen e gjasave për raportim të dhunës në familje dhe largim nga situatat e dhunshme në familje. Megjithatë, në kërkesat e mëparshme, gjykatat rrallë herë i kanë përdorur këto masa. Pjesa më e madhe e urdhrave për mbrojtje janë përqendruar te lëshimi i një apo dy masave, siç është ndalimi i keqbërësit që t'i afrohet viktimës brenda një distance të specifikuar. Këto masa nuk i përmbushin nevojat më afatgjata të të mbijetuarave të dhunës.[230] Formulari i ri i kërkesës, i hartuar nga ZMNV-ja ka kërkuar t'i sensibilizojë më shumë viktimat për masat që ata mund të kërkojnë, duke kontribuar kështu në zgjerimin e gamës së masave që kërkohen nga ana e viktimave dhe që lëshohen nga gjykatat.[231] Kësisoj, kjo politikë duhet të shihet si zhvillim pozitiv nga ana e ZMNV-së. Megjithatë, mbetet të vlerësohet shkalla në të cilën janë kërkuar dhe zbatuar masat e ndryshme.

MV-të trajnohen më shumë sesa dy herë në vit për dhunën në familje, edhe pse disa respondentë kanë vënë në dukje nevojën për trajnime të mëtejshme me qëllim që ata të jenë mbrojtës më të fuqishëm. Një MV nxori në pah vështirësitë që lidhen me përgjegjësinë ligjore që ata kanë kur janë përfaqësues të autorizuar të viktimave dhe, në të njëjtën kohë, monitorojnë seancat në gjykata. "Është e pamundur t'i luash këto dy role gjatë një seance dëgjimore në gjykatë", tha ai.

Mbështetur në intervistat që RrGGK-ja ka kryer me MV-të, vihet re se shumica e tyre janë në dijeni për detyrat dhe përgjegjësitë që u janë parashikuar në PSV. Megjithatë, ndërkohë që disa MV besonin se, me ndryshimet e reja në kornizën ligjore, ka pasur përmirësime në qasjen dhe qëndrimet e tyre, të tjerët nuk shihnin ndonjë ndryshim të konsiderueshëm, meqenëse "misioni i tyre gjithmonë ka qenë lufta kundër dhunës në familje." Zyrtarë të tjerë kanë perceptime të përziera në raport me bashkëpunimin e tyre me MV-të lidhur me rastet e dhunës në familje. Policia dhe punonjësit socialë kanë tendencën të bashkëpunojnë mirë me MV-të dhe e vlerësojnë punën e tyre si pozitive. OJQ-të, strehimoret dhe akterët ndërkombëtarë kanë kritika që lidhen kryesisht me keqtrajtimin e viktimave të dhunës në familje (p.sh. bërtitja ndaj tyre), pikëpamjet tradicionale për normat gjinore, si dhe mos-informimin e policisë apo QPS-ve kur atyre u raportohet një rast. Krahas kësaj, MV-të raportohet se përpiqen që të kenë mirëkuptim të përbashkët rreth detyrave dhe përgjegjësive në rastet e dhunës speciale, posaçërisht pas ndryshimit të mandatit të tyre, bazuar në Kodin e ri Penal.[232] Duhen kryer hulumtime të tjera për të shqyrtuar mënyrën në të cilën mandati i ri i tyre ndikon në mbrojtjen praktike dhe asistencën ndaj viktimave të dhunës në familje.

## Zyrat për Ndihmë Juridike

Zyrat për Ndihmë Juridike u ofrojnë mjete juridike grupeve të rrezikuara të mbuluar nga asistenca sociale. Në vitin 2012, Ligji i Kosovës për Ndihmë Juridike Falas i ka përfshirë viktimat e dhunës në familje në listën e kategorive të personave që kanë të drejtë të nisin procedura për të kërkuar ndihmë juridike falas.[233] Në këtë kuptim, roli i Zyrtarëve për Ndihmë Juridike është i ndryshëm nga ai i MV-ve, të cilët menaxhojnë të gjitha rastet e krimeve. Në mungesë të dokumentacionit

përkatës për kategorinë e viktimave të dhunës, si bazueshmëri e kërkesës merret deklarata me shkrim e mbrojtësit të viktimave.[234] Ligji për Ndihmë Juridike Falas i informon zyrtarët posaçërisht për rëndësinë e konfidencialitetit.[235]

Sikurse kërkohet nga PNV-na, pika 2.3.1, Zyrat për Ndihmë Juridike kanë përgatitur dhe shpërndarë broshura për informimin e qytetarëve lidhur me ndihmën juridike. Këto zyra kanë ndjekur edhe trajnime për kornizën ligjore për dhunën në familje.

Ende mbetet shqetësim financimi i disa Zyrave për Ndihmë Juridike në Kosovë. Të varura nga financimet ndërkombëtare për një kohë të gjatë, tetë zyra janë mbyllur në qershor të vitit 2015.[236] Tashmë në Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë dhe Gjilan janë në funksion vetëm pesë Zyra për Ndihmë Juridike, të cilat financohen nga shteti. Këto financime nuk mjaftojnë për të mbuluar nevojat. Nevojitet një alokim i përhershëm në buxhet nga ana e Qeverisë së Kosovës me qëllim që të financohen të gjitha zyrat.

## Institucioni i Avokatit të Popullit

Dhuna në familje është një çështje që përfshihet në kategorinë e të drejtave të njeriut. Institucioni i Avokatit të Popullit është përgjegjës për adresimin e akuzave për shkelje të të drejtave të njeriut nga ana e shtetit.[237] Prandaj, në rast se ndonjë institucion i Kosovës, gjatë adresimit të ndonjë rasti të dhunës në familje, e keqtrajton viktimën e dhunës, kjo e fundit ka të drejtë ta raportojë rastin te Avokati i Popullit për hetim dhe ndihmë. Avokati i Popullit ka zyra rajonale në Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë, Gjakovë, Gjilan dhe Graçanicë. Zyrat rajonale kanë një njësi për Barazinë Gjinore dhe një Zyrtar për Barazinë Gjinore. Përsa i takon konfidencialitetit, punonjësit e Institucionit të Avokatit të Popullit duhet të nënshkruajnë një deklaratë që i detyron ata të mos zbulojnë informata. Klientët bien dakord për informatat që lejohen të ndahen me institucionet e tjera.

Avokati i Popullit duket se ka trajtuar vetëm një rast të dhunës në familje (në vitin 2012),[238] gjë e cila rezultoi me shkarkimin nga puna të një gjyqtari për mos-kryerjen e detyrave në pajtim me kornizën ligjore.[239] Rastet e tjera për dhunë në familje, që i janë drejtuar Avokatit të Popullit, u janë referuar institucioneve të tjera përkatëse ku mund të marrin ndihmë, meqenëse ato raste binin jashtë përgjegjësive specifike të Avokatit të Popullit.[240]

Avokati i Popullit konsideron se dhuna në familje bën pjesë në çështjet kryesore që duhet të adresohen nga organet qeveritare dhe jo-qeveritare.[241] Një shqetësim që ngriti Avokati i Popullit është mungesa e transparencës së organeve qeveritare për përgjegjësitë që lidhen me adresimin e dhunës në familje. Për shembull, Avokati i Popullit është i mendimit se Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadrin e Zyrës së Kryeministrit ka përgjegjësi për raportimin në parlament të hapave të ndërmarra në adresimin e dhunës në familje, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Megjithatë, ai tha se kjo nuk ka ndodhur ndonjëherë në praktikë.

Për Avokatin e Popullit, është me rëndësi vendimtare që të sigurohet që i gjithë zinxhiri i institucioneve që adreson dhunën në familje të funksionojë si duhet. Për shembull, ai e vlerëson mungesën e kompensimit për viktimat e dhunës në familje si një tregues domethënës që ky "zinxhir" nuk funksionon si duhet. Një pengesë tjetër që ka identifikuar Avokati i Popullit është edhe mungesa e mekanizmave monitorues për të gjitha institucionet përgjegjëse për adresimin e dhunës në familje. Ai tha se pengesat e tjera kanë të bëjnë me praktikat e ndryshme që ndjekin gjyqtarët në rajone të ndryshme, praktika këto të cilat nuk janë të unifikuara.

## Mbrojtja e dëshmitarëve

Disa respondentë kanë përmendur se mos-vënia e mbrojtjes në dispozicion të personave që raportojnë dhunën në familje i ka ndaluar ata nga raportimi i saj. Përveç urdhrave për mbrojtje, sistemi i Kosovës për mbrojtjen e dëshmitarëve të krimeve të dhunshme parashikon edhe masa të tjera, si: zhvendosja e dëshmitarëve, marrëveshjet dypalëshe midis Kosovës dhe shteteve të tjera për të mbrojtur rastet e ndjeshme që kërkojnë mbrojtje, si dhe mbështetja financiare për dëshmitarët nën mbrojtje.[242] Në Ligjin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve parashihet se ekziston një Komision për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, i cili përbëhet nga Kryeprokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës, Kryesuesi i Zyrës

së Hetuesisë së Policisë së Kosovës, si dhe Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, të inkuadruar brenda policisë.

RrGGK-ja nuk ka gjetur asnjë provë të viktimave të krimeve të dhunës dhe që kanë marrë mbrojtje si pjesë e sistemit të mbrojtjes së dëshmitarëve. Një raport i kohëve të fundit përmend mungesën e vullnetit politik dhe të mbikëqyrjes së Komisionit, si sfidat bazë për sigurimin e mbrojtjes së dëshmitarëve. [243]

Mënyra të tjera potenciale të mbrojtjes së dëshmitarëve mund të përfshijnë: sigurimin që gjatë procedurave përpara gjykatave, ata të jenë në gjendje të dorëzojnë dëshmi pa u përballur në mënyrë të drejtpërdrejtë me kryerësin; sigurimin që ata të mund të presin në dhoma të ndara nga kryerësi; dhe sigurimin e transportit të sigurtë për në gjyq dhe nga gjyqi. Në Kosovë, Kodi i Procedurës Penale parashikon që gjatë marrjes në pyetje në procedurën paraprake në rastet "më serioze", dëshmia e dëshmitarëve mund të transkriptohet fjalë për fjalë, të audio-incizohet, apo të video-incizohet.[244] Më pas "mund të përdoret si provë e drejtpërdrejtë nëse dëshmitari nuk është në dispozicion." Megjithatë, kjo nuk mund të jetë e vetmja provë dhe duhet të konfirmohet edhe nga prova të tjera. RrGGK-ja nuk ka mundur të mbledhë informata lidhur me atë nëse kjo është praktikuar në Kosovë në rastet e dhunës në familje. Mbrojtjet që janë të disponueshme për viktimat e dhunës në familje do të mund të përbënin një fushë e cila kërkon hulumtime të mëtejme.

## Procedurat civile përpara gjykatave themelore

Gjykatat luajnë një rol vendimtar në procesin e sigurimit të një trajtimi të drejtë dhe të ligjshëm të rasteve të dhunës në familje. Ato janë përgjegjëse për trajtimin në mënyrë të paanshme dhe me dinjitet të të gjitha palëve, duke përfshirë viktimat e dhunës në familje dhe kryesit e veprës penale. Si pjesë të procedurës civile, gjykatat shqyrtojnë kërkesat për urdhër të mbrojtjes dhe urdhrat për mbrojtje emergjente, duke vendosur për masat e mbrojtjes të cilat parashikohen nga Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Gjykatat janë të detyruara që të marrin vendime lidhur me urdhrat për mbrojtje brenda afateve ligjore të parapara në Ligj. Përsa u përket PSV-ve, gjykatat duhet t'i shqyrtojnë rastet e dhunës në familje si çështje me përparësi dhe urgjencë. Edhe kodi i etikës i gjyqtarëve u bën thirrje që të sigurojnë konfidencialitet të plotë lidhur me rastet, edhe pse disa gjyqtarë të intervistuar dukeshin që as nuk e dinin këtë dhe as nuk dinin se si funksiononte.

**"Ne e hartuam Komentarin e Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, pikërisht për të lehtësuar punën e gjykatësve dhe me qëllim që ata të mos gjendeshin të papërgatitur lidhur me atë se çka duhet bërë kur trajtojnë një rast të dhunës në familje".**
- Përfaqësues i ABGj-së

Në vitin 2014, ABGj-ja publikoi një komentar për Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, i cili synonte t'u ofronte udhëzime gjyqtarëve në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje.[245] Ky komentar u është shpërndarë gjithë gjykatave anembanë Kosovës. Më tej, Forumi i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve është në procesin e përgatitjes së një doracaku profesional për gjykatës dhe prokurorë, për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Instituti Gjyqësor i Kosovës ka trajnuar gjyqtarë për trajtimin e rasteve, duke nisur që nga momenti kur ato raportohen, e deri te interpretimi i dispozitave ligjore. Megjithatë, trajnimet nuk kanë qenë të detyrueshme dhe ka qenë në dorën e gjyqtarëve nëse do të merrnin pjesë ose jo.

Në përgjithësi, gjyqtarët kanë prirje të jenë të sensibilizuar për detyrat e tyre, në pajtim me PSV-të. Megjithatë, pak prej tyre janë të informuar për PNV-në ose përgjegjësitë që dalin prej tij. Për shembull, vetëm dy gjyqtarë kanë raportuar se kanë zbatuar aktivitetin 4.1.2 të PNV-së "ofrimi i shërbimeve dhe këshillimeve juridike falas për viktimat e dhunës në familje, si edhe ofrimi i mbrojtjes ligjore falas për këto viktima."

Mes respondentëve duket se ka një pajtueshmëri mjaft të gjerë që gjykatat e kanë përmirësuar performancën e tyre në lidhje me rastet e dhunës në familje, edhe pse ende ekziston nevoja për përmirësime të mëtejme. Disa respondentë e kanë konsideruar rastin e Diana Kastratit si kyç në influencimin e ndryshimit të sjelljeve. Një përfaqësues i OShC-së bëri këtë koment:

Në vitet 2010 dhe 2011, situata ka qenë shumë e keqe. [Përpara rastit të Diana Kastratit] ti kishe gjyqtarë që as e dinin se ekzistonte një ligj për dhunën në familje. Ata thoshin: "S'është fundi i botës se i dha i shoqi një shuplakë. Nga dashuria e ka bërë." Pas rastit të Diana Kastratit, ne nisëm një fushatë mediatike lidhur me këtë çështje dhe gjërat ndryshuan. Tashmë gjykatat kanë një gjyqtar të specializuar i cili merret me këto lloj rastesh. Kur janë specialistë në fushë, edhe qëndrimet që kanë u ndryshojnë. [246]

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për rastin e Diana Kastratit konsiderohet si një rast akull-thyes, në raport me dhunën në familje në Kosovë, sepse ai ka mobilizuar reagimin e gjyqësorit të Kosovës duke kërkuar që rasti i dhunës në familje, d.m.th. lëshimi i urdhrave për mbrojtje nga ana e gjykatave të Kosovës, të marrë përparësi në pajtim me afatet kohore të parapara nga Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Më tej, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka nxjerrë vendimin nr. 22/2012 si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, me anë të të cilit u kërkohet gjyqtarëve të Kosovës të veprojnë me shpejtësi lidhur me lëshimin e urdhrave për mbrojtje. Kjo gjë i ka ndryshuar kërkesat fillestare të Strategjisë së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra, e cila nuk i konsideronte rastet e dhunës në familje si çështje me prioritet.

**"Gjyqtarët këmbëngulin që gratë të kthehen në shtëpitë e tyre [ku është ushtruar dhuna]. Gjyqtarët nuk duan zgjatje të rasteve, meqë duan t'i përfundojnë rastet vetëm me një seancë gjyqësore. Nëse ajo [viktima] do të shkonte në strehimore, do të kishte më shumë vëllim pune, meqenëse do të zhvilloheshin më shumë seanca deri në vendosjen e rastit. Gjyqtarëve nuk u intereson për nevojat e grave".**

- Përfaqësues i një strehimoreje

Që prej asaj kohe, identifikimi i gjyqtarëve të gjykatave civile, të cilët janë të specializuar për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, është vlerësuar si një hap shumë pozitiv në drejtim të përmirësimit të reagimit institucional ndaj rasteve të dhunës në familje. Për më tepër, respondentët kanë përmendur dhënien prioritet të rasteve të dhunës në familje dhe përgjigjen në kohë të gjykatave në lëshimin e urdhrave për mbrojtje dhe urdhrave për mbrojtje emergjente, të cilat shihen si përmirësime të rëndësishme në reagimin e gjykatave ndaj rasteve të dhunës në familje.[247]

Pavarësisht këtyre përmirësimeve, ende ekzistojnë disa sfida. "Janë vërejtur vonesa në lëshimin e urdhrit për mbrojtje në rastet kur gjyqtarët e specializuar janë në pushim apo dalin në pension."[248] Për më tepër, sikurse është përmendur, RrGGK-ja ka raportuar në vitin 2009 se gjyqtarët kanë prirjen të përdorin vetëm disa prej masave të mundshme të cilat mund t'i përdorin si pjesë e urdhrave për mbrojtje. Të dhënat lënë të kuptohet se gjykatat kryesisht bëjnë pajtimin e çifteve. *Komentari i Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje*, të cilin e përmendëm më sipër, e shënonte këtë si diçka shqetësuese:

Është vërtetuar se në shumë raste, gjatë gjykimit të dhunës në familje, gjyqtarët e marrin rolin e pajtimit të viktimës dhe kryesit të dhunës në vend që të procedojnë dhe mbrojnë viktimën e dhunës ashtu siç kërkohet me ligj. Prolongimi - zvarritja e procedurave gjyqësore duke u fokusuar në pajtimin e palëve, ka sjellë pasoja në përsëritjen e dhunës në familje dhe mos ofrim i mbrojtjes adekuate për viktimën ashtu siç kërkohet me këtë ligj.[249]

Pjesën më të madhe të njerëzve të cilët kanë vuajtur nga dhuna në familje (duke përfshirë këtu edhe fëmijët) shpeshherë i kanë kthyer tek shtëpitë ku jetonin keqbërësit, pa e analizuar ndikimin që mund të ketë kjo në shëndetin e tyre mendor dhe fizik.[250] Në mënyrë alternative, gratë i kanë detyruar të shkojnë në strehimore. Disa respondentë nuk kanë rënë dakord me qasjen që "kryesit të rrinë në shtëpi, ndërsa viktimat në strehimore." Ata mendonin që gjykatat duhet të parashikojnë që kryesit të largohen nga shtëpitë ose të paguajnë qira, sikurse është paraparë si masë e mundshme në Ligj. Përdorimi i kufizuar i masave mesa duket vazhdon edhe sot, sipas të të intervistuarve nga institucione të ndryshme. Zyrtarët kanë deklaruar se përdorin masa të kufizuara për shkak të shqetësimit për zbatueshmërinë e një mase të caktuar apo atë nëse policia e ka relativisht të lehtë ta monitorojë

zbatimin e masës. Gjykatësit mesa duket lëshojnë pak masa ku masa e mbrojtjes e ndalimit të afrimit viktimës së dhunës në familje është ajo që përdoret më së shpeshti.[251]

Në të njëjtën kohë, zyrtarët kanë komentuar për sfidat që ndeshen *në praktikë* në zbatimin e urdhrave për mbrojtje. Ka pasur sfida me masat e ndalimit të afrimit viktimave dhe ato të ndarjes së përkohshme të pasurisë mes bashkëshortëve.[252] Kjo lidhet me kushtet e jetesës së disa kosovarëve, të cilët jetojnë në familje të mëdha ku jeton edhe viktima e dhunës në familje dhe, për këtë arsye i duhet të përballet edhe me reagimet e anëtarëve të familjes së keqbërësit/keqbërëses, të cilët janë të zemëruar që ai/ajo nuk është në familje. Kryetari i një gjykate themelore vuri në dukje se është e vështirë të zbatohet kjo masë aty ku ka shumë njerëz që jetojnë në një banesë me dy dhoma dhe që nuk kanë asnjë vend tjetër ku të shkojnë, përveç nëse shteti investon në banesa sociale.[253] Një gjyqtar i gjykatës themelore dha këtë shpjegim:

> Është shumë e vështirë ta zbatosh ligjin për shkak të rrethanave dhe kushteve në Kosovë; e kam fjalën për ato socio-ekonomike ose materiale. Unë kam pasur një rast ku burri e nxori gruan jashtë shtëpisë dhe ajo mbeti jashtë. Familja e saj nuk donte që ato të kthehej tek prindët. Ajo nuk kishte se si ta mbante veten; nuk kishte një vend të sigurt dhe as para për të paguar qiranë. Si këto raste kam pasur, por gjykata e apelit mendon që unë po u bëj shumë presion burrave, kështu që e ktheu rastin për rishqyrtim. Unë po e shqyrtoj me vëmendje këtë rast sepse kushtet socio-ekonomike të shoqërisë sonë janë shumë të ashpra për zbatimin me efikasitet të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Rrethanat përcaktohen nga kushtet ekonomike. Po qe se ai nuk punon dhe nuk ka mundësi të paguajë qira, nuk ka kuptim që t'i shqiptohet ajo masë.[254]

Gjithashtu, respondentët kanë thënë se edhe për shkak të kushteve në Kosovë, domethënë mungesës së vendndodhjeve të disponueshme për trajtimin e keqbërësve, gjyqtarët rrallë herë nxjerrin masa për këshillimin e keqbërësve.

**"Zakonisht pas dy javëve burgim të bashkëshortit [dhunuesit], ajo kërkon që ta lirojmë për shkak të fëmijëve dhe ngaqë është e papunë dhe nuk e mban dot familjen".**

- Prokuror

Në vitin 2009, RrGGK-ja ka gjetur se institucionet kanë pasur prirjen të përdorin Ligjin e Familjes, i cili nxit ripajtimin mes anëtarëve të familjes, në vend të ndjekjes penale *ex officio* për krime të kryera brenda familjes. Në vitin 2015, disa gjyqtarë vazhdonin të këmbëngulnin në idenë se "ripajtimi" mund të përdoret në vend të gjyqeve penale. Besimi në ripajtim duket se është edhe më i fortë në rastet e dhunës në familje ku përfshihen fëmijët. Bashkimi i familjes ka prirjen të konsiderohet si rezultati më i mirë për fëmijët. Përparësi kanë qenë gjithmonë fëmijët e familjes, dhe pastaj masat [ligjore]," tha për RrGGK-në një gjyqtar i gjykatës themelore. "Ne si prioritet kemi mbrojtjen e familjes. Zakonisht mundohemi t'i këshillojmë në fillim për të zvogëluar tensionet."[255] Nga 36 raste, ky gjyqtar tha me krenari se ka dhënë 12 urdhra për mbrojtje dhe pjesën tjetër e kishte "pajtuar". E vërteta është që pajtimi nuk parashikohet në detyrat e gjyqtarit. Theksimi i ripajtimit mund të kontribuojë në recidivizëm dhe përjetësim të dhunën (zakonisht) kundër grave, mes të tjerash, me anë të minimit të vazhdueshëm të të drejtave të të mbijetuarve për mjete ligjore efektive. Duke marrë parasysh përpjekjet e përsëritura për ripajtim si dhe potencialin që ka kjo praktikë për shkeljen e të drejtave njerëzore të grave, RrGGK-ja beson se klauzolat e Kodit Penal, të cilat lidhen me dhunën në familje, Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, si dhe Ligji për Familjen, do të duhet t'ua ndalojnë shprehimisht prokurorëve dhe gjyqtarëve përfshirjen në zgjidhjen e kontesteve.

Vetëm tre respondente të anketuara, të cilat ishin dhunuar, u shprehën se kishin pasur përvoja me gjykatat. Një grua tha se gjykata e ishte trajtuar mirë, ndërsa dy thanë se i kishte trajtuar shumë keq. Një rast i veçantë, i përshkruar me hollësi nga një i anketuar, i ilustron problematikat që mund të ekzistojnë:

> Dhuna u ushtrua nga bashkëshorti, vjehrra, dhe tri kunatat. Rasti përfundoi në gjykatë, ku u divorcuan në mos-prani të saj. Për keqbërësin nuk pati asnjë ndëshkim, ndërsa avokati i viktimës ishte i korruptuar nga pala kundërshtare. Ata nuk paguan kurrë kompensim.[256]

Së pari, kur bëhet një divorc, duhet të jenë të pranishme të gjitha palët. Së dyti, pretendimet për dhunë do të duhej të ishin gjykuar në procedurën penale para gjykatës, në mënyrë të veçuar nga procedura civile, e cila ka të bëjë me divorcin. Së treti, duket se ka pasur një dështim në zbatimin e kompensimit të parashikuar për viktimën. Ndonëse këto çështje mund të mos jenë shumë të përhapura ose plotësisht të verifikueshme nga ky hulumtim, historitë e treguara nga të anketuarat vënë në dukje padrejtësitë e mundshme që mund të jenë duke u bërë dhe që do të duhet të monitorohen me kujdes nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe akterët e tjerë.

Me pak fjalë, sfidat që mbeten kanë të bëjnë me vazhdimin mos-dhënies përparësi rasteve të dhunës në familje, disa vonesa në lëshimin e urdhrave për mbrojtje, numrin e pamjaftueshëm të gjykatësve në gjykata për menaxhimin e volumit të punës (gjë e cila kontribuon në vonesa), korrupsionin, nepotizmin, si dhe prirjen e gjyqtarëve për të ofruar pak masa të qëndrueshme në urdhrat për mbrojtje. Mos-funksionimi i gjykatave në Kosovën veriore përbën një sfidë për njerëzit që jetojnë atje, për sa i takon qasjes që ata kanë te urdhrat për mbrojtje. Në veri të Kosovës përbën sfidë edhe zbatimi i urdhrave për mbrojtje, në pajtim me Ligjin e Kosovës.[257]

## Procedurat penale përpara gjykatave

Në procedurat penale, gjykatat kanë kompetencë të dënojnë kryesit e veprave penale të dhunës në familje, personat të cilët kanë shkelur urdhrat për mbrojtje, si dhe personat të cilët kanë kryer ndonjë vepër penale brenda familjes. Gjykatat kanë për obligim që t'i njoftojnë të gjitha palët në procedurë për të drejtat që i përkasin atyre, si dhe pasojat e mosveprimit të tyre.[258]

**"Komshija ime ka pësuar dhunë në familje nga bashkëshorti i saj, i cili pinte shumë. Ata u divorcuan, mirëpo atë nuk e ndëshkuan për atë që bëri."**
- Burrë, 62 vjeç, Pejë

Krahas kësaj, nën mandatin e ZMNV-së, neni 218 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, përdoret tashmë për të parashtruar deklaratën e dëmeve për dëmet e bëra, brenda gjashtëdhjetë ditëve duke filluar nga data e parashtrimit të aktakuzës nga ana e prokurorit ose pas ngritjes së akuzës për veprën penale. Deklarata ka për qëllim të mbështesë viktimat për të "paraqitur ndikimin që ka pasur vepra penale [...] dhe e ndihmon [...] viktimën për t'u konsideruar si palë në procedurë penale." Kjo deklaratë mund të shërbejë edhe si kërkesë pasurore në procedurë civile. MV-të ose, në mungesë të tyre, oficerët e policisë, mund t'i ndihmojnë viktimat për t'i plotësuar formularët. Në gjykatë mund të jepet shpjegime edhe më të hollësishme të dëmeve.[259]

Disa përfaqësues të institucioneve kanë shprehur shqetësimin se gjyqtarët kanë dhënë dënime shumë të ulëta për kryesit e krimeve brenda familjes.[260] Një respondent ka vënë në dukje se "gati 100%" e dënimeve në rastet penale kanë qenë lënie e garancisë ose periudhë e provës.[261] "Nëse paguan një gjobë prej 200 eurosh për ta rrahur gruan, e rreh nja tre herë dhe paguan vetëm 600 euro," tha një oficer policie. Ekzistojnë raporte për autorë krimi të cilët dënohen rregullisht me arrestim ose arrest shtëpie, gjë e cila ua ka mundësuar të kthehen në shtëpi. Ndërkohë që disa të anketuar ua vënë fajin gjykatave, një prokuror është shprehur se, "gjyqtarët ankohen që raportet që u jepen atyre nga QPS-të dhe policia janë shumë të dobëta dhe nuk përmbajnë informata dhe kjo është arsyeja pse ata nuk mund të japin dënime më të larta."

**"Ekzekutimi i dënimeve merr shumë kohë dhe nuk është strikt; gjyqtarët japin dënime minimale."**
- Drejtor i policisë rajonale

Ekzistojnë edhe raporte për autorë të krimit të cilët lirohen shpejtë nga burgu. "Problemi janë gjykatat. Ato i nxjerrin autorët e krimeve shumë herët," u shpreh një oficer policie. Për shembull, "kishim pesë muaj që e kërkonim një autor krimi; ai kishte bërë dhjetë kërcënime dhe një sulm. Pasi e kapëm, gjykata e liroi pas një muaji." Disa zyrtarë kanë vënë në dukje se edhe në rastet e recidivizmit janë dhënë dënime të ulëta. Zyrtarët kanë përmendur se nuk i kushtohet rëndësi shkeljes së urdhrave për mbrojtje. Shkelja e një urdhri për mbrojtje rrallë herë është konsideruar si vepër penale, prandaj edhe nuk identifikohet si rast recidivist, i

**"Ata e morrën kryesin e dhunës. Ai u mbajt në burg për një muaj dhe pas kësaj ai u lirua. Tani ai është i lirë dhe vazhdon të jetë i rrezikshëm."**
- Burrë, mosha 62, Ferizaj

cili çon në mos-ekzekutimin e dënimeve të përshtatshme, në pajtim me kërkesat e Ligjit të Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Nuk ekzistojnë udhëzime të qarta për praktikuesit që punojnë në fushën e sundimit të ligjit në lidhje me mënyrën e trajtimit dhe monitorimit urdhrat për mbrojtje, shkeljen e tyre dhe kujt duhet t'i raportojë viktimat për shkeljen e urdhrit të mbrojtjes dhe si duhet policia të trajtojë rastin.[262]

Me pak fjalë, sfidat që kanë identifikuar të intervistuarit kanë përfshirë: vonesat në lëshimin e dënimeve në disa gjykata; numrin e pamjaftueshëm të gjyqtarëve në gjykata për menaxhimin e vëllimit të punës (gjë e cila kontribuon te vonesat); korrupsionin; nepotizmin; dhe dënimet e ulëta. Një sfidë specifike për veriun e Kosovës është mungesa e gjykatave funksionale, çka e vështirëson qasjen në drejtësi të viktimave të dhunës.

## Shërbimi Korrektues i Kosovës

Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) ka për mision "risocializimin e të burgosurve duke respektuar të drejtat e tyre fondamentale pa marrë parasysh racën, gjuhën dhe religjionin si dhe siguron një ambient të sigurt për stafin, të burgosurit dhe shoqërinë."[263] ShKK-ja është përgjegjëse për të burgosurit, të arrestuarit dhe minorenët, në pajtim me ligjet e Republikës së Kosovës, konventat evropiane, si dhe rregulloret e tjera përkatëse. Kur gjykatat marrin vendimin për të burgosurit, të arrestuarit, apo minorenët, përgatitet një plan individual për kohën e tyre në shërbimin korrektues. Për sa i takon rehabilitimit, punonjësit socialë së bashku me ekspertë të tjerë si mjekët, psikiatrit dhe psikologët, ekzaminojnë gjendjen e tyre fizike dhe psikologjike. Nëse personi ka probleme që lidhen me abuzimin me alkoolin dhe/ose drogën apo shfaq shenja të ndonjë problemi psikologjik, ShKK-ja duhet të krijojë kushte me qëllim që ata të marrin shërbimet e duhura. Në rast se ShKK-ja nuk ka profesionistë për trajtimin e tyre, ajo bashkëpunon me institucione të tjera të cilat e ofrojnë trajtimin e kërkuar, të tilla si: spitali psikiatrik, instituti i forenzikës, dhe Qendra Mediko-Psikoterapeutike "Labirinti". Për sa i përket risocializimit të të dënuarve, ShKK-ja bashkëpunon me MAShT-in, Ministrinë e Drejtësisë, MPMS-në, Qendrat Rajonale të Punësimit, QPS-së, dhe Drejtoritë Komunale të Arsimit. Ndërkohë që bashkëpunimi i tyre është pozitiv, sfidat financiare mund ta vështirësojnë risocializimin. "Shteti nuk ka buxhet për të ulur papunësinë në popullsinë e gjerë, e lerë më në këto raste," u shpreh një përfaqësues i ShKK-së.[264] Në përgjithësi, përfaqësuesit e ShKK-së duket se janë të informuar rreth kornizës ligjore për dhunën në familje. ShKK-ja nuk kishte asnjë regjistër për numrin e rasteve që kishin pasur dhe që lidheshin me dhunën në familje ose për llojet e shërbimeve që janë ofruar në raste të tilla.

## Shërbimi sprovues

I vendosur në Ministrinë e Drejtësisë, Shërbimi Sprovues është përgjegjës për organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative dhe të riintegrimit shoqëror të personave të dënuar.[265] Shërbimi Sprovues ka për mision "reduktimin e krimit, zvogëlimi e shkallës së recidivizmit dhe rritjen e përgjithshme të sigurisë për shoqërinë tonë." Veç kësaj, Shërbimi Sprovues është përgjegjës për vlerësimin e mënyrës të trajtimit të personave të cilët kanë kryer vepra penale; ekzekutimin e masave për delikuentët e mitur; "mbikëqyrjen dhe ndihmën ndaj personave të dënuar gjatë mbajtjes së dënimeve alternative; mbikëqyrjen dhe ndihmën ndaj kryesve të varur nga droga, ose alkooli të cilët i nënshtrohen trajtimit të detyrueshëm rehabilitues i cili mbahet në liri; mbikëqyrjen dhe ndihmën ndaj personave të dënuar të liruar me kusht; zhvillimin e programeve individuale të mbikëqyrjes; hartimin e raporteve për ekzekutimin e dënimeve alternative dhe personave te liruar me kusht nga burgu për Prokurorët, Gjykatat dhe Panelin për Lirim me Kusht; udhëzimin dhe mbështetjen ndaj personave të dënuar në përfundim të dënimit të tyre; dhe menaxhimin e të dhënave.[266]

Duke marrë parasysh që një prokuror besonte se "pothuaj 100%" e rasteve dërgohen për periudhë sprovuese, është me interes të vëmë në dukje se Shërbimi Sprovues nuk përmendi se kishte ndihmuar as edhe në një rast të vetëm të dhunës në familje.[267] Për individët të cilët vuajnë dënim me burgim për shkak të kryerjes së krimeve në familje, çështje serioze mbetet rehabilitimi dhe ri-integrimi i tyre. Kryesit e veprave penale nuk mund të futen përsëri në shoqëri pa kurrfarë përkrahjeje, udhëzimi, apo shkathtësish të reja për t'u përballur me çështjet socio-psikologjike që mund të kenë ndikuar tek ta

për ushtrimin e dhunës. Në fakt, respondentët nga institucione të ndryshme e kanë përmendur si problematike mungesën e programeve të trajnimit për personat të cilët kanë kryer krime të tilla, kur është fjala për minimizimin e recidivizmit.

## Qendrat për Punë Sociale

Qendrat për Punës Sociale (QPS-të) janë institucione publike në nivelin komunal, të cilat kanë kompetenca për mbrojtjen e qytetarëve që kanë nevojë për shërbime sociale dhe familjare, duke përfshirë mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për personat të cilët kanë vuajtur nga dhuna në familje. QPS-të koordinojnë aktivitetet me akterët e tjerë në procesin e përkrahjes dhe fuqizimit të të mbijetuarave të dhunës. Sipas PSV-ve, "Qendra për Punë Sociale për të gjitha viktimat e referuara apo identifikuara bën ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në bazë të vlerësimit të nevojave që ka viktima dhe ka për obligim koordinimin e shërbimeve sociale për viktimën deri te rintegrimi i tij/saj në shoqëri. Qendra për Punë Sociale secilit rast i cakton një zyrtar për menaxhimin e rastit dhe mbështetjen e saj/tij në shërbime. Ky menaxher i rastit e merr përsipër mbikëqyrjen e rastit. Menaxheri i rastit e vlerëson gjendjen sociale dhe ekonomike të viktimave të dhunës në familje. Kjo e mundëson QPS-në të identifikojnë nevojat e viktimës dhe t'i koordinojë shërbimet e duhura. Vizita në shtëpi mund bëhen me qëllim të vlerësimit të gjendjes së përgjithshme të familjes, strehimore etj."[268]

Edhe QPS-të janë institucione të cilat janë përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Kështu, QPS-të kanë një mandat të gjerë për të ofruar përkujdese sociale dhe/ose këshillim për fëmijët në nevojë, d.m.th. pa përkujdesje prindërore, që kanë paaftësi ose sëmundje mendore, aftësi të kufizuar fizike, janë delikuentë, ose vuajnë si pasojë e konflikteve familjare.[269] Ato gjithashtu kanë kompetenca si organ kujdestarie për të miturit, në pajtim me Kodin e Drejtësisë për të Mitur në Kosovë.[270] Në rastet që procedohen përpara gjykatave, punonjësit socialë duhet të dëshmojnë lidhur me nevojat e fëmijës. Ata duhet t'i vizitojnë familjet ku ka pasur dhunë për t'u siguruar që fëmijët janë në rregull.

**"Ato [QPS-të] nuk vijnë t'i vizitojnë fëmijët ose të shohin nëse shkojnë në shkollë apo janë sëmurë. Kjo është përgjegjësi e tyre, mirëpo gjithmonë thonë se nuk kanë mjete transporti."**
- Përfaqësues i një strehimoreje

Respondentët kanë shprehur disa shqetësime lidhur me transferimin e përgjegjësive të mëparshme të MPMS-së te QPS-të. Shqetësimet, në pjesën më të madhe të tyre, kanë të bëjnë me mungesën e kompetencës në radhët e personelit të QPS-ve për kryerjen e të gjitha detyrave të tyre, si dhe me buxhetin e pamjaftueshëm që është alokuar në nivel komunal për kryerjen e këtyre detyrave.[271] Disa respondentë mendonin se performanca e QPS-ve është përmirësuar dhe se ato i kanë trajtuar "mirë" personat që kanë vuajtur nga dhuna. Ndërkohë, respondentët e tjerë kanë thënë se disa janë më të mira sesa disa të tjera. Shqetësimet që kanë shprehur zyrtarët që punojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me këtë institucion (siç janë MV-të, policët, gjykatat dhe strehimoret), kanë të bëjnë me angazhimin e tyre për rastet që i mbështesin dhe i monitorojnë. Kritikat përfshijnë mos-pasjen e stafit profesionist të mjaftueshëm, mos-përgjigjen ndaj kërkesave (për shkak të mungesës së stafit), shkeljen e konfidencialitetit të klientëve, mos-monitorimin e fëmijëve pas strehimit të tyre,[272] dhe mos-pjesëmarrjen në seancat gjyqësore edhe pse janë të detyruar të marrin pjesë në to. Edhe hulumtimi i vitit 2009 i RrGGK-së gjeti se QPS-të nuk vijnë në gjykatë për rastet me të miturit.[273]

Në pajtim me Ligjin e Familjes dhe Kodin e tyre të Etikës, punonjësit socialë duhet ta sigurojnë konfidencialitetin. Një punonjës social u shpreh: "Është i rëndësishëm dhe duhen bërë përpjekje për ta ruajtur." Një tjetër tha se konfidencialiteti "nuk respektohet ashtu siç duhet në QPS-në tonë." Kushtet e punës kanë bërë që disa punonjës socialë ta kenë të vështirë ta ruajnë konfidencialitetin, sikurse u shpreh njëri prej tyre:

> Ky është problemi me ne, shqiptarët. Ne duam të dimë çdo gjë. Sidomos këtu në institucionin tonë, kjo gjë është e vështirë ngaqë nuk kemi një sallë të posaçme për intervistat. Kati i parë është kafene dhe i dyti për shërbimet sociale. Kjo gjendje duhet të ndryshojnë që palët të mos takohen me njëra-tjetrën. Ndonjëherë ndodh që vjen një palë për asistencë sociale dhe e sheh

palën tjetër që ka ardhur për shkak të dhunës në familje. Sidomos gratë, të cilave u pëlqen të dinë për çdo gjë, fillojnë e pyesin: "Po ti, çfarë bën këtu?"

Të tjerë thanë se edhe pse në të paktën tetë QPS janë krijuar dhoma intervistimi që janë miqësore për fëmijët, ato nuk kishin hapësirën e nevojshme. "Dy punonjës socialë punojnë në të njëjtën zyrë. Kur na vjen ndonjë rast, njëri prej nesh duhet të largohet nga zyra dhe të presë diku jashtë derisa të përfundojë intervistimi me klientin," tha një punonjës social. Kjo mund të ndikojë në aftësinë e punonjësve socialë për të punuar me efikasitet, duke marrë parasysh këtu vëllimin e punës.

Disa punonjës socialë kanë marrë pjesë në trajnime për çështjet që ndërlidhen me dhunën në familje, ndonëse jo të gjithë.[274] Disa respondentë nga QPS-të kanë thënë se nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në trajnime të ndërlidhura me dhunën në familje. Ekziston edhe një doracak për punonjësit socialë, i cili ka të bëjë me punën e tyre kundër dhunës në familje. Të gjithë punonjësit socialë do të përfitonin nga trajnimi për këshillimin e kryesve të dhunës.

Kur pyeten për PSV-të, disa punonjës socialë kanë qenë të informuar për to, ndërsa të tjerët jo, çka lë të kuptohet se ka një mungesë të njohurive të mjaftueshme. Disa punonjës socialë mendonin se që prej vitit 2011, qasja dhe qëndrimet kundrejt dhunës në familje janë përmirësuar. "Përpara vitit 2011, ata [kolegët e mi] nuk e merrnin shumë seriozisht: 'punë e madhe se ia dha një shpullë ose që nuk e la të shkonte te familja e vetë', tha një punonjës social". "Mirëpo, me kalimin e kohës, me trajnimet që kemi marrë [...] njerëzit filluan ta merrnin këtë punë me më shumë seriozitet dhe e kuptuan se kjo është dukuri e keqe." Pavarësisht disa përmirësimeve, komentet që kanë bërë punonjës të tjerë socialë lënë të kuptohet se ende ekzistojnë sfida:

> Numri është i ekzagjeruar. Secili person përjeton dhunë në ndonjë moment: qoftë psikologjike, seksuale, apo ekonomike. Ne duhet të raportojmë vetëm rastet që përsëritet dhe që nuk mund të zgjidhen. Prioriteti [im] është që ta ribashkoj familjen sepse ndonjëherë dhuna mund të jetë e rastësishme dhe mund të zgjidhet në seanca.[275]

Edhe QPS-të janë të përfshira në menaxhimin e rasteve që kanë të bëjnë me dhunën në familje, në veçanti kur përfshihen fëmijët.[276] Me mbështetjen e OJQ-ve dhe programeve ndërkombëtare, QPS-të në fare pak komuna (d.m.th. Vranjevc, Graçanicë dhe Fushë Kosovë) kanë ngritur disa shërbime sociale për viktimat e dhunës në familje, të cilat duhet të ndërlidhen me programet për fuqizimin e familjes, sikurse parashikohet në PNV.[277]

## Të drejtat e kujdestarisë dhe qasja te fëmijët

**"Ka pasur një kur burri nuk e linte nënën të shihte fëmijët e saj, edhe pse gjykata i kishte dhënë asaj të drejtën t'i shihte një herë në muaj."**
- Burrë, 62 vjeç, Prishtinë

Një tematikë e cila përshkruan sondazhin dhe të intervistuarit lidhur me atë se pse dhuna në familje nuk raportohet është se nënat kanë frikë se mos i humbin fëmijët e tyre. Sikurse deklaroi një përfaqësues i një OJQ-ve, "Për hir të familjes dhe fëmijëve të tyre, gratë durojnë dhunën dhe tolerojnë që këto gjëra t'u ndodhin atyre."[278] Për shembull, një respondente dha detaje për një rast: "Nusen e rrahu vjehrra dhe bashkëshorti derisa u gjakos. Ajo e mori në telefon policinë, por pastaj e tërhoqi rastin për shkak të fëmijëve të saj dhe u kthye në shtëpinë e bashkëshortit."[279] Intervistat lënë të kuptohet se gratë kthehen në situatat e dhunës në familje për shkak të frikës se mos i humbin fëmijët e tyre. Frika që gjykatat gjithmonë do t'ua japin kujdestarinë burrave nuk mbështetet në mënyrë të plotë me prova. Nga 778 raste gjyqësore që kanë vëzhguar Shoqata e Avokatëve "Norma" midis viteve 2012 dhe 2013, në 68 % të tyre , fëmijët u janë besuar nënave.[280] Megjithatë, këto të dhëna statistikore nuk zbatohen domosdoshmërisht për gjithë Kosovën.

QPS-së luajnë një rol në procedura duke i rekomanduar gjykatës interesat më të mira të fëmijës. Pjesa më e madhe e zyrtarëve që punojnë në QPS kanë thënë se gjithmonë i marrin parasysh nevojat e fëmijës kur i këshillojnë gjykatat lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me kujdestarinë e fëmijëve. Me "nevoja" punonjësit socialë nënkuptojnë vetëm nevojat materiale: cili prind është i punësuar ose ka

mjete financiare për ta mbajtur fëmijën? Edhe shkathtësitë prindërore do të duhet të monitorohen nga ky institucion dhe të merren në konsideratë. Megjithatë, disa QPS i kanë këshilluar gjykatat t'u japin kujdestarinë autorëve të dhunës në familje thjesht për shkak të aftësisë së tij/saj për t'ia plotësuar fëmijës apo fëmijëve nevojat financiare. Sikurse komentoi një punonjës social: "Kur përfshihen fëmijët, ata zakonisht shkojnë te viktima dhe jo te autori i dhunës. Mirëpo ndonjëherë ndodh edhe e kundërta. Nuk ka kuptim të parashtrohet pyetja se pse kushtet [financiare] bëjnë që të ndodhë kështu."[281] Ky pohim është i gabuar dhe nuk e merr parasysh rrezikun e dhunimit që u kanoset fëmijëve. Hulumtimi i mëparshëm i RrGGK-së ka gjetur se kujdestaria e fëmijëve u është dhënë autorëve të dhunës vetëm sepse kanë gjendje financiare më të mirë. Epërsia financiare është vlerësuar shumë më lartë sesa mirëqenia mendore dhe fizike e fëmijëve. Shembuj të kësaj janë dhënë në një raport ku flitet për një autor të dhunës i cili kishte marrë nën kujdestari fëmijët, edhe pse dihej se ai ushtronte dhunë edhe ndaj fëmijëve.[282] Përparësi duhet të kenë interesat më të mira të fëmijës.

**"Në rastet e kujdestarisë së fëmijëve, lidhja emocionale mes fëmijës dhe prindërit duhet të merret parasysh më shumë sesa rrethanat ekonomike të të dy prindërve. Disa kolegë të mi mendojnë se gjendja ekonomike është më e rëndësishme."**

- Punëtor social

Në disa rrethana sfidë paraqet edhe prania e anëtarëve të tjerë të familjes të cilët janë gjithashtu të përfshirë në përkujdesjen e fëmijëve. Për shembull, një punonjës social tha:

> Për shembull, ka qenë njëherë një rast i kujdestarisë së fëmijës në të cilin i ati, autori i dhunës, jetonte jashtë Kosovës dhe fëmijët ishin nën kujdestarinë e babait të tij, d.m.th. gjyshit. Ne [QPS-të] kërkuam që nëna t'i mbante fëmijët gjatë fundjavave dhe gjatë ditëve të festave. Avokati, gjyqtari dhe punonjësi social shkuan t'i merrnin fëmijët nga shtëpia. Megjithatë, ky është momenti kur hezitojnë gjyqtarët. Ata kërkojnë mënyra për t'i marrë fëmijët ndërkohë që vetë babai i tyre nuk është i përfshirë.

Respondentët kanë vënë në dukje gjithashtu se mungesa e zbatimit të urdhrave për mbrojtje ose të masave të gjykatës civile, të cilat i detyrojnë prindërit të paguajnë alimentacionin, i vë nënat në një pozitë shumë të vështirë: "Shpeshherë, këto zvarritje bëjnë që gratë që kujdesen për fëmijët e tyre të shkojnë te Qendra për Punë Sociale ose te Drejtoria jonë për të kërkuar artikuj ushqimorë bazë."[283]

## Strehimoret dhe OJQ-të

Strehimoret kontraktohen nga MPMS-ja, në veçanti nga Departamenti për Mirëqenie Sociale, për të ofruar shërbime të strehimores. Në veçanti, Ligji i Kosovës për Shërbimet Sociale dhe Familjare parasheh: "Çdo organizatë joqeveritare që ofron shërbime sociale dhe familjare duhet të regjistrohet pranë organit përkatës dhe të licencohet nga Departamenti i Mirëqenies Sociale, si edhe t'u përmbahet rregulloreve, udhëzimeve dhe procedurave lidhur me aktivitetet e tyre siç përcaktohen nga Ministria."[284] Financimi i Ministrisë përplotësohet me financimet nga komunat, në disa komuna, si dhe nga mbështetja financiare e ofruar nga donatorët.

Financimi i qëndrueshëm për strehimoret mbetet një sfidë dhe çështje e nxehtë debati. Sipas një përfaqësuesi tjetër të një strehimoreje, MPMS-ja i ka vonuar pagesat mujore. Në korrik, u skadoi kontrata për shërbimet dhe MPMS-ja i rihapi procedurat e prokurimit që strehimoret të aplikonin për financime nga qeveria. Përfaqësuesit e strehimoreve janë ankuar se kjo procedurë është shumë e lodhshme dhe fondet që shpërndahen janë të pamjaftueshme.

Duhet vendosur një vijë e hollë midis kontrollit shtetëror të strehimoreve të cilat janë të regjistruara si organizata jo-qeveritare dhe mbikëqyrjes shtetërore të punës së personelit të strehimoreve në përdorimin e fondeve publike dhe punës së tyre profesionale. Shteti do të duhet të mos i "kontrollojë" strehimoret. Megjithatë, nëse shpenzohen fondet shtetërore, atëherë duhet të ketë mbikëqyrje të plotë dhe transparente të fondeve publike. Strehimoreve duhet t'u kërkohet të raportojnë në mënyrë të qartë për të gjitha shpenzimet e tyre, si dhe të jenë transparente lidhur me fondet e tjera të përfituara, d.m.th. nga akterë ndërkombëtarë. Më tej, tani që është kryer licencimi i ofruesve individualë të shërbimeve dhe strehimoreve, do të duhet të ketë njëfarë mbikëqyrjeje nga ana

e MPMS-së për të siguruar që punonjësit socialë të licencuar që punojnë në strehimore t'i realizojnë si duhet detyrat e tyre, duke përfshirë qasjen e duhur në raport me të mbijetuarat e dhunës në familje. Kjo nuk shërben vetëm për të siguruar që plotësohen standardet minimale në ofrimin e shërbimeve dhe që nuk shkelen të drejtat e viktimave. Kjo ka për synim edhe sigurimin që shpenzimet efikase dhe efektive të fondeve të shtetit për këto lloj shërbimesh të jenë në harmoni me detyrimet kontraktuale të strehimoreve.

Në bazë të PSV-ve, roli i strehimoreve është vendimtar në drejtim të rehabilitimit dhe ri-integrimit të viktimave të dhunës. Referimi te strehimoret mund të bëhet nga policia, e cila është e detyruar t'i dërgojë viktimat në strehimore, institucione të tjera, ose në mënyrë të pavarur, nga personat që kanë pësuar dhunë. Të mbijetuarat e dhunës kanë të drejtë të zgjedhin nëse dëshirojnë të qëndrojnë përkohësisht, në varësi të specifikave të rastit të tyre. Ato mund të qëndrojnë deri në gjashtë muaj në një strehimore të caktuar, edhe pse aty ku paraqitet nevoja bëhen edhe përjashtime. [285] Të gjitha strehimoret organizojnë kurse të ndryshme profesionale për gratë, për t'i ndihmuar në gjetjen e një pune pasi të largohen nga strehimorja. Më tej, strehimoret kanë bashkëpunim me qendrat për trajnime profesionale dhe zyrat e punësimit, kështu që personat e strehuar mund të përfitojnë nga shërbimet e tyre.

Disa prej strehimoreve kanë deklaruar se kanë pasur politika të qarta të ruajtjes së konfidencialitetit, të cilat stafi duhej t'i nënshkruante. Dy-tre prej punonjësve të intervistuar të një strehimoreje nuk dinin për këto politika. Në një strehimore, "Çdo klient i kësaj qendra nënshkruan një formular ku specifikohet se atyre nuk u lejohet të flasin për vendin ku i kanë parë klientët e tjerë dhe identitetin e tyre. Po ashtu, u japim të nënshkruajnë edhe një formular ku theksohet se pasi largohen nga strehimorja nuk u lejohet të flasin për gjërat që kanë parë këtu."

Stafi i strehimores ka ndjekur disa trajnime gjatë viteve të kaluara, duke përfshirë edhe "identifikimin e rasteve klinike", sikurse parashikohet në PNV 3.1.3 si dhe trajnime për mbrojtje nga HIV dhe SST, respektivisht (PNV 3.1.4). Ndonëse pjesa më e madhe e përfaqësuesve të strehimoreve nuk kishin njohuri lidhur me PSV-të, disa prej tyre kishin. Megjithatë, sipas disa respondentëve, nuk ishin trajnuar të gjithë anëtarët e stafit të strehimoreve. Pavarësisht marrjes pjesë në shumë trajnime ndër vite, disa përfaqësues të strehimoreve ende kanë paragjykime lidhur me klientët e tyre. Për shembull, një përfaqësues i një strehimoreje, tha:

> Gratë nuk kanë interes të mësojnë asgjë. Ato duan vetëm të shohin telenovela të ndryshme dhe të bëhen bjonde. Të gjitha duan t'i lyejnë me ngjyrë të bardhë flokët. E gjithë dyshemeja është me pllaka. Kur e pastrojnë, vetëm sa e lagin me leckë. Ndjekin kurse të kuzhinës në qendrën për trajnim profesional, mirëpo akoma nuk dinë të dallojnë perimet nga frutat. Ato i rrahin fëmijët e vetë. [286]

Mungesa e dhembshurisë dhe mirëkuptimit për gratë, të cilat kanë vuajtur nga dhuna, për traumën që kanë kaluar, si dhe për nevojat e tyre të veçanta për këshillim psikologjik, të linte me gojë hapur. Anëtarët e stafit të strehimoreve kanë nevojë për më shumë trajnime profesionale për traumën, këshillimin e të mbijetuarve të traumës, si dhe për qasjen ndaj tyre.

Edhe disa përfaqësues të institucioneve janë shprehur të shqetësuar që strehimoret nuk kishin hapësirë apo personel të mjaftueshëm për t'i ndihmuar si duhet viktimat e dhunës.[287] "I gjithë thelbi qëndron në atë që [rastet] nuk po marrin mbështetje nga institucionet dhe familjet e tyre," u shpreh një oficer i policisë i një NjHDhF-je. "Unë e kam të lehtë ta bëj punën time. Mund ta raportoj rastin dhe ta informoj prokurorin, por nuk mund të gjej strehimore për to." Respondentët kanë vënë në dukje mungesën e hapësirës në strehimoret për qëndrim afatgjatë për gratë të cilat qëndrojnë për më shumë sesa maksimumi prej gjashtë muajsh dhe në veçanti për fëmijët. Për shembull, një psikologe shkollore ka komentuar se komuna e saj ka arritur kuotën e fëmijëve që lejohen të dërgohen në fshatin SOS. Shqetësimin e tij e ka shprehur edhe një Mbrojtës i Viktimave: "Çfarë të bëjmë me fëmijët? Sidomos kur janë djem mbi 13-vjeçarë? Ata nuk mund të shkojnë në strehimore së bashku me nënat e tyre." Veç kësaj, ende nuk ka asnjë strehimore për burrat, personat e komunitetit LGBT, apo në veri të Kosovës. Një çështje specifike për komunat e veriut të Kosovës është që OJQ-të nuk i ushtrojnë aktivitetet e tyre në pajtim me PSV-të. "Ne i mbështesim viktimat gjatë ditës dhe, kur paraqitet nevoja, së bashku me policinë

ndihmojmë në zgjidhjen e rasteve," u shpreh një përfaqësues i një OJQ-je nga veriu i Kosovës. Respondentë të ndryshëm kanë komentuar lidhur me faktin që pak persona kanë një vend ku të shkojnë pas qëndrimit në strehimore, gjë e cila mund ta ndikojnë në mënyrë negative mirëqenien e tyre.

Përtej ofrimit të strehimit, strehimoret dhe disa organizata të tjera lokale dhe ndërkombëtare kanë organizuar edhe fushata sensibilizuese. Pjesa më e madhe e këtyre fushatave janë realizuar gjatë 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës ndaj grave, por të tjerat janë realizuar gjatë gjithë vitit. Këto organizata dhe organizata të tjera u kanë ofruar ndihmë ligjore falas personave që kanë vuajtur nga dhuna në familje.

## Institucionet arsimore

Sipas Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë (MAShT) do të hartojë akte nën-ligjore ose do të ofrojë mbështetje për rritjen e ndihmës dhe për infrastrukturën e nevojshme për mbështetjen e zbatimit të Ligjit.[288] Krahas kësaj, edhe institucionet arsimore sipas Programit të Kosovës për Dhunën në Familje duhet të ofrojnë psikologë në shkolla për t'i ndihmuar fëmijët që kanë nevojë për përkrahje. Sikurse përmendëm më sipër, të gjitha institucionet kanë përgjegjësi ligjore ta raportojnë abuzimin me fëmijët dhe mësimdhënësit janë prej personave të cilët kanë më shumë të ngjarë të ndeshen me raste potenciale të abuzimit me fëmijë. Lidhur me këtë përgjegjësi, institucionet arsimore kanë prezantuar Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA), i cili përfshin një seksion ku mund të raportohet dhuna në familje, çfarëdolloj dhune në shkollë apo brenda familjeve. Për shembull, "Nëse një mësimdhënës sheh të nxira në fytyrën e një nxënësi, ai/ajo mund ta raportojë këtë në sistem dhe më pas informatat i përcillen policisë dhe institucioneve të tjera," ka shpjeguar Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA). Në të ardhmen, programi do të jetë i qasshëm nga policia, QPS-të, DKA-të, si dhe institucionet e tjera përkatëse.

Sipas pikës 1.1.2 të PNV-së, MAShT-i dhe komunat do të duhet të angazhojnë në komuna 40 pedagogë dhe psikologë. RrGGK-ja ka marrë dëshmi kontradiktore lidhur me atë nëse kjo është zbatuar. Ndërkohë që zyrtarët komunalë të arsimit nga Peja dhe Gjilani kanë thënë se kjo është zbatuar, zyrtarë të arsimit nga Ferizaj, Prishtina, Prizreni, Gjakova dhe MAShT-u kanë thënë se nuk është zbatuar. Një sfidë kyçe në zbatim ka qenë financimi i pamjaftueshëm, sikurse ka vënë në dukje një zyrtar i arsimit, "Nga njëra anë, kjo është paraparë në PNV, por nga ana tjetër nuk kanë alokuar buxhet të mjaftueshëm. Për këtë ka udhëzime administrative, por pjesa më e madhe e shkollave nuk i kanë këto udhëzime." Zyrtarë të tjerë arsimore nuk kanë qenë dakord me këtë, duke vënë në dukje se MAShT-i kishte krijuar një buxhet për psikologët dhe pedagogët në shkolla, por komunat i kishin shpërdoruar fondet për punësim të mësimdhënësve dhe për qëllime të tjera.[289] Në çdo rast, nevoja për më shumë pedagogë dhe psikologë në shkolla ka qenë një temë e përsëritur si nga zyrtarët e arsimit, ashtu edhe nga gratë e reja.[290] Më tej, ishte e qartë se disa psikologë që shërbejnë në shkolla nuk kishin marrë asnjë trajnim për dhunën në familje dhe për punën me viktimat e këtij lloji të dhunës.[291]

Disa komuna (p.sh. Prishtina, Gjakova) kanë deklaruar se ua kishin ndarë të gjitha shkollave protokollin e MAShT-it për dhunën në familje. Më tej, arsimimi i lidhur me dhunën në familje supozohet se është përfshirë në disa kurse. Megjithatë, disa mësimdhënës ishin të painformuar që dhuna në familje është e mbuluar në planprogramin mësimor të shkollës. Njëri prej tyre tha: "dhuna në familje trajtohet kur flitet për dhunën në përgjithësi." Një mësimdhënës tjetër tha se dhuna në familje është diskutuar si pjesë e modulit për familjen dhe rolin e gruas në martesë, familje, dhe shoqëri. Numri i përgjithshëm i përgjigjeve lë të kuptohet se ende nuk është institucionalizuar në të gjitha shkollat një qasje e harmonizuar në drejtim të arsimimit të nxënësve për dhunën në familje.

Asnjë prej mësimdhënësve të intervistuar nuk duhej se i njihte PSV-të apo përgjegjësitë e tyre sipas këtyre procedurave, të cilat përfshijnë informimin e organit të kujdestarisë ose policisë në rastet kur mësimdhënësi/mësimdhënësja dyshon që ndonjë fëmijë është viktimë dhe/ose i nënshtrohet ndonjë forme të dhunës në familje, duke dorëzuar një formular të identifikimit dhe referimit. Vetëm njëri prej 11 mësimdhënësve të intervistuar në komuna të ndryshme ka përmendur shprehimisht se rastet mund të referoheshin: "Mësimdhënësit në shkollën tonë përpiqen t'i identifikojnë nxënësit të cilët janë

**"Si mësimdhënës, dikur besoja se t'i godisje fëmijët ishte diçka e duhur, por tani nuk besoj më."**
- Edukator

viktimë e dhunës në familje. Ne mund t'i identifikojmë në mënyra të ndryshme, qoftë nga mungesa e përqendrimit, qoftë nga shenjat fizike të dhunës. Ne i referojmë këta nxënës te psikologu i shkollës apo institucionet e tjera përkatëse."[292] Shihet qartë se detyra për të raportuar gjithmonë rastet e dhunës në familje, ku vihet re se potencialisht përfshihen edhe fëmijë, nuk është kuptuar si duhet. As mësimdhënësit nuk dukej se ishin shumë të informuar për konfidencialitetin apo se e kuptonin mirë atë – asnjë prej tyre nuk iu referua ndonjë politike specifike të konfidencialitetit.[293] Si psikolog, unë e marr çështjen e konfidencialitetit shumë seriozisht," u shpreh një respondent. "Mësimdhënësit e kanë më të vështirë. I kam dëgjuar të përmendin emra në sallën e mësimdhënësve."

Ndërkohë që disa respondentë mendonin se qasja dhe qëndrimet e mësimdhënësve kundrejt dhunës në familje ishin përmirësuar gjatë viteve të fundit, intervistat me të tjerët kanë sugjeruar që nuk ka ndodhur kështu me të gjithë mësimdhënësit. Disa prej deklaratave të mostruara të mësimdhënësve, janë si më poshtë:

> "Gratë duhet të dinë se çka mund të durojnë, por nuk duhet harruar që ka edhe gra të cilat vetë e vënë veten në atë pozitë ku mbi to do të ushtrohet dhunë."[294]
>
> "Disa kolegë besojnë se goditja e grave e rrit sensibilizimin e tyre; të tjerë besojnë se çdo gjë mund të zgjidhet me bashkëbisedim."[295]
>
> "Disa kolegë janë kundër dhunës. Të tjerët janë rritur në mënyra tradicionale dhe u mësojnë brezave të tjerë se fjalën e fundit e thotë burri. Në vend që të nxisin ndryshimin, ata i edukojnë brezat e rinj me këtë mendësi."[296]
>
> "Kur s'është faji i saj, ata duhet të flasim për situatën dhe ta zgjidhin."[297]
>
> "Kur vjen puna te divorci, unë jam patriarkal dhe asnjëherë s'do ta lija fëmijën të largohej ose shkonte me nënën e vet. Ata [fëmijët] janë nga gjaku i linjës së burrit, "prindit". E di që nuk më lejohet të flas për këtë me legjislacionin modern, por me traditën që kemi ne, nuk ka shans [që nëna] t'i marrë fëmijët. Kemi qenë dëshmitarë të shumë e shumë rasteve kur gratë janë martuar përsëri dhe kanë lindur fëmijë të tjerë, kështu që tani ato kanë dy palë fëmijë. Dhe fëmijët janë jetimë, viktima. Unë do të përballoja çdo gjë, çdo dhunë, nga gruaja ime vetëm e vetëm që fëmijët e mi të mos jetonin pa prind. Gruaja [...] mund të martohet me një burrë më të pasur dhe me të mund të ketë fëmijë të tjerë. Pastaj kërkon prapë divorcin dhe ligji ia jep këtë të drejtë. Ajo ia merr gjithë pasurinë [burrit], pa dhënë kurrfarë kontributi. E merr fëmijën, meqë këtë ia mundëson ligji, dhe kjo është mënyra se si krijohen problemet në shoqëri. Pra këtu çështja e dhunës nuk është më problem, por ajo e shfrytëzon këtë mundësi dhe ambiciet e veta personale që të bëhet udhëheqëse ose pronare e atij kapitali."[298]

Këto komente lënë të kuptohet se ka një mungesë të sensibilizimit dhe të mirëkuptimit lidhur me të drejtat ligjore reale; ka një tendencë mes disa mësimdhënësve për fajësimin e grave për dhunën që ushtrojnë burrat, për përforcimin e patriarkisë, e cila i minon të drejtat e grave gjerësisht në shoqëri, dhe për të vendosur një shembull negativ për fëmijët lidhur me rolet sociale dhe të drejtat e personave që kanë vuajtur nga dhuna në familje. Duke marrë parasysh rolin e rëndësishëm që kanë mësimdhënësit në arsimimin e brezave të ardhshëm, ndërgjegjësimi dhe njohuritë e tyre janë thelbësore për të siguruar transmetimin e duhur të mesazhit lidhur me socializimin, rolet e familjes, dhe dhunën në familje. Edukatorët dhe mësimdhënësit kanë nevojë për trajnime shtesë lidhur me rolet gjinore, socializimin dhe të drejtat ligjore.[299]

## Institucionet shëndetësore

Sipas Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Ministria e Shëndetësisë ka mandatin të zhvillojë dhe sigurojë infrastrukturë ndihmëse dhe të nevojshme për mbështetjen e zbatimit të ligjit. Më konkretisht, Ministria ka hartuar dhe miratuar Udhëzimin administrativ për mënyrën e trajtimit të

kryesve të dhunës në familje ndaj të cilëve është shqiptuar masa mbrojtëse e trajtimit të obligueshëm mjekësor nga varësia e alkoolit dhe substancave psikotrope.[300]

**"Të moshuarin e dhunonte i biri. Fqinjët e njoftuan policinë të cilët e morën atë [djalin], mirëpo meqenëse është përdorues droge, e konsideruan "të sëmur mendor" dhe e lanë të lirë. Tani jetojnë në të njëjtën ndërtesë, por jo në të njëjtën shtëpi."**
- Vajzë, 19 vjeçe, Suharekë

Megjithatë, duhet të zhvillohet më tej infrastruktura e nevojshme për ofrimin e këtyre shërbimeve. Kryesit që janë trajtuar njëherë në objektet e spitaleve të kujdesit primar, pasi janë larguar nga ato objekte nuk u janë nënshtruar trajtimeve përcjellëse.[301] Veç kësaj, duket se këto trajtime nuk janë të disponueshme në të gjithë Kosovën. "Urdhrat për mbrojtje të cilët kërkojnë që kryesit të trajtohen në institucione për abuzim me drogën dhe alkoolin, nuk mund të zbatohen për shkak të mungesës së këtyre institucioneve," ka komentuar një përfaqësues i një OJQ-je. Mungesa e objekteve për trajtim në vendndodhje të ndryshme në Kosovë mund të bëjë që kryesit të kthehen në familje ku kanë ushtruar dhunë dhe potencialisht t'i vënë njerëzit në rrezikun e dhunës recidiviste.

Ndërkohë që viktimat e dhunës në familje mund të mos u qasen institucioneve shëndetësore,[302] në disa raste institucionet shëndetësore mund të jenë ndër institucionet e para që ndeshen me persona të cilët mund të kenë pësuar dhunë. Kështu, institucionet shëndetësore përbëjnë një pjesë të rëndësishme të mekanizmit të referimit. Në pyetjet lidhur me dokumentin e PSV-ve, mjekët në përgjithësi janë të informuar. Madje edhe ata që nuk kanë dëgjuar asnjëherë për PSV-të duket se janë të njohur me përgjegjësitë sipas këtyre. Disa respondentët që punojnë në sallat e urgjencës, kanë thënë edhe se kishin formularë për regjistrimin e rasteve të dhunës seksuale dhe asaj në familje, të cilat u ishin ofruar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. Një mjek u shpreh:

> Kur punoja si doktor në Klinë, ishte një grua që erdhi për herë të dytë ose të tretë për të kërkuar trajtim mjekësor. Bashkëshorti i saj ushtronte dhunë [kundër saj]. E raportova rastin në polici. Burri më mori në telefonin më vonë dhe më falënderoi dhe më tha se ai dhe bashkëshortja e tij tanimë kishin marrëdhënie shumë të mira.[303]

Në përputhje me Betimin e Hipokratit dhe Ligjin për Shëndetësinë,[304] mjekët e institucioneve shëndetësore duhet të sigurojnë konfidencialitetin e të gjitha informatave. Pjesa më e madhe e mjekëve kanë thënë se kishin politika të qarta të cilat ishin marrë me seriozitet, edhe pse disa prej tyre u shprehën se "ka qenë e vështirë". Disa të tjerë thanë se nuk kishin dijeni për asnjë politikë, por mendonin se konfidencialiteti ishte me rëndësi. Kjo lë të kuptohet se ekziston nevoja për trajnim shtesë për disa prej anëtarëve të personelit shëndetësor lidhur me rëndësinë e konfidencialitetit.

**"Meqenëse në Qendrat e Mjekësisë Familjare nuk na vijnë raste të dhunës në familje, nuk kemi arsye t'i bëjmë këto trajnime. Ç'është e vërteta, nuk kemi qenë të informuar që duhet t'i organizojmë këto trajnime."**
- Përfaqësues i Drejtorisë Komunale të Shëndetësisë

Duke mbajtur parasysh rolin e tyre si reaguesit e parë potencialë, punonjësit e institucioneve shëndetësore duhet të marrin trajnim, sikurse edhe parashihet në PNV 2.2.1. Ky trajnim është organizuar dhe ofruar kryesisht nga akterë ndërkombëtarë. Për doktorët është hartuar edhe një udhëzues praktik për mënyrën e menaxhimit dhe regjistrimit të rasteve të dhunës në familje. Trajnimi ka përfshirë çështje të tilla si: identifikimi i shenjave të dhunës në familje, trajtimi i dhunës në familje, konfidencialiteti, identifikimi i shenjave të abuzimit seksual, si dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve. Janë trajnuar edhe anëtarë të personelit të sallave të urgjencës, shëndetit mendor, mjekësisë ligjore, gjinekologjisë dhe institutit mjekësor.

Intervistat me mjekët kanë sugjeruar se ka pasur përmirësim të disa prej qëndrimeve të tyre ndaj personave që kanë pësuar dhunë në familje. Pavarësisht kësaj, disa doktorë të intervistuar nga RrGGK-ja, duke përfshirë ata që punojnë në klinikat private, më parë, nuk kishin marrë pjesë në asnjë trajtim që lidhej me dhunën në familje. Për më tepër, edhe pse mund të jenë pika e parë e kontaktit pas referimit

nga policia, pak prej doktorëve të sallave të urgjencës dukej se ishin trajnuar për identifikimin e shenjave të dhunës dhe për qasjen e duhur që duhet të përdoret për viktimat e dhunës në familje.

Komentet e bëra nga disa prej mjekëve ishin për t'u shqetësuar. Njëri tha: "Duhet të hulumtojmë se cili është problemi i vërtetë si me burrat, ashtu edhe me gratë, në marrëdhënien ku është ushtruar dhunë, sepse jo gjithmonë është faji i burrave." [305] Sikurse kemi përmendur më sipër, justifikimi i dhunës me argumentin se dhuna "provokohet" mund të nënkuptojë që doktorët janë të keqpërgatitur për trajtimin e personave që vuajnë nga dhuna.

**"Si doktor, duhet të bëj kujdes kur shkruaj raportet për lëndimet. Kur gruaja thotë se e kanë goditur, por nuk ka asnjë shenjë të dukshme, duhet të jesh ca i rezervuar. Mos ndoshta po dëshiron vetëm ta akuzojë kryerësin apo vërtetë është goditur? Kjo është e vështirë të provohet sidomos në rastin e dëmtimeve të lehta. Gjëja më e mirë që mund të bëhet është që ajo të ekzaminohet për një periudhë kohore me një ekip."**

- Doktor i emergjencës

Një shqetësim i ngritur nga mjekët e familjes ka qenë mungesa e psikiatërve në ekipet e tyre. [306] Ekzistojnë shqetësime të mëtejshme për sa i takon kapacitetit të psikiatërve dhe psikologëve në kryerjen e detyrave të tyre në raport me rastet e dhunës në familje. Një psikologe e vjetër në profesion tha se psikiatrit nuk dinë si ta bëjnë punën e vetë dhe nuk janë të përgatitur për të menaxhuar rastet e dhunës në familje. "Nuk kam mundur të shoh kurrfarë ndryshimi në cilësinë e punës së psikiatërve," tha ajo.

## Qendrat e Aftësimit Profesional dhe Zyrat e Punësimit

Një çështje e përsëritur nga respondentët ka qenë ajo se personat që largohen nga strehimoret ende nuk i kanë mundësitë e duhura për të siguruar punësim dhe se fuqizimi ekonomik i grave ishte një "hallkë e dobët" në procesin e rehabilitimit dhe ri-integrimit. Zyrat e Punësimit, Qendrat e Aftësimit Profesional (QAP) dhe OShC-të, duke përfshirë këtu edhe programet që financohen nga donatorë, kanë kërkuar të ofrojnë shërbime të punësimit dhe kualifikime profesionale për viktimat e dhunës në familje, në pajtim me veprimet e parashikuara në PNV. Zyrat e Punësimit janë përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave, regjistrimin e të papunëve, këshillimin profesional për punësim dhe udhëzimin në karrierë, ndërmjetësimin në procedurat e punësimit, informimin e punë-kërkuesve të regjistruar për mundësitë e trajnimit, përfshirjen e punë-kërkuesve në trajnimin profesional, dhe dhënien e deklaratave të papunësisë.[307] QAP-ët ofrojnë trajnim profesional për personat e interesuar, të referuar nga Zyrat e Punësimit.

Të dhënat e kategorizuara sipas gjinisë, lidhur me përfituesit, tregojnë se nga QAP-ët përfitojnë më shumë burrat sesa gratë dhe se numri i grave që i lënë trajnimet është më i madh sesa ai i burrave. [308] Ndërkohë që punonjësit e QAP-ët në përgjithësi nuk dinin të kishin ndihmuar persona që kishin vuajtur në veçanti nga dhuna, disa punonjës të QAP-ve kanë thënë se kanë ofruar trajnime profesionale për viktimat e dhunës në familje.[309] Temat e kurseve kanë qenë: furrtaria, kompjuterat, gjuha angleze, leximi, shkrimi, gatimi, prodhimi i ushqimeve, rrobaqepësia, asistenca administrative, bletaria, manikyri, pedikyri, dhe parukeria. Është e paqartë shkalla në të cilën këto kualifikime plotësojnë kërkesat e tregut të punës dhe/ose do t'i ndihmonin viktimat e dhunës të gjenin punë. Më tej, është e diskutueshme që punësimi në punët që paguhen pak, siç janë fusha e rrobaqepësisë, parukerisë, dhe furrtarisë, do t'i ndihmonte gratë të bëheshin të pavarura nga ana financiare.

Në përgjithësi, gjatë viteve të fundit, përmes Zyrave të Punës janë punësuar më shumë burra sesa gra. Kështu, në vitin 2011, 32% e të punësuarve kanë qenë gra, në vitin 2012, 24%, në vitin 2013, 34 %.[310] Punësimi përgjithësisht i pabarabartë i grave përmes Zyrave të Punës mund të ndikojë edhe më shumë te gratë që janë viktima të dhunës në familje. Gratë të cilat kanë pësuar dhunë në familje mund të përballen me sfida shtesë që lidhen me traumën dhe izolimin. Për shembull, në pyetjen se përse gjithmonë mundnin të punësonin vetëm një person të caktuar që kishte vuajtur nga dhuna në familje për tri muaj, një këshilltar i një Qendre Rajonale të Punësimit u përgjigj: "Shikoni, ne jemi shumë të kujdesshëm për

**"Është e vështirë t'i punësosh këto gra në sektorin privat, sepse punëdhënësit kanë frikë se mos kryerësi vjen në objektet e biznesit dhe krijon probleme. Kjo është arsyeja pse them që të punësohen në sektorin publik."**

- Punonjës social

punësimin e tyre sepse zakonisht kryerësi, bashkëshorti, i ndjek dhe mund të shkaktojë probleme edhe për punëdhënësin. Bashkëshorti i saj mund të jetë i dhunshëm edhe në vendin e saj të punës." Pa u marrë me këtë ose pa u trajnuar për menaxhimin e kësaj situate, zyrtarët e punësimit do ta kenë të vështirë t'i gjejnë mundësitë për punësimin e grave të cilat kanë vuajtur nga dhuna në familje.

Ndërkohë që MPMS-ja është në procesin e përgatitjes së një moduli për trajnimin e zyrtarëve të punësimit lidhur me punën me viktimat e dhunës në familje, nuk duket se deri më sot, ndonjë prej zyrtarëve të këtyre institucioneve kishte marrë trajnim lidhur me këtë çështje. Të intervistuarit nga Zyrat e Punësimit dhe QAP-ët në përgjithësi dukeshin që nuk kishin njohuri për PSV-të dhe e kuptonin dhe njihnin në mënyrë të kufizuar situatën e veçantë dhe pengesat me të cilat përballen viktimat e dhunës. Ndërsa disa thoshin se kishin politika për konfidencialitetin në marrëdhëniet e tyre të punës, të tjerët nuk kishin dijeni për këto politika.

**"Shikoni, kur gruaja [flet për veten] punën gjithë ditën dhe pastaj shkon me vrap në shtëpi, asaj nuk i mbetet shumë kohë për të lexuar këto materiale. Tani jemi bërë si robotë."**
- Përfaqësuese e QAP-së (duke iu përgjigjur pyetjes për PSV-të

## Institucionet komunale

Pas decentralizimit, komunat kanë marrë kompetenca në veçanti lidhur me financimin e ofruesve të shërbimeve, siç janë strehimoret. Në pajtim me PNV-në, ato do të duhet të heqin mënjanë burimet për "strehimin social" për viktimat e dhunës në familje dhe, në raste të veçanta, të ofrojnë edhe ndihmë materiale për fëmijët dhe familjet që janë në nevojë.[311]

Disa respondentë kanë vënë në dukje përmirësimin e vullnetit të autoriteteve komunale për adresimin e dhunës në familje, në veçanti tri komunat e synuara nga agjencitë e Kombeve të Bashkuara dhe avokimi i shoqërisë civile. Këto komuna kanë krijuar mekanizma koordinues të cilët përfshijnë të gjitha palët e interesuara, me qëllim që të përmirësohet edhe më tej ndihma që u jepet viktimave të dhunës. Deri më sot, raportohet se Gjilani, Gjakova, Dragashi, dhe Prizreni kanë mekanizma koordinues. Këto mekanizma e lehtësojnë zbatimin e kornizës ligjore dhe koordinimin në menaxhimin e rasteve në nivelin komunal.

Pavarësisht avancimit, disa zyrtarë kanë shprehur shqetësim që përmes decentralizimit, disa kompetenca u janë deleguar komunave, në një kohë kur këto nuk i kanë kapacitetet dhe/ose burimet e mjaftueshme për ushtrimin e tyre. "Decentralizimi i kompetencave nga Departamenti për Mirëqenie Sociale në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale te komunat i ka vënë këto të fundit nën presion, ngaqë nuk i kanë kapacitet për trajtimin e këtyre problematikave," u shpreh një përfaqësues i shërbimeve sociale. [312] "Për shembull, janë bërë katër muaj tashmë që në strehimore mbajmë një grua me katër fëmijë. Pas dy muajve ajo duhet të largohet [nga strehimorja], por komuna nuk ka mundësi t'i japë asaj ndonjë strehë apo t'i ofrojë strehim pas kësaj kohe." Respondentët në përgjithësi kanë rënë dakord se zgjidhjet për periudhën e pas-strehimit, të tilla si strehimi shoqëror, mbetet të kufizuara ose inekzistente. Vetëm një komunë (Gjakova) duket se ka alokuar burime për strehimin e viktimave të dhunës në familje (sikurse parashihet në PNV).[313]

## Koordinimi ndër-institucional: "Nëse nuk e raportoj rastin, zinxhiri shkëputet"[314]

Disa respondentë kanë vënë në dukje nevojën për përmirësimin e bashkëpunimit ndër-institucional: "Institucionet nuk i njohin detyrimet e veta. I dërgojnë viktimat nga njëri institucion te tjetri dhe, në këtë mënyrë, i ri-viktimizojnë ato, sepse u duhet t'i ritregojnë historitë e tyre shumë herë", u shpreh një mësimdhënës. Është e paqartë edhe shkalla në të cilën secili rast ndiqet gjatë gjithë procesit. Për shembull, një zyrtar i policisë dha këtë koment: "Nuk na kanë dhënë kurrë informata kthyese lidhur me rastet që kanë përfunduar në gjykatë dhe ndonjëherë ndodh që i marrim njerëzit dhe i çojmë në gjykata për herë të dytë për të njëjtat gjëra. [...] Në bazën tonë të të dhënave kemi pasur shumë raste ku personi ka figuruar me dosje të hapur, ndërkohë që në gjykatë, ka pasur dosje të mbyllur."[315] Është e qartë se një bazë ndër-institucionale e konsoliduar e të dhënave lidhur me konfidencialitetin dhe

mbrojtjen e të dhënave, do të mund ta lehtësonte koordinimin midis palëve të interesuara dhe do ta përmirësonte menaxhimin e rasteve.

Gjithashtu, është theksuar edhe nevoja për të siguruar që politikat e nivelit kombëtar të zbatohen mirë nëpërmjet koordinimit të qasjes në nivel komunal për kryerjen e shërbimeve të ndryshme për viktimat e dhunës në familje. Komunat, të cilat i kanë krijuar tashmë këto mekanizma të koordinimit, mund të përbëjnë një model të praktikave më të mira për mekanizmat e ngjashëm të cilët do të krijohen edhe në vendndodhje të tjera. Duke mbajtur parasysh që strehimoret u shërbejnë rajoneve të tëra dhe jo vetëm një komune, ekziston gjithashtu edhe nevoja që, aty ku paraqitet nevoja, të nxitet bashkëpunimi ndërmjet komunave.

Koordinimi në veriun e Kosovës në veçanti, paraqet vështirësi për shkak se veprojnë sisteme të ndryshme. Ndërkohë që Policia e Kosovës është duke punuar, gjykatat nuk funksionojnë. Sot për sot nuk ka asnjë strehimore. Edhe pse disa prej QPS-ve funksionojnë sipas sistemit të Kosovës, QPS-të e tjera veprojnë në pajtim me kornizën ligjore të Serbisë.[316] Duhen bërë përpjekje për të siguruar që edhe personat që jetojnë në veri të kenë qasje në mbrojtje të mjaftueshme.

# Rekomandime

## Për kornizën ligjore

- Të ndryshohet Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje me qëllim që të përfshijë rolet dhe përgjegjësitë e secilës agjencie që lidhet me masat e rehabilitimit dhe të ri-integrimit, si dhe të përcaktohen qartë procedurat që mbeten të paqarta, në veçanti lidhur me qëllimin e ligjit, synimin të tij, dhe aktet nën-ligjore. Kjo do të siguronte hetime, ndjekje penale dhe kompensim efektiv dhe efikas për viktimat e dhunës në familje.
- Të sigurohet që ligji ofron një mjet efektiv ligjor në rastet kur ekzistojnë ende kushtet për dhënien e urdhrave për mbrojtje. Kufizimet aktuale të ligjit lidhur me zgjatjen e urdhrave për mbrojtje, pa ofrimin e masave alternative në rastet kur vazhdojnë kushtet, përbëjnë shkelje të të drejtave të viktimave të dhunës në familje për mjet efektiv ligjor dhe mbrojtje nga ana e shtetit kundër akteve të dhunës në familje. Duke marrë parasysh rrethanat, kufizimi kohor prej 24 muajsh për urdhrat për mbrojtje, i cili përcaktohet me ligj, do të duhet të ofrojë një numër të pakufizuar të zgjatjeve.
- Të ndryshohet Ligji me qëllim që të përcaktohen më qartë mjetet ligjore penale, si dhe të nxitet zbatimi i mjeteve juridike civile në rast të shkeljes së urdhrave për mbrojtje. [317]
- Të ndryshohet ligji me qëllim që "kryesit" të referohen si "kryerës të dyshuar".
- Të ndryshohet Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Ligji i Familjes dhe Kodi Penal me qëllim që të ndalohen zgjidhjet alternative të kontesteve në rastet e dhunës në familje, në pajtim me nenin 48 të Konventës së Këshillit të Evropës.
- Të fillojë hartimi i amendamenteve në Kodin Penal ku dhuna në familje të përcaktohet si vepër penale, duke u mbështetur në rekomandimet e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familjes. Kjo konventë u kërkon shteteve të ofrojnë kujdes të duhur dhe të ndërmarrin masat e nevojshme ligjore për "të siguruar hetim dhe ndjekje penale efektive për veprat penale."
- Të ndryshohet Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale me qëllim që të përcaktohet dhe kriminalizohen veprat e dhunës në familje, në pajtim me përkufizimet e dhëna në Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.
- Të ndryshohen PSV-të për të përshkruar në mënyrë të qartë rolet dhe përgjegjësitë e secilës agjenci të përfshirë, duke e bërë dokumentin e PSV-ve, në të njëjtën kohë, më miqësor ndaj përdoruesit. Të harmonizohen PSV-të me mandatin e ri të MV-ve.
- Të sigurohet që të gjitha institucionet që kanë përgjegjësi ligjore për zbatimin e kornizës ligjore, të caktojnë burime të mjaftueshme financiare në buxhetet vjetore.
- Përmes një procesi pjesëmarrës dhe duke u mbështetur në këtë hulumtim, të hartohet Programi i ri Nacional kundër Dhunës në Familje dhe PNV-ja.

## Për Programin e ri Nacional dhe Planin e Veprimit

- Të përfshihen të gjithë treguesit në të gjitha nivelet e hierarkisë logjike, duke përfshirë rezultatet, objektivat specifike, dhe objektivat e përgjithshme. Duhet të përfshihen linjat bazë të qarta të të dhënave, synimet dhe afatet kohore për arritjen e tyre.
- Institucioneve t'u caktohen përgjegjësi specifike dhe këto të emërohen në mënyrë specifike, duke i kërkuar llogari secilit institucion për përgjegjësitë që ka. Të shmanget delegimi i përgjegjësive ligjore te "akterët privatë", "donatorët", "media" apo shoqëria civile, sepse është shumë e vështirë që ato të mbajnë përgjegjësi ligjore. Këto duhet të bëhen pjesë dhe të përfshihen përmes mekanizmave të ndryshëm me një rol mbështetës dhe këshillëdhënës.
- Të sigurohet që institucionet përkatëse alokojnë buxhet të mjaftueshëm për zbatimin e PNV-së.
- Të identifikohen veprimet për sigurimin që përgjegjësitë nacionale të zbatohen dhe institucionalizohen në nivel komunal, duke përmirësuar hallkat midis institucioneve të nivel qendror me ato të nivelit lokal. Kur bëhet fjalë për menaxhimin e rastit, të përfshihet përcjellja e rrjedhës së

rasteve nëpër institucione dhe mbledhja dhe raportimi i të dhënave statistikore të ndara sipas kategorive, në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore.

- Të sigurohet që të gjithë zyrtarët përgjegjës të marrin trajnim të mjaftueshëm për traumën, identifikimin e shenjave të dhunës me bazë gjinore, qasjen e duhur për ndihmesën për viktimat e dhunës, si dhe konfidencialitetin. Donatorët dhe akterët e tjerë që kërkojnë të financojnë ofrimin e këtyre trajnimeve, duhet të koordinohen dhe të sigurojnë që këto trajnime të institucionalizohen në institucionet e Kosovës (p.sh. përmes IKAP, KGjK, dhe AKSP) me qëllim që ato të jenë të vet-qëndrueshme dhe jo thjesht *ad hoc*.
- Të përdoren fushatat sensibilizuese për edukimin e qytetarëve për të drejtat e tyre dhe se ku mund ta raportojnë dhunën, duke përfshirë edhe raportimin në institucione të ndryshme. Të krijohet një plan publik gjithëpërfshirës më i konsoliduar, ku të përfshihen akterë të ndryshëm me mesazhe të përbashkëta dhe të drejtuara kah grupeve të synuara. Të sigurohet një qasje më e koordinuar mes akterëve të ndryshëm për rritjen e sensibilizimit, në drejtim të shpenzimit më efikas dhe efektiv të burimeve. Fushatat sensibilizuese do të duhet të përqendrohen te çështje të tilla si: të drejtat ligjore, asistenca e disponueshme, institucionet konkrete ku merret ndihmë (me informata të kontaktit), mënyra e raportimit të veprimeve të ndaluara që bëjnë institucionet, si dhe minimi i keqkuptimeve të zakonshme lidhur me dhunën, në të cilët bëjnë pjesë thënie si: "dhuna në familje ndodh për faj të grave", "dhuna vjen nga papunësia", "nuk mund të ketë dhunë seksuale mes çifteve të martuara", "dhuna në familje është më e përhapur në zonat rurale" (të gjitha këto thënie janë hedhur poshtë nga të dhënat statistikore).
- Në strategji, shprehimisht duhet t'u kushtohet vëmendje nevojave dhe rasteve të veçanta të dhunës me të cilat përballen personat e komunitetit LGBT, personat me aftësi të kufizuara, gratë, burrat dhe fëmijët.
- Të adresohen sfidat specifike me të cilat përballen njerëzit në veri të Kosovës, duke përfshirë strehimoret, shërbimet dhe koordinimin.
- Të gjendet një zgjidhje për trajtimin dhe strehimin e burrave që përjetojnë dhunë, duke përfshirë djemtë që janë mbi 12 vjeç dhe që nuk mund të qëndrojnë në strehimoret ekzistuese.
- Kryesve të dhunës t'u vihet në dispozicion trajtimi dhe, nëse është e mundur, edhe strehimi.
- Të rinovohet dhe përforcohet angazhimi për banim social për viktimat e dhunës në familje, duke siguruar që çdo komunë të marrë një numër specifik të banesave që janë të disponueshme për një kohë specifike për secilin klient, brenda kuadrit të një programi më të qartë të rehabilitimit për personat që largohen nga strehimoret.
- Të vendoset fokusi te rehabilitimi dhe riintegrimi, duke përfshirë hapat konkretë për institucionalizimin e përhershëm të: trajtimit rehabilitues për kryesit e veprës; këshillimit familjar, duke përfshirë atë për traumë; këshillimit psikologjik të përballueshëm nga ana ekonomike dhe të kualifikuar për personat që kanë pësuar dhunë në familje; dhe çështjeve që janë skicuar më poshtë në rekomandimet për institucionet specifike.
- Të realizohet një fushatë në terren pas miratimit të PNV-së me qëllim që të sigurohet që të gjithë personat përgjegjës për zbatimin e saj të jenë plotësisht të informuar për rolet dhe përgjegjësitë e tyre.

### Për Ministrinë e Drejtësisë dhe Koordinatorin Nacional

- Të alokohet një buxhet për një pozitë të përhershme të nëpunësit civil në zyrën e Koordinatorit Nacional, i cili do të jetë përgjegjës për monitorimin e avancimit në zbatimin e Programit të ri Kombëtar dhe PNV-së, si dhe për mbledhjen dhe konsolidimin e të dhënave që lidhen me treguesit e PNV-së.
- Të sigurohet koordinim më i mirë mes gjithë akterëve të përfshirë, duke përfshirë në veçanti organizatat qeveritare, organizatat jo-qeveritare dhe ato të donatorëve, duke ngritur një grup punues ndërministror, me përfshirjen e akterëve të shoqërisë civile që kanë ekspertizë në këtë fushë.

- Të caktohen financime për fondin e kompensimit për viktimat, në pajtim me Ligjin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të sigurohet që gjyqtarët të jenë të informuar për të, dhe të monitorohet zbatimi i tij. Këtu përfshihet ndjekja e numrit të llojeve të ndryshme të rasteve, duke përfshirë rastet që kanë të bëjnë me krime brenda familjes, ku jepet kompensimi dhe sasia e dhënë e tij.
- Të monitorohet numri i llojeve të ndryshme të masave të urdhrave për mbrojtje, të cilat kërkohen prej gjykatave dhe jepen prej tyre.

### Për Institutin Gjyqësor të Kosovës

- Të organizohen rregullisht trajnime të përbashkëta për prokurorë, gjyqtarë, Policinë e Kosovës, MV-të dhe QPS-të, me qëllim të përmirësimit të komunikimit dhe koordinimit në raport me ndjekjen penale të rasteve të dhunës në familje.
- Të sigurohet që të gjithë gjyqtarët e çështjeve civile dhe penale të marrin trajnim të mirë për dispozitat e ligjit dhe që trajnimi të adresojë keqkuptimet lidhur me fajësimin e viktimës, ripajtimin familjar dhe kujdestarinë e fëmijës.
- Të sigurohet që gjyqtarë e çështjeve civile të trajnohen mirë për masat e disponueshme të urdhrave për mbrojtje, si dhe për interesat më të mira të fëmijës përtej thjesht mirëqenies financiare.
- Të caktohet dhe ofrohen trajnime të avancuara për kuadrot e gjyqtarëve të gjykatave penale, të cilët specializohen për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, dhunës seksuale dhe formave të tjera të dhunës me bazë gjinore.

### Për Zyrën e Prokurorit dhe ZMNV-së

- Të monitorohet vazhdimisht mënyra në të cilën mandati i ri i MV-ve ndikon në praktikë te mbrojtja e tyre dhe ndihma për personat që kanë vuajtur nga dhuna në familje.
- Të ndiqen në mënyrë elektronike llojet e masave që kërkohen dhe jepen.
- Të krijohet një vend pune për një hetues të specializuar për dhunën në familje, pranë Zyrës së Prokurorit.[318]

### Për Policinë

- Të inkorporohen në trajnimin e detyrueshëm për gjithë oficerët e policisë informata të mëtejshme për dhunën në familje, për mënyrën e identifikimit të shenjave të traumës dhe për komunikimin me personat që kanë përjetuar trauma si rezultat i dhunës me bazë gjinore. Trajnimi do të duhet të adresojë edhe keqkuptimet lidhur me fajësimin e viktimave dhe pajtimin familjar.
- Të bëhen kërkesa për buxhet të mjaftueshëm për të siguruar që të gjitha stacionet e policisë të kenë hapësirë të mjaftueshme për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe që NjHDhF-të të pajiset plotësisht dhe të plotësohen me personel me qëllim kryerjen e detyrave të tyre. Plotësimi me personel do të duhet të sigurojë që të gjitha NjHDhF-të, në çdo kohë, të kenë në dispozicion oficere (gra) për t'u përgjigjur rasteve të dhunës në familje.
- Të rritet llogaridhënia për oficerët e policisë të cilët nuk u përgjigjen me shpejtësi dhe si duhet rasteve të dhunës në familje, dhe në pajtim me ligjin në fuqi në Kosovë; të sigurohet nga ana e Inspektoratit të Policisë hetime të shpejta të performancës së raportuar si të dobët, duke i ndjekur me masa disiplinore të rrepta, me tolerancë zero.
- Të sigurohet që të gjitha NjHDhF-të t'i informojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe të menjëhershme QPS-të për rastet e dhunës në familje.
- Të sigurohet që numri i posaçëm për rastet e dhunës në familje të mbahet i disponueshëm 24 orë në ditë, në përputhje me Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Për Strehimoret

- Të sigurohet që personeli i strehimoreve të ketë përfunduar me sukses trajnimin profesional për traumën, këshillimin e të mbijetuarave të traumës, si dhe për qasjen.
- Të publikohen në internet raporte vjetore, duke përfshirë portretizimin transparent të të gjitha shpenzimeve dhe raporteve të auditimit, në drejtim të përmirësimit të imazhit dhe demonstrimit të transparencës lidhur me fondet e përfituara qoftë nga shteti, qoftë nga akterët ndërkombëtarë.

Për MPMS-në

- Të sigurohet që të gjithë punonjësit e licencuar për të ndihmuar personat që kanë vuajtur nga dhuna në familje, duke përfshirë punonjësit dhe personelin e strehimoreve, ta kenë përfunduar me sukses trajnimin profesional për intervistimin, traumën, këshillimin e të mbijetuarave nga trauma, këshillimin për rehabilitim, qasjen, këshillimin e kryesve të dhunës, dhe bashkëpunimin me akterë të tjerë në pajtim me PSV-të.
- Të sigurohet që të gjithë punonjësit socialë të jenë të informuar për PSV-të dhe rolin e përgjegjësitë që ata kanë, të cilat u përcaktohen nga PSV-të.
- Të caktojë një buxhet të përhershëm për strehimoret, i cili duhet të jetë i mjaftueshëm që ato të mbulojnë të gjitha shpenzimet, duke përfshirë këshillimin dhe përkujdesjen për viktimat e dhunës.
- Të kryejë vizita të rregullta për të monitoruar cilësinë e shërbimeve të ofruara nga personat edhe organet që ndihmojnë personat që kanë vuajtur dhunë në familje, duke përfshirë këtu edhe strehimoret, me qëllim që të sigurohet që të përmbushen standardet zyrtare të cilësisë dhe shërbimet themelore. Të ndërmerren hapa të menjëhershëm për të adresuar çfarëdolloj neglizhence në raport me viktimat e dhunës në familje apo keqtrajtimin e tyre. Të sigurohet që personat që e kryejnë monitorimin të jenë të mirë-trajnuar për standardet minimale të përkujdesjes dhe për qasjen e përshtatshme.
- Të përmirësohen hallkat lidhëse ndërmjet strehimoreve, QAP-ve dhe Zyrave të Punës, duke identifikuar në mënyrë më aktive trajnimet për shkathtësitë që kërkohen në treg si dhe punët e përshtatshme për personat e dhunuar, në veçanti gratë. Të sigurohet që oficerët të trajnohen për qasjet e duhura lidhur me ndihmën për personat që kanë përjetuar trauma.

Për Ministrinë e Shëndetësisë

- Të sigurohet trajnim i detyruar për të gjithë profesionistët e shëndetit (në formën e kualifikimeve, duke përfshirë edhe klinikat private) lidhur me identifikimin e shenjave të dhunës, referimin, dhe mënyrën se si bëhet komunikimi me personat që kanë përjetuar dhunë.
- Të sigurohet që i gjithë personeli të trajnohet për hapjen dhe gjurmimin e rasteve të dhunës në familje.
- Të alokohen financime të mjaftueshme me qëllim që kudo në Kosovë të vihen në dispozicion të plotë shërbime këshillimore psikologjike për të mbijetuarat, kryesit e veprës dhe familjet, duke përfshirë këtu edhe fëmijët. Të sigurohet që psikologët dhe psikiatrit e punësuar të jenë të trajnuar plotësisht për këshillimin në rastet e traumave dhe dhunës me bazë gjinore. Infrastruktura e zhvilluar duhet të sigurojë disponueshmërinë e këshillimit edhe pasi marrësit e shërbimit të largohen nga spitalet.
- Të organizohet një fushatë për promovimin e shërbimeve të këshillimit psikologjik dhe për arsyet se pse këto janë të mira për gjithë shoqërinë, në drejtim të adresimit të pengesave kulturore me të cilat përballen njerëzit që kërkojnë këshillim psikologjik.
- Të nxirret një udhëzim administrativ për t'i informuar punonjësit e qendrave shëndetësore për PNV-në e re, menjëherë pas miratimit të tij, dhe përgjegjësitë që ata kanë duke u mbështetur në atë plan.

**Për MAShT-in**

- Të sigurohet trajnim për gjithë edukatorë, mësimdhënësit, psikologët dhe pedagogët e shkollave për rolet gjinore, identifikimin e shenjave të dhunës, përgjegjësitë ligjore në rastet e dhunës kundër fëmijëve, referimet, konfidencialitetin, dhe mënyrën e komunikimit me viktimat e dhunës.
- Të përfshihen në planprogramet mësimore informata të përditësuara lidhur me rolet gjinore, socializimin, parandalimin e stereotipave gjinorë dhe dhunën në familje.
- Të vendosen në shkollë më shumë psikologë të kualifikuar dhe të mbështetur me buxhet të përhershëm dhe të sigurohet që ata trajnohen në mënyrë të përshtatshme për rolet e tyre.

**Për Zyrat për Ndihmë Juridike**

- Të sigurohet që të caktohen burime të mjaftueshme qeveritare për funksionimin e Zyrave për Ndihmë Juridike.

**Për Shërbimet Korrektuese dhe Sprovuese**

- Të sigurohet që zyrtarët e këtyre shërbimeve janë të trajnuar me një çasje të veçantë në ofrimin e ndihmës ndaj kryesve të dhunës gjatë proceseve të rahabilitimit dhe riintegrimit të tyre.
- Të ofrojnë këshillim psikologjik gjatë rehabilitimit të kryesve të dhunës në familje.

**Për komunat**

- Të vendosen mekanizma të koordinimit në nivel komunal dhe, aty ku është e përshtatshme, në atë rajonal, për dhunën në familje, me qëllim që të përmirësohet koordinimi midis institucioneve përkatëse dhe të ofrohet një qasje e përmirësuar dhe holistike për ndjekjen e rasteve gjatë gjithë procesit.
- Të alokohen burime nga buxheti komunal për të financuar strehimoret dhe strehimin social.

# Shtojca 1. Metodologjia e hulumtimit

Ky aneks paraqet hollësi të mëtejshme lidhur me metodologjinë e hulumtimit që kemi përdorur. Për t'iu përgjigjur pyetjeve të hulumtimit, të cilat janë përvijuar në hyrjen e këtij studimi, hulumtimi ka përdorur metoda të përziera: 1) është shqyrtuar korniza ligjore për identifikimin e hendeqeve në kornizën ligjore dhe zbatimin e saj; 2) është realizuar një anketim kombëtar i amvisave me 1,315 qytetarë, për matjen e vetëdijesimit, qëndrimeve dhe incidencës së dhunës në familje; 3) janë realizuar intervista me përfaqësues të rreth 200 institucioneve dhe organizatave të përfshira në zbatimin e kornizës ligjore; janë shqyrtuar të dhënat statistikore të mbledhura nga institucionet përkatëse. Më poshtë jepen hollësi të mëtejshme.

## Anketimi

Të dhënat sasiore janë mbledhur përmes anketimit në shtëpi të individëve, i cili është realizuar në gjithë Kosovën.

**Pyetësori:** Instrumenti i anketimit përmbante kryesisht pyetje me fund të mbyllur dhe ishte i ngjashëm me instrumentin anketues të vitit 2008, me qëllim që të mundësohej krahasimi (shihni Aneksin 3). Lidhur me besueshmërinë, RrGGK-ja ka përfshirë disa pyetje me kuptim të ngjashëm, të formuluara ndryshme dhe të vendosura në vende të ndryshme të pyetësorit. Pjesa më e madhe e pyetësorëve, të cilët janë plotësuar përmes intervistave ballë për ballë, kanë zgjatur afërsisht gjysmë orë, edhe pse një sondazh zgjati pak më pak sesa dy orë. Kohëzgjatja mesatare e intervistave ka qenë 35 minuta, me një devijim standard prej 12 minutash.

**Pilotimi (pre-testi)**: Anketimi është paratestuar përpara anketimit real në zonat rurale dhe urbane të Prishtinës. Kjo i ka mundësuar ekipit të hulumtimit të shohë nëse instrumenti i sondazhit është dizajnuar si duhet dhe nëse qytetarët e kuptonin atë. Duke u mbështetur në këtë pilotim, janë bërë edhe disa modifikime të vogla.

**Anketuesit**: Anketuesit janë përzgjedhur në bazë të formimit të tyre arsimor, shkathtësitë e komunikimit, shkathtësitë profesionale, etikën dhe gatishmërinë e tyre për t'u bërë pjesë e hulumtimit. Kryesisht anketuesit ishin studentë të psikologjisë dhe sociologjisë. Për intervistimin e grupeve të ndryshme, RrGGK-ka ka përfshirë edhe anketues nga grupet etnike minoritare, të cilët flisnin shumë gjuhë. Anketuesit kanë qenë të ekuilibruar nga pikëpamja gjinore. Duke mbajtur parasysh ndjeshmërinë e çështjes, gratë kanë intervistuar gratë ndërsa burrat kanë intervistuar burrat. Lista e anketuesve është paraqitur në pjesën e mirënjohjes të këtij hulumtimi.

**Trajnimi i anketuesve**: Për të gjithë anketuesit është zhvilluar një trajnim i detyrueshëm dy-ditor. Trajnimi ka siguruar që anketuesit ta njohin mandatin e hulumtimit, instrumentin e anketimit, procedurat e kontrollit dhe logjistikën. Një pjesë tjetër e rëndësishme e trajnimit ka qenë edhe rëndësia e ruajtjes së sigurisë dhe mirëqenies emocionale të respondentëve, si dhe mënyra e menaxhimit të situatave të ndryshme të cilat mund të krijoheshin gjatë anketimit, për shembull shfaqja e shenjave të traumave nga respondentët ose ndërhyrjet e anëtarëve të familjes. Veç kësaj, trajnimi është përqendruar në etikën e anketuesve, duke marrë parasysh çështjen e ndjeshme me të cilën merret ky hulumtim.

**Mostra e hulumtimit:** RrGGK-ja ka anketuar 1,315 qytetarë të të gjitha grupeve etnike dhe të moshës 18 vjeç e sipër. RrGGK-ka ka përzgjedhur një mostër të rastësishme të popullatës së Kosovës. Mostra ka përfshirë banorë të zonave rurale dhe urbane dhe 181 pika monstrimi të përzgjedhura në mënyrë rastësore në 132 vendbanime në 36 komuna. Mostra përfaqëson gjithashtu edhe të gjitha grupet etnike në Kosovë, duke qenë se përzgjedhja është bërë duke përdorur metodën e mostrimit rastësor me shumë shkallë. Ndarja në strate e respondentëve është bërë mbi bazën etnike dhe rajonale. Kuotat e mostrimit janë caktuar duke përdorur të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, të prillit të vitit 2011, të siguruara nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK).[319] Mostra e përgjithshme është ndarë në tri nën-grupe: nën-grupi i shqiptarëve, nën-grupi i serbëve dhe nën-grupi i grupeve të tjera etnike. Më pas, mostra është stratifikuar sipas rajonit dhe profilit banesor (urban/rural) të secilit rajon.

**Përkatësia etnike**: Mostra është përbërë nga shqiptarë, serbë të Kosovës dhe grupet minoritare jo-serbe në Kosovë (minoriteti turk, boshnjak, goran, romë, ashkali dhe egjiptian). Parimet e stratifikimit kanë qenë të njëjta për të trija grupimet etnike. Për të siguruar numrin e mjaftueshëm të anëtarëve nga secili nën-grup i caktuar i popullatës, me qëllim që të bëheshin vlerësime të besueshme lidhur me atë grup, RrGGK-ja i ka mbi-mostruar serbët e Kosovës dhe grupet e tjera minoritare. Të dhënat më pas janë peshuar gjatë analizimit me qëllim që kjo të merrej parasysh.

**Përfaqësimi gjeografik:** Ekipi i hulumtimit ka kryer anketime në të gjitha rajonet dhe pothuaj në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.

**Mosha dhe gjinia**: Në mënyrë rastësore, sipas teknikës së ditëlindjes më të afërt, nga çdo familje janë përzgjedhur respondentë të moshës 18 vjeç e sipër. Kjo natyrshëm krijon një shpërndarje proporcionale të grave dhe burrave, në mënyrë të ngjashme me shpërndarjen në popullatë. Sipas ASK-së, 50.3% e popullsisë janë burra ndërsa 49.7% janë gra.

**Procesi i intervistimit:** Anketimi është kryer nga data 19 deri me 28 shkurt. Nga 1,315 individë të anketuar, 20 nuk kanë mundur ose refuzuan ta plotësonin të gjithë atë. Në shtatë raste, intervista është lënë në mes sepse respondentët nuk kishin kohë të vazhdonin. Në pesë raste, respondentët thjesht refuzuan të vazhdonin. Tre respondentë nuk mundën të përfundonin për shkaqe të ndryshme, duke përfshirë moshën e madhe, sëmundjen, ose ndalimin nga dikush tjetër. Ka pasur edhe katër raste ku të intervistuarit nuk ishin të gatshëm psikologjikisht për ta vazhduar intervistën, gjë e cila pritet me intervistat që kanë të bëjnë me informata të një natyre kaq të ndjeshme dhe private. Në përgjithësi, e gjithë intervista dhe anketa është plotësuar nga 98.4% të pjesëmarrësve.

Pasi u trajnuan për praktikat psikologjike moderne, hulumtuesve iu kërkua të vëzhgonin respondentët në raport me disa dimensione, të tilla si: sinqeriteti, të kuptuarit dhe rehatia. Këta elementë janë të rëndësishëm për të vlerësuar gabimin dhe për të kuptuar shkallën në të cilën respondentët janë përgjigjur me sinqeritet pyetjeve të tilla delikate. Hulumtuesit kanë vlerësuar se si kanë shkuar intervistat. Në pothuaj 50% të intervistave, intervistuesit nuk kanë shkruar komente, meqenëse intervista ka shkuar mirë dhe nuk kanë pasur ndonjë përshtypje për të raportuar. Sipas intervistuesve, vetëm 1,6% (21 intervista) shkuan shumë dobët dhe 5 % (70) shkuan relativisht dobët. Afërsisht 30% e intervistave kanë shkuar “mirë” dhe 13.4% “shumë mirë”.

Studimi i çështjeve delikate, siç është dhuna në familje, krijon probleme si metodologjike, ashtu edhe teknike për hulumtuesin. Për shkak të perceptimit social të dhunës në familje si diçka e padëshirueshme dhe implikimeve në të ardhmen, gjasat e përgjigjeve të pasakta mund të jenë të larta. Hulumtuesit besojnë se 30% e respondentëve mund të kenë qenë jo të sinqertë në një ose më shumë prej përgjigjeve që kanë dhënë.

Respondentëve në hulumtim u është kërkuar të plotësojnë në mënyrë të pavarur një tabelë për përvojat e tyre personale me dhunën në familje. Për të siguruar privatësinë, kjo tabelë është dizajnuar të plotësohej nga respondenti pa ndërhyrjen e intervistuesit. Në rreth 96.2% të rasteve, respondentët e kanë plotësuar tabelën vetë, pa ndihmën e intervistuesit. Në 28 raste (2,1%), respondentët kanë pasur nevojë ose kanë kërkuar ndihmën e intervistuesit për ta plotësuar tabelën. Ndërhyrja nga hulumtuesit mund të ketë ndikuar në përgjigjet që janë dhënë, edhe pse në një numër fare të vogël të rasteve.

Hulumtuesve iu kërkua që të masnin nivelin e të kuptuarit të respondentëve. Për shkak të niveleve të ndryshme të arsimimit dhe pengesave potenciale gjuhësore, është me rëndësi të identifikohen përgjigjet që ngatërrohen për shkak të problemeve në të kuptuar. Në 94.6% të intervistave, intervistuesit besojnë që respondentët i kanë kuptuar plotësisht pyetjet. Ka pasur vetëm 23 raste për të cilat intervistuesit besojnë se respondentët nuk kanë arritur t’i kuptojnë pyetjet që u janë bërë. Veç kësaj, në 47 raste të tjera, respondentët dukeshin se i kuptonin pyetjet në mënyrë të pjesshme.

Në disa situata, prania e personave të tjerë gjatë intervistimit mund të ketë ndikuar në përgjigjet e respondentëve. Edhe pse intervistuesit janë udhëzuar që të marrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar një hapësirë private për të realizuar intervistën, në Kosovë, duke marrë parasysh kushtet e jetesës, kjo është mjaft e vështirë të arrihet. Më tej, në familjet ku mund të ushtrohet dhunë, kontrollimi i veprimeve të anëtarëve të familjes, në vetvete, nënkupton që respondenti mund të mos ketë mundur

të flasë lirshëm kur anëtarët e tjerë të familjes kanë qenë aty rrotull. Në 93,9% të intervistave, respondentët kanë qenë vetëm. Në 45 raste (3,4%), gjatë gjithë intervistës, i pranishëm ka qenë edhe një anëtar tjetër i familjes dhe në 35 raste (2,6%), gjatë intervistës, për një pjesë të kohës, të pranishëm kanë qenë persona të tjerë. Prania e të personave të tjerë ka rëndësi të theksohet sepse respondentët, në prani të tyre, në disa raste mund t'i kenë ndryshuar përgjigjet për shkak të dëshirueshmërisë sociale ose frikës. Për shembull, në një rast ekstrem, kur intervistuesi e pyeti respondenten nëse kishte ndonjë koment tjetër, vjerra e saj i tha: "Mos fol më se mbase bën ndonjë gabim dhe more fund." Edhe pse ka ndodhur edhe kështu, duke marrë parasysh përqindjen e vogël të rasteve, prania e personave të tjerë mund të ketë pasur pak ndikim te gjetjet.

Intervistuesit janë udhëzuar që gjatë gjithë intervistës të vëzhgojnë gjuhën e trupit të respondentëve, sjelljen e tyre, ndryshimin e intonacionit, dhe rehatinë. Në 163 intervista (12,4%), intervistuesit besojnë se respondentët kanë shfaqur shenja të parehatisë. Në pjesën tjetër të intervistave, intervistuesit nuk kanë vënë re ndonjë luhatje në nivelin e rehatisë. Nivelet e rehatisë mund të shërbejnë si tregues për përvojat personale me dhunën në familje dhe/ose parehatinë për të diskutuar për një temë të tillë. Veç analizimit të sjelljes së respondentëve, intervistuesve iu kërkua të shprehin mendimin e tyre lidhur me atë nëse respondentët mund të kenë përjetuar dhunë në familje. Në 41 raste, intervistuesit besonin se respondentja mund të ketë përjetuar dhunë në familje. Nga këto raste, gjatë intervistës, 25 thanë se vuanin nga ndonjë formë e dhunës, ndërsa 16 mund të jenë raste të paraportuara të dhunës në familje, të cilat nuk janë përfaqësuar në të gjeturat e intervistimit. Ka pasur 52 raste ku intervistuesit ishin të sigurtë që në familjen e respondenteve ushtrohej dhunë.

**Kontrolli:** Dy persona, të cilët nuk ishin përfshirë në intervistim, bënë kontrollin e intervistave. Kontrolli përfshinte vizita rastësore në terren për të siguruar që po ndiqej metodologjia e mostrimit dhe për të kontrolluar cilësinë e punës së anketuesve. Për sigurimin e saktësisë, kontrolluesit bënë edhe kontrollin e një mostre prej 10 % të anketave të plotësuara, të përzgjedhura rastësisht.

**Hedhja e të dhënave:** Të dhënat janë futur nga dy persona të cilët nuk ishin përfshirë në intervistim, duke përdorur SPSS 22.0 për analizimin e të dhënave. Ata kanë futur informata cilësore (kualitative) si anekdotat, citimet, dhe rekomandimet në një bazë të të dhënave në Microsoft Word, ku janë koduar në mënyrë të pavarur nga disa anëtarë të ekipit të hulumtimit.

**Analiza e të dhënave:** Udhëheqësi i Hulumtimit të RrGGK-së, një statisticien, dhe një praktikant kanë analizuar të dhënat në SPSS. Të dhënat janë peshuar për të marrë parasysh mbi-mostrimin e grupeve etnike minoritare, aty ku është e përshtatshme. Janë kryer disa teste statistikore dhe krahasime, në bazë të të dhënave të vitit 2008. Lexuesit mund të vënë re se përqindjet e përmendura në këtë raport, lidhur me vitin 2008, mund të ndryshojnë nga numrat në raportin e vitit 2008. Kjo ka ndodhur për shkak se të dhënat e vitit 2008, të paraqitura në "*Siguria fillon në shtëpi*", nuk janë peshuar duke marrë parasysh përkatësinë etnike. Në këtë raport, të dhënat janë peshuar për të adresuar mbi-mostrimin e grupeve të minoriteteve (i cili është i nevojshëm për nxjerrjen e çfarëdo përfundimi statistikisht domethënës, në bazë të etnicitetit dhe krahasimit të të dhënave ndër vite). Peshimi statistikor i të dhënave të vitit 2008 është bërë duke u bazuar në të dhënat e periudhës para regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë që janë përdorur në atë kohë, sipas të cilave mendohej se shqiptarët përbënin 88% të popullsisë, serbët 6% dhe grupet e tjera minoritare 6%. Të dhënat e vitit 2015 janë peshuar statistikisht duke u mbështetur në të dhënat e regjistrimit të popullsisë dhe duke shtuar edhe 40.000 serbë që besohet se jetojnë në veri të Kosovës, gjë e cila rezulton në këto përqindje: shqiptarët 92%, serbët 4%, dhe grupet e tjera etnike 4%.

## Demografia e mostrës

Grafikët e mëposhtëm ilustrojnë përbërjen demografike të mostrës së këtij studimi. Të intervistuarit kanë qenë të moshës nga 18 deri 88 vjeçare.







## Intervistat cilësore (kualitative)

Krahas anketave, ekipi i hulumtimit ka realizuar edhe intervista individuale me akterët kyç që kanë përgjegjësi ligjore lidhur me dhunën në familje. Institucionet dhe respondentët janë listuar në aneksin 4. Duke u mbështetur në përgjegjësitë e tyre ligjore, njohuritë e këtyre përgjegjësive, si dhe përvojat praktike me rastet e dhunës në familje, është hartuar një udhëzues i përgjithshëm për intervistat. Respondentëve iu kërkua, ndër të tjerash, që të reflektonin lidhur me ndryshimet që kishin ndodhur që prej hulumtimit të mëparshëm të RrGGK-së. Intervistat janë realizuar midis prillit dhe tetorit të vitit 2015 në Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Prishtinë, Vushtrri dhe Ferizaj. Pjesa më e madhe e intervistave janë realizuar nga dy anëtarë të ekipit të hulumtimit, duke përfshirë një intervistues dhe një mbajtës shënimesh. Në aspektin e reflektimit, fakti që të rejat kanë realizuar intervista dhe që intervistuesit vinin nga një grup i njohur i të drejtave të grave, mund të ketë ndikuar në përgjigjet që lidhen me pikëpamjet. Intervistat janë incizuar pasi të intervistuarit kanë dhënë pëlqimin. Intervistat kanë zgjatur mesatarisht 45 minuta. Më pas, ato janë transkriptuar dhe koduar në mënyrë të pavarur nga anëtarë të ndryshëm të ekipit të hulumtimit, në drejtim të kombinimit të hulumtuesve.

## Kontrolli i cilësisë dhe shqyrtimi nga kolegët

“Kombinimi” i hulumtuesve që ishin anëtarë të ndryshëm të ekipit me fusha të ndryshme ekspertize, ka kontribuar në kontrollin e cilësisë, meqenëse raporti është shqyrtuar me kujdes lidhur me saktësinë nga ana e të gjithë anëtarëve të ekipit. Ekipi i hulumtimit e ka qarkulluar draft-raportin përfundimtar midis anëtarëve të Grupit Këshillues, si dhe disa respondentëve kyçë për shqyrtim dhe kontroll të cilësisë. Rishikimet janë bërë duke u mbështetur në të dhënat hyrëse përpara publikimit.

# Shtojca 2. Monitorimi i Zbatimit të Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje 2011-2014 Korniza Logjike

Në tabelën në vijim, RrGGK përmbledh progresin e bërë në zbatimin e Programit dhe Planit Nacional kundër Dhunës në Familje për periudhën 2011-2014, bazuar në monitorimin e pavarur të institucioneve nga RrGGK, përfshirë këtu intervistat dhe vrojtimet. Shtatë kolonat e para janë marrë direkt nga Plani i Veprimit origjinal. Në kolonën "Shkalla e Zbatueshmërisë" RrGGK ofron vlerësimin në lidhje me shkallën se sa është zbatuar, ku "0" do të thotë se nuk është zbatuar, "0.5" do të thotë se është zbatuar pjesërisht dhe "1" do të thotë se është zbatuar plotësisht. Kolona e fundit ofron detaje shtesë dhe dëshmi për të mbështetur vlerësimin e RrGGK-së mbi shkallën se sa është zbatuar. Në kolonën e buxhetit, RrGGK tenton të identifikoj shpenzimet aktuale të njohura në shkronja të pjerrëta nën shpenzimet e buxhetuara. Megjithatë, ka të ngjarë që ekzistojnë shpenzime të tjera të panjohura. Përllogaritja e shpenzimeve aktuale mund të jetë një lehtësim për planifikimet e shpenzimeve në PNV-në e re.

| Objektivat Strategjike | Objektivat Specifike | Aktivitetet | Institucioni Përgjegjës & Përkrahës | Periudha | Buxhet | Indikatorët e monitorimit | Shkalla e zbatueshmërisë | Analiza RrGGK-së së zbatimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. Deri në vitin 2014, të krijojmë mekanizma efikas dhe gjithëpërfshirës për parandalimin e dhunës në familje. | 1. 1 Të hartohen politika në nivel qendror dhe lokal për parandalimin, mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat dhe ushtruesit e dhunës në familje. | 1.1.1. .Hartimi i programeve për psikologët për në shkolla | MASHT<br>DKA<br>Grupi i punës | 2011-2012 | 7,000 € BKK | - Programi i hartuar<br>- Raportet e punës të grupit punues | 0.5 | Shumica e komunave i kanë vetëm 2-3 psikolog për komunë. Zakonisht, një për gjimnaz dhe dy në shkolla fillore. Edhe pse ekziston korniza ligjore, asnjë program formal nuk është zbatuar. |
| | | 1.1.2. Hartimi i programeve për punonjës social, MPMS që në vitin 2006 ka te hartuar Doracakun profesional pre Nëpunësit e Shërbimeve Sociale „Reagimi ndaj Rasteve të Dhunës në Familje " hartuar nga MPMS në bashkëpunim me OSBEnë | MPMS | | 70,000 € | MPMS për organizimin e trajnimeve për Ofruesit e Shërbimeve sociale | 0.5 | Shumica e punëtorëve social kanë cekur mbajtjen e trajnimeve para vitit 2011. Trajnimet shtesë janë organizuar nga akterët tjerë, përfshirë këtu OSBE-në. Indikatori reflekton arritje të këtij aktiviteti. |
| | | 1.1.3. Pëfshirja e 80 pedagogëve dhe psikologëve në komuna | MASHT<br>Komunat<br>Drejtoritë Komunale të arsimit | Academic year 2011-12 | 34,560€ BKK<br>*MASHT i ka alokuar. 864.000 € vjetor*[320] | Numri i psikologëve dhe pedagogëve<br>Numri i shkollave pilot me psikolog | 1.0 | Tetëdhjetë pedagog dhe psikolog janë të punësuar në Kosovë.[321] |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1.1.4. Pëfshirja e kurrikulës me tema të dhunës në familje dhe marrëdhënieve familjare në katedrën e psikologjisë. | Faculty of Philosophy | Academic year 2011 12 | 21,600 € Universiteti | Kurrikula e miratuar | 1 | Përfshirja e kurrikulës në të gjitha nivelet e edukimit para-universitar. Fakulteti i Edukimit modulet mbi stereotipet dhe rolet gjinore; mbajtja e dhunës larg nga jeta; çfarë është seksualiteti. Departamenti i Psikologjisë e ka "Psikologjinë e Gjinisë". Në "Psikologjinë Klinike" dhe "Psikologjia Zhvillimore" trajtohen aspektet gjinore, përfshirë dhunën në familje, ngacmimet seksuale, si të trajtohen klientët që kanë përjetuar dhunë në familje.[322] |
| 1.2. Të sensibilizohet shoqëria mbi dhunën në familje. | 1.2.1.Organizohen fushata mediale me temë dhunën në familje. | MAPL<br>MD<br>MoJ<br>Donatorët<br>OJQ<br>Mediat | 2011-14 | 5,000 €<br>1,500 €<br>29,900 €<br>Institucionet përgjegjëse.<br>*6 zyrtarë i kanë vlerësuar shpenzimet, që barazohen me të paktën: 134,400 €; ICITAP ka shpenzuar 5,200€[323];* | Numri i fushatave mediale të pregatitura.<br>Ndikimi në publik. | 0.5 | Janë organizuar të paktën 62 fushata mediale.[324] Shumica janë fushata në TV, të përcjellura me broshura dhe fushata në radio. Shumica janë organizuar në kuadër të 16 ditëve të aktivizmit. Është e pamundur të ndiqen të gjitha fushatat. Shumë pak analiza janë bërë për të matur ndikimin, Megjithatë, hulumtimi i RrGGK-së (më lart) mund të shfrytëzohet si ndikim. Për disa indikatorë qytetarët janë më të vetëdijshëm. Por, në disa indikator të tjerë, vetëdija mbetet e njëjtë, ndërsa në disa raste qytetarët janë bërë më konzervativ (shih analizën më lartë). Prandaj, ndikimi publik në sensibilizimin e shoqërisë është i pamjaftueshëm. |
| | 1.2.2. Tryezat të rrumbullakëta me pjesëmarrje të komunitetit dhe subjekte relevante (media, institucione qendrore dhe lokale, OJQ) | MD<br>Institucionet qendrore dhe lokale<br>(Ministritë dhe komunat)<br>OJQ<br>Donatorët<br>Mediat | 2011-14 | 1,000 € për vit<br>*8 të anketuar i kanë vlerësuar shpenzimet në total: 6,600 €. Tutje, institucione të ndryshme kanë shpenzuar 214,174€ në total në këtë aktivitet.[325] Varësisht nga # i pjesëmarrësve, mesatarisht një tryezë e rrumbullakët kushton 500-600€.* | Numri i tryezave të organizuara.<br>Numri i pjesëmarrësve.<br>Ndikimi në ngjarjet mediale<br>Ndikimi në publik (vlerësim i ndikimit në publik) | 1 | Shumica e tryezave të rrumbullakëta janë organizuar nga donatorët ndërkombëtarë dhe strehimoret. Në përgjithësi, 24 zyrtarë kanë raportuar organizimin e 227 tryezave të rrumbullakëta me një pjesëmarrje mesatare prej 30 pjesëmarrësish, në total përafërsisht 6,810 pjesëmarrës.<br>Shumë pak është analizuar ndikimi i tyre.<br>Organizatat kanë thënë se tryezat e rrumbullakëta kanë një ndikim pozitiv në ngritjen e vetëdijes në mesin e zyrtarëve.<br>Vërejtje: Është e paqartë se kush është përgjegjës për financimin e kësaj linje buxhetore. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.3. 1.3. Të krijohen mekanizma për edukimin dhe vetëdijesimi e të rinjve mbi dhunën në familje | 1.3.1. Në përmbajtje të emisioneve për fëmije në radio dhe televizione të përfshihet çështja e dhunës në familje. | Media<br>Gazetaret<br>Donatorët (UNICEF; UNDP; UNIFEM)<br>MKRS<br>Teatrot<br>ABGJ<br>Komisioni i Pavarur për Media | 2011-2013 | Nuk ka kosto | Numri i programeve, shkrimeve, artikujve, kolumnave, performancave teatrale dhe dokumentarëve të zbatuar deri më sot. | 0.5 | RrGGK nuk ka mundur të gjej dëshmi për programet për fëmijë në media. Ka patur shfaqje teatrale të implementuara nga OSHC-të dhe dokumentarë, megjithatë nuk i targetojnë fëmijët. Ka një mospërputhje në mes të aktiviteteve, objektivave specifike dhe indikatorëve, gjë që e bënë monitorimin e vështirë. Shpenzimet aktuale nuk janë konsideruar; krijimi i programeve të tilla mund të jetë i shtrenjtë. Qeveria nuk mund të kërkoj këtë nga mediat private apo teatrot, pa ofruar fonde, të paktën për shpenzimet e realizimit të tyre (madje edhe për RTK-në). |
| 1.4. Të rritet masa e raportimit të dhunës në familje | 1.4.1. Përmirësimi i data bazës ekzistuese duke përfshire edhe institucione të tjera përveç MPMS dhe MD | Policia, prokuroria, gjykatat, qendrat për punë sociale, Strehimoret, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë<br>Donatorët | 2012-2014 | 150,000 €<br>Donatorët | Databaza është e përmirësuar.<br>Numri i rasteve të regjistruara.<br>Raportet e bazuara në rastet e regjistruara.<br>Numri i politikave të ndikuara nga të dhënat e mbledhura. | 0.5 | Secili institucion ka mbajtur të dhëna vetëm për veten.[326] Policia dhe MV në Zyren e Prokurorit i përditësojnë të dhënat, si dhe i publikojnë ato në baza vjetore. QPS-të mbledhin të dhëna, por nuk bëjnë raporte publike për shërbimet e ofruara. Gjykatat, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë ende nuk kanë të dhëna të qarta mbi rastet/shërbimet e ofruara. Është e paqartë të dihet se si numri i rasteve të raportuara ka ndikuar në politika. |
| | 1.4.2. Edukimi i popullatës për raportimin e dhunës në familje | ABGJ<br>Media<br>Shkollat<br>Komunat | 2011-2013 | Nuk ka kosto<br>*ABGJ ka raportuar të ketë shpenzuar 13,319 € in 2011 dhe 3,000 € në 2012*[327] | Raportet e vlerësimit të impaktit<br>Numri i raportimeve. | 1.0 | Edukimi u organizua kryesisht gjatë fushatës 16 ditëshe.[328] Numri i rasteve të raportuara në polici duket të jetë rritur pak nga viti 2011 deri në vitin 2013. Nuk është bërë ndonjë vlerësim i ndikimit. Siç vërehet, këto aktivitete nuk ishin pa kosto.[329] |
| | 1.4.3. Informimi i popullatës mbi institucionet ku raportohet dhuna | Policia MD<br>Media<br>Komisioni për Ndihmë Juridike<br>ABGJ<br>Shkollat<br>Qendrat për punë sociale<br>Komunat Donatorët | 2011-2013 | Nuk ka kosto<br>*Edhe pse nuk është paraparë buxhet, një zyrtarë ka raportuar shpenzime prej 4,000 € për printimin e broshurave* | Fushatat për ngritjen e vetëdijes.<br>Numri i broshurave.<br>Numri i publikimeve .<br>Transmetimet televizive. | 0.5 | Ishte e vështirë të mblidhen të dhëna për të gjitha fushatat për ngritjen e vetëdijes, broshurat, publikimet dhe transmetimet televizive. Shih 1.4.2. Zyrtarët nga këto institucione nuk ishin të gjithë të qartë lidhur me atë se a ishin fushatat vetëdijësuese kundër dhunës në familje në përgjithësi, apo kishin të bënin me atë se ku mund të raportohet dhuna në familje. Fakti që qytetarët në masë të madhe janë të informuar për policinë, por shumë pak prej tyre dinin për institucionet tjera, të bën të mendosh se kjo nuk është zbatuar plotësisht. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1.4.4. Të ngrihen kapacitetet e PK për ndryshimin e qasjes ndaj dhunës si fenomen, viktimave të dhunës dhe dhunuesit | Policia | 2011-2013 | Nuk ka kosto<br>*Akademia për Siguri Publike, ICITAP, UNDP ka ndarë 39,456 €*[330] | Numri i rasteve të adresuara nga policia | 0.5 | Shumë prej policëve duket që shfaqin kapacitete të përmirësuara krahasuar me hulumtimin e RrGGK në vitin 2008. Megjithatë, në disa regjione NJHDhF-të nuk kanë marrë pjesë në ndonjë trajnim, përveç kursit për Dhunën në Familjë në akademi, që nënkupton që nuk janë ofruar kurse të tjera. Zhvillimi dhe ofrimi i kurseve do të kishte ndikime në shpenzime në buxhetin e policisë. Indikatori për numrin e rasteve të adresuara është indikator sasiorë (4,338),[331] por nuk reflekton ndryshimin cilësorë të cilit i referohet ky aktivitet. |
| 2. Të arrijmë që deri në vitin 2013,të kemi siguruar mekanizma efikas të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje. | 2.1. Të sigurojmë shërbime efikase për mbrojtjen fizike të viktimave të dhunës në familje në të gjithë territorin e Kosovës. | 2.1.1.Të realizohet një studim mbi hartën e mbulimit me shërbime për viktimat e dhunës | ABGJ, Policia<br>Strehimoret<br>Në bashkëpunim me institucionet OJQ, Donatorët | 2011 | 25,000 € NGOs<br>Donatorët | Përfundimi i hulumtimit.<br>Të gjeturat dhe rekomandimet. | 0 | I pa-përfunduar për shkak të mungesës së fondeve. |
| | | 2.1.2. Ngritja e banesave sociale për strehimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje në rajonet e Prishtinës dhe Prizrenit | Ministria e financave Komuna, Donatorët | 2011-14 | 500,000 €<br>Donatorët<br>Komunat<br>MF<br>*Komuna e Pejës ka ndarë 75,000 €*[332] | Fondet e alokuara<br>Numri i banesave të ndërtuara<br>Numri i viktimave të strehuara<br>Numri i vendimeve të marra për t'i licensuar strehimoret | 0.5 | Vetëm disa komuna kanë financuar banesat sociale, por siç duket kjo nuk është bërë përmes programeve të qarta dhe të qëndrueshme.[333] Për shembull, kryetarët e komunave kanë përdorur fonde diskrecionale për të ofruar banesa për disa raste apo kanë ofruar financime të përkohshme, por siç duket fondet nuk janë alokuar në mënyrë të përhershme. E as banesat nuk janë ndërtuar, apo njerëzit nuk janë strehuar në to. Numri i personave të strehuar në banesa sociale nuk ishte në dispozicion, pasi që nuk është monitoruar mjaftueshëm. Pesë strehimore kanë licenca për punë në nivel regjional, përderisa dy janë ende në proces të licensimit. Strehimoret ende ofrojnë vetëm strehim afat-shkurtër.[334] |
| | | 2.1.3. Ngritja e një mekanizmi bashkëpunimi ndërmjet komunave për strehimin e viktimave të dhunës në familje | Komunat, Strehimoret | 2011 | Nuk ka kosto<br>Strehimoret<br>Komunat | Zbatimi i Memorandumeve të Mirëkuptimit | 1 | PSO-të ekzistojnë zyrtarisht dhe kështu krijojnë bashkëpunim. Në të njëjtën kohë, disa komuna (jo të gjitha) kanë nënshkruar Memorandume të Mirëkuptimit me strehimoret dhe/ose kanë krijuar mekanizma koordinues lokal.[335] Koalicioni i strehimoreve përkrahë rrjetëzimin në mes të komunave. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.2. Të ngremë kapacitetet e aktereve (policisë, prokurorisë, gjykatave dhe qendrave për punë sociale) për trajtimin e dhunës në familje. | 2.2.1. Organizimi i trajnimeve për (rreth 150 pjesëmarrësve) Gjykatësit, prokuroret, policet, mbrojtësit e viktimave, punëtorët shëndetësore dhe social, zyrtarë dhe punëtorë të arsimit, zyrtarët për ndihmë juridike. | IKAP<br>ABGJ<br>Instituti Gjyqësor i Kosovës<br>Akademia policore e Kosovës<br>Institucionet qendrore<br>Donatorët | 2011-2014 | 200,000 €<br>Donatorët<br>Institucionet përgjegjëse<br>11,734 €<br>*Donatorët & OSBE ka ndarë 78,897 € dhe IKAP, IGJK, MSH shpenzuan €644*[336] | Numri i trajnimeve të organizuara<br>Numri i pjesëmarrësve<br>Numri i moduleve të pregatitura | 1 | Disa trajnime ishin organizuar për qindra pjesëmarrës (aq shumë nga akterë të ndryshëm, sa që ishte e vështirë të llogariten). Në shumicën prej tyre morrën pjesë udhëheqësit e departamenteve, dhe më pak nga zyrtarët që punojnë me personat që kanë përjetuar dhunë në familje. Si organizatat ndërkombëtare, ashtu edhe insitucionet e Kosovës kanë organizuar dhe financuar trajnime. Nuk ishte e mundur të përcaktohet numri i moduleve pasi që nuk janë mbajtur shënime. Veçanërisht, është e paqarte se si mund të jetë "Ligji i Kosovës" një akter përgjegjës. |
| | 2.2.2. Pajisja me mjetet e domosdoshme (komunikimit, makina dhe telefona) për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. | MF<br>Policia<br>Komunat<br>Donatorët (UNDP)<br>Operatoret privat<br>MD<br>MAP | 2011-2014 | 100,000 €<br>Buxheti Vjetor i Kosovës.<br>Donatorët 2.<br>Shpenzime për karburante.<br>Mirëmbajtja (veturat ekzistuese për një vit)<br>29,000 € | Numri i artikujve dhe paisjeve të ofruara<br>Ngritja e performancës së stafit në trajtimin dhe adresimin e rasteve të dhunës në familje | 0.5 | Donatorët, përfshirë edhe agjencitë e KB-së kanë ofruar paisje veçanërisht për policinë. Ishte e vështirë të gjindet numri i saktë i artikujve apo rritja (më saktë, "përmirësimi") i përformancës së stafit, përveç përmes hulumtimit të RrGGK-së (shih më lartë). Performanca duket të jetë përmirësuar me disa përjashtime. Disa prej tyre, ende kanë mungesë paisjet e duhura. |
| | 2.2.3. Krijimi i hapësirave të mjaftueshme të trajtimit të viktimave prej raportimit deri në gjykim. | MEF, MPMS, MD, Policia, Gjykatat , Prokuroria, Qendrat për punë sociale, OJQ | 2012-2013 | 92,000 € vjetore | Hapësira e ofruar (m²/për secilin pjesëtarë të stafit dhe viktimë) | 0.5 | Disa stacione policore kanë dhoma të ndara për intervistimin e viktimave. Dhomat miqësore për intervistimin e fëmijëve janë krijuar në 8 QPS dhe 7 stacione policore. Jo të gjitha komunat ose institucionet kanë hapësirë të mjaftueshme. Indikatori ishte i vështirë për tyu matur në m². |
| 2.3. Sigurimi i ndihmës juridike falas për viktimat e dhunës në familje | 2.3.1. Përgatitja e broshurave, fletëpalosjeve të cilat informojnë qytetarët për ndihmën juridike falas | Komisioni për ndihmën juridike falas | 2011-2013 | 5,000 € vjetore | | 1.0 | Broshurat janë pregatitur dhe shpërndarë. Kësaj objektive specifike i duhet një indikator: "rritje e numrit të personave që marrin ndihmë ligjore falas". Pa indikator, zbatimi nuk mund të matet.[337] |
| | 2.3.2. Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të përfshira në trajtimin e viktimave të dhunës | Komisioni për ndihmën juridike falas, Institucionet OJQ | 2011 | Nuk ka kosto | Numri i marrëveshjeve të zbatuara<br>Numri i institucioneve të përfshira | 1.0 | Disa marrëveshje të tilla janë nënshkruar. Megjithatë, PSO-të kanë zënë vendin e tyre dhe institucionet duhet të bashkëpunojnë në përputhje me PSO-të. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2.3.3. Hartimi i procedurave standarde operative për trajtimin e viktimave të dhunës.<br>2.3.3.1. Hartimi i Standardeve minimale për ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje , MPMS<br>2.3.3.2. Hartimi i Standardeve minimale për ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje , MPMS | MD, MPMS (Grup i punës, përfshire Institucionet qendrore dhe ekspertet) | 2011 | 12,000 €<br>Donatorët Komisioni Evropian | PSO-të për trajtimin e viktimave dhe kryesve të veprave janë aprovuar | 1.0 | PSO-të dhe standardet minimale ekzistojnë. Megjithatë, ato mund të mos jenë zbatuar plotësisht. Disa përfaqësues të institucioneve nuk e dinin që egzistojnë PSO-të. RrGGK nuk ka mundur ta identifikojë as një rast të vetëm që kryesi i veprës ka pranuar shërbime. |
| 3. Të sigurojmë shërbime efikase për rehabilitimin dhe integrimin e viktimave dhe kryesve të dhunës në të gjithë territorin e Kosovës<br>. | 3.1. Të ndërtojmë dhe fuqizojmë kapacitetet e punonjësve të shëndetësisë, të shërbimeve sociale, për ofrimin e shërbimeve viktimave të dhunës në familje | 3.1.1. Hartimi i një protokolli mjekësor të trajtimit të viktimës së dhunës në familje. | MSH<br>Ekspertët<br>OJQ<br>Donatoret | 2011-2014 | 3,000 € | Është aprovuar protokoli mjeksorë | 1.0 | Është zhvilluar dhe aprvuar një protokol mjekësorë. Është shpërndarë në vitin 2014, kur ky PNV ishte afër skadimit. Prandaj, ende ka nevojë të zbatohet plotësisht. |
| | | 3.1.2. Trajnimi i punonjësve të shëndetësisë për trajtimin e viktimave të dhunës në familje<br>(*Trajnimi i rreth 150.000 pjesëmarrësve nga fusha e shëndetësisë dhe shërbimeve*) | MSH , OJQ | 2011-2014 | 37,000 €<br>*MSH & UNFPA kanë ndarë 20,986 € së bashku*[338] | Numri i pjesëtarëve të stafit të trajnuar | 0.5 | Vetëm 700 pjesëtarë të stafit shëndetësorë janë trajnuar deri më tani nga MSh.[339] Megjithatë, RrGGK nuk ka arritur të kontaktojë as një mjek/infermier nga klinikat private ose publike që të ketë marrë pjesë në një trajnim të tillë, që nënkupton që kjo ka nevojë të ngritet. |
| | | 3.1.3. Trajnimi i punonjësve të strehimoreve për identifikimin e rasteve klinike | OJQ, Strehimoret MPMS, MSH | 2011-2014 | 200,000 € | Numri i trajnimeve<br>Numri i pjesëmarrësve në trajnim | 1.0 | Pjesëtarët e stafit të strehimoreve janë trajnuar në këtë temë, si dhe në tema të tjera. Nuk ishte e mundshme të përcaktohet numri i trajnimeve dhe pjesëmarrësve. Në strehimoren në Ferizaj janë trajnuar vetëm pjesëtarët e stafit që punojnë direkt me viktimat. Në Gjakovë janë trajnuar vetëm 3 pjesëtarë të stafit, përderisa në Prizren është trajnuar i tërë stafi i strehimores. |
| | | 3.1.4. Trajnimi i stafit të strehimoreve për mbrojtjen nga SST dhe HIV | MSH, Ekspertët, OJQ, Donatorët | | *MSH ka ndarë 3,000 €*[340] | Numri i trajnimeve<br>Numri i pjesëmarrësve në trajnim | 0.0 | Disa pjesëtarë të stafit të strehimoreve përmendën shkurtazi SST-të dhe HIV, por ata nuk raportuan që të kenë marrë pjesë në trajnime specifike për këto.[341] |
| | | 3.1.5. Trajnim i punonjësve të medies për trajtimin e dhunës në familje | Asociacioni i gazetarëve OJQ Ekspertët Donatorët | 2011-2014 | 80.000 €<br>*UNDP WSSI & UNICEF kanë ndarë 13,562 € së bashku*[342] | Numri i trajnimeve<br>Numri i pjesëmarrësve në trajnim | 0.5 | Tri organizata ndërkombëtare donatore kanë raportuar organizimin e trajnimeve të tilla.[343] Numri i pjesëmarrësve ishte minimal. |
| | | 3.1.6. Trajnimi i punëtoreve social të Qendrave për Punë Sociale për trajtimin e dhunës në familje | Qendrat për Punë Sociale<br>OJQ<br>Donatorët | 2011-2014 | *UNICEF ka ndarë 46,500 €*[344] | Numri i trajnimeve<br>Numri i pjesëmarrësve në trajnim | 1.0 | Punëtorët social janë trajnuar, më së shumti nga organizatat ndërkombëtare donatore dhe MPMS. Megjithatë, nuk mund të përcaktohet numri i trajnimeve dhe pjesëmarrësve. |

© Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, 2015

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 3.2. Të ngrisim politika të mbështetjes ekonomike të viktimave dhe ushtrueseve të dhunës. | 3.2.1. Hartimi i programeve ekonomike në bashkëpunim me donatoret dhe operatorët private, bankat, dhe bizneset | MZHE<br>MTI<br>MF<br>ABGJ<br>Donatorët | 2012-2014 | *UNDP, USAID/IOM kanë ndarë 66,233 €*[345] | Numri i viktimave të përkrahura<br>Shuma e aprovuar e granteve | 0.5 | Kishte përpjekje për të filluar një program të tillë nga një donator, por qeveria nuk morri përgjegjësi, dhe kjo nuk ishte e qëndrueshme. Vetëm disa gra janë përkrahur me grante për fillimin e bizneseve; është e panjohur nëse bizneset ishin të qëndrueshme. Në nivelin e objektivës specifike, nuk është zhvilluar ndonjë program i qëndrueshëm. |
| | 3.3. Të ndërtojmë dhe fuqizojmë shërbime sociale (shëndetësore, sociale, ekonomike, juridike) për viktimat dhe kryesit e dhunës në familje | 3.3.1. Diagnostikimi falas i viktimave të dhunës në familje të strehuara në strehimore | MSH<br>MD<br>Strehimoret<br>Donatorët<br>Operatoret privat | 2011-2014 | Nuk ka kosto | Numri i viktimave të kontrolluara. | 1.0 | Kjo është zbatuar. Megjithatë, shpenzimet e shtetit egzistojnë dhe nuk janë marrë në konsideratë. Identifikimi i numrit të viktimave ishte i vështire, pasi që shënimet janë ende të shkruara me dorë në letër dhe nuk mbahen në mënyrë elektronike. |
| | | 3.3.2. Shërbime shëndetësore dhe sociale për personat me aftësi të kufizuar, viktima të dhunës në familje | OJQ<br>MSH<br>Donatorët<br>Qendrat e shëndetit mendor | 2011-2014 | Nuk ka kosto | Numri i personave me nevoja të veçanta të përkrahur | 0.5 | Ata kanë ofruar shërbime shëndetësore pa pagesë. Megjithatë, numri i personave të përkrahur nuk është në dispozicion. |
| | | 3.3.3. Formim profesional për viktimat e dhunës në familje | MPMS, MASHT, OJQ<br>Qendrat për Punë Sociale<br>Donatorët<br>Biznesi<br>Qendrat për formim profesional | 2011-2014 | 40,000 € çdo vit | Numri i përfituesve<br>Numri i personave të punësuar | 0.5 | Numri i përfituesve dhe personave të punësuar nuk është mbajtur shënim mjaftueshëm.[346] Gratë janë të trajnuara në sektorë "tradicional" që konsiderohen "për gra", të cilët mund të mos sjellin të ardhura të mjaftueshme. Shumica e institucioneve ofrojnë trajnime bazuar në kërkesat e përfituesve, në vend se të ofrojnë trajnime bazuar në kërkesat e tregut të punës. |
| | | 3.3.4. Ndërmjetësim për punësimin e viktimave të dhunës | DPP-MPMS<br>Qendrat Rajonale të Punësimit | 2011-13 | Nuk ka kosto | Numri i personave të punësuar | 0.5 | Shumica e ndërmjetësimit për punësim duket se është ofruar nga strehimoret, duke i punësuar ato në sektorin privat ose në projekte të strehimoreve. QRP-të kanë pasur vështirësi në gjetjen e punës për këdo, veçanërisht për gratë.[347] DPP nuk mban shënime për numrin e personave që kanë përjetuar dhunë që kanë qenë të punësuar, kështu që ishte e pamundur të sigurohen informata lidhur me këtë indikatorë. |
| | | 3.3.5. Shërbimet sociale për viktimat të ndërthuren me programe për fuqizimin e familjes | Qendra për Punë Sociale<br>SOS fshati-programi i fuqizimit te familjes<br>Donatorët | 2011-13 | Nuk ka kosto | Numri i programeve<br>Shtrirja gjeografike e programeve<br>Familjet përfituese | 0.5 | Nuk kishte informata në dispozicion për këtë. Të vetmet shërbimeve për të cilat kemi njohuri janë nga SOS Fshatrat për Fëmijë që kanë një program mbi fuqizimin e familjes që nga viti 2014 në Vranjevc, Graçanicë dhe Fushë Kosovë. Në bashkëpunim me QPS-në ata identifikojnë familjet dhe punojnë kryesisht me minoritetet. Kjo gjë kushton. |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4. Rehabilitimi dhe re- integrimi i qëndrueshëm i viktimave të dhunës në familje | 4.1. Ofrimi i shërbimeve rehabilituese/trajtimi shëndetsor dhe psikosocial, mbrojtja ligjore si edhe strehimi i viktimave të dhunës ne familje | 4.1.1. Ofrimi i Shërbimeve rehabilituese dhe psikosociale brenda strehimoreve i viktimave të dhunës në familje | MPMS, OJQ-strehimore, komunat, QPS -të | 2011-13 | 800,000 € | Një numër i viktimave përfitojnë nga këto shërbime, gjashtë strehimore janë kontraktuar nga MPMS | 0.5 | Përafërsisht 1,057 persona kanë pranuar rehabilitim dhe shërbime psikologjike nëper stremire.[348] Pesë strehimore janë kontraktuar. Në PNV është e paqartë se prej nga duhet të vijë ky buxhet, dhe financimi shtetëror i qëndrueshëm i strehimoreve dhe këtyre shërbimeve duhet të zgjidhet. Cilësia e shërbimeve është ende e dobët dhe financimi i paqartë, kështu që nuk është zbatuar plotësisht. |
| | | 4.1.2. Ofrimi i shërbimeve dhe këshillimeve juridike falas për viktimat e dhunës ne familje , si edhe ofrimi i mbrojtjes ligjore falas për këto viktima. | Ministria e Drejtësisë, Mbrojtesit e viktimave, Policia, Gjykata, QPS | 2011 - 2014 | *Zyra për Ndihmë Ligjore, MV, UNDP, OJQ kanë ndarë 1,265,055 €*[349] | Një numër i viktimave që përfitojnë nga shërbimet ligjore falas | 1 | Rreth 177 persona kanë pranuar shërbime falas dhe këshillime juridike nga Zyrat për Ndihmë Ligjore në mes të viteve 2001 dhe 2014. |
| | | 4.1.4 Ofrimi i shërbimeve te aftësimit profesional për viktimat dhunës ne familje | MASHT, Drejtorat per arsim prane komunave, QPS MPMS-DPP , Zyrat regjionale te punësimit | 2011 - 2014 | | | 1 | Strehimoret nw bashkwpunim me akterwt tjerw, siç janw QRP-tw dhe Qendrat pwr Aftwsim Profesional, ofruan kwto shwrbime. Megjithatw, indikatori dhe numri janw tw paqarta. |
| | | | Totali i shpenzimeve:<br>Buxheti i Kosovës:<br>Donatorët:<br>Të tjera: | | 2.,414,560 €<br>1,612,854 €<br>780,106 €<br>21,600 € | | 70.6% | Duke e ndarë shumën e numrave lidhur me zbatimin dhe duke i pjesëtuar ato me numrin total të veprimevve (34), RrGGK vlerëson se kjo përqindje e PNV është zbatuar. |

Bazuar në hulumtimin e RrGGK-së këtu dhe në hulumtimin e RrGGK-së *"Me çfarë çmimi?,* shpenzimet mesatare për zbatimin e PNV për vitet 2011-2015 janë më shumë se 2,854,026 €.

# Shtojca 3. Pyetësori

*Pyetësori është përshtatur në stilin dhe madhësinë e shkronjave në mënyrë që të kursejmë letër në printim.*

---

*Për hulumtuesin para intervistës.*

Kodi i intervistuesit: __ ___ Koha e fillimit të intervistës *(kopjo në fund të pyetësorit):* __ __ : __ __

1. Numri i pyetësorit: ___ ___ ___ ___

2. Kodi i Komunës___________________________

3. Zona rurale/urbane:
3.1. Fshati (Nuk ka stacion policor, Qendër për Punë Sociale)
3.2. Qyteza (Vendbanim rural por ka stacion policor ose QPS)
3.3. Qyteti (Vendbanim urban)

4. **Gjinia:**
4.1. Grua
4.2. Burrë

*(Intervista fillon pasi që të keni lexuar Deklaratën mbi Hulumtimin dhe Formën e Miratimit. Ju lutemi të lexohet vetëm teksti që është me shkronja të theksuara, me shkronja italike vlen vetëm për ju.)*

5. **Në cilin vit keni lindur?** _________

6. **Cila është përkatësia etnike?**
6.1 Shqiptar
6.2 Serb
6.3 Rom
6.4 Ashkali
6.5 Egjiptian
6.6 Boshnjak
6.7 Goran
6.8 Turk
6.9 ____________
6.10 Të tjera (shkruaje të lutem) ________

7. **Sa vite shkollim i keni përfunduar?** ___ ___

8. (*Nëse jeni ndalur nga shkolla*) **cila ka qenë arsyeja kryesore që nuk keni vazhduar më tutje shkollimin** (*rretho të gjitha përgjigjet që përshtaten*)?
8.1. Nuk kam dashur të vazhdoj
8.2. Vështirësitë financiare në familje
8.3. Vështirësitë financiare në familje dhe familja ka favorizuar vëllaun motrën
8.4. Është dashur të punojë për të fituar para
8.5. Shkolla ishte shumë larg nga vendbanimi
8.6. Nuk kishte siguri të udhëtoje deri në shkollë
8.7. Familja ime nuk e ka ditur rëndësinë e shkollimit
8.8. Më është dashur të kujdesem për anëtarin e familjës (p.sh. me aftësi të kufizuara, fëmijët, të moshuarit)
8.9. Jam martuar
8.10. Dhuna në familje
8.11. Jam detyruar apo ndaluar nga insistimi i nënës të vazhdoj shkollimin
8.12. Jam detyruar apo ndaluar nga insistimi i babait të vazhdoj shkollimin
8.13. Jam detyruar apo ndaluar nga partneri të vazhdoj shkollimin
8.14. Jam detyruar apo ndaluar nga anëtarët tjerë të familjes të vazhdoj shkollimin
8.15. Të tjera ___________________________________

9. **Statusi juaj martesor?**
9.1 Beqar/e → kalo tek P. 13
9.2 I/e martuar → kalo tek P. 10
9.3 Bashkëjetesë → kalo tek P. 10
9.4 I/e fejuar → kalo tek P.10

9.5 I/e divorcuar → kalo tek P. 10
9.6 I/e vejë → kalo tek P. 10
9.7 I/e fejuar → kalo tek P.10

10 **Sa kohë jeni apo keni qenë i/e martuar/bashkëjetuar** *(në martesën e tanishme nëse keni qenë i/e martuar edhe më herët)*? ___ ___
11 **Sa vjeçar/e ishit kur jeni martuar?** ___ ___

12 **A keni fëmijë, nëse po sa?** __

13 **Me kë jetoni në shtëpi?**
13.1. Familjen e ngushtë (prindërit, vëllezërit, motrat)
13.2. Familjen e ngushtë në martesë (burrin/gruan, dhe/apo fëmijët)
13.3. Familjen e gjerë të partnerit (vjehrrën, vjehrrin, kunatin, kunatën, etj.)
13.4. Familjen time të gjerë (vëllezërit, motrat dhe farefisi tjetër)
13.5. Shoqërinë time
13.6. Partnerin (i/e pamartuar)
13.7. Vetëm
13.8. Të tjera ______________________________________________

14 **Sa anëtarë jetojnë në një shtëpi me ju, tani?** __________

15 **Cili është statusi i punësimit tani?** (rretho të gjitha përgjigjet që përshtaten)
15.1 Punoj me pagë jashtë shtëpisë → kalo tek P17
15.2 Punoj pa pagë rreth shtëpisë (fermer/e, kujdesem për kafshët si lopët, pulat, delet, etj.)
15.3 Punoj në shtëpi pa pagesë (kujdesem për fëmijët, të moshuarit, kujdesem për kopshtin, mirëmbajë shtëpinë, etj.) → kalo tek P16
15.4 Punoj kohë pas kohe → kalo tek P16
15.5 I/e papunësuar, duke kërkuar punë → kalo tek P
15.6 I/e papunësuar, nuk kërkoj punë → kalo tek P16
15.7 Ende student/e, nxënës/e → kalo tek P16
15.8 I/e pensionuar → kalo tek P18
15.9 Nuk kam mundësi të punojë → kalo tek P16

16 (*Nëse punoni pa pagesë apo kohë pas kohe*) **Cila është arsyeja KRYESORE që ju punoni pa pagesë apo punoni vetëm kohë pas kohe?** *(rretho të gjitha përgjigjet që përshtaten)*
16.1 Më duhet të punoj në shtëpi (kujdesi për fëmijët, të moshuarit, kujdes për kopshtin, mirëmbajtja e shtëpisë, etj.)
16.2 Më duhet të punoj jashtë shtëpisë (fermer/e, kujdesem për kafshët si lopët, pulat, delet etj.)
16.3 Nuk kam pasur mundësi të gjej punë
16.4 Nuk më duhet puna, kam të ardhura të mjaftueshme
16.5 Familja nuk më lejon të punojë
16.6 Jam student/e apo nxënës/e
16.7 Nuk ia vlen të punoj (p.sh pagat e ulta)
16.8 I/e pensionuar
16.9 Nuk kam mundësi të punojë
16.10 Të tjera ________________
99 Nuk di / Nuk kam përgjigje

17 (*Nëse punoni)* **Cila është paga juaj mujore?** ___ ___ __ ___

18 (*Nëse i/e martuar*) **Partneri/ja juaj a është i/e punësuar me pagë mujore?**
18.1 Po
18.2 Jo

19 **Në total, sa anëtarë janë të punësuar me pagë brenda shtëpisë tuaj?** ______________

20 **A mund të kalkuloni të ardhurat e MUAJIT TË FUNDIT (Janar) brenda shtëpisë tuaj, të cilat sigurohen nga të gjithë anëtarët e familjes dhe nga të gjitha burimet e të ardhurave që keni?** ___ ___ ___ ___

21. **Në familjen tuaj a merrni ndihmë sociale nga ndonjë institucion?**
21.1 Po
21.2 Jo
0 Refuzoj 99 Nuk e di/ Nuk kam pëërgjigje

Tani kam disa pyetje tjera. Do të doja të ju pyesja për ngacmimin seksual.

22. A mund të më tregoni se çfarë nënkupton për ju ngacmimi seksual? I

| | |
|---|---|
| 22.1 | Përdhunimi apo tentimi për dhunim |
| 22.2 | Presioni i dhunshëm për favore seksuale |
| 22.3 | Të prekurit, pickimi, shtyrja |
| 22.4 | Mbështetja për trupin e personit, pa lejen e tij/saj |
| 22.5 | Shikime dhe gjeste seksuale pa dëshirën e personit |
| 22.6 | Dërgimi i letrave, thirrjet telefonik pa dashjen e personit |
| 22.7 | Presion për të dalur së bashku (për kafe, drekë, darkë) |
| 22.8 | Pyetje, vërejtje apo shaka seksuale pa dashjen e personit |
| 22.9 | Referimi i personave me fjalë si: loqkë, zemër, syn, llokum etj. |
| 22.10 | Fishkëllima në rrugë |
| 22.11 | Të gjitha më lartë |
| 22.12 | Postimi i fotove pa lejen e personit në Internet pa dashjen e personit |
| 22.13 | Favorizimi në këmbim të përfitimeve seksuale |
| 22.13 | Të tjera ______________________________ |
| 99 | Nuk e di/ Nuk dua të përgjigjem |

| Ju lutem, a mund të më tregoni se cila nga rastet e më poshtme mund të përfshijë ngacmimin seksual? | Po | Jo | Nuk e di |
|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 99 |
| 23. Një burrë e ngacmon seksualisht një grua | | | |
| 24. Një burrë e ngacmon seksualisht një burrë tjetër | | | |
| 25. Një grua ngacmon seksualisht një burrë | | | |
| 26. Një grua ngacmon seksualisht një grua | | | |
| 27. Kur kolegu/ia bënë komente të natyrës seksuale për kolegen/un | | | |
| 28. Kur shefi e prek punëtorin/ren në mënyrë të cilin ai/ajo nuk ka dëshirë të preket | | | |
| 29. Postimi i fotove seksuale të personit tjetër në internet | | | |
| 30. Të komentuarit e personit në rrugë, që e bënë këtë person të ndihet jo rehat | | | |
| 31. Mësimdhënësi/ja i kërkon nxënësit/es të shkojë natën vonë në zyre për të marr notën | | | |
| 32. Shefi e bënë punëtorin/ren të dalë për darkë së bashku me qëllim të mbarimit të punëve jashtë zyres | | | |

Sipas mendimit tuaj, deklaratat e mëposhte a janë të vërteta apo të pa-vërteta?

| | E vërtetë | E pa-vërtetë | Nuk e di |
|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 99 |
| 33. Gratë i sjellin vetes problemet me ngacmim seksual duke u veshur apo duke u sjellë në mënyrë provokative | | | |
| 34. Ngacmimi seksual në punë mund të vijë VETËM nga udhëheqësit | | | |
| 35. Njerëzit natyrshëm ngacmojnë seksualisht të tjerët kur ata kanë tërheqje ndaj tyre, dhe kjo është në rregull | | | |
| 36. Ngacmimi seksual nuk i bënë asnjë të keqe personit që ngacmohet | | | |
| 37. Vajzave të reja ju pëlqen të ngacmohen seksualisht | | | |

Tani i kam disa pyetje më personale. Ju lutem më tregoni, nëse ndonjëra nga gjërat më poshtë ju ka ndodhur juve. Nëse po, sa shpesh?

| | 0 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 9 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Gjatë viti të fundit (nga Janari 2014) | | | | | | |
| | Asnjëher ë | Kur isha e/i re/ri | Disa herë në ditë | 1 herë në ditë | Çdo javë | Çdo muaj | 5-11 herë në vit | 1-4 herë në vit | ND/ NP |
| 38. Dikush ka bërë komente të padëshiruara seksuale, shaka apo gjestikulacione për ty apo në lidhje me ty (përfshirë këtu edhe në rrugë) | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 39. Dikush ju ka bërë komente të padëshiruara seksuale dhe shaka në Internet | | | | | | | | | |
| 40. Dikush ka postuar foto tuaja ku ju jeni i/e zbuluar në Internet | | | | | | | | | |
| 41. Dikush ka ekspozuar veten në praninë tuaj pa dëshirën tuaj | | | | | | | | | |
| 42. Është treguar seksi apo ju ka treguar foto seksi të cilat ju nuk keni dashur t'i shihni | | | | | | | | | |
| 43. Të ka prekur në mënyrë seksuale të padëshiruar prej jush | | | | | | | | | |
| 44. Mësimdhënësi/ja ju ka prekur në mënyrë seksuale, duke ju bërë të mos ndiheni rehat | | | | | | | | | |
| 45. Ju kanë quajtur Gej apo Lesbike në mënyrë negative | | | | | | | | | |
| 46. Ju kanë shtyrë të bëni diqka seksuale të cilën ju nuk keni dashur ta bëni | | | | | | | | | |

47. A keni qenë ndonjëherë i/e nagcmuar seksualisht në ndonjërën nga mënyrat e poshtëshënuara (*rretho të gjitha përgjigjet që përshtaten)*

47.1 Komente seksuale të padëshiruara të bëra në rrugë
47.2 Bllokimi i rrugës
47.3 Ju kanë përcjellur
47.4 Fishkëlluar
47.5 Ju kanë bërë komente seksuale eksplicite
47.6 I ka rënë borisë së automobilit
47.7 Ju ka prekuar apo shtrënguar
47.8 Ofendim seksual
47.9 Të gjitha
47.10 Nuk më kanë ngacmuar → kalo tek P 51
47.11 Tjetër ______________________________
99. Nuk e di / Nuk kam përgjigje → kalo tek P 51

48. Kush e ka bërë këtë? (*rretho të gjitha përgjigjet që përshtaten)*

48.1 Mësimdhënësi/ja
48.2 Person i panjohur në rrugë
48.3 Shefi
48.4 Kolegu
48.5 I/e njohur
48.6 Shoku/shoqja
48.7 Të tjerë__________________ 99. Nuk e di / Nuk kam përgjigje

© Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, 2015

49. (*Nëse përshtatet*) Nëse juve ju ka ndodhur të ju ngacmojë dikush seksualisht në rrugë, çfarë keni bërë?
49.1 I kam injoruar
49.2 Kam qeshur
49.3 Jam përgjigjur me fjalë
49.4 I jam përgjigjur fizikisht
49.5 Kam njoftuar autoritetet përkatëse
49.6 Tjetër _______________
99 Nuk e di / Nuk kam përgjigje

50. *(Nëse përshtatet)* Nëse një person i panjohur ka qenë i pranishëm kur të kanë ngacmuar seksualisht, si ka reaguar ai person?
50.1 E ka injoruar ngacmimin
50.2 Është përgjigjur me fjalë
50.3 Është përgjigjur fizikisht
50.4 Kanë lajmëruar autoritetet përkatëse
50.5 Tjetër ______________
99 Nuk e di / Nuk kam përgjigje

51. A e keni raportuar ndonjëherë ju apo dikush që ju e njihni ngacmimin seksual? Po Jo
Nëse po çfarë ka ndodhur? *(Kujt i kanë raportuar? Çfarë kanë bërë? Kur ka ndodhur kjo?)*

______________________________________________________________________________

Tani do të doja të dija më shumë për ju dhe familjen tuaj. Kush do të thonit se i merr shumicën e vendimeve në lidhje me atë se si duhet të shpenzohen paratë në shtëpinë tuaj për....

| | 1<br>Unë | 2<br>Partneri/ja im/e | 3<br>Babai | 4<br>Nëna | 5<br>Vjehrri | 6<br>Vjehrra | 7<br>Kunati | 8<br>Vendim i përbashkët (shkruaje) | 9<br>Tjertër | 99<br>ND/NP |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 52. Blerjet e mëdha si veturat e reja apo mobiljet? | | | | | | | | | | |
| 53. Për edukimin e fëmijëve (p.sh. nëse fëmija do të vazhdojë edukimin apo çfarë do të studioj)? | | | | | | | | | | |
| 54. Kush vendos në familje për ndonjë çështje të rëndësishme? | | | | | | | | | | |

55. Çfarë ndodh kur dikush nuk pajtohet apo kundërshton vendimin e atij personi?
55.1 Asgjë
55.2 Personi i/e cili/a merr vendimin nevrikoset
55.3 Personi i/e cili/a merr vendimin bërtet
55.4 Personi i/e cili/a merr vendimin mund të lëndojë fizikisht personin i cili kundërshton apo nuk pajtohet me të
55.5 Njëherë diskutohet pastaj merret vendimi
55.6 Të tjera ___________________________________________________
55.7 Nuk e di/ Nuk kam përgjigje

Do të lexoj për ju disa fjali. Ju lutem më thuani nëse pajtoheni, pjesërisht pajtoheni, pjesërisht nuk pajtoheni, nuk pajtoheni apo nuk e dini.

| | 1 | 2 | 3 | 4 | 0 | 9 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Pajtohem | Pjesërisht pajtohem | Pjesërisht nuk pajtohem | Nuk pajtohem | Refuzoj | Nuk e di |
| 56. Ndonjëherë është në RREGULL që burri t'i bie gruas së tij | | | | | | |
| 57. Ndonjëherë fëmija duhet të goditet | | | | | | |
| 58. Djemtë duhet të kenë disiplinë më të ashpër se vajzat sepse kjo i bën ata më të fortë | | | | | | |
| 59. Vajzat kanë nevojë për më shumë disiplinë se djemtë në mënyrë që ato të jenë të moralshme | | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 60. Personat me aftësi të kufizuara duhet të qëndrojnë brenda në shtëpi, sepse ata e turpërojnë familjen | | | | | | |
| 61. Është normale dhe e natyrshme që ndonjëherë dhuna ndodh kur ka keqkuptime në mes burrit e gruas | | | | | | |
| 62. Është normale dhe e natyrshme nëse dhuna në familje ndodh kur dikush përdorë pije alkoolike | | | | | | |
| 63. Të moshuarit janë barrë për familjen | | | | | | |
| 64. Dhuna seksuale ASNJEHERE nuk mund të ndodh në mes dy të rriturve të cilët janë të martuar | | | | | | |
| 65. Nëse burri është i papunësuar, dhuna mund të ndodhë ndonjëherë | | | | | | |
| 66. Nuset e reja duhet të kenë më shumë përgjegjësi që të pastrojnë dhe gatuajnë, se sa anëtarët tjerë të familjes | | | | | | |
| 67. Në Kosovë ekziston Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje | | | | | | |
| 68. Nëse fqinjët dëgjojnë se në një familje ka dhunë, do ta konsideronin si të turpshme | | | | | | |
| 69. Dhuna është çështje familjare, prandaj fqinjët nuk duhet të raportojnë tek policia | | | | | | |
| 70. Çdo burri që rrah gruan e tij, do të duhej t'i vinte turp | | | | | | |
| 71. Dhuna është pjesë normale në çdo lidhje, dhe shoqëria do të duhej ta pranonte se dhuna mund të ndodh nganjëherë | | | | | | |
| 72. Ushtruesit e dhunës në familje janë fajtorë dhe duhet të denohen me ligj | | | | | | |
| 73. Nëse ka dhunë në familje, gruaja duhet të shkojë në strehimore apo te familja e saj, derisa burri duhet të qëndrojë në shtëpi deri sa të zgjidhet problemi | | | | | | |
| 74. Kur ndodh dhuna, nuk ka kuptim të lajmërohet policia, pasi që ata nuk do të ndërmarrin asgjë | | | | | | |

Tani do të lexoj disa veprime që mund të ndodhin në familje. Ju lutem, më tregoni mendimin tuaj nëse ndonjë nga këto veprime mund të konsiderohet dhunë në familje: po ose jo.

| Lloji | 1 | 2 | 0 | 9 |
|---|---|---|---|---|
| | Po | Jo | Ref. | Nuk e di |
| 75. Thirrja e anëtarëve të familjes me emra ofendues apo sharja e anëtarëve të familjes | | | | |
| 76. Të ndëshkohet fëmija duke e goditur | | | | |
| 77. Të ndëshkohet fëmija duke e rrahur me shkop ose rrip | | | | |
| 78. Të kontrollohet se ku mund ose nuk mund të shkojë anëtari i familjes | | | | |
| 79. Të ndikohet vendimi i personit me nevoja të veçanta se me kë do të martohet | | | | |
| 80. Mos lejimi i anëtarit të familjes të punojë jashtë shtëpisë | | | | |
| 81. Kërcënimi se do të lëndohet ndonjë anëtar tjetër i familjes | | | | |
| 82. Një i rritur qëllon me shuplakë, grushton apo shkelmon anëtarin tjetër të familjes kur ata nuk pajtohen | | | | |
| 83. Ngacmimi/prekja e anëtarit të familjes në mënyrë seksuale pa dëshirën e tij/saj | | | | |
| 84. Partneri i/e cili/a bën marrëdhënie seksuale pa pëlqimin apo vullnetin e partnerit të saj/tij | | | | |

85. Sipas mendimit tuaj cilat janë arsyet KRYESORE që ndodh dhuna në familje (*rretho të gjitha arsyet që i/e intervistuari/ja përmend*)?
  85.1 Papunësia në familje
  85.2 Situata e rëndë ekonomike
  85.3 Kjo është kultura jonë
  85.4 Mungesë arsimimi
  85.5 Konsumimi i alkoolit
  85.6 Kundërshtimet apo diskutimet intensive
  85.7 Traumat e luftës
  85.8 Martesat kundër dëshirës së tyre
  85.9 Familjet e mëdha nuk kanë hapsirë të mjaftueshme për jetesë
  85.10 Martesat e hershme
  85.11 Për të diciplinuar anëtarët e familjes
  85.12 Të tjera __________
  99 Nuk e di / Nuk kam përgjigje

86. **Sipas mendimit tuaj, sa është e përhapur dhuna në familje në fshatin/qytetin tuaj? Në kuptimin që anëtarët brenda familjes përdorin dhunë ndaj njëri-tjetrit?** (*Sqaro më tutje nëse ka nevojë, përmende emrin e fshatit/qytetit ku po realizohet intervista)*

86.1 Kjo nuk ndodh në fshatin/qytetin tim (0%)
86.2 Ndodh vetëm në disa familje (1-25%)
86.3 Ndodh në mes të një të katërtës dhe gjysmës së familjeve (26%-50%)
86.4 Ndodh në mes të gjysmës dhe tri të katërtave të familjeve (51%-75%)
86.5 Ndodh në mes të tri të katërtave dhe gati të gjitha familjeve (75%-99%)
86.6 Ndodh në të gjitha familjet (100%)
99 Nuk e di / Nuk kam përgjigje

**Në VITIN e fundit (Janar – Dhjetor 2014) , sa shpesh ju personalisht keni parë apo dëgjuar se në ndonjë familje, janë bërë gjërat që do të përshkruajmë më poshtë: çdo ditë, çdo javë, çdo muaj, 5-11 herë, 1-4 herë, kurrë. Nëse nuk jeni të sigurt, ju lutemi na tregoni mendimin tuaj...**

| | 0 | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 99 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Sa shpesh gjatë vitit të fundit keni parë apo dëgjuar ...** | **Asnjë herë** | **Çdo ditë** | **Çdo javë** | **Çdo muaj** | **5-11 herë në vit** | **1-4 herë në vit** | **ND/ NP** |
| **87. Anëtarët e familjes i bërtasin njëri-tjetrit** | | | | | | | |
| **88. Dëgjohen zëra të lartë sikur dy persona në familje po godasin apo shtyejnë njëri-tjetrin** | | | | | | | |
| **89. Grua e cila ka shenja sikur të ishte rrahur nga dikush** | | | | | | | |

90. **Në vitin e fundit (Janar– Dhjetor 2014), a mund të numroni në sa familje që ju i njihni, ka ndodhur dhuna në familje?** __ __

**Mendoni një person të cilin ju e njihni dhe e dini se ka qenë viktimë e dhunës në familje. Mos na tregoni se kush është ky person, por na tregoni a është ...** (Nëse jo → kalo tek 99)

| Nr. | 1 | 2 | 3 | 4 | 0 | 99 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 91. | Burrë | Grua | X | X | Askënd | ND/ NP |
| 92. | Fëmijë (0-12) | Tinejxher (13-18) | I/e rritur (19-50) | I/e moshuar (51+) | | ND/ NP |
| 93. | Pa shkollë | Me disa ose të gjitha vitet e shkollimit fillor | Me disa ose të gjitha vitet e shkollimit të mesëm | Disa vite ose me universitet | | ND/ NP |
| 94. | I/e punësuar për € | Fermer/e (pa €) | I/e pa punësuar | X | | ND/ NP |

95. **Çfarë dhune përjeton ai ose ajo** (*lexo përgjigjet 1-4*)**?**
95.1 **Dhunë psikologjike:** thirrja me emra ofendues, xhelozi, gënjeshtra gjatë tërë kohës
95.2 **Dhunë fizike:** rrahje me grushta, shuplaka, shkelmim
95.3 **Dhunë seksuale:** kur e detyron personin të ketë marrëdhënie seksuale kur ai/ajo nuk don, apo të bëj akte seksuale të cilat ai/ajo nuk i don
95.4 **Dhunë ekonomike:** kur nuk i lejohet personit të shfrytëzojë parat kur ka nevojë për to
95.5 **Të tjera:** ________________________________
95.6 Kombinim (*shkruaje #)* ________________________________
99 Nuk e di / Nuk kam përgjigje

96. **Cili është personi nga i/e cili/a ai/ajo përjetoi më së shpeshti dhunë?**
96.1 Partneri
96.2 Babai
96.3 Nëna
96.4 Vëllai
96.5 Motra
96.6 Djali
96.7 Vajza
96.8 Vjehrri
96.9 Vjehrra
96.10 Tjera: ______ 99. Nuk e di / Nuk kam përgjigje

97. **Cilat janë rezultatet negative të dhunës tek ai/ajo** (*rretho të gjitha përgjigjet që përshtaten)***?**
97.1 Plagë trupore
97.2 Probleme psikologjike
97.3 Pamundësi të kujdeset për fëmijët
97.4 Pamundësi të kujdeset për vetën

97.5 Mendime për vetëvrasje
97.6 Tentime për vetëvrasje
97.7 Ndërprerja e shkollimit
97.8 Nuk mund të punojë dhe kjo ka ndikim në situatën ekonomike
97.9 Vrasja
97.10 Të tjera ________ 99. Nuk e di / Nuk kam përgjigj

**98. Si ballafaqohet personi me dhunën apo si e zvogëlon dhembjen që i shkaktohet (*rretho të gjitha përgjigjet që përshtaten)*?**
98.1 Tërhiqet/Nuk flet me të tjerë
98.2 Flet me shokët
98.3 Flet me anëtarët e familjes
98.4 Flet me psikologun apo këshilluesin
98.5 Shkon tek mjeku
98.6 Lajmëron policinë
98.7 Shkon në strehimore
98.8 Ndahet apo divorcohet
98.9 Lëshon shtëpinë për një kohë dhe jeton diku tjetër
98.10 Tjetër_______________ 99. Nuk e di / Nuk kam përgjigje

**99. A keni njohuri se ku duhet të shkoj të kërkojë ndihmë personi i cili ka përjetuar dhunë (*rretho të gjitha përgjigjet që përshtaten)***
Te shoku ose shoqja
99.1 Tek një anëtar tjetër i familjes
99.2 Në polici
99.3 Në Qendrën për Punë Sociale
99.4 Te Mbrojtësi i Viktimave
99.5 Avokati
99.6 Në organizata lokale apo OJQ
99.7 Tjetër ______________________________ 99. Nuk e di / Nuk kam përgjigje

100. **A njihni ndonjë person i cili ka raportuar ndonjëherë rast të dhunës në familje?** Po Jo → kalo tek 110

(nëse po) **Pasi që kanë raportuar...**

| | 1 | 2 | 99 |
|---|---|---|---|
| | Po | Jo | NP / ND |
| 101. A ka ardhur policia? | | | |
| 102. Personi që ka përjetuar dhunë a e ka lëshuar shtëpinë për të qëndruar diku tjetër? | | | |
| 103. A i është ofruar personit ndihmë nga Qendra për Punë Sociale? | | | |
| 104. A i është ofruar personit ndihmë nga ndonjë OJQ e grave apo nga ndonjë strehimore? | | | |
| 105. A i është ofruar personit ndihmë nga Mbrojtësi i Viktimave? | | | |
| 106. A ka pranuar personi ndonjë formë tjetër e ndihmës ligjore? | | | |
| 107. A është arrestaur kryersi i dhunës? | | | |
| 108. A ka shkuar çështja në gjyq? | | | |
| 109. A është dënuar kryersi i dhunës? | | | |

(*Hulumtues/e: shkruaj detajet se çfarë ka ndodhur më poshtë)*

110. **Nëse do të të kishte ndodh ty personalisht dhuna në familje, a mendoni se do të shfrytëzonit ndonjë ligj i cili do tu ndihmonte në këtë situatë?**
110.1 Po
110.2 Jo → 109.2.1 Pse jo? ____________________________________________
99. Nuk e di / Nuk kam përgjigje

**Tani do të ju bëj disa pyetje shumë personale. Dua të ju tregoj dhe siguroj edhe një herë se këto përgjigje apo informata nuk do t'i ndajë me askënd. Gjithashtu dua që ju ta dini se nëse nuk ndiheni mirë apo rehat kurdo gjatë kohës kur ne po bisedojmë, mund të më thuani nëse keni nevojë për pushim, të tejkalojmë ndonjë pyetje, apo ta ndërprejmë diskutimin.**

111. **A është kërkuar nga ju të keni më shumë fëmijë se sa keni pasur dëshirë?**
111.1 Po
111.2 Jo → kalo tek P 113
99 Nuk di / Nuk kam përgjigje

112. (*Nëse po*) **kush ju ka bërë presion?**(*rretho të gjitha përgjigjet që përshtaten)*
112.1 Partneri/ja
112.2 Prindërit
112.3 Prindërit e burrit/gruas
112.4 Anëtarët tjerë të familjes
112.5 Të tjerët _______________ 112.6 Kombinim (shkruaje): _____________ 99. Nuk e di / Nuk kam përgjigje

113. *(Nëse kanë fëmijë)* **Si i diciplinoni fëmijët tuaj?** *(Nëse nuk ka fëmijë)* **Sipas mendimit tuaj, si duhet diciplinuar fëmijët?** (*rretho të gjitha përgjigjet që përshtaten).*
113.1 Nuk i kam lejuar të luajnë me shokët dhe shoqet (ndëshkuar)
113.2 Nuk i kam lejuar të shohin TV/laptop/tablet
113.3 Është dashur të punojnë më shumë në shtëpi
113.4 Është dashur të qëndrojë në dhomën e tyre
113.5 Është dashur të qëndrojë brenda në shtëpi
113.6 Kam ngritur zërin, i kam kërcënuar
113.7 I kam rrahur me shuplakë
113.8 I kam rrahur me shkop ose rrip
113.9 I kam këshilluar
113.10 Të tjera ________________________ 113.11 Pa ndëshkim 99. Nuk e di / Nuk kam përgjigje

**114. A diciplinohen njëjtë si vajzat, ashtu edhe djemtë?**
114.1 Po
114.2 Jo → 114.2.1 Si diciplinohen vajzat? ______________________________________
114.2.2 Si diciplinohen djemtë? ______________________________________

**115. Kur kujtoni fëmijërinë tuaj, në çfarë mënyre ju kanë ndëshkuar prindërit kur keni bërë diçka që ka qenë e papranueshme?**
115.1 Nuk më kanë lejuar të luaj me shokët dhe shoqet (ndëshkuar)
115.2 Më është dashur të punojë më shumë në shtëpi
115.3 Më është dashur të qëndrojë në dhomën time ose brenda në shtëpi
115.4 Kanë ngritur zërin
115.5 Më kanë rrahur me shuplakë
115.6 Më kanë rrahur me shkop ose rrip
115.7 Të tjera ______________________________________
115.8 Nuk më kanë ndëshkuar 99 Nuk e di / Nuk kam përgjigje

116. **Në vitin e fundit (Janar – Dhjetor 2014), sa shpesh mund të thuani se personat e familjes tuaj të kanë bërtitur, sharë apo të kanë bërë të ndihesh shumë keq?**
116.1 1 deri 5 herë
116.2 6 -11 herë
116.3 Çdo muaj
116.4 Çdo javë
116.5 Çdo ditë
116.6 Asnjëherë 0 Refuzon 99. Nuk e di / Nuk kam përgjigje

117. **Gjatë vitit të fundit (Janar – Dhjetor 2014), sa shpesh ju ka lënduar fizikisht dikush i familjes tuaj?**
117.1 1 deri 5 herë
117.2 6-11 herë
117.3 Çdo muaj
117.4 Çdo javë
117.5 Çdo ditë
117.6 Asnjëherë 0 Refuzon 99 Nuk e di / Nuk kam përgjigje

**118. A ju ka goditur ndonjëherë dikush në familjen tuaj me mjete si shkop, rrip, apo thikë?**
118.1 Po → 118.1.1 Çfarë ? ____________________ 118.1.2 Kush ? __________________
118.2 Jo 0 Refuzon të përgjigjet 09 Nuk e di / Nuk kam përgjigje

**Do të të jap një listë të gjërave që mund të ndodhin në një familje. Në këto 7 kolona, (***trego kartën dhe bëj me gisht te kolonat)***, ju lutem vendosni një X se në çfarë periudhe të jetës suaj kanë ndodhur secila prej tyre: kur ishit fëmijë, tinejxher/e, i/e rritur, (***nëse aplikohet)* **gjatë shtatzënisë, ose më shumë se një herë gjatë jetës suaj. Rretho të gjitha përgjigjet që përshtaten. Prandaj, ju lutem shkruajeni në kolonën e fundit VETËM GJATË VITIT TË FUNDIT, nëse ka ndodhur çdo ditë, javë, muaj apo 1-11 herë në vit. Kjo kartë, do të mbetet plotësisht anonime, askush nuk do të e dijë se ju e keni plotësuar, ju lutem më tregoni nëse keni pyetje apo nëse ju duhet ndihma ime.** *(Karta së bashku me lapsin i ipet të anketuarit që të plotësohet në mënyrë të pavarur. Pastaj, kur të jetë kompletuar, vendoseni atë në një zarf dhe mbylleni.)*

| ____ | 0 | 1 | 2 | 3 | 4 | 9 | Në vitin e fundit, sa shpesh ka ndodhur? |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Asnjëherë | Fëmijëri | Adoleshencë | I/e rritur | Shatëzënë | ND/NP | |
| 119. Anëtari i familjes ju ka thirrur me emra ofendues | | | | | | | 0 herë<br>1-11 herë (1)<br>Çdo muaj (2)<br>Çdo javë (3)<br>Çdo ditë (4)<br>ND/NP (99) |
| 120. Anëtari i familjes ju ka kontrolluar se ku mund të shkoni e ku jo | | | | | | | 0 herë<br>1-11 herë (1)<br>Çdo muaj (2)<br>Çdo javë (3)<br>Çdo ditë (4)<br>ND/NP (99) |
| 121. Familja juaj nuk ju ka lejuar të punoni me pagesë jashtë shtëpisë | | | | | | | 0 herë<br>1-11 herë (1)<br>Çdo muaj (2)<br>Çdo javë (3)<br>Çdo ditë (4)<br>ND/NP (99) |
| 122. Anëtari i familjes i/e cili/a i kishte të holla ka refuzuar të ju jap para kur për ju kanë qenë te domosdoshme | | | | | | | 0 herë<br>1-11 herë (1)<br>Çdo muaj (2)<br>Çdo javë (3)<br>Çdo ditë (4)<br>ND/NP (99) |
| 123. Anëtarët e familjes ju kanë shtyrë që ju t'u jipni atyre pagën tuaj mujore/asistencën sociale | | | | | | | 0 herë<br>1-11 herë (1)<br>Çdo muaj (2)<br>Çdo javë (3)<br>Çdo ditë (4)<br>ND/NP (99) |
| 124. Familja juaj nuk ju ka lejuar të shkoni tek mjeku kur ju ishit sëmurë | | | | | | | 0 herë<br>1-11 herë (1)<br>Çdo muaj (2)<br>Çdo javë (3)<br>Çdo ditë (4)<br>ND/NP (99) |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 125. Anëtari i familjes ju ka kërcënuar se do të ju lëndoj juve apo dikënd të afërm tuajin | | | | | | | 0 herë<br>1-11 herë (1)<br>Çdo muaj (2)<br>Çdo javë (3)<br>Çdo ditë (4)<br>ND/NP (99) |
| 126. Anëtari i familjes ka pasur armë dhe ju ka kërcënuar se do ta përdorë atë kundër jush | | | | | | | 0 herë<br>1-11 herë (1)<br>Çdo muaj (2)<br>Çdo javë (3)<br>Çdo ditë (4)<br>ND/NP (99) |
| 127. Anëtari i familjes ju ka rënë shuplakë | | | | | | | 0 herë<br>1-11 herë (1)<br>Çdo muaj (2)<br>Çdo javë (3)<br>Çdo ditë (4)<br>ND/NP (99) |
| 128. Anëtari i familjes ju ka rënë, grushtuar apo shkelmuar | | | | | | | 0 herë<br>1-11 herë (1)<br>Çdo muaj (2)<br>Çdo javë (3)<br>Çdo ditë (4)<br>ND/NP (99) |
| 129. Anëtari i familjes ju ka ngacmuar/prekur pjesët intime në një mënyrë në të cilën ju nuk keni dashur | | | | | | | 0 herë<br>1-11 herë (1)<br>Çdo muaj (2)<br>Çdo javë (3)<br>Çdo ditë (4)<br>ND/NP (99) |
| 130. Partneri juaj ju ka bërë presion të keni marrëdhënie seksuale kur nuk keni pasur dëshirë | | | | | | | 0 herë<br>1-11 herë (1)<br>Çdo muaj (2)<br>Çdo javë (3)<br>Çdo ditë (4)<br>ND/NP (99) |
| 131. Anëtari i familjes iu ka detyruar të bëni akte seksual të cilat ju nuk keni dëshiruar | | | | | | | 0 herë<br>1-11 herë (1)<br>Çdo muaj (2)<br>Çdo javë (3)<br>Çdo ditë (4)<br>ND/NP (99) |

Faleminderit shumë për këto informata. Tani kam edhe disa pyetje personale. Jemi pothuajse në përfundim.

132. **Cilët nga anëtarët e familjes tuaj ka ushtruar më së shpeshti dhunë ndaj jush?**

132.1 Partneri/ja (burri /gruaja) ___
132.2 Nëna ___
132.3 Babai ___
132.4 Vëllai ___
132.5 Motra ___
132.6 Vjehrra ___
132.7 Vjehrri ___
132.8 Njerku ___
132.9 Njerka ___
132.10 Kunata ___
132.11 Kunati ___
132.12 Nusja ___
132.13 Djali ___
132.14 Vajza ___
132.15 Të tjerë ________________ ___ 99 Nuk e di / Nuk kam përgjigje

**133.** (*nëse ka fëmijë në atë shtëpi)* **A ka dëgjuar ose parë ndonjëri prej fëmijëve këtë dhunë duke ndodhur në shtëpi?**

133.1 Po
133.2 Jo
133.3 Nuk më kujtohet 99 Nuk e di 0 Refuzon të përgjigjet

**134. Cilat ishin rezultatet negative të dhunës në familje që ndikuan në jetën tuaj** (*rretho të gjitha përgjigjet që përshtaten)*?

134.1 Asgjë → kalo tek III Parandalimi
134.2 Lëndime
134.3 Probleme psikologjike
134.4 Pamundësi të kujdesem për fëmijët
134.5 Pamundësi të kujdesem për vetën
134.6 Mendime për vetëvrasje
134.7 Tentim për vetëvrasje
134.8 Tjera_______________________ 0 Refuzon të përgjigjet 99 Nuk e di

**135. A keni pasur probleme shëndetsore si rezultat i dhunës në familje?**

135.1 Po
135.2 Jo → kalo tek III Parandalimi 0 Refuzon të përgjigjet

**136.** (Nëse po) **Çfarë probleme shëndetësore keni pasur si rezultat i dhunës në familje** *(rretho të gjitha përgjigjet që përshtaten)*?

136.1 Depresion
136.2 Kokë-dhëmbje
136.3 Shtypje të lartë të gjakut
136.4 Nervozë
136.5 Frikë të vazhdueshme
136.6 Shenja në trup
136.7 Gjymtyrë të thyera
136.8 Lëndime tjera
136.9 Të tjera _________________ 136.10 Të tjera ______________ Refuzon të përgjigjet

**137.** (Nëse po) **Nëse jeni lënduar si rezultat i dhunës, a jeni vizituar te mjeku? 1 2 99**

137.1 Po 136.1.1 → A mendoni se mjeku ju ka trajtuar me respekt? Po Jo ND/NP
136.1.2 → A ju ka dhënë mjeku raport mbi atë se çfarë ka ndodhur? Po Jo ND/NP

137.2 Jo 137.2.1 → Pse? _____________________________________________
137.3 Nuk jam lënduar

138. Kur keni përjetuar dhunë, a i keni treguar ndonjërit prej të poshtëshënuarve? Nëse po, kujt dhe si ju kanë trajtuar?

| # | | | Si ju kanë trajtuar? | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Po | 1<br>Shumë keq | 2<br>Keq | 3<br>Mirë | 4<br>Shumë mirë | 0<br>Refuzon |
| 138.1 | Anëtarit të familjes | | | | | | |
| 138.2 | Policisë | | | | | | |
| 138.3 | Shokut/shoqes | | | | | | |
| 138.4 | Përfaqësuesve të strehimores | | | | | | |
| 138.5 | Aktivisteve të OJQ ve | | | | | | |
| 138.6 | Punëtorit social në Qendrën për Punë Sociale | | | | | | |
| 138.7 | Mbrojtësit të Viktimave / Avokatit | | | | | | |
| 138.8 | Psikologut ose psikiatrit | | | | | | |
| 138.9 | Prokurori | | | | | | |
| 138.10 | Gjyqtarit | | | | | | |
| 138.11 | Tjetër____________ | | | | | | |
| 138.12 | Askujt | | | | | | |
| 99 | Nuk e di / Nuk kam përgjigje | | | | | | |

139. Pasi që keni përjetuar dhunë, çfarë ju ka bërë të ndiheni më mirë?
139.1 Asgjë
139.2 Të flas më shokë/shoqet
139.3 Të flas me anëtarë të familjes
139.4 Të flas me psikologun ose këshilluesin
139.5 Të punoj diçka (si të qëndisë apo të pres dru)
139.6 Të fle
139.7 Të largohem diku tjetër për një kohë
139.8 Të dënohej ushtruesi i dhunës me burg
139.9 Shkurorëzimi
139.10 Ndarja
139.11 Të tjera __________________________ 99 Nuk e di / Nuk kam përgjigje

III. Parandalimi

Tani dua të marrë mendimin tuaj lidhur me atë se si shoqëria dhe qeveria jonë mund të ndalin apo të zvogëlojnë dëmet që shkaton dhuna.

140. Sipas mendimit tuaj çfarë llojë asistence do të ishte më e nevojshme për personat të cilët vuajnë nga dhuna në familje (*rretho të gjitha përgjigjet që përshtaten)*?
140.1 Ndihma profesionale nga psikologu, psikiatri apo këshilluesi
140.2 Këshillim familjar
140.3 Vendqëndrim të sigurtë (strehimore)
140.4 Qasje pa pagesë në sistemin shëndetësor
140.5 Qasje më të madhe në arsimim
140.6 Qasje për asistencë legale pa pagesë
140.7 Asistencë për të gjetur punësim
140.8 Asistencë për të siguruar një shtëpi
140.9 Asistencë për të siguruar tokë
140.10 Asistencë për të filluar një biznes të ri
140.11 Të tjera ______________________ 99 Nuk e di / Nuk kam përgjigje

141. Çfarë mund të bëjë qeveria për të trajtuar më mirë dhunën në familje?

_______________________________________________________________________________

142. A keni ndonjë gjë tjetër për të cilën doni të më flisni apo të më tregoni?

_______________________________________________________________________________

(Hulumtuesi/ja: të plotësohet nga *intervistuesi/ja vetëm pas intervistës)*

143. Data e vizitës: __ __ / __ __ / __ __ __ __
D D M M V V V V

144. Koha / fillimi i intervistës: __ __ : ___ ___

145. Përfundimi: __ __ : __ __

**146. A është pyetësori i përfunduar?**
146.1 Po → kalo tek 148
146.2 Jo

**147.** (Nëse jo,) **cila është aryeja që pyetësori nuk është përfunduar?**
147.1 I/e intervistuari/a nuk ka pasur mundësi ta përfundojë (e.g. sëmurë, shumë i/e vjetër, dikush tjetër ishte prezent gjatë intervistës)
147.2 I/e intervistuari/ ka refuzuar të vazhdojë
147.3 I/e intervistuari/ nuk ka pasur kohë të vazhdojë
147.4 I/e intervistuari/ nuk ishte i/e gatshmëm/e të vazhdojë intervistën
147.5 Të tjera

**148. Sa ka zgjatur intervista?**
148.1 0 -30 min
148.2 31- 60 min
148.3 61- 89 min
148.4 90 -119 min
148.5 120+ min

**149. Ju lutem shkruani komentet tjera rreth intervistës, duke përfshirë edhe përshtypjen tuaj si intervistues dhe çdo shpjegim të mundshëm (si ka shkuar intervista, shpjegim për komentet e respodentit, shpjegim për gjuhën trupore të respodentit gjatë intervistës, ndonjë ngjarje relevante ilustruese, dhe pyetje të veçanta, etj)**
___________________________________

**Si intervistues, ju lutem vërtetoni me nënshkrim se pyetësori është plotësuar në bazë të njohurive më të mira që keni poseduar.**

Emri i intervistuesit/es: ____________________ Nënshrkimi i intervistuesit/es:_______________

Emri i mbikqyrësit/es: _____________________ Nënshkrimi i mbikqyrësit/es:_______________

# Shtojca 4. Lista e të intervistuarve

Personat në vijim janë nga institucionet dhe organizatat që janë intervistuar nga RrGGK në mënyrë që të informojnë këtë hulumtim. Ata/ato janë të listuar/a në rend alfabetik me emrin e parë.

| Emri dhe Mbiemri | Institucioni | Pozita | Komuna |
|---|---|---|---|
| Adnan Zahiri | Qendra Rajonale e Punësimit | Sekretarë | Gjilan |
| Aferfita Vllasaliu- Saliu | Policia e Kosovës | Police | Gjilan |
| Afijete Sada | Gjykata Themelore Komunale | Gjykatës civil | Gjakovë |
| Afrim Ahmeti | Drejtoria Rajonale e Policisë së Kosovës | Zëvendës drejtor | Prishtinë |
| Afrim Ibrahimi | UNICEF | Zyrtar për mbrojtjen e fëmijëve | Prishtinë |
| Agim Magrilaj | CSGD | Zyrtar i programeve | Prishtinë |
| Agim Pula | ZMNV | Mbrojtës i Viktimave | Gjakovë |
| Agon Myftari | Teatri Kombëtar | Drejtor Artistik | Prishtinë |
| Ahmet Panxhaj | Klinikë Private | Gjinekolog | Pejë |
| Ajmane Barani | Drejtoria Komunale për Arsim | Drejtore | Mitrovicë |
| Ajser Skenderi | Gjykata Themelore Komunale | Gjykatës | Prizren |
| Ajshe Nuhiu | OJQ Vita-Jeta | Drejtore | Prishtinë |
| Alida Miftari | Shoqata e Grave Zejtare | Drejtore | Prizren |
| Anton Nrecaj | Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal | Këshilltar ligjor | Prishtinë |
| Arben Hoti | Gjykata Themelore Komunale | Gjykatës | Ferizaj |
| Arbenita Gashi | Qendra e Emergjencës Mitrovicë | Infermiere | Mitrovicë |
| Arber Beka | Inspektorati Policor i Kosovës | Udhëheqës i marrëdhënieve me publikun | Prishtinë |
| Arber Hamiti | Qendra e Emërgjencës | Mjek | Ferizaj |
| Arbërie Nagavci | Drejtoria Komunale për Arsim | Drejtore | Prishtinë |
| Ardiana Shala | SOS fshatrat | Udhëheqëse e Kujdesit Alternativ | Prishtinë |
| Ardita Ramizi Bala | Qendra për Mirëqenien e Gruas | Drejtore | Pejë |
| Arjeta Dermaku | Qendra e Emërgjencës | Infermiere | Gjilan |
| Arlind Popaj | ZMNV | Mbrojtës i Viktimave | Prishtinë |
| Arrita Gjikolli | Shkollë e mesme | Mësimdhënëse | Pejë |
| Armend Rugova | Ministria e Administratës Publike | Koordinator i departamentit për të drejtat e njeriut | Prishtinë |
| Arsim Gërxhaliu | Departamenti i Forenzikës | Drejtor | Prishtinë |
| Avni Zahiti | Policia Rajonale e Kosovës | Zëdhënës | Mitrovicë |
| Basri Kastrati | ZMNV | Menaxher | Prishtinë |
| Basri Komoni | Drejtoria Komunale për Shëndet dhe Mirëqenie Sociale | Drejtor | Gjakovë |
| Bekim Mehana | Policia e Kosovës | Polic | Prishtinë |
| Berenika Gashi | UNDP WSSI (më parë) | | Prishtinë |
| Berlinda Berisha | Policia e Kosovës | NjHDhF | Gjakovë |
| Besa Beqiri Zejnullahu | Shkollë e mesme | Mësues | Ferizaj |
| Besa Veseli | Zyra për Barazi Gjinore | Zyrtare | Mitrovicë |
| Besim Avdimetaj | Drejtoria e Arsimit | Drejtor | Pejë |
| Brikena Sylejmani | UNDP | Këshilltare për çështje gjinore | Prishtinë |
| Bukurije Leti | Medika BL | Drejtore | Prishtinë |
| Burhan Maxhuni | ZMNV | Mbrojtës i Viktimave | Mitrovicë |
| Demë Laha | Policia e Kosovës | NjHDhF | Gjakovë |
| Diana Qarkaxhija | Drejtoria e Arsimit | Drejtore | Gjakovë |

| Emri dhe Mbiemri | Institucioni | Pozita | Komuna |
|---|---|---|---|
| Drita Delolli | Policia e Kosovës | Police | Ferizaj |
| Drita Klaiqi | Zyra për Barazi Gjinore | Zyrtare | Gjilan |
| Drita Krasniqi | OAZA | Menaxhere | Prizren |
| Drita Vukshinaj | Shoqata e Grave me Aftësi të Kufizuara | Drejtore | Prizren |
| Driton Marevci | Policia e Kosovës | Polic | Ferizaj |
| Dusica Djinovic | Qendra për Punë Sociale | Punëtore sociale | Mitrovicë e Veriut |
| Edi Gusia | Agjencia për Barazi Gjinore | Udhëheqëse e Divizionit për Raportim dhe Monitorim | Prishtinë |
| Elhame Berisha | Drejtoria e Mirëqenies Sociale | Drejtore | Prizren |
| Elida Berisha | Policia e Kosovës | Police | Pejë |
| Elinda Elshani | Qendra e Emergjencës | Infermiere | Prizren |
| Elmina Mahmuti | Policia Rajonale e Kosovës | Drejtor | Gjilan |
| Elvane Shehu | Qendra për Mirëqenie Sociale | Punëtor Social | Gjakovë |
| Enes Mehmeti | Gjykata Themelore Komunale | Gjykatës | Ferizaj |
| Engjëllushe Susuri | Shkollë e mesme | Mësuese | Prizren |
| Enver Murtezi | Qendra e Emergjencës | Mjek | Gjilan |
| Ergita Zajmi | Shkollë e mesme | Mësuese | Pejë |
| Eroll Raskova | Drejtoria e Financave | Zyrtar financiar | Prishtinë |
| Fadil Gashi | Policia e Kosovës | Polic | Pejë |
| Fahri Drevinaj | Psikiatria Forenzike | Psikiatër | Prishtinë |
| Fahrie Qoraj | Ministria e Zhvillimit Ekonomik | ZBGj | Prishtinë |
| Fakete Kuka | Ministria e Administrimit të Pushtetit të Lokal | ZBGj | Prishtinë |
| Fakete Elezi | Qendra Rajonale e Punësimit | Këshilltare për punësim | Gjakovë |
| Fatime Jasiqi | Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë | ZBGj | Prishtinë |
| Fatmir Baloku | Gjykata Themelore Komunale | Gjykatës Civil | Pejë |
| Fatmire Hysenaj | Policia e Kosovës | Polic | Prishtinë |
| Faton Ademi | Gjykata Themelore Komunale | Gjykatës | Mitrovicë |
| Fazile Bungu | OJQ HendiFer | Drejtore | Ferizaj |
| Fetije Bajrami | Gjykata Themelore Komunale | Prokurore | Vushtrri |
| Fetije Mehmeti | Shoqata Gruaja e Bashkuara | Drejtore | Prizren |
| Flora Macula | UN Women | Drejtore | Prishtinë |
| Flutura Zena | Agjencia për Ndihmë Juridike Falas | Asistente/ Këshilltare Ligjore | Prishtinë |
| Gani Kamberi | Policia e Kosovës | NjHDhF | Mitrovica |
| Gezim Bekqeli | Qendra e Aftësimit Profesional | Koordinator dhe Trajner | Prishtinë |
| Gëzim Pozhegu | Gjykata Themelore Komunale | Gjykatës | Gjakovë |
| Hajrije Haxhiaj | Drejtoria e Financave | Drejtore | Pejë |
| Hake Gegaj | Qendra Rajonale për Punësim | Këshilltare për Punësim | Prizren |
| Halil Zahiri | Gjykata Themelore Komunale | Gjykatës | Gjilan |
| Hamdije Selmani | Qendra për Punë Sociale | Punëtor Social | Ferizaj |
| Hamez Berisha | Qendra e Emergjencës | Mjek | Mitrovicë |
| Hektor Elezi | Klinikë Private | Mjek | Prizren |
| Hilmi Jashari | Instituti i Avokatit të Popullit | Avokat i popullit | Prishtinë |
| Ibrahim Krusha | OJQ NEVO Concept | Koordinator | Prizren |
| Ibrahim Musliu | Drejtoria për Mirëqenie Sociale | Drejtor | Ferizaj |
| Ibrahim Terstena | ZMNV | Mbrojtës i Viktimave | Ferizaj |
| Ilmi Limoni | Drejtoria e Financave | Zyrtar financiar | Gjilan |
| Imer Beka | Prokuroria Themelore | Kryetar i Prokurorisë | Prishtinë |
| Indira Elshani | Caritas Kosova | Koordinatore | Prizren |
| Ismet Rrahmani | Prokuroria Themelore | Prokurorë | Ferizaj |
| Jeta Rexha | Shkollë e mesme | Mësimdhënëse e psikologjisë | Gjakovë |

| Emri dhe Mbiemri | Institucioni | Pozita | Komuna |
|---|---|---|---|
| Jubilea Kabashi | Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve | Drejtore | Prizren |
| Kada Bunjaku | Gjykata Themelore Komunale | Kryetare e gjykatës | Vushtrri |
| Kadri Gashi | Iniciativa "Bonu Burrë" | Koordinator i Projektit | Prishtinë |
| Kaltrina Kelmendi | Departamenti i Psikologjisë, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" | Asistente Profesoreshë | Prishtinë |
| Kastriot Jashari | KAPS- Departamenti për Trajnime dhe Përkrahje Arsimore | Drejtor | Vushtrri |
| Kristë Gjokaj | Policia Rajonale e Kosovës | Drejtor | Gjakovë |
| Leonora Kelmendi; | Policia e Kosovës | NjHDhF | Mitrovicë |
| Linda Sanaja | UN Women | Koordinatore e Projektit | Prishtinë |
| Lindita Jashari | Policia e Kosovës | Police | Ferizaj |
| Liridon Shala | Klinika Private Pediatrike | Asistent i mjekut | Prizren |
| Liridona Haziri Mustafa | ZMNV | Mbrojtës i Viktimave | Gjilan |
| Lirije Syla | Drejtoria e Financave | Zyrtare financiare | Ferizaj |
| Lulejete Prekazi | Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit | Koordinatore e Projektit | Prishtinë |
| Luljeta Sallahu | Shkollë e mesme | Mësimdhënëse | Ferizaj |
| Lumnije Shllaku | Zyra për Barazi Gjinore | ZBGj | Gjakovë |
| Lumturije Ibra | Qendra për Mirëqenien e Gruas | Koordinatore | Pejë |
| Majlinda Gojani | Shkollë e mesme | Mësimdhënëse | Gjakovë |
| Mehat Berisha | Qendra për Punë Sociale | Drejtor | Gjilan |
| Mehreme Hoxha | Prokuroria Themelore | Prokurore | Prizren |
